

ÇËSHTJA ÇAME: VËSHTRIM HISTORIKO-JURIDIK (1913-1939)

Blerina Sadik

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
(Shkenca Juridike), me profil (E Drejtë Ndërkombëtare), për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ferit Duka

Numri i fjalëve: 51,236

Tiranë, Prill 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull: **“Çështja Çame: Vështrim Historiko-Juridik (1913-1939)”**, është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar më parë. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Emri mbiemri dhe nënshkrimi

ABSTRAKTI

Në harkun kohor 1913-1939, fati i Çamërisë dhe i çamëve ishte në funksion të ndërtimit të kombit grek. Historiografia shqiptare dhe ajo greke kanë një përplasje të theksuar në trajtimin e kësaj çështje. E dyta i justifikon dhe i anashkalon shpeshherë shkeljet që shteti grek bëri ndaj të drejtave themelore të çamëve, ndërsa e para vë theksin tek masakrat që qarqet greke ushtruan mbi këtë popullsi. Teza e studiuesve shqiptarë mund të duket hiperbolike, por s'është veçse një e vërtetë, pasi Greqia synoi homogjenizimin e krahinës së Çamërisë që prej aneksimit të saj më 1913 duke zbatuar politika të ashpra të spastrimit etnik mbi popullsinë e këtij territori. Për këto arsye, ky studim synon të analizojë ligjshmërinë e qëndrimeve zyrtare të përfaqësuesve të shtetit grek, si dhe të autoriteteve të Lidhjes së Kombeve, pasi këta ishin aktorët kryesorë politikë të cilët përcaktuan fatin e shqiptarëve të Çamërisë. Greqia vuri në shërbim të saj legjislacionin kombëtar, i cili qëndronte në themel të këtij spastrimi etnik. Gjithashtu, synimet e saj i ndihmoi edhe brishtësia e së Drejtës Ndërkombëtare, së bashku me zhvillimet e tjera siç ishte "Krizja e Azisë së Vogël". Në funksion të procesit të shkëmbimit të popullsive greko-turke, pjesa dërrmuese e çamëve mori karakteristikat e "pa shtetësisë", pasi të drejtat themelore të tyre "u ngrinë" deri në vërtetimin e origjinës përkatëse. Në vitet '30 politikat e spastrimit etnik ndaj çamëve vijuan. Për shkak të gjendjes së rrënuar nën qeverisjen greke për rreth tridhjetë vite, popullsia e krahinës u zvogëlua ndjeshëm. Spastrimi etnik i Çamërisë u realizua në një masë të konsiderueshme gjatë harkut kohor 1913-1939.

Fjalët kyçe: Çështja Çame, të Drejtat Themelore të Njeriut, Qeveria Greke, Qeveria Shqiptare, Lidhja e Kombeve

ABSTRACT

During the timeframe 1913-1939, Chameria and chams' destiny depended on the Greek nation-building. The Albanian and Greek historiography have contrasted views in regard to this issue. The latter often justifies and neglects the denials that the greek state excersized on the basic rights of this population, while the former emphasizes the massacres that greeks made on this population. The thesis of the Albanian researchers might seem hyperbolic, but it is simply the truth, because Greece sought the homogenization of Chameria region since its annexation in 1913 through the implementation of harsh policies of ethnic cleansing on the population of this territory. For this reason, this study seeks to analize the legitimacy of the attitudes of the greek state and League of Nations' representatives, since they were the main political actors who determined the fate of the Albanians of Chameria. Greece used its legislation for the implementation of this ethnic cleansing. Also, its objectives were helped by the fragility of the existing International Law, and other circumstances like the "Asia Minor Crisis". During the exchange of the greco-turkish populations, the majority of chams became "stateless", since their Fundamental Rights were "frozen" up to the confirmation of the respective origin. Due to the ravaged situation under the Greek government for almost thirty years, the population of this region was notably reduced. The ethnic cleansing of Chameria was achieved considerably within the timeframe 1913-1939.

Key Words: Cham Issue, The Fundamental Rights of Individuals, Greek Government, Albanian Government, League of Nations.

DEDIKIMI

Familjes sime, dhe

Gjyshërve të mi, të shpërngulur forcërisht nga vendlindja e tyre në vitin 1944 për shkak të genocidit grek ndaj çamëve.

...Nana Momës, e cila më fliste shpesh herë me nostalgji e dashuri të madhe për Çamërinë.

FALENDERIME

Për realizimin e këtij punimi dua të falenderoj përzemërsisht:

Udhëheqësin shkencor Profesor Ferit Dukën dhe Zonjën e tij, Profesoreshë Valentina Dukën, të cilët më kanë ndihmuar dhe mbështetur pa u kursyer në çdo fazë të studimeve të mia doktorale, duke më dhënë në këtë mënyrë një burim të fortë motivacioni për përfundimin e këtij rrugëtimi studimor. Në veçanti Profesor Feritin, i cili me përkushtim e profesionalizëm ka ndjekur punimin tim doktoral.

Profesor Hajredin Isufin, prej të cilit kam patur fatin të mësoj shumë për Çamërinë.

Familjen time për mbështetjen që më ka dhënë në çdo hap të jetës, ashtu sikurse edhe gjatë kësaj periudhe, veçanërisht mamin dhe babin.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Kreu I: Hyrje	1
1.1 Objekti i Studimit	3
1.2 Qëllimi dhe Rëndësia e Studimit	3
1.3 Pyetjet Kërkimore dhe Hipoteza.	5
1.4 Rishikimi i Literaturës	7
1.5 Metodologjia dhe Metodat e Studimit	13
1.6 Kufizimet e Punimit	14
1.7 Pëmbajtja dhe Struktura e Punimit	16
Kreu II: Drejt Spastrimit Etnik të Çamërisë: Legjislacioni Ndërkombëtar dhe Koncepti i Etnisë (1913-1939)	20
2.1 Të Drejtat Themelore të Njeriut e të Minoriteteve- Greqia në Rastin e Çamëve	20
2.2 Shkëmbimi i Popullsive Greko-Turke dhe Shpërngulja e Detyruar	30
2.3 Koncepti i Etnisë	33
Kreu III: Aneksimi i Çamërisë dhe Zhvillimet 1913-1920	37
3.1 Krahina e Çamërisë dhe Megali Idea	37
3.2 Qëndrimet e Qarqeve Greke pas Aneksimit të Çamërisë	40
3.3 Traktati i Athinës dhe Nismat për Homogjenizimin e Territoreve Greke dhe Turke	46
3.4 Pushtimi Italian në Çamëri (1917)	50
3.5 Çështja Çame dhe Konferenca e Paqes në Paris 1919	54
Kreu IV: Çamët në Shkëmbimin e Popullsive midis Greqisë e Turqisë	67
4.1 Qëndrimet dhe Pikëpamjet Greko-Turke për Shkëmbimin e Popullsive dhe Përfshirja e Çamëve në këtë Proces	67

4.2 Përcaktimi i Popullsisë me Origjinë Shqiptare	77
4.3 Punimet e Komisionit Mikst	88
4.4 Qeverisja Greke në Çamëri gjatë Shkëmbimit të Popullsive Greko-Turke	107
4.5 Pasojat e Shkëmbimit të Popullsive Greko-Turke mbi Pronat e Çamëve	127
4.6 Disa Vlerësime Demografike për Krahinën e Çamërisë në Vështrim Krahësues	136
Kreu V: Të Drejtat Themelore të Njeriut në Çamëri gjatë Viteve '30	139
5.1 Status Quo-ja e të Drejtave Themelore të Njeriut	139
5.2 E Drejta e Shkollimit në Gjuhën Shqipe	145
5.3 E Drejta e Pronës gjatë Viteve '30	154
5.4 Propaganda për Emigrimin e Çamëve	162
Kreu VI: Qeveria Shqiptare dhe Lidhja e Kombeve për Çështjen Çame	167
6.1 Roli i Qeverisë Shqiptare	167
6.2 Mobilizimi i Diplomacisë së Tiranës në Mbrojtje të të Drejtave të Popullsisë Çame	176
6.3 Lidhja e Kombeve dhe Përballjet Shqiptaro-Greke	188
Kreu VII: Konkluzione	195
Rekomandime	199
Bibliografia	201

Kreu I: Hyrje

Çamëria është një krahinë e cila gjendet në jugperëndim të gadishullit Balkanik. Në ditët e sotme, ajo njihet zyrtarisht me emrin Thesproti, ashtu siç njihet dikur në antikitet. Çamëria dhe Thesprotia aktuale përfshijnë të njëjtat njësi administrative si Margëlliçi, Arpica, Filati, Parga, Igumenica, Paramithia etj, por sipërfaqja tërësore e tyre ndryshon. Megjithatë, në këtë punim do t'i referohem Çamërisë së aneksuar nga Greqia në vitin 1913, e cila kufizohet në veri me lumin e Pavllës, në jug me gjirin e Artës, në lindje me malet e Pindit e në perëndim me detin Jon.¹ Sipërfaqja e këtij territori është rreth 2550 km².² Teza e prejardhjes së emrit Çamëri lidhet me lumin Kalama ose *Thyamis*.³

Përpara nisjes së Luftërësive Ballkanike, kjo krahinë ishte e banuar nga shqiptarët në pjesën dërrmuese të saj.⁴ Pas aneksimit të këtij territori në vitin 1913, nisi të krijohet zyrtarisht

¹ Për më tepër shih: Isufi 2006: 1; Akademia e Shkencave e Shqipërisë 2007: 496; Mihalopoulos 1993: 19; Baltisiotis 2011: 2; Meta 2007: 5.

² Meta 2007: 7; Minga 2006: 12.

³ Çabej cituar në Meta 2007: 5; Fallmerayer 2003: 94; Leake 1814: 257; Kola 2010: 235, 236; Galanti 1901: 38;

⁴ Raça 2009: 253; Destani dhe Elsie 2013: xxxiv; Destani dhe Tomes 2012: 117; Ekzistojnë gjithashtu edhe një sërë të dhënash të cilat tregojnë vijimësinë e faktorit Shqiptar në Çamëri dhe Epir që prej antikitetit. Për më tepër shih: Isufi 2006: 1-10; Frashëri 2015: 15-195; Xhufi 2006: 27-29; Popullsia e kazave të Margëlliçit e të Mazrekut regjistrohej me emra shqiptarë si Gjin, Gjoni, Lekë në burimet osmane të shek. XVI etj, shih Duka 2009: 201-207; Leake shkruante në fillim të shek. XIX se “skaji më jugor i Shqipërisë është Preveza, dhe Suli është ekstremi tjetër i këtij kufiri”, shih: Leake: 256; Gjithashtu, historiani italian Galanti njeh si kufirin jugor të Shqipërisë Prevezën, shih: Galanti 1901: 11; Shqipëria e Jugut njihet si Epir, shih Cora 1875: 1-2; Brun dhe Balbi 1842: 579-599, si dhe faqen 611, në të cilën përmenden disa nga qendrat kryesore Çamërisë (Parga, Filati, Preveza, Paramithia etj) si pjesë përbërëse të Shqipërisë së Jugut.; Historiani grek Aravantinos shkruante se “...*banorët çamë të Parakallamit, pranë lumit Kalamas, e njihnin dhe flisnin disa gjuhën greke, ndërsa në krahinën e Dagit, e cila përfshinte Paramithinë dhe Margëlliçin, vetëm pak mund të shpreheshin në Greqisht...*”. Shih: Aravantinos 1857: 168; Vetëm disa vite përpara veprës së Aravantinos, Foscolo deklaronte se gjuha e folur në Epir është arnautishtja ose shqipja. Shih: Petrotta 2013: 48; Për më tepër, historiani italian Galanti përmend praninë e shtatë konsullatave greke në Epir gjatë kësaj periudhe, shih, Galanti 1901: 77; Gjithashtu, në një shkresë që Spiridon Trikupi* Sekretari i Shtetit Grek (Kryeministri) në Pallatin Mbretëror dhe të Punëve të Jashtme të Greqisë, nga Nafplio (kryeqyteti i Greqisë deri më 1834), i dërgonte të përzgjedhurit për postin e konsullit grek në Epir dhe Shqipëri, ai përmend si rezidencë të kësaj konsullate Prevezën, duke njohur në këte mënyrë sovranitetin e Perandorisë Osmane mbi Provincat e Saj Epiri dhe Shqipëria**. Në këtë shkresë nuk dallohen tone nacionaliste, përveç udhëzimeve diplomatike dhe shprehjes së interesit për lehtësimin e lundrimit të Greqisë nga Portet e Epirit, i cili sidoqoftë, më vonë hyri bindshëm në planet gjeostrategjike të Greqisë.*** Shih: Arkivi Historik i Ministrisë së Jashtme të Greqisë (Ιστορικό Αρχείο Υπουργείου Εξωτερικών, më tej

një çështje jo vetëm e të Drejtave Themelore të Njeriut, por edhe një çështje e të drejtave të minoritetit çam brenda kufijve të shtetit të ri grek.

Mohimi i këtyre të drejtave kërkon një trajtim ndër-disiplinor, historik dhe juridik, i cili do të shtrihet deri në vitin 1939, pasi nisja e Luftës së Dytë Botërore dhe e Luftës Italo-Greke nuk la më hapësirë për trajtimin e tyre në kuadrin e legjislacionit ndërkombëtar e kombëtar.

Shtet formimi dhe shtet ndërtimi i Greqisë u shoqërua me mohimin e të Drejtave Themelore të Njeriut dhe të minoriteteve. Menjëherë pas aneksimit, popullsia e Çamërisë i vuajti këto pasoja në mënyrë të drejtpërdrejtë për shkak të politikave shtrënguese të cilat kishin për qëllim spastrimin etnik të këtij territori. Këto politika shtriheshin që nga mungesa e dialogut midis autoriteteve greke dhe çamëve e deri në keqtrajtime fizike të drejtpërdrejta të ushtruara ndaj kësaj popullsie prej këtyre autoriteteve, në një kohë kur Greqia kishte marrë përsipër detyrimin ligjor ndërkombëtar për respektimin e të Drejtave Themelore të Njeriut.

Vështirësia për asimilimin e çamëve, dhe nevoja për spastrimin etnik të tyre, buronte për shkak të përkatësisë fetare myslimane të pjesës dërmuese të kësaj popullsie.⁵ Ndërsa të krishterët e kishin më të lehtë identifikimin me vlerat e shoqërisë greke, për shkak të fesë

IAYE.) Zyra Qëndrore /1833/36.7/ *Konsullatat e Greqisë në Azinë e Vogël, Epir dhe Shqipëri, Kretë dhe Maqedoni*. [Udhëzimet që Spiridon Trikupi i dërgonte të përzgjedhurit të Mbretit Oto për të kryer funksionet e konsullit në Prevezë] Shkresa nr. 1036. (15/27 Shtator 1883).

*(në disa vepra të karakterit historik mbiemri i tij shkruhet me prapashtesën –s në fund, çka është e zakonshme për emrat e përveçëm grekë; në këtë shkresë ai e nënshkruan mbiemrin e tij Trikupi)

***(njohja e sovranitetit të Perandorisë Osmane nga ana e Greqisë ishte një akt formal për të vijuar më tej me interesat e saj politike dhe ekonomike)*

****(historiani Galanti shkruan për një betejë disa mujore në vitin 1847 gjatë së cilës çamët u ngritën kundër Perandorisë Osmane në ndihmë të Greqisë, por ata nuk morën prej saj ndihmat që u kishte premtuar. Shih: Galanti 1901: 219; Sidoqoftë Çamëria, vijoi të mbetej në synimet ekspansioniste të shtetit Grek, të cilat ajo i arriti zyrtarisht pas Konferencës së Londrës (1913))*

⁵ Për Islamizimin e Krahinës shih: Isufi 2006: 10-26.

ortodokse. Për këtë arsye, politikat e spastrimit etnik u zbatuan vetëm ndaj çamëve myslimanë.

1.1. Objekti i Studimit

Ky punim do të analizojë kuadrin e të Drejtave Themelore të popullsisë shqiptare të Çamërisë gjatë harkut kohor 1913-1939. Studimi do të fokusohet kryesisht në të drejtën e jetës, të drejtën e pronës, të drejtën e arsimimit në gjuhën amtare, dhe të përdorimit të kësaj gjuhe në jetën e përditshme, të drejtën e shtetësisë, të drejtën e votës. Gjithashtu, do të trajtohen etapat kryesore të spastrimit etnik që Greqia zbatoi mbi çamët e fesë myslimane, me anë të shkeljes në mënyrë të vazhdueshme të ligjeve municipale dhe të së Drejtës Ndërkombëtare. Për më tepër, do të analizohet ndikimi i së Drejtës Ndërkombëtare dhe i Lidhjes së Kombeve në Çështjen Çame gjatë kësaj periudhe. Do të shihet gjithashtu edhe roli i shtetit Shqiptar si aktori i vetëm politik që mund të mbronte këtë çështje në arenën ndërkombëtare, si rrjedhojë e detyrimit moral dhe juridik që kishte për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes së çamëve, të cilët ishin banorë të njërës prej krahinave shqiptare të shkëputura padrejtësisht nga territori shqiptar si pasojë e vendimeve të Konferencës së Londrës (1913).

1.2. Qëllimi dhe Rëndësia e Studimit

Ky studim ka për qëllim të dokumentojë zhvillimet dramatike në Çamëri gjatë periudhës 1913-1939, kohë gjatë së cilës autoritetet qendrore dhe vendore greke mohuan dhe shkelën sistematikisht të Drejtat Themelore të çamëve si individë, e aq më tepër si minoritet, duke injoruar kështu marrëveshjet ndërkombëtare si dhe ligjet greke.

Çështja Çame është një çështje aktuale dhe e pazgjidhur në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë. Që prej vitit 1944⁶ e deri në ditët e sotme, kjo çështje është shtruar në diskutimet politike të këtyre dy vendeve. Megjithatë, ekzistenca e këtij problemi vijon të refuzohet tërësisht nga pala greke. Por, çamëve u është mohuar në mënyrë sistematike gëzimi i një sërë të Drejtave Themelore si e drejta e jetës, e pronës, e arsimimit, e përdorimit të gjuhës amtare në vendet publike etj⁷, të cilat do të analizohen në këtë punim me anë të një sërë burimesh arkivore shqiptare, greke, italiane, britanike, dhe të Lidhjes së Kombeve, në mënyrë që aspektet historike dhe juridike të Çështjes Çame të dokumentohen sa më mire. Madje, me qëllim që të dalë në pah më qartë pikëpamja e autoriteteve greke të kohës, janë shfrytëzuar edhe burime arkivore nga Ministria e Punëve të Jashtme të Greqisë.

Në mungesë të analizave dhe trajtimit të duhur shkencor të rrethanave historike dhe juridike të Çamërisë në këtë periudhë (1913-1939) ka qenë më e lehtë që të justifikohet politika e qarqeve greke për dëbimin përfundimtar të tyre⁸. Nëpërmjet këtij studimi, ne përpiqemi të vërtetojmë shkencërisht se një qëndrim i tillë nuk ka asnjë bazë juridike, duke qenë se çamët u detyruan të shpërnguleshin kolektivisht, dhe në vijim atyre iu atribua fajësia kolektive, e cila nuk qëndron në parimet themelore të së drejtës.

⁶ Në këtë vit u ushtrua genocidi ndaj kësaj popullsie. Ky genocid kulmoi me masarken e muajit Mars 1945, në Filat pas së cilës asnjë çam nuk guxoi të kthehej më në tokat e veta në Çamëri.

⁷ Në vitin 1923, në vijim të shkëmbimit të popullsive greko-turke, popullsia myslimane e Çamërisë mori statusin e “pa shtetësisë”, pasi asaj iu ndalua çdo e drejtë themelore në funksion të zbatimit të këtij procesi deri në momentin e vërtetimit të kombësisë së secilit prej tyre. Ky vërtetim ishte produkt i një sërë makinacioneve të qarqeve greke, të cilat synonin spastrimin etnik të kësaj krahine. Për më tepër shih në këtë punim “*Kreu IV: Çamët në Shkëmbimin e Popullsive midis Greqisë e Turqisë*”.

⁸ Dëshmi të aktit final të spastrimit etnik të krahinës së Çamërisë gjenden në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej AMPJ), Dosja 59/2, f. 4-6, Viti 1945. Përfaqësues të Çamërisë në Emigrim. *Promemorje Misionit të Aleatëve pranë Shtabit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të Shqipërisë*”.

1.3. Pyetjet Kërkimore dhe Hipoteza

Në historiografinë e huaj, shqiptare e më pak në atë greke, vihet re qëndrimi i ashpër i Greqisë ndaj minoriteteve në këtë periudhë kohore (1913-1939). Duke analizuar burimet parësore e dytësore të shfrytëzuara për këtë punim lindin një sërë pyetjesh kërkimore të cilat na ndihmojnë për të vërtetuar shtrirjen e këtij qëndrimi në lidhje me popullsinë shqiptare të Çamërisë, dhe për të kuptuar arsyet përkatëse që çuan në krijimin e një gjendje të përkeqësuar të të Drejtave Themelore të Njeriut e të Minoritetit në këtë krahinë. Këto pyetje kërkimore janë:

- *Cili ishte qëndrimi i shtetit grek ndaj konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të Drejtave Themelore të Njeriut dhe të minoriteteve? Si ndikoi ky qëndrim në Çamëri?*
- *Cili ishte roli i Traktatit të Athinës (1913) dhe i Konventës për Shkëmbimin e Popullsive Greko-Turke (1923)? A ishin çamët subjekte të këtyre marrëveshjeve? Si ndikoi kriteri fetar në zbatimin e të tilla marrëveshjeve?*
- *A u zbatua Traktati i Minoriteteve për Greqinë (1920) ndaj çamëve?*
- *Ç'rol luajtën autoritetet vendore në Çamëri?*
- *Ç'qëndrim mbajti Lidhja e Kombeve ndaj Çështjes Çame?*
- *Ç'vend zinte Çështja Çame në politikën shqiptare në këtë periudhë? A do të kishte ndikuar rrjedhën e kësaj çështje zbatimi i parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet shqiptaro-greke?*

Në vijim të pyetjeve kërkimore, një element tjetër i rëndësishëm në një punim doktoral është hipoteza. Ky studim do të paraqitet me tre hipoteza të cilat lidhen me çështjen kryesore.

Hipoteza e parë e punimit është: ***Pas aneksimit të Çamërisë më 1913, politika zyrtare greke ka synuar spastrimin etnik të këtij rajoni si dhe mohimin sistematik të të drejtave të popullsisë çame.*** Ky synim lidhet me veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve të shtetit grek gjatë kësaj periudhe, të cilat pasqyroheshin në gjendjen e rënduar në terren.

Hipoteza e dytë është: ***Mungesa e mekanizmave të duhur të së Drejtës Ndërkombëtare për mbrojtjen e të Drejtave Themelore të Njeriut dhe të minoritetit gjatë harkut kohor (1913-1939) ka ndikuar në spastrimin etnik të krahinës së Çamërisë më tepër sesa interesi kombëtar i Greqisë për homogjenizimin e këtij territori.*** Pasi Lidhja e Kombeve nuk kryente hetime në terren për petitionet e paraqitura në lidhje me çështjet e minoriteteve, të cilat shpeshherë ishin më tepër çështje të të Drejtave të Njeriut. Të tilla verifikime realizoheshin në sajë të vullnetit individual të autoriteteve të mandatuara prej saj për këto qëllime. Rrjedhimisht, për arsye të ndryshme, shpesh herë verifikimet në terren ishin sipërfaqësore ose nuk realizoheshin aspak, duke e lënë gjendjen e minoriteteve të pandryshuar.

Hipoteza e tretë: ***Mungesa e zbatimit të reciprocitetit në marrëdhëniet shqiptaro-greke, ndikoi në përkeqësimin e gjendjes së popullsisë çame në Greqi.*** Ndonëse disa prej aktorëve ndërkombëtarë të kohës i frikësoheshin zbatimit të reciprocitetit midis këtyre dy vendeve, shteti shqiptar nuk e shfaqti asnjëherë vullnetin e duhur për zbatimin e këtij parimi, i cili ndoshta do të kishte ndikuar në rrjedhën e Çështjes Çame.

1.4 Rishikimi i Literaturës

Për këtë punim janë përdorur një sërë burimesh parësore dhe dytësore. Janë shfrytëzuar burime të Arkivit Qëndror të Shtetit Shqiptar, Arkivit të Ministrisë së Punëve Jashtme të Shqipërisë, Arkivit Historik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë, Arkivit të Lidhjes së Kombeve, Arkivit të Parlamentit Grek dhe të Bibiliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Për sa i përket akteve normative, në këtë punim do të analizohen një sërë konventash ndërkombëtare të ratifikuara nga Greqia, duke u fokusuar kryesisht në marrëveshjet zyrtare të saj me shtetin Turk. Për më tepër, do të shihen disa nga ligjet kryesore të reformës agrare. Po ashtu, do të citohen akte të tjera juridike të përmendura në studimet e autorëve grekë, në pamundësi për t'i gjetur ato, në mënyrë që të plotësohet kuadri ligjor ekzistues i cili jo rrallë herë ishte në kundërshtim me marrëveshjet ndërkombëtare.

Në punim do të paraqiten edhe disa statistika të hartuara nga autoritetet përkatëse të shtetit grek, të cilat japin një informacion të vlefshëm për zhvillimet kryesore demografike të kohës siç ishte ardhja e refugjatëve dhe vendosja e tyre në krahinën e Çamërisë, popullsia e së cilës ishte e detyruar të përballej me këtë fenomen, përtej vështirësive të tjera që haste në këtë periudhë.

Ndërkohë, dokumentacioni arkivor shqiptar jep një pasqyrë më të gjerë të Çështjes Çame, dhe të përpjekjeve të shtetit shqiptar e të patriotëve për këtë problem. Në vitin 1913, kur Çamëria u aneksua nga shteti Grek ishte një krahinë e banuar me një popullsi autoktone shqiptare në pjesën dërrmuese të saj. Për këtë jepen dëshmi të shumta nga personalitete të kohës. Ali Dino (7 Qershor 1924), ish-deputeti çam i Parlamentit Grek, i paraqiti kryetarit të Komisionit Mikst një sërë argumentesh mbi autoktoninë shqiptare të banorëve të krahinës së

Çamërisë, në një kohë kur çamët ishin të detyruar për shkak të dhunës që ushtrohej mbi ta që të shpërnguleshin masivisht nga trojet e tyre si pasojë e Konventës për Shkëmbimin e Popullsive Greko-Turke (30 Janar 1923). Në këtë dokument ai përmend autorët si: Leake, Pouqueville, Smart, Ibrahim Manzour Effendi, Boue, Poujade, Gervinius, Finlay, Bopp, Brun, Reclus, të cilët pohonin në trajta të përgjithshme praninë e popullsisë shqiptare në pjesën dërrmuese të krahinës së Epirit, ashtu sikurse dhe në Çamëri.⁹

Autori Shkëlzen Raça, duke cituar disa statistika osmane në prag të Luftërave Balkanike, pohon se sipas këtyre të dhënave në Çamëri rreth 60% e popullsisë ishte shqiptare.¹⁰ Në disa qendra të kësaj krahine popullsia ishte tërësisht shqiptare, pa praninë e asnjë banori grek, si dhe në zona të tjera raporti i pranisë së shqiptarëve në krahasim me praninë e grekëve ishte disa herë më i madh.¹¹

Shkelja e të drejtave themelore të çamëve që prej aneksimit të krahinës së tyre nga Greqia, pasqyrohet me anë të një sërë dokumentash italiane në veprën e Giovanni Antonio Colonna di Cesaro (1922). Autori jep dëshmi mbi keqtrajtimet që autoritetet greke kryenin ndaj çamëve, dhe nga ana tjetër shkruan mbi reagimin e tyre për praninë italiane në krahinë, e cila ishte pozitive, pasi këto autoritete i dhanë atyre të drejtat dhe liritë themelore të cilat iu ishin mohuar që prej vitit 1913.

Botimi i serive "Dokumentet Diplomatike Italiane (1980)" mbështet të njëjtën pasqyrë të fakteve të kësaj periudhe, duke vënë theksin në keqtrajtimet fizike të rënda që bëheshin ndaj kësaj popullsie nga autoritetet greke. Largimi i pranisë ushtarake italiane shihej nga

⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 79, Viti 1924, f. 273-280. *Raport mbi Kriteret Bazë për Përcaktimin e Kombësisë së Banorëve të Çamërisë [sugjeruar nga Ali Dino].* (7 qershor 1924)

¹⁰ Raça 2009: 235.

¹¹ Ibidem.

çamët si një lloj braktisje, çka tregon se gjendja e të drejtave themelore të tyre nuk ishte aspak premtuese për një të ardhme të mirë nën qeverisjen greke.

Ndërkohë, Greqia nuk e kishte braktisur endrrën e Megali Idesë në prag të nisjes së punimeve të Konferencës së Paqes në Paris (1919), gjatë së cilës ajo kërkoi me ngulm aneksimin e Epirit të Veriut. Keqardhjen për mosarritjen e këtij synim e gjejmë të shprehur dhe në arkivat e Lidhjes së Kombeve gjatë viteve '30, në përgjigje të peticioneve të çamëve, ku shihet shpesh herë një paralelizim i rastit të Çamërisë, sikur popullsia e saj jetonte në kushte optimale, me krahinën e lakmuar të Epirit të Veriut, e cila sipas qeverisë greke vuante për shkak të qeverisjes së papërshtatshme shqiptare.¹² Qeveria greke theksonte se shteti shqiptar nuk dinte të trajtonte siç duhej minoritetin grek, dhe për këtë arsye, në argumentimin e tyre, krahina e banuar nga kjo popullsi duhet t'i bashkangjitej territorit të shtetit grek.¹³

Dhjetëvjeçari i dytë i krahinës së Çamërisë nën qeverisjen greke karakterizohet nga periudha e shkëmbimit të popullsive greko-turke dhe e përfshirjes së çamëve në këtë proces si pasojë e vakuumit juridik të përjashtimit nga ky proces të popullsive të cilat nuk kishin kombësi turke ndonëse i përkisnin fesë myslimane. Një analizë të thelluar mbi pasojat e rënda juridike dhe ekonomike që ky shkëmbim pati mbi shqiptarët e Çamërisë e jep autori Kostantinos Tsitselikis (2012). Lambros Baltiotis (2011) gjithashtu ndan qëndrime të ngjashme me Tsitselikis në lidhje me gjendjen e çamëve gjatë kësaj periudhe. Në shkrimet e tyre vihet re se shpronësimi la pasoja të konsiderueshme në popullsinë mbi të cilën u aplikua, siç ishin çamët në këtë rast.

¹² Lidhja e Kombeve, C.349.1935.I.; Lidhja e Kombeve, C.81.1935.I.

¹³ Ibidem.

Autorë të tjerë si Eleftheria Manda (2015), George Mavrogordados (1983), vënë në dukje ndër të tjera vonesën e procedurave administrative të shpronësimeve, të cilat prekën çamët gjithashtu. Jorgos Margaritis (2009) deklaroi haptazi se refugjatët grekë të ardhur nga Azia e Vogël kishin në mbështetje të tyre legjislacionin grek për të uzurpuar pronat e çamëve.

Një pasqyrë të detajuar mbi gjendjen e mjeruar të çamëve që prej aneksimit të krahinës nga Greqia, e jep historiani Hajredin Isufi (1997; 2002; 2006; 2007) i cili ndërthur analizën historike me aspektin juridik të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore, civile, dhe ekonomike të çamëve. Isufi deklaroi se Grekët synonin çrrënjosjen e popullsisë çame nga trojet e veta.¹⁴ Në mbështetje të këtij argumenti, në arkivat e Lidhjes së Kombeve gjendet një kërkesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë, në të cilën kërkohet leje e posaçme nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve për të shkëmbyer 1000-1500 shqiptarë të cilët ndodheshin në portin e Pargës në pritje për t'u shpërngulur drejt Turqisë, mirëpo ishin ndaluar nga qeveria greke në vijim të vendimit të Lidhjes së Kombeve që Komisioni Mikst të shqyrtonte shkëmbimin e shqiptarëve.¹⁵ Në këtë dokument të Lidhjes së Kombeve (C.641.1924.VII.) Dendramis i quan *shqiptarë* individët e përfshirë në këtë situatë, por autorja greke Divani si dhe Prof. Arben Puto i përcaktojnë më tej këta individë duke deklaruar se ata ishin *çamë*.¹⁶

Në fund të muajit Tetor 1924, Dendramis, në shkresën e tij të rradhës¹⁷ drejtuar Lidhjes së Kombeve, tregohet i kujdesshëm duke mos përmendur më kombësinë shqiptare të individëve të sipërpërmendur, por duke i njohur ata thjesht si *myslimanë*. Këto dy dokumente

¹⁴ Isufi 1997: 61, 62.

¹⁵ Lidhja e Kombeve, C.641.1924.VII.

¹⁶ Shih: Divani 1995: 229-230; Puto 2010: 193-194.

¹⁷ Lidhja e Kombeve, C.813.1924.VII.

tregojnë qëndrimin e qeverisë greke ndaj elementit shqiptar, prej të cilit çamët nuk bëjnë përjashtim. Për më tepër, në "Raportin e 10-të tremujor mbi hapjen e Zyrës Autonome për Vendosjen e Refugjatëve" deklarohet se:

"Qeveria Greke kishte dërguar një numër të madh refugjatësh në këtë krahinë (bëhet fjalë për Çamërinë), duke parashikuar nisjen (shpërnguljen) e 22,000 Myslimanëve që ishin konsideruar si të shkëmbyeshëm, dhe si rrjedhojë, subjekte për t'u shpërngulur drejt Turqisë".¹⁸

Me rëndësi të veçantë është dhe dokumenti i arkivës greke mbi urdhërin e datës 5 nëntor 1923 të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë për përcaktimin e origjinës shqiptare, i cili bazohej në tre kritere: *"vendlindja e të interesuarve të ishte në territorin e shtetit shqiptar, ose në Greqi me kusht që baballarët e tyre të kishin lindur në territorin e njohur ndërkombëtarisht të shtetit shqiptar, si dhe mungesa e ndërgjegjes turke tek fëmijët e të interesuarve"*¹⁹, çka nënkuptonte rrjedhimisht dhe mungesën e ndërgjegjes turke tek pjesa tjetër e familjeve të tyre. Këto kritere të përdorura për përcaktimin e origjinës shqiptare ishin një mjet që shërbenin për të manipuluar mendimin mbi ndërgjegjen kombëtare, e cila ishte mëse e vështirë për t'u përcaktuar gjatë kësaj periudhe për shkak të zhvillimeve të kohës.

Për sa i përket periudhës së shkëmbimit të popullsive greko-turke, autori grek Mihalopulos (1993) deklaronte se çamët nuk e kishin idenë mbi origjinën e tyre, dhe reagonin vetëm për çështjet pronësore. Kjo shprehje, e cila karakterizon qëndrimin e një sërë autorëve grekë, u hodh poshtë nga një tjetër autor i së njëjtës kombësi, Margaritis (2009) i cili

¹⁸ Lidhja e Kombeve, C.308.M.117.1926.II.

¹⁹ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Spiros Ikonou. *Tin Sin Jenikhin Dhiikisin Ipiru*. [Drejtuar Administratës së Përgjithshme të Epirit]. (nr. konfidencial 119). (29 Nëntor 1923).

përkundrazi deklaronte se çamët bënë përpjekje të shumta në mbrojtje të çështjes së tyre duke u munduar të informonin aktorët politikë mbi origjinën e tyre shqiptare. Një mendim të ngjashëm e shpreh dhe Baltsiotis (2011) i cili deklaroi se çamët arritën të krijonin një lidhësi të fortë sidomos gjatë viteve '20 për atë sa i ngritën çështjet e tyre për diskutim edhe pranë Lidhjes së Kombeve.

Gjatë viteve '30, autorët Tsitselikis, Manda, Baltsiotis, Isufi, pasqyrojnë në veprat e tyre pandryshueshmërinë e gjendjes së të drejtave të njeriut në Çamëri, duke theksuar një sërë problematikash si keqtrajtimet fizike të cilat vijonin të ishin të ashpra ndaj çamëve e deri tek pengesat e çështjeve administrative. Këtu, sidomos dallohet autorja Manda (2015), sipas së cilës keqtrajtimet fizike ndaj çamëve ishin më të lehta sesa ndaj pjesës tjetër të popullsisë, siç ishte në rastin e përdorimit të gjuhës amtare, pasi qeveria greke edhe gjatë Metaksait, i druhej një keqtrajtimi të minoritetit grek nga qeveria shqiptare. Por, burimet arkivore shqiptare japin një numër të konsiderueshëm dëshmish mbi rrahjet e dhunshme që autoritetet lokale ushtronin ndaj popullsisë çame në rastet kur ata përdorornin gjuhën shqipe në hapësirat publike.²⁰

Për sa i përket rolit të qeverisë shqiptare dhe të Lidhjes së Kombeve për çështjen çame, literatura është disi më e kufizuar. Për këtë do të përdoren kryesisht burimet arkivore të botuara në lidhje me veprimtarinë e përfaqësuesit shqiptar në Greqi Mithat Frashërit, përshtatur nga Luan Malltezi dhe Sherif Delvina.

Frashëri ishte skeptik mbi rolin e qeverisë shqiptare në mbrojtje të të drejtave të çamëve dhe të shqiptarëve që jetonin në Greqi. Ai ishte një mbështetës i zbatimit të parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet shqiptaro-greke. Mungesa e zbatimit të këtij parimi i dha një

²⁰ AQSH, Fondi 251, Dosja 164, Viti 1936, f. 8. *Raport për Keqtrajtimet e Autoriteteve Greke ndaj Popullsisë Vendase*. (20 Maj 1936)

shtysë të madhe Greqisë për të vepruar lirisht, sipas synimeve të saj, mbi çamët e shqiptarët në tërësi. Por, duhet theksuar gjithashtu se qeveria Shqiptare hartoi një sërë vendimesh për të pritur në Shqipëri çamët e shpërngulur nga Greqia, ashtu sikurse dhe ata të cilët ishin zhvendosur fillimisht drejt Turqisë, por duke gjetur atje kushte të mjerueshme ishin drejtuar më pas drejt vendit amë, Shqipërisë, e cila nga ana e saj hasi një sërë vështirësish pasi nuk mori mbështetje nga aktorët ndërkombëtare, dhe Lidhja e Kombeve, për fluksin e këtyre “refugjatëve” shqiptarë.

Literatura për Çështjen Çame gjatë harkut kohor 1913-1939 nuk nxjerr në pah zinxhirin e mekanizmave që zbatonte Lidhja e Kombeve në funksion të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve dhe të njeriut njëkohësisht me problematikat e tjera që shoqëronin këtë çështje gjatë kësaj periudhe. Autorët grekë e justifikojnë shpeshherë qëndrimin e Greqisë. Madje, për çështjen e pronave Divani (1995) shprehej se “çifligarët myslimanë nuk donin të shihnin pronat e tyre t’u ndaheshin refugjatëve”. Në fakt qëndrimet e Divanit janë të ngjashme me frymën e përgjithshme që karakterizonte përgjigjet e qeverisë greke ndaj peticioneve të çamëve, sidomos pranë Lidhjes së Kombeve. Edhe pse këtyre peticioneve i kushtohej vëmendja e duhur sipas mekanizmave të kohës, të tillë instrumentë ishin të pamjaftueshëm për kryerjen e verifikimeve përkatëse, si dhe vendosjen në vend të të drejtave të mohuara të kësaj popullsie prej autoriteteve greke.

1.5 Metodologjia dhe Metodatat e Studimit

Hulumtimi në burime parësore, dhe akte normative, ka qenë një ndër objektivat kryesore për realizimin e këtij punimi, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet paanësia në trajtimin e Çështjes Çame. Për shkak të shtrirjes kohore të këtij studimi (1913-1939),

përveç analizimit të dokumentacionit të karakterit historik e juridik, aplikimi i metodave të tjera studimore nuk u gjykua i përshtatshëm.

Metodat e përdorura për këtë punim janë metoda cilësore, duke qënë se studimi ka një karakter përshkrues dhe analitik. **Metoda e rastit të veçantë** ka për qëllim të përqëndohet në *Çështjen Çame* dhe trajtimin e të drejtave themelore të kësaj popullsie, duke u ndalur në pengesat e hasura në gëzimin e këtyre të drejtave si dhe arsyet përkatëse. **Metoda historike** është metoda kryesore e përdorur në këtë punim. Kjo metodë është aplikuar në gjetjen dhe shfrytëzimin e burimeve parësore, si dokumentacioni arkivor, dhe aktet normative të kohës. Ajo ndihmon në sqarimin e sfondit historik të rrethanave të caktuara që lidhen me kuadrin e të Drejtave Themelore të Njeriut e të Minoritetit në Çamëri gjatë harkut kohor 1913-1939. Si burimet arkivore ashtu edhe aktet normative janë të paplota në rast se nuk analizohet përmbajtja e tyre duke u fokusuar në shpjegimin e termave përkatës. Për këtë lind nevoja e përdorimit të **metodës analitike**, e cila synon të nxjerrë në pah interpretimin e termave, dhe të dispozitave ligjore të akteve normative kombëtare dhe ndërkombëtare. Për shkak të natyrës së çështjes kryesore të këtij punimi, lind nevoja e aplikimit të **metodës krahasuese** gjithashtu, pasi do të ballafaqohen qëndrimet e ndryshme të historiografisë greke, të huaj dhe asaj shqiptare, duke synuar analizën objektive të këtij punimi; gjithashtu, kjo metodë do të përdorët edhe në krahasimin e rastit të çamëve me grupe të tjera etnike, apo minoritete të cilat u gjendën brenda territorit të shtetit të ri grek (pas aneksimeve të vitit 1913).

1.6 Kufizimet e Punimit

Trajtimi i problematikës që rrok ky studim hasi në disa kufizime të cilat kanë të bëjnë me paraqitjen e statistikave të sakta, dhe pamundësinë për të trajtuar çdo aspekt të Çështjes

Çame me anë të burimeve arkivore greke. Por, për rrethanat historike të periudhës së studiuar nuk ka qenë e mundur nxjerrja e statistikave të sakta, pasi ato mbështesnin pikëpamjen e kombit që i paraqiste ato. Sidoqoftë, gjatë trajtimit të çështjeve në këtë studim janë paraqitur disa statistika në periudha të ndryshme kohore, të cilat në prespektivën krahasuese nxjerrin në pah anësinë e palës së interesuar. Rrjedhimisht, prania e kombësive të ndryshme në Çamëri nuk mund të përcaktohet saktësisht. Sidoqoftë, dëshmitë e nxjerra nga një sërë burimesh parësore e dytësore, të hartuara nga personalitete të huaja e greke, në periudha të ndryshme historike, dëshmojnë se kjo krahinë nuk banohej nga një popullsi greke, e as turke, siç Greqia doli në përfundimin e statistikave të mbledhura gjatë vitit 1923 në Çamëri.²¹ Për më tepër, nuk ka të dhëna as për një vendosje të mundshme të kolonive turke në këtë rajon. Por, një numër i madh dëshmish të autorëve të huaj, të cilët ishin thjesht vizitorë në këtë territor në periudha të ndryshme historike, pasqyrojnë faktin se Çamëria banohej në mënyrë kompakte nga popullsi autoktone shqiptare.²²

Nga ana tjetër, trajtimi i çdo çështje të këtij punimi me anë të burimeve arkivore greke nuk u bë i mundur për shkak të pamundësisë për të gjetur një gamë më të gjerë të këtyre dokumenteve. Sidoqoftë, këto burime arkivore pasqyrojnë idenë mbizotëruese në qarqet greke, të cilët i konsideronin çamët si armiq. Ato mbartin një ngarkesë të theksuar emocionale, ashtu sikurse dhe një pjesë e historiografisë greke në lidhje me Çështjen Çame. I njëjti sfond vihet re edhe në burimet parësore e dytësore shqiptare, pasi vuajtjet e çamëve ishin të pandërprera për shkak të shkeljes së të drejtave themelore të tyre. Duke pasur si objektiv që

²¹ Për më tepër shih “4.2 Përcaktimi i Popullsisë me Origjinë Shqiptare”

²² Shih: AQSH, Fondi 251, Dosja 79, Viti 1924, f. 273-280. *Raport mbi Kriteret Bazë për Përcaktimin e Kombësisë së Banorëve të Çamërisë [sugjeruar nga Ali Dino].* (7 qershor 1924)

analiza e këtij studimi të jetë e saktë dhe e plotë, pengesat që na ofrojnë burimet greke e shqiptare në këtë sfond do të tejkalohen duke përdorur dokumentacionin arkivor të Lidhjes së Kombeve, në të cilin dallohet një ton më neutral sesa në burimet e sipërpërmendura.

1.7 Përmbajtja dhe Struktura e Punimit

Ky punim është i ndarë në shtatë krerë. Kreu i parë trajton aspekte të përgjithshme kërkimore dhe metodologjike të studimit, siç janë: objekti, qëllimi dhe rëndësia e punimit, pyetjet kërkimore dhe hipoteza, metodologjia dhe metodat e studimit, kufizimet, si dhe përmbajtja dhe struktura e punimit.

Kreu i dytë shtjellon pikat kryesore mbi të cilat Greqia u bazua për zbatimin e politikave të spastrimit etnik mbi popullsinë shqiptare të Çamërisë. Në ndihmë të këtyre politikave ishte brishtësia e së Drejtës Ndërkombëtare, ashtu sikurse dhe makinacionet që u përdorën për të manipuluar mendimin mbi ndërgjegjen kombëtare të çamëve, në funksion të shpënguljes së tyre nga krahina e Çamërisë. Për sa i përket të Drejtës Ndërkombëtare, do të analizohet Konventa e Hagës (II, 1899), e cila do të shihet thjesht në këndvështrimin e vlerave normative që ajo mbarte më tepër sesa të detyrimit faktik që Greqia kishte përballë këtij akti ndërkombëtar. Do të analizohet gjithashtu edhe përmbajtja e Traktatit të Athinës (1913) e Traktatit të Minoriteteve (1920), si dhe Konventa për Shkëmbimin e Popullsive Greko-Turke (1923), në lidhje me të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut e të minoriteteve për sa i përket Çështjes Çame. Seksioni i fundit i këtij kreu do të trajtojë disa koncepte teorike mbi interpretimin subjektiv të etnicitetit, duke u fokusuar në qëndrimet e Greqisë ndaj çamëve.

Kreu i tretë ka të bëjë me zhvillimet kryesore të dhjetëvjeçarit të parë pas periudhës së aneksimit të Çamërisë deri në vitin 1920. Për këtë fillimisht do të jepen disa të dhëna mbi

konceptin e Megali Idesë, origjinën e këtij koncepti deri në zhvillimet politike të viteve 1912-1913. Më tej, do të vijohet me ndikimin që pushtimi grek pati në terren, dhe pasqyrimin e sjelljes së autoriteteve ushtarake mbi popullsinë vendase. Traktati i Athinës si dhe marrëveshja e parë për shkëmbimin e popullsive greko-turke do të analizohen duke nxjerrë në pah dispozitat e këtij dokumenti që sanksiononte të Drejtat Themelore të popullsisë që banonin territoret e ceduara nga Perandoria Osmane si dhe synimet reale të Greqisë e Turqisë. Për përcaktimin e subjekteve të këtij traktati u përdor kriteri fetar, në vend të kriterit kombëtar. Në seksionin e pushtimit italian do të pasqyrohet qëndrimi i tyre ndaj të drejtave dhe lirive themelore të çamëve, si dhe reagimet përkatëse. Ndërsa në seksionin e fundit i cili ka të bëjë me Konferencën e Paqes në Paris (1919) do të analizohen pritshmëritë dhe arritjet e palës shqiptare si dhe rezultatet përfundimtare në lidhje me këto kërkesa.

Në kreun e katërt do të analizohet roli i çamëve në shkëmbimin e popullsive greko-turke. Në sythin e parë do të pasqyrohet qëndrimi grek dhe ai turk ndaj këtij procesi në tërësi duke u fokusuar në rastin e çamëve. Në sythin e dytë të këtij kreu, do të trajtohen procedurat e para që shteti grek vuri në funksion të mbarëvajtjes së procesit të shkëmbimit të popullsive. Në këtë sfond, Greqia shfaqte qëndrime të dyanshme në lidhje me atë çka kishte deklaruar zyrtarisht me anë të përfaqësuesve të saj, pasi aktet juridike të kësaj periudhe “ngrinë” të drejtat themelore të popullsisë që i përkiste fesë myslimane deri në vërtetimin e origjinës përkatëse.

Më tej, do të shtjellohet platforma që Komisioni Mikst ndoqi në terren, si dhe "pa/anësia" që zbatoi në lidhje me çështjen e çamëve. Procesi i shkëmbimit të popullsive greko-turke la një sërë pasojash në krahinë, të cilat do të analizohen në seksionin e katërt të këtij kreu duke u përqëndruar në lëvizjet kryesore të qeverisë greke dhe ligjet e para që

ndërmorri në funksion të shpronësimeve kryesisht ato që kishin për qëllim vendosjen e refugjatëve. Më tej, do të vijohet me analizimin e pozitave të popullsisë së ardhur nga Azia e Vogël, rrethanat që shkaktonin sjellje të caktuara dhe bashkëjetesa e vështirë e çamëve me ta për shkak të gjendjes së krijuar. Do të analizohet gjithashtu edhe roli i autoriteteve lokale dhe i klerit mysliman. Në vijim, do të përshkruhet gjendja e krahinës së Çamërisë në përfundim të procesit të shkëmbimit, i cili ndonëse ishte vendosur zyrtarisht në pranëverën e vitit 1926, vijoi të zbatohet edhe për disa vite më vonë me anë të politikave "të heshtura", sidomos përsa i përket çështjes së pronave. Në sythin e fundit të këtij kreu do të jepen disa vlerësime demografike në vështrim krahasues të cilat synojnë të pasqyrojnë lëvizjet e popullsisë çame dhe të refugjatëve të ardhur nga Azia e Vogël si dhe ndikimet e tyre në terren.

Kreu i pestë do të pasqyrojë *status quo*-në e të Drejtave Themelore të Njeriut në Çamëri, të cilat nuk pësuan thujtë asnjë ndryshim gjatë viteve '30. Shkelja dhe mohimi i tyre në këtë kohë ishte disi më i zbutur në krahasim me vitet '20, por sidomos në gjysmën e parë të këtyre viteve ('30). Një vëmendje të veçantë do të marrin e drejta e arsimimit në gjuhën amtare, si dhe e drejta e pronës, duke u ndalur gjithashtu edhe në propagandën e rradhës që u vu në zbatim ndaj çamëve për t'i bërë ata që të braktisnin trojet e veta, pasi kjo propagandë kishte të bënte me hartimin e një sërë politikave lehtësuese për blerjen e pronave të kësaj popullsie nga elementi grek.

Roli i qeverisë shqiptare dhe i Lidhjes së Kombeve për çështjen çame do të analizohen në kreun e gjashtë të këtij punimi. Në sythin e parë do të pasqyrohen përpjekjet e qeverisë shqiptare, e të diplomatëve të vendit në mbrojtje të kësaj çështje. Në sythin e dytë do të trajtohen qëndrimet e aktorëve politikë shqiptarë e të huaj mbi zbatimin e parimit të

reciprocitetit. Në sythin e tretë do të analizohet roli i Lidhjes së Kombeve si dhe ballafaqimet shqiptaro-greke pranë kësaj organizate.

Në kreun e shtatë do të jepen përfundimet e këtij studimi, e më tej disa rekomandime.

Kreu II: Drejt Spastrimit Etnik të Çamërisë: Legjislacioni Ndërkombëtar dhe Koncepti i Etnisë (1913-1939)

2.1. Të Drejtat Themelore të Njeriut e të Minoriteteve - Greqia në Rastin e Çamëve

Në fillim të shek. XX, kodifikimi i të Drejtave Themelore të Njeriut dhe të minoriteteve ishte në hapat e parë të tij. Në nivel ndërkombëtar, të Drejtat Themelore të Njeriut gjendeshin të inkorporuara në Ligjin Humanitar Ndërkombëtar me anë të konventave të ndryshme, të cilat rregullonin marrëdhëniet e palëve gjatë luftrave, siç ishte Konventa e Hagës (II, 1899²³). Në periudhat vijuese, të Drejtat Themelore të Njeriut dhe të minoriteteve filluan të inkorporoheshin në legjislacionet kombëtare, ashtu siç ndodhi me shtetin grek në rastin e Traktatit të Minoriteteve (1920). Sipas historianit dhe juristit Prof. Arben Puto, regjimi i minoriteteve “mund të thuhet se u plotësua në kuadrin e Lidhjes së Kombeve”.²⁴ Megjithatë, duhet theksuar fakti se këto akte normative nuk arritën të ndikonin tek palët firmëtare për ndryshimin e gjendjes së minoriteteve. Sidoqoftë, shtetet të cilat i kishin inkorporuar të tilla marrëveshje ndërkombëtare në kuadrin e tyre legjislativ kishin detyrimin ligjor për t’i respektuar ato.

Në harkun kohor 1913-1939, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Greqia, të cilat kishin të bënin drejpërdrejtë ose tërthorazi me çamët ishin: Konventa e Hagës për “Ligjet dhe Zakonet e Luftës në Terren” (1899), Traktati i Athinës (1913), Traktati i Minoriteteve (1920), dhe Konventa për Shkëmbimin e Popullsive Greko-Turke (1923²⁵).

²³ Konventa e Hagës (II, 29 Korrik 1899) mbi “*Ligjet e Zakonet e Luftës në Terren*”

²⁴ Puto 2001: 173

²⁵ Gjykata Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare, e konsideronte Konventën për Shkëmbimin e Popullsive Greko-Turke të natyrës së veçantë, shih: Gjykata Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare 1925: 3.

Gjatë kësaj periudhe, qeveria greke e aplikonte të Drejtën Ndërkombëtare sipas teorisë dualiste, e cila e ndan atë nga ligji municipal. Sipas mbështetësit të kësaj teorie, juristit gjerman Triepel, e Drejta Ndërkombëtare ishte një "vullnet i përbashkët" i shteteve sovrane.²⁶ Juristi Shaw duke analizuar tezën e Triepel shkruan se shteti sovran mund "t'i japë jetë një rregulli mbi të cilin ai nuk ka kontroll" duke e kthyer vullnetin e tij në një nivel më të ulët sesa vullneti i përbashkët i shteteve të tjera.²⁷ Nga ana tjetër, Dikson deklaron se të drejtat dhe detyrimet që lindin brenda një sistemi (ndërkombëtar ose kombëtar), nuk mund të kalojnë automatikisht edhe në sistemin tjetër.²⁸ Por, në këtë kohë, së bashku me formimin dhe ndërtimin e shteteve komb, rryma mbizotëruese e politikës ishte realizmi pasi shtetet ishin të interesuara për të arritur qëllimet dhe idealet përkatëse të përcaktuara nën kuadrin e politikave zyrtare të tyre, çka nuk linte hapësirë për të drejtat e njeriut e aq më pak të minoriteteve. Hans Morgenthau, deklaronte se *"realizmi politik refuzon të identifikojë aspiratat morale të një kombi të caktuar me ligjet morale që drejtojnë universin"*.²⁹ Për këto arsye, shteti grek nuk arriti të konkretizonte normat ndërkombëtare për mbrojtjen e të Drejtave Themelore të Njeriut e të minoriteteve në legjislacionin e brendshëm, pasi ato nuk përkonin me interesat politike të tij.

Duke nisur që prej shek. XVIII e deri në krijimin e Lidhjes së Kombeve ekzistonte një përplasje midis *jus in bello* dhe *jus ad bellum*, pasi në këtë periudhë e drejta sovrane për të nisur luftën ishte e pakufizuar.³⁰ Dikson shkruan se *"e drejta ndërkombëtare rregullonte veprimet konkrete të zhvillimit të luftës, por nuk ndërhynte në të drejtën e shtetit për ta"*

²⁶ Shaw 2003: 29.

²⁷ Ibidem.

²⁸ Dikson 2011: 141.

²⁹ Morgenthau 2008: 14.

³⁰ Shih: Dikson 2011: 406.

vazhduar atë".³¹ Ky sfond i të Drejtës Ndërkombëtare të kohës e justifikonte angazhimin e palëve në luftë, përtej ekzistencës së konventave të cilat sanksiononin respektimin e të drejtave të njeriut, dhe në të njëjtën kohë kishin për qëllim zvogëlimin e pasojave të luftës tek palët e treta.

- *Konventa e Hagës mbi "Ligjet e Zakonet e Luftës në Terren"*

Greqia kishte firmosur e ratifikuar Konventën e Hagës në lidhje me ligjet dhe zakonet e luftës (II, 1899), gjithashtu ishte firmëtare e Konventës së Hagës (IV, 1907). Këto akte ndërkombëtare, ndër të tjera sanksiononin dhe "sjelljen" e palëve ndërluftuese kundrejt personave neutralë, në mënyrë që të evitoheshin dëmet e ndryshme që mund të lindnin deri në mbarim të luftrave. Për rendin ndërkombëtar të kohës, vlen të theksohet se kjo konventë nuk mori rëndësinë e duhur nga asnjëra prej palëve firmëtare, e as nga Greqia. Sidoqoftë, në këtë punim do t'i referohemi këtij akti juridik vetëm për vlerën normative, morale dhe aktuale që ajo mbart.

Konventa e dytë (IV, 1907) ndryshonte në disa dispozita të modifikuara dhe të shtuara në krahasim me Konventën e parë (II, 1899), e megjithatë, të 17 vendet që e ratifikuan Konventën e parë, nuk e ratifikuan të dytën. Neni 4 i Konventës së vitit 1907, shpreh se Konventa e vitit 1899 qëndronte në fuqi për vendet që e kishin firmosur (ratifikuar) atë, edhe në rastin kur ato nuk e kishin ratifikuar Konventën e dytë. Kjo e fundit nuk mbarte detyrimin ligjor për shtetet, por rregullat që ajo sanksiononte u njohën, disa vite më vonë, të vlefshme në "formën deklarative" për rregullimin që ato i bënin marrëdhënieve të palëve në luftë.³² Në

³¹ Dikson 2011: 406.

³² Konventa e Hagës (IV, 18 Tetor 1907) mbi *"Ligjet e Zakonet e Luftës në Terren"*.

dhjetëvjeçarin e parë të shek. XX, shtete të ndryshme nuk i dhanë vlerë të madhe këtij akti ndërkombëtar, e pavarësisht këtij fakti, ky dokument mbetej një detyrim ligjor për ta. Greqia shkeli disa nga nenet e Konventës (II, 1899) në lidhje me angazhimet e saj ushtarake në Çamëri. Këtë konventë ajo e kishte ratifikuar më 4 Prill të vitit 1901.

Neni 2 i saj, shpreh se dispozitat e sanksionuara në të kanë vlerë vetëm në lidhje me luftën midis dy ose më shumë prej shteteve firmëtare. Turqia e kishte ratifikuar këtë konventë në datën 12 Qershor 1907, çka e bënte atë ligjërish të detyrueshme për këto dy shtete, në periudhën e pushtimit të krahinës së Çamërisë (1912-1913). Nga ana tjetër, krahina e Çamërisë vijonte të ishte juridikisht një territor i Perandorisë Osmane. Rrjedhimisht, çdo shkelje ndaj këtij territori dhe popullsisë së tij, përbënte njëkohësisht mosrespektimin e kësaj konvente nga ana e shtetit grek.

Shkeljet kryesore ndaj kësaj konvente, në rastin e krahinës së Çamërisë, u kryen prej muajit tetor 1912 deri më 17 dhjetor 1913, periudhë e cila përkon me pushtimin e këtij territori deri në firmosjen e aktit zyrtar që përcaktoi kufirin jugor të Shqipërisë me Greqinë, Protokollit të Firences (1913), i cili la Çamërinë nën kufijtë zyrtarë të shtetit grek.

Neni 23, pika (b), "ndalon vrasjen në mënyrë të pabesë të individëve që i përkasin shtetit ose ushtrisë armike". Një ndër shkeljet më të njohura të autoriteteve greke, ndaj këtij neni, në krahinën e Çamërisë ishte masakra e përroit të Selanit, ku të paktën 70 krerë u ekzekutuan në mars të vitit 1913.

Pika (e) ndalon përdorimin e armëve të ndryshme, me anë të të cilave synohet të shkaktohet plagosje e tepruar. Pika (g), ndalon shkatërrimin ose pushtimin e pronave të palës armike, nëse ky nuk bëhet për arsye të nevojshme të luftës.

Neni 25 ndalon sulmin ose bombardimin mbi qytete, fshatra, banesa ose ndërtesa të pambrojtura. Neni 28 shpreh se plaçkitja e qyteteve ose vendeve është e ndaluar. Plaçkitja ishte zyrtarisht e ndaluar sipas nenit 47 të aneksit të kësaj konvente.³³

³³ Konventa e Hagës (II, 29 Korrik 1899) mbi "Ligjet e Zakonet e Luftës në Terren".

Mohimi i të drejtave të sanksionuara në këtë Konventë, dhe shkelja e dispozitave të saj nga ana e autoriteteve greke, u shtri edhe pas mbarimit të periudhës së pushtimit të Çamërisë.

Në seksionin e tretë të kësaj Konvente (II, 1899), i cili ka të bëjë me “Autoritetin ushtarak mbi territorin armik”, Greqia shkeli nenin 43 që sanksiononte kalimin e autoritetit ekzistues tek pushtuesi, i cili kishte për detyrë të vendoste rendin publik dhe sigurinë duke respektuar ligjet në fuqi. Këtu vlen të theksohet se autoritetet greke e lanë në fuqi legjislacionin osman me anë të ligjit të datës 14 mars 1913.³⁴ Por, nga ana tjetër, ruajtja e rendit dhe sigurisë në këto rrethana ishte në nivel utopik. Sipas pikëpamjes realiste, pranimi i të tilla marrëveshjeve nga ana e shteteve shtrihej deri "në një farë mase", por "këto kufizime morale" nuk merreshin parasysh nga vende të ndryshme në kohë të caktuara.³⁵

Neni 45 i kësaj konvente ndalonte autoritetin pushtues të ndikonte në vullnetin e popullsisë së territorit të pushtuar me qëllim që ata të shpreheshin në mbështetje të tij (pushtuesit).³⁶ Shkelje të ndryshme u kryen nga autoritetet greke ndaj popullsisë së territoreve të pushtuara, dhe sidomos gjatë punimeve të Komisionit për përcaktimin e kufirit shqiptaro-grek (1913), pasi popullsia vendase detyrohej me mënyra të drejpërdrejta ose të tërthorta për t'u shprehur në mbështetje të qeverisjes greke në territoret ku ata banonin.³⁷

Neni 46, sanksiononte respektimin e nderit dhe të drejtave të familjes, të jetës së individit dhe pronës private, të lirive dhe besimit fetar. Gjithashtu, shprehej se prona private nuk mund të konfiskohej.³⁸ Autoritetet greke e shkelën këtë nen gjatë pushtimit të Çamërisë,

³⁴ Dushku 2014: 182.

³⁵ Morgenthau 2008: 257.

³⁶ Konventa e Hagës (II, 29 Korrik 1899) mbi “*Ligjet e Zakonet e Luftës në Terren*”.

³⁷ Për shembuj më konkretë shih seksionin 3.2.

³⁸ Konventa e Hagës (II, 29 Korrik 1899) mbi “*Ligjet e Zakonet e Luftës në Terren*”.

pasi një dispozitë e tillë nuk mund të zbatohet në një kohë kur keqtrajtime të formave të ndryshme (të rënda) aplikoheshin edhe ndaj popullsisë neutrale.

- *Traktati i Athinës (1913)*

Në përfundim të Luftërave Balkanike, Greqia firmosi marrëveshjen dypalëshe me shtetin turk (Traktatin e Athinës 1913), në vijim të cedimit të territoreve të cilat i përkisnin më parë Perandorisë Osmane. Ashtu si në disa akte të tjera ndërkombëtare³⁹, edhe në këtë dokument vihet re përdorimi i kriterit fetar në përcaktimin e subjekteve në vend të kriterit të etnicitetit, që do të thotë se në traktat bëhet fjalë për komunitetet *Myslimane*, dhe rrjedhimisht, këtij grupimi do t'i njiheshin e respektoheshin të drejtat themelore pas kalimit të territorit nën juridiksionin e shtetit grek.

Në nenin 11 të këtij akti ndërkombëtar sanksionohen të Drejtat Themelore të Njeriut për popullsinë e territoreve në fjalë, si e drejta e jetës, e pronës, e nderit, e fesë, dhe i zakoneve përkatëse, të cilat duhet të respektoheshin “në mënyrë të përpiktë”.⁴⁰ Gëzimi i këtyre të drejtave duhet të ishte i njëjtë siç ishte për qytetarët grekë.

Sidoqoftë, çamëve do t'u ishin respektuar të drejtat themelore në rast se ky traktat do të ishte zbatuar, por për shkak të rrethanave historike, konflikteve ushtarake, si dhe të veprimeve e mosveprimeve të vendimarrësve politikë të Greqisë, as ky akt ndërkombëtar nuk u respektua.⁴¹

³⁹ Shih Traktati i Athinës (1926), i firmosur midis Greqisë e Turqisë në vijim rregullimit të procesit të shkëmbimit të popullsisë përkatëse. Në nenin 4 të tij, përveç subjekteve greke dhe turke, njihet dhe një subjekt tjetër të cilët ishin “Myslimanët”.

⁴⁰ Shih Neni 11 Traktati i Athinës (1913)

⁴¹ Shih seksionin “3.3 Traktati i Athinës: Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Myslimanëve vs. Nismat për Homogjenizimin e Territoreve Greke dhe Turke”

- *Traktati i Minoriteteve për Greqinë (10 Gusht 1920)*

Pas Luftës së Madhe, dhe në përfundim të punimeve të Konferencës së Paqes së Parisit (1919), u hartuan Traktatet e Minoriteteve, të cilat lindën si një nevojë për të përballuar tensionet etnike që ishin ndezur për shkak të krijimit të shteteve komb. Shtete të shumta, i kthyen këto traktate pjesë të legjislacionit të tyre të brendshëm, ashtu sikurse dhe Greqia, e cila e ratifikoi këtë dokument në 29 Shtator të vitit 1923.⁴²

Në prag të hartimit të këtyre marrëveshjeve nga shtetet përkatëse për mbrojtjen e minoriteteve, në një memo të autoriteteve greke, ndër të tjera, për shqiptarët deklarohet, se:

*"Edhe Shqiptarët mund të hapin shkolla speciale (për minoritetet), por ata nuk e kanë parashikuar këtë duke qenë se kanë ndërgjegje të pastër greke dhe dëshirojnë që fëmijët e tyre, pavarësisht se në ambientin familjar flasin gjuhën shqipe, të marrin një shkollim të pastër grek."*⁴³

Një deklaratë e tillë nuk ishte e bazuar në të dhëna të nxjerra prej popullatës shqiptare, e megjithatë ajo mbeti e pandryshuar në mendimin e qarqeve greke ndër vite.

Gjatë kësaj periudhe (1920-1923), çamët (shqiptarët) nuk mund të ankoheshin për shkeljet që autoritetet Greke bënë ndaj tyre, por edhe pas ratifikimit të këtij akti ndërkombëtar, çështjet e çamëve të cilat dilnin në pah si rrjedhojë e shkeljeve të neneve të

⁴² Fletorja Zyrtare e Greqisë. Nr. 311. (30 Tetor 1923). Marrë nga http://www.et.gr/index.php?option=com_wrapper&view=%20wrapper&Itemid=104&lang=el.

⁴³ Shënim*- Memo nuk ka datë, as dërgues, as marrës. Nga dosja e shfletuar bëhet fjalë për draftet e paraqitura nga qeveria greke për të pasqyruar, sipas saj, gjendjen e minoriteteve nën qeverisjen e ligjeve greke. Dosja është e vitit 1922 sipas shënimit në fletën e parë, por disa prej dokumenteve janë të vitit 1919. IAYE. Zyra Qëndrore /1922/114/3/1/1/ *Memoire sur les Droits des Minorites en Grece*. [Memo mbi të drejtat e Minoriteteve në Greqi].

kësaj marrëveshje nuk gjetën zgjidhje as në nivel ndërkombëtar, për shkak të mekanizmave të papërshtatshëm për shqyrtimin e këtyre rasteve.

Sipas nenit 2 të Traktatit të Minoriteteve (1920), *"Greqia merrte përsipër mbrojtjen e plotë të jetës dhe të lirive të të gjithë banorëve të Greqisë pa dallim vendlindje, kombësie, gjuhe ose feje. Të gjithë banorët e Greqisë mund të ushtrojnë lirisht, në mënyrë publike ose private, çdo praktikë, fe ose besim, të cilat nuk shkojnë në kundërshtim me rendin ose moralin publik."*⁴⁴

Sipas nenit 1, të këtij akti ndërkombëtar, Greqia i njihte nenet 2 dhe 8 (të drejtën e shkollimit dhe të përdorimit të gjuhës amtare) si ligje themelore, mbi të cilat nuk do të dilte asnjë ligj tjetër, e aq më pak akt nënligjor.⁴⁵ Në nenin 8 deklarohet se *minoritetet racore,*

fetare dhe gjuhësore duhet të gëzojnë të njëjtin trajtim prej ligjit si shtetasit e tjerë grekë. Për më tepër, ata duhet të kenë të drejtën të vendosin, administrojnë dhe kontrollojnë, me anë të shpenzimeve të tyre, institucione bamirësie, fetare ose sociale, shkolla dhe institucione të tjera arsimimi me të drejtën për të përdorur gjuhën e tyre dhe të praktikojnë fenë e tyre në to.

Në nenin 3 deklarohet se *nënshtetësia shqiptare njihej ipso facto dhe pa asnjë formalitet për banorët të cilët banonin në territoret që iu transferuan Greqisë në Traktatet pas datës 1 Janar 1913.*

⁴⁴ Traktati për Mbrojtjen e Minoriteteve në Greqi (1920).

⁴⁵ Ibidem.

Sipas nenit 16, të gjitha të drejtat që lidheshin me minoritetet racore, fetare ose gjuhësore përbënin detyrime të natyrës ndërkombëtare dhe ishin të vendosura nën garancinë e Lidhjes së Kombeve.

Të gjitha nenet e kësaj konvente, të cilat duhet të zbatoheshin mbi çamët nuk u morën në konsideratë gjatë harkut kohor (1913-1939).

- *Konventa për Shkëmbimin e Popullsive Greko-Turke*

Ndonëse u hartua nën vëzhgimin e autoriteteve të Lidhjes së Kombeve, kjo marrëveshje ishte në kundërshtim me nenin 23, pika (b⁴⁶) të Konventës së kësaj organizate, sipas së cilës subjektet e marrëveshjes, të cilat në këtë rast ishin shtetet, *duhet t'u siguronin një trajtim të drejtë banorëve autoktonë të territoriteve që ata kishin nën kontrollin e tyre.*⁴⁷

Sidoqoftë, kjo konventë u hartua gjatë punimeve të Konferencës së Lozanës (20 Nëntor 1922 - 24 Korrik 1923), pas përfundimit të luftës greko-turke (1922) dhe u gjykua si e nevojshme për zhvillimet e kohës, duke qenë se vala e refugjatëve grekë të cilët shpërnguleheshin prej Turqisë drejt shtetit të tyre amë kishte nisur prej kohësh. *De jure*, ajo mori fuqi me anë të Traktatit të Lozanës, i cili u firmos më 24 Korrik 1923.⁴⁸

Në nenin 1 të kësaj marrëveshje deklarohet se duke nisur që prej datës 1 Maj duhet të fillonte shkëmbimi i detyrueshëm i popullsisë turke të fesë ortodokse, me popullsinë greke të fesë myslimane, por kjo datë kishte vetëm një karakter tregues duke qenë se ky shkëmbim kishte nisur kohë më parë.

⁴⁶ Në opinionin këshillimor të GJPDN kjo Konventë u gjykua si “e natyrës së veçantë”, shih Gjykata Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare 1925: 3.

⁴⁷ Shih: Traktati i Versajës (1919).

⁴⁸ Turqia e ratifikoi këtë Traktat në 23 Gusht 1923, ndërsa Greqia më 25 Gusht 1923. Instrumentet për ratifikimin e këtij dokumenti u depozituan në Paris, më 6 Gusht 1924. Për më tepër shih nenin 142 të Traktatit të Lozanës.

Në nenin 2 të këtij dokumenti, ndër përjashtimet e përmendura, nuk bënin pjesë çamët, të cilët ndonëse ishin myslimanë, nuk i përkisnin kombësisë turke. Si rrjedhojë, shqiptarët u shqetësuan për shkak të kësaj zbrazëtie ligjore, dhe kërkuan siguri të mëtejshme nga palët hartuese të kësaj marrëveshje. Nga ana e saj, pala greke iu përgjigj atyre [shqiptarëve] vetëm në formën e deklaratave zyrtare, të cilat sidoqoftë nuk mbartnin asnjë detyrim ligjor.

Sipas Gjykatës Permanente të Drejtësisë Ndërkombëtare, kombësia e banorëve të një shteti të caktuar supozohej të ishte rregulluar në bazë të ligjit municipal të tij,⁴⁹ por një fakt i tillë nuk kishte ndodhur në rastin e shqiptarëve, duke i vështirësuar së tepërmi pozitat e popullsisë myslimane që jetonte në trojet e aneksuara nga Greqia.

Neni 12 i kësaj konvente i jepte fuqi të plotë Komisionit Mikst për të vendosur mbi të gjitha çështjet që do të dilnin në pah gjatë zbatimit të procesit të shkëmbimit të popullsisë. Mirëpo, pa nisur punën e tij në terren komisioni, qarqet zyrtare greke po hartonin dhe zbatonin makinacionet e para për përcaktimin e origjinës së popullsisë në Çamëri, sipas pikëpamjes zyrtare të shtetit grek.⁵⁰ Komisioni nuk vepronte në mënyrë neutrale, siç sanksionohej në këtë konventë, pasi merrte për bazë edhe deklarata subjektive të disa personave si për shembull të krerëve të klerit mysliman, të cilët jo rrallë herë shfaqën mbështetjen për shkëmbimin e shqiptarëve myslimanë të Çamërisë.

Ndryshe nga kjo marrëveshje, në Traktatin e Sevres (1920), neni 143 (Mbrojtja e Minoriteteve) kërkonte shkëmbimin vullnetar të popullsisë të racës greko-turke.⁵¹ Duke qenë se kjo konventë (30 Janar 1923) kishte si kriter kryesor kriterin fetar, ky fakt e bën më

⁴⁹ Gjykata Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare Ndërkombëtare 1925: 22.

⁵⁰ Shih urdhërin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë së datës 5 Nëntor 1923.

⁵¹ Shih: Traktati i Sevres.

të lehtë të mendohet se synimi i hartimit të këtij dokumenti ndërkombëtar kishte të bënte me eliminimin e “minoriteteve të padëshiruara”⁵² nga këto shtete të reja si Greqia e Turqia.

2.2 Shkëmbimi i Popullsive Greko-Turke dhe Shpërngulja e Detyruar⁵³

Shkëmbimi i detyruar ishte i debatueshëm për legjitimitetin që ai mbarte, pasi disa prej aktorëve politikë kryesorë të kohës e shihnin atë si një domosdoshmëri për shkak të rrethanave të krijuara në nivel rajonal, por nga ana tjetër mbështetësit e të Drejtave Themelore të Njeriut e kundërshtonin atë. Shpërngulja e një popullsie të caktuar konsiderohej si e papranueshme dhe *de jure* ishte e tillë⁵⁴, pasi ishte në kundërshtim me të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut duke i bërë ata të zhvendoseshin në një shtet tjetër në mënyrë që një shtet i caktuar të arrinte qëllimet e veta politike.

Sipas autorit Yildirim, kjo konventë ishte "konfuze në terma", dhe shërbeu për të përjashtuar nga këto dy vende "minoritetet e padëshiruara" prej tyre.⁵⁵ Autori vijon më tej duke përmendur se ndër minoritetet e padëshiruara për Greqinë ishin edhe shqiptarët.⁵⁶ Sipas Prof. Putos, pasi Greqia të kishte shpërngulur myslimanët, asimilimi i popullsisë së krishterë do të kishte qenë më i lehtë, dhe në këtë mënyrë ajo do të mund të deklaronte jo vetëm që nuk kishte aneksuar toka shqiptare pas vitit 1913, por mund të paraqiste si të drejtë kërkimin e “Vorrio-Epirit”.⁵⁷

⁵² Emërtim i përdorur nga autori turk: Yildirim 2006: 9.

⁵³ Për më tepër shih Kreu IV: “Çamët në Shkëmbimin e Popullsive midis Greqisë e Turqisë”

⁵⁴ Konventa e Lidhjes së Kombeve neni 23 (B).

Marrë nga http://avalon.law.yale.edu/20th_century/leagcov.asp#art23

⁵⁵ Yildirim 2006: 9;

⁵⁶ Ibidem.

⁵⁷ Puto 2010: 179.

Në vitin 1924, Profesor Tenekides deklaronte se: *"Shkëmbimi i detyrueshëm është një nga shkeljet më serioze të lirive të individit dhe i së drejtës së pronës, si dhe një hap prapa i trishtueshëm i së Drejtës Ndërkombëtare. Ai i jep hapësirë perceptimeve primitive dhe të egra të luftës, duke qënë se humbja kthehet në një shkatërrim të popullsisë, të mirat e të cilës janë plaçkitur prej fituesit dhe vetë populli detyrohet të emigrojë ose të skllavërohet."*⁵⁸

Në një mënyrë të ngjashme një tjetër profesor i kohës, Seferiades, i shihte traktatet që rregullonin shkëmbimin e popullsive si *"të pavlefshme dhe ilegjitime"*, pasi ato shkonin ndesh me të drejtat themelore të njeriut.⁵⁹

Ndërsa më pranë pikëpamjes realiste mund të paraqesim autorin Howland, i cili dallonte katër elementë që e karakterizonin këtë marrëveshje të konkretizuar midis Greqisë e Turqisë. Elementi i parë, kishte të bënte me shpërnguljen e forcuar e cila erdhi si pasojë e veprimeve ushtarake midis dy vendeve; elementi i dytë, ishte nevoja për të shpërndarur idetë nacionaliste, dhe sipas tij, në këtë marrëveshje nuk përfshiheshin interesat ekonomike; elementi i tretë kishte të bënte me çrrënjosjen e popullsive autoktonte, dhe në fund, i gjithë procesi pati përmasa të mëdha.⁶⁰

Fenomeni i shkëmbimit të popullsisë u konsiderua nga aktorët politikë të kohës, si një nevojë urgjente për të parandaluar katastrofat. Pas Luftës Greko-Turke, kriza e refugjatëve të Azisë së Vogël kishte marrë përmasa të konsiderueshme, të cilat nuk mund të përballoheshin me asnjë mjet tjetër përveçse me vendosjen e këtyre personave të shpërngulur në vendin amë.

⁵⁸ Tsitselikis 2012: 80.

⁵⁹ Ibidem.

⁶⁰ Howland 1926: 1; Për më tepër: Bayir 2016: 82, e cila shkruan se në mënyrë të paprecedentë janë shpërngulur forcërisht thuhet 1,700,000 individë.

Emigrimi i banorëve me kombësi greke nga Turqia ishte një proces i gjatë i cili nuk po gjente një zgjidhje përfundimtare. Duke parë që personat e larguar nga zonat e luftës nuk mund të riktheheshin përsëri në trojet e tyre, u pa e arsyeshme që të arrihej në një marrëveshje zyrtare midis Turqisë dhe Greqisë, e cila ndryshe nga marrëveshja e vitit 1914, që kishte karakter dypalësh, tanimë po vendosej me dakordësinë e aktorëve ndërkombëtarë të kohës, nën sfondin e Lidhjes së Kombeve, duke i dhënë legjitimitet një procesi kundërshtues ndaj të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Në memorandumin që Harold C. Jaquith (1923), përfaqësuesi i Lidhjes së Kombeve i dërgonte Widdingut, përfaqësuesit të Komisionit Mikst, për këtë çështje, deklarohet se vonesat në realizimin e procesit të shkëmbimit të popullsisë do të sillnin humbje ekonomike dhe katastrofa humanitare. Ai theksonte se nëse popullsia e përcaktuar për këtë proces nuk do të gjendej në territoret përkatëse gjatë periudhave të kultivimit, do të humbiste përfitimet nga prodhimet e këtyre pronave. Në të njëjtën mënyrë, procesi i pandalur i emigracionit në këto zona kërkonte një ndërhyrje për të evituar katastrofa të mëtejshme humanitare.⁶¹

Në Shtator 1925, Howland, Presidenti Amerikan i Komisionit të Vendosjes së Refugjatëve tha përpara Këshillit të Lidhjes së Kombeve se homogjenizimi i territoreve, në këtë rast të Greqisë, duke larguar popullsitë me etni të ndryshme, sillte paqen në këto krahina,⁶² por “kjo paqe” kërkonte spastrime të tjera etnike, siç ndodhi me popullsinë shqiptare në Greqi. Për shkak të numrit të madh të refugjatëve të ardhur nga Turqia, Greqisë i duhej të përballonte krizën e refugjatëve, duke i vendosur ata në pronat e myslimanëve,

⁶¹ IAYE. Lidhja e Kombeve. 1923/5/4/1/ Jaquith, H.C. (26 Shtator 1923). *Copy of Memorandum from Mr. Jaquith (N.E.R) to Mr. Widding, of the Commission for Exchange of Populations*. [Kopje e Memorandumit nga Z. Jaquith (N.E.R) për Z. Widding, të Komisionit të Shkëmbimit të Popullsisë].

⁶² Pallis 1929: 543.

"sapo këta të fundit të largoheshin", siç deklaronte edhe Kaklamanos në një telegram të dërguar nga Londra në Athinë (përveç masave të shpronësimit). Në këtë telegram, ai deklaronte se delegacioni grek e kishte kërkuar me domosdoshmëri "evakuimin e myslimanëve".⁶³

Përveç rregullimit të shpërnguljes sipas Konventës (30 Janar 1923), ajo arrihej dhe me mjete të tjera në mënyrë të tërthortë. Autorja Mulaj deklaroi se: "*Spastrimi etnik ka të bëjë me krijimin e një mjedisi ku frika dhe pasiguria janë në rritje, gjë e cila çon në shpërnguljen e një popullsie të caktuar*".⁶⁴ Në të njëjtën mënyrë, sipas saj "mohimi i të drejtës së punësimit, të shkollimit, të shëndetit publik, të shërbimeve publike dhe administrimit pulik; ashtu sikurse dhe mohimi i të drejtës së asociimit së bashku me legjislacionin paragjykses dhe shtypës" janë taktika të spastrimit etnik.⁶⁵ Të gjitha këto politika u zbatuan gjatë periudhës 1913-1939 ndaj popullsisë çame duke i detyruar ata të shpërnguleshin forcërisht nga trojet e tyre.

2.3 Koncepti i Etnisë

Përkatësia etnike më tepër sesa një "e vërtetë shkencore" është një "interpretim subjektiv", çka nënkupton se të jashtmit mund të aplikojnë kritere të ndryshme ndaj një grupi etnik, në një prespektive tjetër nga ajo në të cilën ai e sheh veten e tij.⁶⁶ Ky përkufizim sociologjik karakterizon dhe rrugën që ndoqi Greqia në funksion të zbatimit të interesave

⁶³ I.A.Y.E. Lidhja e Kombeve. /1923/5/4/1. *Telegram nga Londra në Athinë nr. 3606*. [Në lidhje me përsheptimin e procesit të shkëmbimit, si dhe largimin e myslimanëve në mënyrë që të vendoseshin refugjatët grekë]. (Teksti në frengjisht). (13 Tetor 1923)

⁶⁴ Mulaj 2010: 6.

⁶⁵ Ibidem.

⁶⁶ Guibernau dhe Rex 2010: 3.

kombëtare të saj, pasi duke i dhënë një interpretim subjektiv origjinës së çamëve dhe mbi të gjitha të pabazuar në kritere të arsyeshme, ajo arriti të ushtronte një tryzni të dukshme mbi ta, me anë të një sërë makinacioneve, duke ua vështirësuar atyre mundësinë që të deklaronin se u përkisnin kombësisë shqiptare.

Politikani boshnjak Silajxhiç shkruan në veprën e tij *“Shqipëria dhe SHBA në Arkivat e Uashingtonit”* se vendet ballkanike ishin *“të mbingarkuara me konfuzionin rreth problemit të identifikimit të përkatësisë fetare me atë kombëtare, duke e përdorur fenë si mjetin legal për asimilimin e pakicave...”*.⁶⁷ Më 1913, gjatë përpjekjeve për aneksimin e Shqipërisë së Jugut, qeveria greke i kërkoi qeverisë italiane të ndërhynte në mbështetje të të krishterëve ortodoksë grekë në Shqipëri, duke u bazuar në një kërkesë të Patriarkanës Ekumenike. Por, qeveria italiane iu përgjigj se Greqia nuk duhet të shqetësohej për pozicionin e shqiptarëve të cilët nuk janë subjekte greke, aq më tepër që ajo nuk kishte pranuar të ndërhynte në një rast tjetër në Maqedoni, duke e njohur pavarësinë e Patriarkanës.⁶⁸

Në rastin e çamëve pati një interpretim subjektiv nga shteti grek mbi kombësinë e tij për shkak të fesë myslimane, e cila asociohej me kombësinë turke. Nga ana tjetër, interpretimi subjektiv i origjinës së kësaj popullsie u shtri gjithashtu edhe tek kompetencat e Komisionit Mikst pasi, përtej detyrës që kishte për të përcaktuar popullsinë që do të shkëmbehej, dhe paqartësisë që karakterizoi platformën e tij në lidhje me çamët, antarët e këtij organi të Lidhjes së Kombeve morën për bazë deklarata subjektive të ndryshme, e sidomos të aktorëve të interesuar për përfshirjen e çamëve në shkëmbim.⁶⁹

⁶⁷ Silajxhiç 1999: 69.

⁶⁸ Shih: Duka 2012: 136, dok. 40; Gurakuqi 2011: 57, 58.

⁶⁹ Për më tepër, shembulli i deklaratave të klerit mysliman, pas të cilave Komisioni doli në përfundimin se 95% e popullsisë çame ishte e kombësisë turke në: Arkivi Qëndror i Shtetit, Tiranë, (më tej AQSH), Fondi

Krahina e Çamërisë banohej nga popullsia autoktone shqiptare, e cila ndonëse kishte pësuar ndryshime gjatë shekujve, siç ishte kalimi në fenë myslimane në pjesën dërmuese të saj, vijonte të ruante të paprekur identitetin kombëtar shqiptar, që shprehej, ndër të tjera, në elementë siç ishte gjuha e folur, pra gjuha shqipe. Përkatësia fetare e tyre vinte si rrjedhojë e pushtimit osman në këto troje. Autori italian Petrotta shkruan se:

“Letërsia popullore tradicionale italo-shqiptare dhe dialektet e folura ende sot në Itali e në Greqi kanë afërsi e përkime kaq të dukshme në fonetikën e morfologjinë e dialektit çam të Epirit, saqë i bien në sy edhe i tingëllojnë në vesh edhe njohësit më të sipërfaqshëm të gjuhës shqipe.”⁷⁰

Autori tjetër Italian Antonio Baldacci deklaronte: *“Ç’ mund të kërkohej më shumë në të mirë të tezës që, në mbërritjen e turqve, epirotët ishin shqiptarë? Dhe ishin shqiptarë të krishterë, sepse bashkë me gjuhën, sollën në Itali edhe fenë e te parëve.”⁷¹*

Të gjitha territoret e pushtuara nga Greqia në vitin 1913 përbëheshin nga popullsia jo-greke në pjesën dërmuese të tyre. De Azcarate shprehet se vlefshmëria e kodifikimit të të drejtave të minoriteteve do të kishte qenë më e madhe në rast se këto grupe etnike do të kishin qenë të përcaktuara mirë.⁷² Por një fakt i tillë ishte në kundërshtim me politikën zyrtare greke e cila në këtë kohë (1913-1939) synonte ndërtimin e identitetit kombëtar grek për territoret e reja të aneksuara pas vitit 1913. Për këtë arsye, për shtetin grek një territor multietnik duhej homogjenizuar, çka nënkuptonte marrjen e masave të nevojshme për arritjen e këtij qëllimi.

251, Dosja 84, Viti 1924, f. 28-30. Raport mbi Vlerësimet e Komisionit Mikst për Përcaktimin e Popullsisë së Këmbyeshme. (9-25 Maj 1924)

⁷⁰ Petrotta 2013: 46.

⁷¹ Baldacci, cituar në Petrotta 2013: 46; Shih gjithashtu: Duka 2009: 192-218.

⁷² De Azcarate 1945: 4.

"Kohezioni shoqëror në një shtet multietnik, arrihet në tre mënyra: balancimi i kërkesave etnike me interesat shtetërorë, asimilimi i minoriteteve etnike në sfondin e politikave qendrore të shtetit, si dhe përjashtimi i minoriteteve etnike nga territori i një shteti të caktuar".⁷³ Si rrjedhojë, Greqia, në pamundësi për të balancuar kërkesat e minoriteteve me interesat e përgjithshëm shtetërorë, zbatoi dy strategji kryesore, të cilat kishin të bënin me asimilimin e minoriteteve që ngjasonin me karakteristikat e përgjithshme të shoqërisë greke, kryesisht për atë grupim që i përkiste fesë ortodokse, dhe nga ana tjetër shpërnguli në mënyrë të detyruar, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndër të tjera, edhe çamët myslimanë, pikërisht për shkak të pamundësisë së asimilimit të tyre pasi elementët kulturorë që i përkisnin kësaj popullsie nuk kishin pika të ngjashme me elementin "helen".

Autori Pentzopoulos deklaroi se shtet formimi i Greqisë ishte *"një proces i gjatë e i lodhshëm, i cili kërkonte sakrifica të mëdha të vuajtjeve njerëzore"*.⁷⁴ Greqia e zgjeroi territorin e saj shtetëror falë interesave të aktorëve ndërkombëtarë të kohës. Ky zgjerim nuk qe i menjëhershëm, por u konkretizua në dhjetëvjeçarët e parë të njohjes zyrtare të saj si shtet në arenën ndërkombëtare. Vështirësia që ky shtet hasi sidomos në aneksimin e territoreve të trungut jugor të Shqipërisë kishte të bënte me kundërshtinë që popullsia vendase paraqiti ndaj synimeve politike të saj, pasi pjesa dërrmuese e tyre nuk identifikoheshin me karakteristikat kryesore të shoqërisë "greke", dhe as nuk mund të asimilohej, sidomos pjesa e cila i përkiste fesë myslimane.

⁷³ Mulaj 2010: 7.

⁷⁴ Pentzopoulos 2002: 25.

Kreu III: Aneksimi i Çamërisë dhe Zhvillimet 1913-1920

3.1 Krahina e Çamërisë dhe *Megali Idea**

Synimet e Greqisë për zgjerimin e mëtejshëm të territorit të saj bazoheshin në konceptin e Idesë së Madhe, e cila mendohet të këtë bazat në fjalimin e kryeministrit grek Janis Koletis, pasi ai propozoi përfshirjen në shtetin e ri të atyre territoreve që lidheshin me historinë helene, pavarësisht se nuk banoheshin nga ajo popullsia [helene].⁷⁵ Sidoqoftë, bëhej fjalë për territore në të cilat prania e banorëve të fesë ortodokse ishte e papërfillshme. Kisha Ortodokse Greke mbështeti në mënyrë të pandërprerë qëllimet politike të Greqisë. Edhe gjatë punimeve të Konferencës së Londrës (1913), patriarku i Kostandinopojës Jermanos i drejtoi një memorandum Grey-t, kryetarit të konferencës, pasi u shqetësua nga një letër e qarqeve ortodokse shqiptare (drejtuar Grey-t) në të cilën kërkohej krijimi i Kishës Ortodokse Shqiptare, pas marrjes së pavarësisë së shtetit shqiptar.⁷⁶

Megjithatë, disa kohë pas deklaratës së Koletisit, përpjekjet ushtarake dhe politike për realizimin e endrrës greke nuk rreshtën. Në vitin 1854, bandat greke pushtuan Thesalinë dhe Epirin⁷⁷, por kjo kryengritje e organizuar nga gjenerali Grivas dështoi⁷⁸ pasi siç shkruan edhe Stavrianos, “Britania dhe Franca nuk mund të toleronin të tilla shqetësime në prapavijë⁷⁹, dhe për këtë arsye dërguan flotën në Pire nga Maji 1854 deri në Shkurt 1857”.⁸⁰

*Megali Idea- Idea e Madhe: Koncept Irredentist i Platformës Politike të Shtetit Grek prej vitit 1854 deri në përfundim të Luftës Greko-Turke (1922).

⁷⁵ Xhufi 2006: 24; Dushku 2014: 172-173; Frashëri 2015: 155-156.

⁷⁶ Frashëri 2015: 209.

⁷⁷ Stickney [1926] 1998: 24.

⁷⁸ Frashëri 2015: 157, 158; Isufi 2015: 109, 110.; Sadiku 2011: 30, 31.

⁷⁹ Kjo ngjarje ndodhi gjatë Luftës së Krimesë (1853-1856). Nisma ishte nxitur nga Rusia “e cila shpresonte së bashku me Greqinë në rebelimin e ortodoksëve të cilët ndodheshin nën juridiksionin e Perandorisë Osmane”, për këtë arsye Franca dhe Britania, si aleatë të Perandorisë Osmane, nuk mund ta lejonin vijimësinë e kësaj kryengritjeje, shih: Stickney [1926] 1998: 23.

⁸⁰ Stavrianos 1958: 295.

Lëvizja tjetër e cila ishte karakterit politik u shënua me Traktatin e Vëslau-t (26 gusht 1867). Territori që kjo Perandori zotëronte ende në gadishullin Ballkanik do të ndahej midis këtyre dy vendeve, çka nënkuptonte një ndarje të territorit shqiptar midis Greqisë dhe Serbisë. Sipas kësaj marrëveshjeje Greqia do të merrte pjesën që i takonte nga gjiri i Ambrakisë deri në Lumin Shkumbin.⁸¹ Një revoltë ishte parashikuar për muajin Mars të vitit 1868 për arritjen e këtyre synimeve, por kjo nuk u realizua mbi të gjitha për shkak të rritjes së antagonizmit greko-sllav në një kohë fare të shkurtër.⁸² Disa qarqe greke në këtë periudhë deklarorin se një afrim i ri me Turqinë do të ishte më fitimprurës për “*shtrirjen e shpirtit grek në Ballkan*”, sesa bashkëpunimi me elementin slav, për shkak të mbështetjes që Rusia po i jepte Bullgarisë për krijimin e kishës së pavarur nga Patriakana.⁸³ Në vijim të punimeve të Kongresit të Berlinit (1878), falë punës së patriotëve shqiptarë dhe interesave gjeopolitikë të kohës, Greqia nuk arriti të aneksonte krahinën e Çamërisë.⁸⁴

Disa muaj para se të nisnin Luftërat Ballkanike, shtetet e gadishullit si Greqia, Serbia dhe Bullgaria, kishin arritur mirëkuptimin e plotë për bashkëpunim midis tyre, ndërsa trazirat në Shqipëri konsideroheshin “shqetësuese” për të ngarkuarin me punë të Serbisë në Berlin.⁸⁵ Sidoqoftë, sipas përfaqësuesit serb, këto fuqi nuk do të bënin asgjë për të trazuar Ballkanin, por do të vepronin së bashku nëse gjendja do të ndryshonte.⁸⁶ Megjithatë, në Luftën e Parë Ballkanike u arrit pushtimi tërësor i krahinës së Çamërisë (shkurt të vitit 1913).⁸⁷ Ndërsa, pas

⁸¹ Frashëri 2015: 158.

⁸² Stavrianos: 395-396.

⁸³ Ibidem: 396.

⁸⁴ Për më tepër shih: Sadiku 2011: 75-110.

⁸⁵ Ministère des Affaires Étrangères 1922: 26, dok. 36.

⁸⁶ Ibidem.

⁸⁷ Për më tepër shih: Isufi 2015: 127-132.

Konferencës së Londrës (1913), pasi kufiri midis Shqipërisë dhe Greqisë do të vendosej gjatë punimeve të një komisioni ndërkombëtar, më 17 Dhjetor 1913, pjesa më e madhe e territorit çam iu dha shtetit Grek, ndërsa vetëm shtatë fshatra të saj i mbetën Shqipërisë.⁸⁸ Për këtë kufi, protestat ishin të shumta nga pala shqiptare. Shtypi shqiptar protestoi bindshëm ndaj kësaj padrejtësie, në lidhje me përgjysmimin e territorit, dhe të popullsisë, si dhe me habinë për faktin se si “interesat politike ndikuan në fatin e një kombi që banonte prej mijëra vjetësh në këto troje”.⁸⁹ Shqiptarët kishin shpresuar shumë në drejtësinë e Fuqive të Mëdha. Rreth një vit përpara marrjes së vendimit për Shqipërinë, një delegacion i parlamentit anglez, i përbërë prej 6 deputetë të qeverisë e të opozitës, mori premtimin e Grejit se “dëshirat dhe synimet” e Shqipërisë do të merreshin parasysh.⁹⁰

Megjithatë, Greqia nuk u ndal pas vendimit të Konferencës së Londrës (1913). Ajo synonte të aneksonte të gjithë trungun jugor shqiptar, njësoj siç kishte synuar në Traktatin e Vëslau-t (26 Gusht 1867), dhe për këtë arsye veprimtaritë ushtarake në këtë krahinë (Shqipërinë e Jugut), duke përfshirë dhe Çamërinë, nuk u ndalën. Një fakt i tillë shënonte një regres të Ligjit Humanitar ekzistues, duke e bërë të pamundur gëzimin e të drejtave themelore për banorët e këtyre territoreve.

⁸⁸ Vickers 2002: 2; Për më tepër mbi përcaktimin e kufirit gjatë Konferencës së Londrës shih: Meta 2007: 26-27; Gazeta “Djalëria” cituar Zenelaj 2013: 289, 290.

⁸⁹ Për më tepër shih: Gazeta “Djalëria” cituar në Zenelaj 2013: 287, 289.

⁹⁰ Zenelaj 2013: 279.

3.2 Qëndrimet e Qarqeve Greke pas Aneksimit të Çamërisë

Pas aneksimit të krahinës së Çamërisë, gjendja në këtë territor vijonte të ishte e tensionuar, duke qenë se kufiri midis Greqisë dhe Shqipërisë nuk ishte përcaktuar ende. Gjithashtu, bandat greke vijonin të terrorizonin në mënyrë të pandërprerë popullsinë vendase. Ky kontekst mbeti thujtse i pandryshuar deri në pushtimin italian në Çamëri, pasi shteti grek përdorte çdo lloj metode të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për arritjen e qëllimeve politike të tij. Drejtimet kryesore që Greqia ndoqi për arritjen e synimeve të saj ishin: veprimet ushtarake, si dhe veprimet administrative, të cilat ndihmuan në zvogëlimin e ndikimit të faktorit çam në këtë rajon.

Masakrat ishin pjesë e pandërprerë e realitetit të kësaj kohe. Dëshmi të diplomatëve të huaj pasqyrojnë gjendjen që po përjetonte në këtë periudhë popullsia shqiptare e Çamërisë dhe e krahinave rreth saj. Në një raport që Harry Lamb, konsulli britanik, i dërgonte Sekretarit të Punëve të Jashtme në Vlorë më 25 tetor 1913, shprehej se qëllimi i autoriteteve ushtarake greke ishte *"shuarja e elementit johelenik në rajon"*, i cili sipas tij ishte pothuajse tërësisht shqiptar.⁹¹ Ai gjithashtu ndalet të theksojë se *"këto veprime ishin cinike dhe të pafalshme, sidomos në Çamëri"*.⁹² Diplomati austriako-hungarez Karl Buhberger⁹³ dëshmon mbi mizoritë greke të kësaj periudhe, përkatësisht pranë rrethinave të Janinës për të cilat ai deklaronte se *"nëpër rrugë kishte muhamedanë të vrarë, e me sy të nxjerrë"*.⁹⁴

⁹¹ Dushku 2014: 184.

⁹² Ibidem.

⁹³ Karl Buhberger ishte një nga firmëtarët e Protokollit të Firences (17 Dhjetor 1913), pasi zëvendësoi konsullin Bilinski.

⁹⁴ Sadiku 2011: 112-113.

Ndër masat e para që ndërmoi ushtria greke kishin të bënin me ç'armatimin e popullsisë në Paramithi dhe Margëlliç.⁹⁵ Autoritetet greke u kthyen dy muaj më vonë me këtë pretekst, dhe duke mos gjetur më armë kryen rrahje e burgosje ndaj popullsisë vendase.⁹⁶ Nga ana tjetër, në këtë kohë, vihet re edhe furnizimi me armë i banorëve të krishterëve të cilët jetonin në fshatrat pranë Çamërisë, në një kohë kur popullsia e kësaj krahine [çamët] ishte e pa armatosur.⁹⁷ Xhamitë dhe varrezat e myslimanëve u shkatërruan.⁹⁸ Në promemorien e paraqitur nga delegacioni shqiptar me 18 Maj të vitit 1921, pala shqiptare deklaronte se në Çamëri që prej vitit 1912 popullsia vendase neutrale dhe e pambrojtur dhunohej në forma të ndryshme nga ushtarakë të rregulltë dhe banda greke.⁹⁹

Gjithashtu, në muajin Mars 1913 u shënua një nga masakrat e para e cila pati jehonë si në shtypin e kohës, ashtu edhe në korrespondencat diplomatike të përfaqësuesve shqiptarë me politikanët e huaj. Në gazetën "Liri e Shqipërisë", raportohet një letër e ardhur nga Izmiri, ku autori denoncon masakrën e Selanit në të cilën informonte se u vranë 72 pjestarë të parisë së Çamërisë, pabesisht, pasi atyre u ishte premtuar dëmshpërblimi për dëmet e shkaktuara nga ushtria greke.¹⁰⁰ Kjo masakër u përgënjështua nga ministri grek në Londër, si dhe Venizelos.¹⁰¹ Aubrey Herbert, një zë i fuqishëm i kauzës shqiptare në këtë periudhë, në letrën

⁹⁵ Dushku 2014: 178.

⁹⁶ Ibidem; Colonna di Cesaro 1922: 182.

⁹⁷ Destani dhe Elsie 2013: 12.

⁹⁸ Dushku 2014: 178.

⁹⁹ Godart [1922] 2015: 279.

¹⁰⁰ Isufi 2002: 147; Isufi 2007: 55; Minga 2003: 110-111. Colonna di Cesaro 1922: 181.

¹⁰¹ Letër e Aubrey Herbert drejtuar botuesit të "The Morning Post", 4 nëntor 1913, botuar më 5 nëntor 1913, në *Aubrey Herbert dhe Krijimi i Shqipërisë së Sotme, Ditarë dhe Letra 1904-1923*. Përshtatur nga Bejtullah Destani dhe Jason Toms, Tiranë, 2012, f. 202-204; Kjo letër ishte një përgjigje për Letrën e datës 24 Tetor 1913, botuar në "The Morning Post" më 25 Tetor 1913, të shkruar nga Drejtori i King's College Ronald Montagu Burrows, si dhe Drejtori i London School of Economics William Pember Reeves, të cilët kishin vënë në dyshim vërtetësinë e deklaratave të Herbert-it, duke qënë se ata mbështesnin pretendimet greke. Për më tepër shih Destani dhe Toms 2012: 200-202, 205-211.

që i dërgonte botuesit të gazetës “The Morning Post”, shkruante se përfaqësuesit e shtetit grek mund “t’i nxirrnin” këta 72 çamë, në vend që të mohonin akuzat për vrasjen e tyre.¹⁰² Gjithashtu, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1913) përfaqësuesi grek pranoi se krimet në Çamëri kryheshin nga andartët dhe qeveria e tij nuk mund të ishte përgjegjëse për këtë, por një deklaratë e tillë u përgënjeshtroi nga diplomatët e huaj të kohës, të cilët pohonin se këto banda komandoreshin nga ushtria e rregullt greke.¹⁰³ Pas kësaj masakre, duke iu referuar dëshmisë së Mazar Dinos dhënë më 28 Korrik 1917 për Komisaratin e Përgjithshëm të trupave italiane që kishin pushtuar Çamërinë, *“përafërsisht për katër-pesë muaj të tjerë, grekët i vodhën popullsisë së këtyre fshatrave çdo gjë që posedonin; e si pasojë e këtij fakti, atyre nuk u mbeti më asgjë.”*¹⁰⁴ Ndërkohë, masakrat ndaj popullsisë çame vazhduan në mënyrë të konsiderueshme edhe gjatë viteve 1913-1915, pasi Greqia nuk kishte hequr dorë nga synimet e shtrirjes territoriale të saj.¹⁰⁵

Komisioni për përcaktimin e kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë hasi në vështirësi gjatë punimeve pasi nuk ishte e lehtë që të përcaktohej vija kufitare sipas parimeve të etnicitetit duke qenë se popullsia vendase ndikohej në mënyrë të konsiderueshme nga qarqet greke.¹⁰⁶ Autoritetet greke e detyronin popullsinë vendase që të firmoste peticione në mbështetje të pushtimit grek në këto zona, nën kërcënimin e armëve.¹⁰⁷ Atyre iu mohojë e drejta për të dalë nga shtëpitë e tyre dhe paria po dërgohej në Janinë në mënyrë që të mos krijoheshin mundësi për të kontaktuar me përfaqësuesit e komisionit.¹⁰⁸ Pavarësisht kësaj,

¹⁰² Destani dhe Tomes 2012: 203.

¹⁰³ Meta 2007: 29.

¹⁰⁴ Colonna di Cesaro 1922: 181.

¹⁰⁵ Për më tepër shih: Meta 2007: 29, 30.

¹⁰⁶ Për më tepër shih: Gurakuqi 2011: 59-85.

¹⁰⁷ Isufi 2007: 54-56.

¹⁰⁸ Ibidem: 203.

popullsia vendase organizonte mitingje për të kundërshtuar padrejtësitë që po i bëheshin.¹⁰⁹ Shpeshherë, këto organizime sillnin pasoja të ndryshme si burgosje për përfaqësuesit dhe nismëtarët kryesorë. Për këtë arsye, mundësia për t'i rezistuar tërësisht këtyre qëndrimeve ishte e papërfillshme, pasi popullsia vendase e sidomos pronarët e tokave u vunë përballë shtrëngimeve të ndryshme deri në humbje të titujve të pronave që zotëronin. Si pasojë, kjo shtresë e popullsisë, e pa të arsyeshme jo rrallë herë pjesëmarrjen në të tilla organizime në mbështetje të autoriteteve greke.¹¹⁰ Një tjetër strategji përdorej nga autoritetet greke për arritjen e qëllimeve të tyre: banorët grekë dërgoheshin në këto krahina të veshur me kostume shqiptare, në mënyrë që të paraqisnin një numër edhe më të madh të mbështetësve të kauzës greke pranë antarëve të Komisionit për përcaktimin e kufirit shqiptaro-grek.¹¹¹

Në këtë periudhë, në gazetën italiane "Il Secolo XIX" raportohej mbi një telegram të dërguar nga një delegat i Çamërisë, në të cilin protestohej për masakrat e kryera nga qeveria greke si dhe për trysninë e ushtruar prej saj në mënyrë që popullsia vendase të firmoste petitionin në mbështetje të aneksimit të Shqipërisë Jugore nga Greqia, pasi në të kundërt një sërë fshatrash do të digjeshin nëse do të kundërshtonin këtë kërkesë të autoriteteve greke.¹¹²

Gjatë kësaj periudhe, kaosi mbizotëronte në Çamëri, duke qenë se kufiri zyrtar midis Shqipërisë e Greqisë nuk ishte përcaktuar ende, dhe Greqia ende nuk kishte hequr dorë nga pushtimi i Korçës dhe Gjirokastrës.¹¹³ Sipas historianit Pëllumb Xhufi, synimet e zgjerimit territorial të vazhdueshëm të Greqisë u parashikuan që prej Kongresit të Berlinit, në

¹⁰⁹ Ibidem.

¹¹⁰ Dushku 2014: 185

¹¹¹ Duka, 2012: 106, dok. 5; Gurakuqi 2014: 139, 140.

¹¹² IAYE. Zyra Qëndrore. 1913/29/3/1/1. Gazeta "Il Secolo XIX". (1913). *Le Proteste Contro la Grecia di una Delegazione Albanese. Un appello all'Italia*. [Protestat e një Delegacioni Shqiptar kundër Greqisë. Një Thirrje për Italinë.]

¹¹³ Dushku 2014: 185.

deklaratën e përfaqësuesit turk Safet Pasha, i cili e quante një iluzion në rast se Greqia nuk do të kërkonte territore të tjera pasi të merrte Epirin dhe Thesalinë.¹¹⁴ Këto zona të ndodhura në veri dhe verilindje të krahinës së Çamërisë, sillnin si pasojë edhe një prani të vazhdueshme të trupave ushtarake të rregullta ose të parregullta greke edhe në territorin jugor shqiptar të pushtuar nga Greqia, dhe rrjedhimisht, siç paraqesin dëshmitë e kohës, popullsia vendase nuk gëzonte më asnjë të drejtë dhe liri themelore. Synimet e Greqisë u “konkretizuan” deri në vitin 1914, me krijimin e Republikës Autonome të Epirit të Veriut, e më pas u hap rruga për një tjetër konflikt të nivelit botëror siç ishte Lufta e Madhe, duke sjellë kështu në mënyrë të dukshme një hap prapa ndaj respektimit të të Drejtave Themelore të Njeriut edhe në këtë zonë të Gadishullit Ballkanik.

Me qeverisjen greke në territoret e pushtuara të Çamërisë, administrata lokale filloi të zëvendësohej gradualisht me të ardhurit, duke përzënë njëkohësisht shqiptarët prej saj. Ndërkohë, u la në fuqi legjislacioni ekzistues osman me anë të ligjit të datës 14 mars 1913.¹¹⁵ Përtej lirive të deklaruar nga ligjet ushtarake greke të sapo vendosura, pjesës shqiptare iu ndalua dhe përdorimi i gjuhës amtare, pasi në rast të kundërt ata keqtrajtoheshin mizorisht.¹¹⁶

Colonna di Cesaro raporton mbi një sërë masakrash që ushtria greke kryente ndaj popullsisë çame në këtë kohë. Një ndër to është edhe masakra e muajit Dhjetor 1916. Ai shkruan se:

Në dhjetor të vitit 1916, ishte përhapur lajmi se Italianët kishin zbarkuar në Gumenicë. Pas kësaj, u dëgjua një e shtënë në malet e Çamërisë. Xhandarmëria greke me këtë rast shkoi në Mazrek, për të gjetur armë, por duke mos gjetur u largua. Mbas njëzetë ditësh mbërriti një batalion i ushtrisë greke me në krye kapiten Nakis duke u shpërndarë nëpër Mazrek e sidomos fshatrat në kufi me

¹¹⁴ Xhufi 2006: 25.

¹¹⁵ Dushku 2014: 182

¹¹⁶ Ibidem.

*zonat e Epirit të pushtuara nga italianët. Trupat greke kryen keqtrajtime të panumërta, që përfshinin arrestime, rrahje, "varje në pemë nga këmbët dhe poshtë kokave të tyre digjej bari me qëllim për t'i asifksuar". Këto trajtime çnjerëzore u zbatuan edhe ndaj grave. Shumë prej tyre u sëmurën e vdiqën.*¹¹⁷

Gjatë pushtimit grek u shkatërruan shtëpitë e fshatrave të kazasë së Paramithisë dhe të Filatit, përkatësisht Gardhiqi me 300 shtëpi, Dhragumi me 200, Petronica me 75, Minina me 60, Ninati me 120, Markati me 120, Janjari me 150. Sipas disa përfaqësuesve çamë të kësaj periudhe, popullsia e Çamërisë ishte përgjysmuar për shkak të "*masakrave, urisë, dhe emigracionit*".¹¹⁸

Vuajtjet e shqiptarëve në këtë kohë patën jehone edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në 7 nëntor 1915, në Boston, u mbajt një miting me mbi 3000 personalitete amerikane, ku fjalën e mbajti George Fred Uilliams, ish ministër i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Athinë. Në fjalimin e tij, ai vuri në dukje shkeljen e të drejtave themelore të popullsisë që banonte në kufij me shtetet fqinjë si Greqia e Serbia, e cila ishte e detyruar të vuante për shkak të masakrave të shkaktuara nga trupat ushtarake të këtyre vendeve. Gjithashtu, Uilliams kërkonte mbështetjen e vendit të tij dhe të vendeve Europiane për mbrojtjen e të drejtave të shtetit Shqiptar dhe popullit të tij.¹¹⁹

Në fillim të vitit 1915, Greqia ndërmori një nisëm administrative në Çamëri. Ajo caktoi një ndarje të re të kazave të krahinës, duke i bërë ato të varura nga dy prefektura kryesore të cilat ishin Janina dhe Preveza. Këto njësi administrative dallonin për përbërjen e

¹¹⁷ Colonna di Cesaro 1922: 182, 183.

¹¹⁸ Ibidem: 182.

¹¹⁹ AQSH, Fondi 848, Dosja 3, Viti 1915, f. 1. Komiteti Shqiptar i Lozanës. *Rezoluta kërkon mbështetjen e Qeverisë Amerikane për Mbrojtjen e Shqipërisë nga Copëtimi i Mëtejshëm i Trojeve të saj prej Serbisë, Malit të Zi e Greqisë.* (7 nëntor 1915); Sadiku 2011: 121.

tyre demografike të përzier, psh. Nënprefektura e Filatit do të kalonte tek Prefektura e Janinës ndërsa nënprefektura e Margëlliçit nga Preveza. Me këtë ndarje, Greqia synonte zvogëlimin e mundësisë që Çamëria të mund të zgjidhte përfaqësues në Parlamentin Grek, dhe rrjedhimisht ndikimi i faktorit çam do të zbehej më tepër.¹²⁰

3.3 Traktati i Athinës dhe Nismat për Homogjenizimin e Territoreve Greke dhe Turke

Nisma për homogjenizimin e territorit të shtetit grek dhe turk vlen të përmendet pasi ishte hapi i parë që çoi më tej drejt konkretizimit të shkëmbimit të popullsisë përkatëse. Ky proces i cili u zyrtarizua tërësisht gjatë dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit të XX-të, solli në këtë mënyrë një ndër strategjitë kryesore të politikës së spastrimit etnik që Greqia zbatoi ndaj çamëve. Periudha pas Luftërave Ballkanike ishte e vështirë për vendet e përfshira. Sipas Mourellos, popullsia civile u largua nga zonat e luftës, e sidomos drejt vendeve të origjinës për sa u përket banorëve të përfshirë në marrëveshjet e Londrës e të Bukureshtit, si dhe në mënyrë të detyruar ato u larguan pas keqtrajtimit të autoriteteve të shteteve përkatëse.¹²¹

Greqia firmosi Traktatin e Paqes me Turqinë më 14 Nëntor 1913. Ky traktat kishte për qëllim vendosjen e marrëdhënieve të mira midis Greqisë dhe Turqisë pas Luftërave Ballkanike, periudhë në të cilën Perandoria Osmane i cedoi Greqisë një pjesë të territoreve që ajo zotëronte në këtë rajon [Ballkan]. Ky akt ndërkombëtar sanksiononte të drejtat e banorëve myslimanë të këtyre territoreve.

¹²⁰ Minga 2006: 136; Sadiku 2011: 123.

¹²¹ Mourellos 1985: 389.

Traktati i Athinës shënon gjithashtu edhe nisjen e qëndrimit të dyanshëm grek ndaj të drejtave themelore të minoritetit dhe të njeriut për sa u përket popullsive të territoreve të ceduara nga Perandoria Osmane. Qëndrimi zyrtar grek, siç shihet në dispozitat e këtij akti ndërkombëtar, është tërësisht në përputhje me respektimin e këtyre të drejtave, në një kohë kur në terren aplikohet një qeverisje shtrënguese e cila nuk linte thuajse aspak hapësirë për respektimin e të drejtave të përmendura më sipër.

Në përmbajtjen e këtij traktati vihet re se banorët e territoreve të ceduara nga Turqia trajtoheshin vetëm në bazë të kriterit fetar, ashtu sikurse ndodhte dhe gjatë qeverisjes së Perandorisë Osmane. Me këtë ndryshim të juridiksionit territorial u anashkalua një e drejtë themelore e këtyre popujve siç ishte e drejta e identitetit të tyre kombëtar i cili nuk i përkiste atij turk, pasi sundimi i Perandorisë Osmane, ndonëse zgjati për shekuj me radhë, nuk arriti të ndryshonte identitetin kombëtar të shumicës dërrmuese të këtyre krahinave. Ky fakt vlente dhe për territorin çam, në të cilin Greqia duhet të aplikonte metoda të ndryshme të asimilimit dhe të spastrimit etnik për të arritur synimet e politikës së saj zyrtare.

Sipas nenit 3 të këtij akti ndërkombëtar, të gjithë personat të cilët kishin marrë pjesë në luftë më parë do të amnistoheshin e nuk do të përndiqeshin për asnjë arsye, dhe të gjitha sentencat juridike e administrative do të anuloheshin. E drejta e nënshtetësisë lihej nën vullnetin e individëve që do të kërkonin ndryshimet reciproke, nëse do të qëndronin turq ose grekë.¹²²

Neni 4 i Traktatit të Athinës i paraprinte marrëveshjes së vitit 1914 midis përfaqësuesit grek e atij turk për nisjen e shkëmbimit të popullsisë.¹²³ Ndonëse në dukje kjo dispozitë

¹²² Traktati i Athinës, 1913: neni 4.

¹²³ Culaj 2004: 167.

shprehte një liri që i jepej këtyre banorëve për të vendosur mbi të drejtën e nënshtetësisë, ai kontribuonte në mënyrë të tërthortë në realizimin e qëllimeve të spastrimit etnik dhe të homogjenizimit të territorit, pasi shtynte në largimin e personave që zgjidhnin këtë të drejtë, brenda një afati tre vjeçar nga territori grek ose ai turk pas zgjedhjes së nënshtetësisë së njërit prej këtyre vendeve.¹²⁴

Në nenin 15 të Protokollit nr.3 të këtij traktati, sanksionohet e drejta për respektimin e shkollave private të Myslimanëve, ku gjuha e mësimi do të bëhej në turqisht, dhe gjuha greke ishte e detyrueshme për t'u mësuar. Asnjë gjuhë tjetër përveç kësaj nuk përmendet në tekstin e këtij traktati.

Përtej nismës ligjore të Traktatit të Athinës, gjendja në Çamëri nuk ishte në pritshmëritë e duhura. Vështirësitë e çamëve, përveç autorëve shqiptarë, u vunë edhe në vëmendjen e autorëve të huaj. Në vitin 1916, Arnoux, autor i pavarur i disa prej gazetave të njohura të kohës, vinte re dëshirën e hershme të Greqisë për shtrirjen e saj territoriale, pavarësisht vështirësive financiare që po haste.¹²⁵

Çamët pas Traktatit të Athinës u quajtën subjekte greke. I njëjti traktat e lejonte këtë popullsi të merrte nënshtetësinë turke duke e lënë atë greke.¹²⁶ Duke u bazuar në faktin se çamët kishin qënë të pushtuar nga Perandoria Osmane në një periudhë për më shumë se katër shekulle, kjo dispozitë ligjore mund të ndikonte në vendimet e mëtejshme të tyre për të

¹²⁴ Ibidem.

¹²⁵ Isufi 2007: 205.

¹²⁶ Në kuadër të bisedimeve mbi shkëmbimin e popullsive greko-turke, në vitin 1924, qeveria greke pranoi detyrimin ligjor që kishte për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të popullsisë shqiptare duke u shprehur se atyre nuk iu ishte dhënë e drejta në këtë kohë për të zgjedhur nënshtetësinë shqiptare pasi ky shtet nuk ishte i njohur në këtë periudhë. Shih: AQSH, Fondi 251, Dosja 81, Viti 1924, f. 22-23. Notë Verbale Kundër Ndërhyrjes së Qeverisë Shqiptare për çështjen e Shqiptarëve të Greqisë si dhe kundër veprimeve të autoriteteve Greke ndaj kësaj popullsie.

rimarrë nënshtetësinë turke. Me fjalë të tjera, ky nen ndikonte në manipulimin e masave, pasi pushtimi grek mbi ta ishte i ashpër dhe largimi i qeverisjes turke shihej si një shpëtim nga shteti i cili, sidoqoftë, kishte ndikuar sadopak në krijimin e identitetit fetar e kulturor të tyre. Në këtë mënyrë, dispozita e përmendur më sipër (Traktati i Athinës: neni 4) ndihmonte në plotësimin e politikave asimiluese greke, nën sfondin e marrëveshjes së negociuar në 14 maj 1914, midis Venizelosit dhe Galip Beut për shkëmbimin e popullsisë greko-turke.¹²⁷ Në këtë marrëveshje, Turqia ishte e interesuar për të përfshirë popullsinë e banorëve grekë të Vilajetit të Ajdinit me banorët myslimanë të Maqedonisë dhe të Epirit.¹²⁸ Ndryshe nga qëndrimi i autoriteteve greke, Turqia kërkonte më me ngulm zbatimin e shkëmbimit të popullsisë, sipas autorit grek Mourellos, si një mjet për ruajtjen e identitetit të saj kombëtar.¹²⁹

Në notën verbale që Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë i dërgoi Legatës së Perandorisë Osmane në Athinë më 23 Maj 1914, shpjegoi modalitetet që duheshin zbatuar gjatë procedurave të shkëmbimit. Në fillim të kësaj shkrese, Ministria Greke shprehu vullnetin e saj për të shkëmbyer vetëm ata persona që do të shprehnin dëshirën e tyre për t'u përfshirë në këtë proces.¹³⁰ Sipas kësaj ministrie, kjo marrëveshje do të mund të zbatohet vetëm pasi të kishte përfunduar shpërngulja e detyruar e popullsisë greke nga Azia e Vogël dhe Thraka, si një "*conditio sine qua non*".¹³¹ Duke parë vazhdimin e masakrave dhe mërgimit të detyruar të Grekëve nga Turqia, përfaqësuesi i Greqisë deklaronte se jo vetëm marrëveshja e shkëmbimit të popullsisë në bazë të vullnetit të lirë nuk mund të zbatohet, por

¹²⁷ Culaj 2004: 167.

¹²⁸ Mourellos 1985: 393.

¹²⁹ Ibidem: 390.

¹³⁰ Ibidem: 394.

¹³¹ Ibidem.

fluksin e madh të refugjatëve greke ajo do ta sistemonte në tokat e zotëruara më parë nga myslimanët që kishin emigruar tashmë jashtë Greqisë.¹³²

Në vitin 1914, qeveria greke hartoi dy ligje të cilat konfiskonin pronat e myslimanëve të cilët ishin larguar nga Greqia ose i linin tokat të pa kultivuara.¹³³ Këto ligje ishin në kundërshtim me nenin 6 të Traktatit të Athinës, në të cilin deklarohet se *"titujt mbi pronën do t'iu njiheshin dhe personave të cilët kishin zhvendosur vendin e banimit në një vend tjetër jashtë Greqisë... gjithashtu, askujt nuk i hiqej e drejta e pronës, në asnjë formë, dhe pa një dëshmipërblim të drejtë"*.¹³⁴

3.4 Pushtimi Italian në Çamëri (1917)

Autorizimi për pushtimin italian në Çamëri u dha më 30 Maj të vitit 1917.¹³⁵ Për çamët ky pushtim, ndonëse zgjati pak muaj, u lejoi atyre të gëzonin të Drejtat dhe Liritë Themelore të munguara që prej vitit 1913. Respektimi i të drejtave të minoritetit çam në Greqi ishte një dukuri e panjohur për shtetit grek, për aq sa dhe në korrespondencën diplomatike italiane të kohës del në pah trajtimi çnjerëzor që autoritet greke ushtronin ndaj çamëve.¹³⁶ Konsulli italian në Janinë, Nuvolari, e quante *"të zakonshëm"* ushtrimin e raprezaljeve nga autoritetet helene ndaj popullsisë siç ishin çamët myslimanë.¹³⁷ Ministri Italian Sforza deklaronte më 9 Korrik 1917, se popullsia shqiptare ishte viktimë e torturave dhe plaçkitjeve greke.¹³⁸

¹³² Ibidem: 395.

¹³³ Tsitselikis 2012: 292.

¹³⁴ Shih: Traktati i Athinës.

¹³⁵ Anchieri dhe Curato 1980: 107, dok. 153.

¹³⁶ Ibidem: 362, dok. 565; f. 376, dok. 589; f. 393, dok. 623.

¹³⁷ Ibidem: 362, dok. 565.

¹³⁸ Ibidem: 376, dok. 589.

Përpara mbërritjes së trupave italiane në Çamëri, populli shqiptar shpresonte në ndryshimin e vendimit të Konferencës së Londrës (1913), dhe krijimin e shtetit shqiptar sipas kufijëve të tij etnikë. Për këtë arsye, kjo prani ushtarake u vlerësua së tepërmi nga vendasit, dhe ringjalli tek ta shpresën për realizimin e bashkimit të kombit nën një shtet.¹³⁹

Komandanti i trupës ushtarake italiane në Shqipëri, Ferrero, i dërgoi një letër Ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë (31 Maj 1917), në të cilën paraqitej për sugjerim deklarata e çlirimit të Shqipërisë (3 Qershor 1917) nga zgjedha e huaj¹⁴⁰, pasi Italia nuk ishte më e gatshme që të zbatonte Traktatin e Fshehtë të Londrës (1915), për shkak të zgjerimit sllav në Ballkan.¹⁴¹ Ndonëse Italia kishte interesat e saj ndaj Shqipërisë, në këtë deklaratë theksoheshin mohimet e të drejtave themelore që i ishin bërë kësaj popullsie. Deklarata vijonte me tekstin: *"... tani ju mund të administroni pronat tuaja, të ardhurat tuaja, frutet e punës suaj për të mirën tuaj. Do të keni institucione publike, gjykata, shkolla të drejtuara nga qytetarë shqiptarë sipas udhëzimeve të funksionarëve italianë"*.¹⁴²

Duke qënë se qëndrimi Italian në Çamëri ishte i shkurtër, autoritetet italiane druheshin se me largimin e tyre Greqia do të mund të keqtrajtonte përsëri popullsinë vendase e cila kishte treguar një mbështetje të fortë për praninë e tyre. Më 7 Korrik 1917, konsulli i përgjithshëm i Italisë në Janinë, Nuvolari, njoftonte Ministrin Sonnino mbi mundësinë e ushtrimit të dhunës nga autoritetet greke ndaj popullsive që kishin shprehur mbështetjen e tyre për pushtimin italian, ndër të cilëve ishin edhe çamët mylsimanë.¹⁴³ Për këtë arsye,

¹³⁹ Minga 2006: 115.

¹⁴⁰ Anchieri dhe Curato 1980: 114, dok. 165.: Shih: Stickney [1926] 1998: 115-118.

¹⁴¹ Stavrianos 1958: 711.

¹⁴² Ibidem.

¹⁴³ Ibidem: 362-363, dok. 565.

konsulli i kërkonte ministrit mbështetje për të përjashtuar në të ardhmen çdo mundësi të ushtrimit të dhunës nga autoritetet greke ndaj këtyre popullsive.¹⁴⁴

Ndërkohë, gjatë pranisë ushtarake italiane në Çamëri, popullsia vendase shprehu solidarësinë e saj me anë të një sërë manifestimeve. Më 27 Korrik 1917, në Filat u organizua një miting i madh.¹⁴⁵ Myftinjtë u paraqitën pranë autoriteteve italiane duke i falenderuar për mënyrën sesi po i trajtonin myslimanët në këtë periudhë të pushtimit të tyre.¹⁴⁶ Të njëjtën shfaqje të mirënjohjes ndaj pushtimit italian e treguan dhe Hebrejtë.¹⁴⁷

Në një raport të datës 30 Korrik 1917, që Fazi i dërgonte Gjeneralit Ferrero, përshkruhej mënyra sesi autoritetet Greke i trajtonin popullsitë jo-greke.¹⁴⁸ Përsa i përket myslimanëve të Epirit, thuhej se drejt tyre ushtrohej dhunë e "*...padëgjuar më parë... drejt burrave e grave...*", që prej aneksimit të krahinës nga autoritetet greke, ku përdorehin edhe metoda si shkatërrime, dhe vjedhje.¹⁴⁹ Për këtë arsye, popullsia e kësaj krahine e pa praninë ushtarake italiane si një çlirim.¹⁵⁰ Për më tepër, në këtë raport sillet në vëmendje një vëzhgim krahasues i pasojave të pushtimit Osman me pasojat e aneksimit Grek, një vërtetim i ngjashëm është pasqyruar dhe në shkrimet e Jorgos Margaritis e Lambros Balitsiotis.¹⁵¹ Fazi, komandanti italian, raportonte bisedën më një funksionar të lartë i cili kishte punuar më parë

¹⁴⁴ Ibidem.

¹⁴⁵ Colonna di Cesaro 1922: 179.

¹⁴⁶ Ibidem: 176-178. Roli i Myftinjve është i debatueshëm, pasi ata siç u shprehën në mbështetje të pushtimit Italian, për të cilin faktet tregojnë se ishte një "qeverisje" që mbronte të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në kundërshtime atë çka qeveria greke u kishte ofruar deri në ato momente myslimanëve, në të njëjtën mënyrë, ata [kleri mysliman] mbrojtën edhe qeverisjen greke sidomos gjatë viteve '20 '30, në një kohë kur faktet nga burime të ndryshme të kohës, pasqyrojnë një realitet të përdhënë për çamët. Për më tepër shih seksionin "4.4. Qeverisja Greke në Çamëri gjatë Shkëmbimit të Popullsive Greko-Turke" -Myftinjtë.

¹⁴⁷ Colonna di Cesaro 1922: 179.

¹⁴⁸ Ibidem: 88-90.

¹⁴⁹ Ibidem: 89.

¹⁵⁰ Ibidem: 90.

¹⁵¹ Shih: Margaritis 2009: 117; Baltsiotis 2011: 2.

për autoritetet greke. Në këtë bisedë thuhej se *"shtypja që pushtimi Osman kishte sjellë në këto zona, ishte tejkaluar në masë vetëm për katër vjet që prej aneksimit dhe qeverisjes Greke"*.¹⁵² Nga ana tjetër, autoritetet greke kishin ngritur një regjim financiar të vështirë për llojin e ekonomisë vendase, e cila konsiderohej "e prapambetur".¹⁵³ Ky regjim ishte i papërballueshëm për popullsinë, në një kohë kur autoritetet qendrore e vendore nuk kishte investuar në veprat publike të zonës dhe nevojat e menjëherëshme që kishte popullsia vendase.¹⁵⁴ Gjatë katër viteve të qeverisjes greke, ashtu siç ndodhte dhe nën administrimin turk, pasi paguheshin funksionarët publikë, pjesa tjetër i dërgohej qeverisë qendrore.¹⁵⁵

Ndërsa, me ardhjen e italianëve në Çamëri u morën një sërë masash lehtësuese për popullsinë vendase. Ata filluan të gëzonin të drejtat e tyre themelore, civile dhe ekonomike, pa dallim kombëtar apo fetar.¹⁵⁶ U lejua vendosja e flamurit Shqiptar në hapsirat publike, u hapën shkollat e para në Filat e Galbaq, dhe në drejtimin e institucioneve u vendosën shqiptarë ndonëse të gjitha këto ishin nën mbikëqyrjen e autoriteteve italiane.¹⁵⁷ Por, Italia nuk arriti të qëndronte në këtë territor për më tepër se disa muaj. Largimi i saj nga Çamëria dhe trojet e tjera Shqiptare, vinte si pasojë e kundërshtimit të Presidentit Uilson, por dhe për shkak të dobësimit të saj në përfundim të Luftës së Madhe.¹⁵⁸ Për këto arsye, ajo vendosi si më të udhës të arrinte marrëveshje me fqinjët e Shqipërisë sesa të qëndronte në këto territore.

Përtej marrëveshjeve për përfitime territoriale që ajo synonte të siguronte në këtë

¹⁵² Colonna di Cesaro 1922: 92.

¹⁵³ Ibidem.

¹⁵⁴ Ibidem: 92, 103.

¹⁵⁵ Ibidem: 103.

¹⁵⁶ Ibidem.

¹⁵⁷ Akademia e Shkencave e Shqipërisë 2007: 498; Anchieri dhe Curato 1980: 113, dok. 165.

¹⁵⁸ Stavrianos 1958: 712.

periudhë, në burimet arkivore italiane shkruhet se autoritetet e këtij vendi do të siguroheshin që Greqia të mos e keqtrajtonte popullsinë e cila më parë kishte treguar mbështetje ndaj trupave ushtarake italiane. Në njoftimin e datës 16 Gusht 1917, me rastin e largimit të tyre nga Çamëria, ministri Sonnino siguronte ministrin Sforza se do të ndiqte me kujdes premtimin e qeverisë Greke e cila ishte shprehur se nuk do të ushtronte asnjë raprezalje kundrejt popullsisë që ishin treguar më parë mbështetës të italianëve.¹⁵⁹ Pas ikjes së kësaj ushtrie nga Çamëria, historiani Minga shkruan se grekët vijuan me një vale tjetër masakrash, vrasjesh e plaçkitjesh, të cilat ishin ndërprerë gjatë pushtimit italian.¹⁶⁰ Ministri Italian Sforza deklaronte se ikja e trupave italiane ishte një braktisje ndaj çamëve.¹⁶¹,

3.5 Çështja Çame dhe Konferenca e Paqes në Paris 1919

Konferenca e Paqes në Paris ishte forumi ndërkombëtar politik i rradhës ku çamët shpresuan për rivendosjen e të drejtave të mohuara më parë, që prej Konferencës së Londrës 1913. Historiani amerikan Schevill shkruan se kjo konferencë “nuk përbën ndonjë objekt interesi të veçantë për Ballkanin”.¹⁶² Por, përfaqësuesit e Shqipërisë edhe të Çamërisë u angazhuan në mënyrë të pandalur për realizimin e kërkesave të tyre pranë këtij forumi ndërkombëtar. Këto kërkesa kishin të bënin me:

1. Rivendosjen e kufijve etnikë të Shqipërisë

¹⁵⁹ Anchieri dhe Curato 1980: 599, dok. 865.

¹⁶⁰ Minga 2006: 116, 117.; Ndonëse ata kishin marrë premtimin e autoriteteve greke se nuk do të ushtrohej raprezalje ndaj popullsisë që kishte shprehur mbështetjen e saj për trupat italiane, këta të fundit e kishin parashikuar, disa javë përpara këtij fakti, rikthimin e keqtrajtimit të autoriteteve greke ndaj këtyre popullsisë fill pas ikjes së tyre. Shih Anchieri dhe Curato: 393, dok. 623.

¹⁶¹ Anchieri dhe Curato 1980: 376, dok. 589.

¹⁶² Schevill 2002:406.

2. Caktimin e një komisioni ndërkombëtar për të bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në krahinat shqiptare prej forcave pushtuese greke dhe serbe.¹⁶³
3. Si dhe dhënien e një mandati të paktën një vjeçar Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në mënyrë që përpara largimit të tyre të mund të mbahej një plebishit ku populli të kishte mundësinë të shprehej për të ardhmen e vetë, duke nënkuptuar se në cilin juridiksion do të dëshironte të qëndronte.¹⁶⁴

Mirëpo, me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, konceptet "idilike" të shpallura nga Presidenti Uilson ishin tepër të vështira për t'u zbatuar në praktikë. Çamëria dhe Kosova ishin dy krahinat më të mëdha të lëna jashtë kufijve të Shqipërisë. Pavarësisht të gjitha lëvizjeve të ndërmarra nga elementi shqiptar në këtë konferencë, çështja çame u përmend vetëm në një dialog midis Mehmet Konicës dhe Mihal Turtullit gjatë sesionit të dëgjimit në Komisionin për çështjet greke, të cilët deklaruan me vendosmëri që ndërgjegja kombëtare e banorëve të Çamërisë ishte shqiptare dhe aspak greke, po ashtu, Greqia po kërkonte një krahinë që asaj nuk i takonte.¹⁶⁵ Duke u nisur që nga ky fakt, çështja çame ashtu sikurse dhe çështja shqiptare nisi e disavantazhuar pasi interesat shqiptare u trajtuan në varësi të interesave greke, përtej faktit që Shqipëria ishte një territor neutral gjatë Luftës së Parë Botërore, e nuk mund të shpaloste interesa gjeostrategjike ashtu sikurse fqinjët e saj.

Gjendja në Çamëri ishte e tensionuar, pasi një sërë trupash e bandash greke ishin vendosur në këtë krahinë, ashtu sikurse dhe në kufirin shqiptaro-grek. Qëllimi i vendosjes së tyre

¹⁶³ Për më tepër shih: Krisafi 2009: 21-33.

¹⁶⁴ Për më tepër shih: Silajxhiç 1999: 105-121.

¹⁶⁵ Puto 2001: 169.

synonte reagimin e Greqisë në rast se Epiri i Veriut, i shumë kërkuar prej saj ndër vite do t'i jepej Shqipërisë.¹⁶⁶

Në këtë periudhë, konsulli italian në Janinë, Nuvolari i raportonte ministrit të Punëve të Jashtme të vendit të tij, Sonnino-s, mbi vendosjen e 400 trupave ushtarake greke në Çamëri, në mënyrë që të ndalonin çdo përpjekje të myslimanëve të kësaj krahine që mund të kishte për qëllim bashkimin me Shqipërinë.¹⁶⁷ Në njoftimin e datës 30 Janar, konsulli italian informonte qeverinë e tij në lidhje me bisedën që kishte zhvilluar me Guvernatorin e Përgjithshëm të Epirit, Stergiadesin, i cili ishte i interesuar së tepërmi për shtimin e trupave ushtarake greke në vijën kufitare të Protokollit të Firences (1913), dhe në Çamëri gjithashtu, në mënyrë që të parandalonte çdo lëvizje të shqiptarëve, të cilët sipas tij ishin të organizuar në formacione të parregullta, ndonëse kjo deklaratë u hodh poshtë prej përfaqësuesit italian, Nuvolarit.¹⁶⁸ Sipas përfaqësuesit italian (30 Janar 1919), ky shtim i trupave ushtarake kishte të bënte me planin që qeveria greke kishte në këtë kohë për aneksimin e territoreve të tjera të Shqipërisë së Jugut. Duke neutralizuar çdo mundësi të një kryengritje të çamëve, shtimi i trupave greke në kufi me Shqipërinë, ndihmonte më tej në ecurinë e planeve të saj për zgjerimin territorial.¹⁶⁹

Pavarësisht këtyre zhvillimeve aktorët politikë shqiptarë bënë një sërë përpjekjesh të cilat kishin për qëllim që rivendosnin në vend të drejtat e popullit shqiptar të mohuara më parë për shkak të zgjedhës së huaj, e sidomos të vendeve fqinje si Serbia e Greqia. Në këtë sfond, vlejnë të përmenden përpjekjet e çamëve të cilët rreth gjashtë vite pas aneksimit, ende

¹⁶⁶ Grispo 1980: 565, dok. 771.

¹⁶⁷ Ibidem: 82, dok. 128.

¹⁶⁸ Ibidem: 109, dok. 166.

¹⁶⁹ Ibidem.

nuk kishin gjetur rrugën e duhur për gëzimin e të drejtave themelore që iu takonin si individë, por dhe si minoritet. Një rol i rëndësishëm gjatë kësaj kohe u luajt kryesisht nga diaspora shqiptare dhe çame në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndërkohë, shoqëri të ndryshme u krijuan për këtë qëllim. Shoqëria Çamëria dhe Partia Kombëtare Shqiptare u krijuan në Worcester, "Vëllazëria" në Hartford, ndërsa në Shqipëri, shoqëria "Vëllazëria Shqiptare", "Të shpëtojmë Çamërinë", "Të mos harrojmë Çamërinë", u krijuan pas Luftës së Parë Botërore.¹⁷⁰ Në mbështetje të këtyre lëvizjeve, në vitin 1919 u krijua Komiteti i Bashkuar i Shqiptarëve në Zvicër.¹⁷¹

Pjesa më e madhe e shqiptarëve të përfshirë në këtë angazhim, mori pjesë në formë të shkruar në këtë konferencë, që në ditët e parë të hapjes së punimeve të saj. Në 18 Janar, gazetat shqiptare në Shtetet e Bashkuara raportojnë mbi një letër që Zj. Dako, bashkëthemeluesja e Partisë Kombëtare Shqiptare në Worcester, i dërgonte kryetarit të Konferencës së Paqes. Në këtë letër, ajo protestonte për kërkesat greke mbi Epirin e Veriut, duke kërkuar në të njëjtën kohë njohjen e Shqipërisë nën kufijtë e saj etnikë, ndryshe nga ç'ishte vendosur në Konferencën e Londrës më 1913.¹⁷² Veprimi i radhës kishte të bënte me një telegram që përfaqësues çamë i dërgonin Z. Clemencau, kryetarit të Konferencës, Presidentit Wilson, Baronit Sonnino, LLOYD George-it, dhe Saionji Kinmochi-t. Në këtë shkresë, ata denonconin vendimet e padrejta të Konferencës së Londrës (1913), duke theksuar vuajtjet nga persekutimi nën juridiksionin e huaj, dhe në të njëjtën kohë kërkonin bashkimin me Shqipërinë. Firmëtarët e këtij peticioni, ishin Beqo Izeti, kryetari i shoqërisë Çamëria, Mete Sejko, Isuf Hyseni, Omer

¹⁷⁰ Akademia e Shkencave e Shqipërisë 2007: 499.

¹⁷¹ Ibidem.

¹⁷² Isufi 2007: 217.

Bako, Refo Çapari, dhe Gazali Dino.¹⁷³ Letrat që Sevasti Qirjazi dhe bashkëshorti i saj Kristo Dako i kishin dërguar edhe Presidentit Uilson, ishin marrë prej tij ashtu sikurse dhe telegramët e tjera në lidhje me çështjen shqiptare, sipas sekretarit të Presidentit.¹⁷⁴

Pas hapjes zyrtare të Konferencës, Shoqëria Anglo-Shqiptare i dërgoi një notë gazetës "The Times", duke theksuar se shqiptarëve po iu mohohet e drejta e dëgjimit në këtë forum ndërkombëtar, në një kohë kur palë të tjera ishin ftuar për të marrë pjesë në të.¹⁷⁵ Përtej faktit që Shqipëria u paraqit më vonë në konferencë me një delegacion të mandatuar nga Qeveria e Durrësit, përfaqësimi i saj ngjalli disa debate, për shkak se nuk njihej legjitimiteti i këtij përfaqësimi, po ashtu në të morën pjesë edhe disa përfaqësi të tjera. Gjatë punimeve të kësaj konference, Esad Pasha deklaroi se Konferenca e Parisit do t'i bënte një padrejtësi shqiptarëve nëse do të njihte delegacionet e Turhan Pashës dhe të Halil Pashës.¹⁷⁶ Një shprehje e tillë tregonte një përçarje të thellë në përfaqësimin e çështjes shqiptare, e cila nuk ndihmonte aspak në objektivat e përcaktuara nga qeveria e Durrësit dhe Diaspora.¹⁷⁷ Duke iu referuar kësaj periudhe, një ndër personalitetet e kohës, Eqerem Bej Vlora theksonte se Shqiptarët nuk kishin asnjë mjet për organizimin e shtetit.¹⁷⁸

Përfaqësimi i Shqipërisë në këtë forum ndërkombëtar nuk kishte lënë "përshtypje të mira", pasi mendohej se përfaqësuesit shqiptarë kërkonin krijimin e një Turqie të vogël, ose

¹⁷³ Ibidem: 228.

¹⁷⁴ Dishnica 2004: 247.

¹⁷⁵ Destani dhe Tomes 2012: 319.

¹⁷⁶ IAYE. Zyra Qëndrore. A Politiki A/5/II 11, Për Shqipërinë, Gazeta "La Tribune". *Declarations d'Essad Pacha sur les Pretendues Delegations Albanaises*. [Deklaratat e Esad Pashës mbi Delegacionet e Pretenduara Shqiptare]. (27 Shkurt 1919).

¹⁷⁷ Për më tepër shih: "Kërkesa e Esat Pashës, f. 30 në Krisafi, 2009, *Kreu I- Kërkesa Shqiptare për dëmshpërblime lufte në Konferencën e Paqes (1919-1920)*."; Shih gjithashtu Siljxhiç: 75, 142-148: Shih gjithashtu: Stickney [1926] 1998: 159-160.

¹⁷⁸ Bej Vlora 2010: 440.

të një province italiane¹⁷⁹, në vend të një shteti shqiptar të qëndrueshëm për të krijuar strukturat e veta të pavarura nga fuqitë e sipërpërmendura. Pavarësisht këtij fakti, pala shqiptare u dëgjua. Përfaqësuesi britanik në panelin e komisionit për çështjet greke tha se nuk ishte e përshtatshme që të dëgjoheshin të gjitha palët e përfshira, por ato mund të shprehnin kërkesat e tyre në formë të shkruar, duke i shtuar kësaj kohe dhe 15 minuta në mënyrë që të shpjegonin idetë e tyre.¹⁸⁰ Në kohën kur delegati amerikan deklaroi dakordësinë e tij për të dëgjuar palën shqiptare, përfaqësuesi francez Laroche tha se nuk kishte një delegacion zyrtar për këtë vend.¹⁸¹ Megjithatë, pala shqiptare u pranua për t'u paraqitur përballë panelit edhe si rrjedhojë e dakordësisë së shprehur nga përfaqësuesit e tjerë.

Përpara sesionit të dëgjimit të datës 27 shkurt 1919, një memorandum i datës 12 Shkurt, i hartuar nga qeveria shqiptare shprehu besimin në drejtësinë e vendimeve që do të jepte Konferenca e Paqes. Pas kësaj, ata kërkuan vendosjen e kufijve etnikë të Shqipërisë, dhe gjithashtu kërkuan reparacione për një numër fshatrash të Shqipërisë Jugore të djegura nga forcat Greke.¹⁸²

Memorandumi i dytë i datës 24 Shkurt shprehte të njëjtat kërkesa. Në lidhje me Çamërinë, në të hidheshin poshte kërkesat Greke mbi Epirin e Veriut, siç ata shpjegonin *"këto kërkesa synonin të detyronin Shqiptarët që të hiqnin dorë nga kërkesat për Epirin e Jugut, sidomos Çamërinë"*.¹⁸³ Kjo ide ishte pjese e një rezolute e cila u raportua gjithashtu në

¹⁷⁹ Dishnica 2004: 249.

¹⁸⁰ Puto 2001: 158.

¹⁸¹ Ibidem: 158-159.

¹⁸² AQSH, Fondi 251, Dosja 10, Viti 1919, f. 22-25. *Memorandum i Paraqitur Fuqive të Mëdha për Njohjen e Territoreve Shqiptare të Shkëputura Padrejtësisht*. (12 Shkurt 1919)

¹⁸³ Naska 1999: 39

gazetën Albania në 27 Mars të atij viti.¹⁸⁴ Në këtë rezolutë, autori i ftonë palët t'i dërgonin peticione Presidentit Uilson, si e vetma mënyrë për një zgjidhje të çështjes shqiptare, duke nënkuptuar dhe çështjen çame.¹⁸⁵ Në mbështetje të kësaj pikëpamje (në kundërshtim me kërkesat Greke për Epirin e Veriut, dhe kundër paraqitjes së Karapanosit si deputet i rajonit në fjalë), disa shqiptarë të fesë së krishterë, të lindur në rajonin e ashtu-quajtur Epiri i Veriut, i dërguan një letër kryetarit të delegacionit Britanik të Konferencës së Paqes më 5 Korrik.¹⁸⁶

Në seancën e dëgjimit, ku mori pjesë dhe delegacioni shqiptar, Mehmet Konica paraqiti disa informacione mbi Çamërinë. Ai deklaroi se *"Çamëria është e banuar kryesisht nga Shqiptarët, dhe Shqiptarë Myslimanë, që do të thotë se nuk ka vend për ndërgjegjen kombëtare greke..."*.¹⁸⁷ Përpara kësaj deklarate, Venizelos ishte paraqitur përballë panelit të këtij komisioni duke deklaruar idenë se kombësia bazohet vetëm në ndërgjegjen kombëtare.¹⁸⁸

Duke iu rikthyer deklaratës së Konicës, Turtulli, i pranishëm në të njëjtën seancë deklaroi se Greqia në emër të kombësisë po kërkonte shumë gjëra; në një kohë kur ajo duhet të ishte treguar më koherente ndaj këtij parimi duke i rikthyer Shqipërisë Çamërinë, një territor që nuk i përket asaj [Greqisë]. Në të njëjtin takim, Turtulli u ndal në deklaratën e Venizelosit duke vënë në dukje përmendjen e një sërë personalitetesh shqiptare nga ana e përfaqësuesit të Greqisë, ndër të cilët ishin edhe funksionarë të lartë të këtij shteti.¹⁸⁹ Në pyetjen që i ishte bërë gjatë punimeve të këtij kongresi mbi faktin që popullsia e Epirit të

¹⁸⁴ Isufi 2007: 239.

¹⁸⁵ Ibidem: 241.

¹⁸⁶ Destani dhe Elsie 2013: 59.

¹⁸⁷ Puto 2001: 169.

¹⁸⁸ Venizelos 1919: 3.

¹⁸⁹ Puto 2001:168.

Veriut fliste dhe kishte si gjuhë amtare gjuhën shqipe dhe jo atë greke, Venizelos e kishte pohuar këtë fakt, gjithashtu edhe prejardhjen e tyre shqiptare, por në vijim deklaronte se *"faktori vendimtar ishte kultura dhe feja e tyre, e cila ishte greke"*.¹⁹⁰ Nga ana tjetër, edhe delegacioni i Epirit të Veriut, prezantoi pozicionin e tij në lidhje me çështjen e polemizuar midis Greqisë dhe Shqipërisë, në lidhje me kufirin midis tyre. Karapanos, në këtë takim deklaroi se Epirotët nuk kishin kërkuar asnjëherë kombësinë shqiptare.¹⁹¹ Në mbështetje të deklaratës së tij, ai iu referua Filatit si një shembull. Në kundërshtim me këtë deklaratë, mund t'i referohemi qëndrimit të Konicës i cili deklaroi se në këtë krahinë (në Çamëri) ndërgjegjia kombëtare greke nuk gjente vend për shkak të vetë përbërjes demografike dhe kulturore të saj.¹⁹²

Të gjithë përfaqësuesit grekë shpreheshin se elementi grek ishte mbizotërues në Shqipërinë e Jugut, dhe ky fakt sipas tyre ishte pasi gjatë qeverisjes Osmane në këto territore kishte patur vetëm shkolla greke. Mirëpo, duhet theksuar fakti se gjatë kësaj qeverisje popujt njiheshin në bazë të fesë së tyre në vend të kombësisë, dhe për këtë arsye, Grekët si ortodoksë, u lejuan të kishin shkollat e tyre.¹⁹³ Shqiptarëve nuk iu lejua kjo e drejtë gjatë kësaj kohe. Shqiptarët ortodoksë, nga ana e tyre, ishin në numër të pakonsiderueshëm. Si pasojë e kësaj, shkollat greke mbizotëronin gjatë kësaj kohe në rajon.¹⁹⁴

¹⁹⁰ Krisafi 2014: 211; Divani 1995: 261; Venizelos 1919: 2, 3; Një qëndrim të njëjtë shfaqti edhe Kasavetis, kryetari i shoqatës Pan-Epirote në SHBA. Shih: Dishnica 2004: 247, i cili deklaroi se: "...Në SHBA ka rreth 60,000 Epirotë, të cilët megjithëse flasin shqip, janë grekë..."; Shih: Stickney [1926] 1998: 152; Gurakuqi 2007: 206.

¹⁹¹ Puto 2001:170.

¹⁹² Puto 2001: 169.

¹⁹³ Ibidem: 19.

¹⁹⁴ Ibidem.

Pas memorandumit të muajit shkurt, lëvizja diplomatike e rradhës ishte kërkesa për dhënien e një mandati Amerikan në territorin shqiptar, në përfundim të të cilit popullsia vendase do të mund të kishte mbajtur një plebishit.¹⁹⁵ Gjatë kësaj kohe, përfaqësuesit shqiptarë kishin filluar të kuptonin se Komisioni mbi çështjet greke nuk po i konsideronte siç duheshin kërkesat e tyre, për këtë arsye ata zgjodhën të ftonin Shtetet e Bashkuara për të administruar territoret e lakmuara për një ose dy vjet. Në përfundim të kësaj periudhe popullsia e këtyre rajoneve do të mund të kishte patur një mundësi për t'u shprehur lirisht e për të vendosur vetë për të ardhmen e saj. Gjithashtu, duke u bazuar edhe në parimet liberale të deklaruara nga Presidenti Wilson mbi vetëvendosjen e popujve.¹⁹⁶

Në 13 Mars, në Worcester, gjatë mbledhjes vjetore të Partisë Kombëtare Shqiptare, kryetari Dako, dhe përfaqësuesit e saj votuan unanimitisht për tre rezoluta. E para kishte për qëllim informimin e Presidentit Uilson dhe të Fuqive të Mëdha për njohjen e shtetit Shqiptar me kufijtë e tij etnikë. E dyta, informonte në lidhje me protestën kundër çdo fragmentimi të mëtejshëm të Shqipërisë. E treta, ishte për vendosjen e një komisioni ndërkombëtar i cili do të mund të vlerësonte dëmet që iu shkaktuan Shqipërisë gjatë Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Madhe.¹⁹⁷

Pas kësaj lëvizje, përfaqësues çamë si Arif Çami, Ahmed Çamëria, Qemo Preveza, Xhevit Ajdonati, i dërguan një letër përfaqësuesve kryesorë të Konferencës, në të cilën ata dënonin aktet e autoriteteve Greke në Çamëri. Përfaqësuesit kërkuan përsëri dhënien e një

¹⁹⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 14, Viti 1919, f. 22. *Notë Shtesë e Qeverisë së Durrësit me Propozimin për Plebishit në Trojet Shqiptare të Rivendikuara*. (7 Mars 1919); Le Temps, 1919, 03.06 (pa autor).

¹⁹⁶ Ibidem.

¹⁹⁷ AQSH, Fondi 30, Dosja 7, Viti 1919, f. 18. *Kërkohet Restaurimi i Shtetit Shqiptar mbi Baza Etnografike duke Përfshirë Kosovën dhe Çamërinë*. (13 Mars 1919)

mandati qeverisës Shteteve të Bashkuara, duke besuar se autoritetet e saj do të mund të shqyrtonin nga afër gjendjen e popullsisë, dhe në këtë mënyrë mund të nxirrej e vërteta e situatës, dhe e fakteve të denoncuar nga përfaqësuesit shqiptarë.¹⁹⁸

Në vijim, përfaqësues të tjerë çam kërkuar dërgimin e Rasih Dinos¹⁹⁹ në këtë Konferencë, e cila po pengohej ndërkohë.²⁰⁰ Për këtë ata i përçollën një telegram Titonit, kryetarit të delegacionit italian në këtë Kongres, si dhe kopjet përkatëse iu dërguan Uilsonit, Castoldit, dhe Clemenceau-it.²⁰¹ Ata i kërkuar përfaqësuesit italian që të ndikonte në mbështetje të çështjes shqiptare gjatë seancave të Konferencës së Paqes (1919).

Në 22 Maj 1919, kryetari i shoqatës Çamëria në Worcester i dërgoi një letër Presidentit Wilson, duke kërkuar me insistim mbështetjen e tij për bashkimin e Çamërisë me territorin e shtetit Shqiptar si një mënyrë për të garantuar paqen në rajonin Balkanik.²⁰²

Kryetari i ri i delegacionit shqiptar pranë Konferencës, Luigj Bumçi, i dërgoi një peticion Clemenceau-it në 25 Korrik, duke vënë në pah mohimin e të drejtave themelore të Çamëve, të cilat sidoqoftë ishin sanksionuar më parë në Traktatin e Athinës midis Greqisë e Turqisë më 1913.²⁰³ Në vijim të kësaj shkrese, Haxhi Murat Çami e përgëzoi Imzot Bumçin

¹⁹⁸ AQSH, Fondi 251, Dosja 14, Viti 1919, f. 42. *Letër në të cilën Theksohen Masat e Rrepta të Marra nga Grekët ndaj Çamërisë, si edhe kërkesa për dërgimin e një Komisioni Anketimi në Vend.* (21 Mars 1919)

¹⁹⁹ Faik Konica për Menesdorf deklaronte: *“Rasih Bej Dino ishte djalë i ish-Ministrit të Punëve të Jashtme Abedin Pashë Dino, i cili më vonë trashëgoi pozitën e Valiut të Angorës dhe të Vilajetit të Ishujve, i cili ka lënë pas vetes një trashëgimi (pasuri) të madhe. Familja e tij (Dino), origjinën e ka nga Preveza...”* Zenelaj 2013: 271.

²⁰⁰ Isufi 2007: 245.

²⁰¹ Ibidem.

²⁰² Ibidem: 251.

²⁰³ AQSH, Fondi 251, Dosja 14, Viti 1919, f. 45-46. *Protestë me anën e së cilës Kërkohet Ndërhyrja e Zh. Klemansos pranë Qeverisë Greke për të mos vënë Pengesë për Tjetërsimin e Pasurive të Luajtshme e të Paluajtshme të Popullsisë Myslimane.* (25 Korrik 1919)

për qendrimin e tij, dhe i kërkoi atij ndihmën për të lehtësuar mbërritjen e Rasih Dinos, përfaqësuesit çam, në Paris.²⁰⁴

Në 16 Shtator, Komiteti Kombëtar Shqiptar në Zvicër i dërgoi një letër kryetarit të Komisionit të Senatit për Çështjet e Jashtme të Shteteve të Bashkuara, duke i kërkuar mbështetje për kërkesat e shqiptarëve nga ana e shtetit të madh *Liberal*, siç i quanin shqiptarët Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pasi ky vend shihej si mbrojtës i parimeve liberale, me anë të të cilave popujt e vuajtur do të mund të gjenin drejtësinë, megjithëse ky ishte një objektiv tepër i vështirë për t'u arritur.²⁰⁵ Ndërkohë, deri në këtë periudhë, çamët nuk kishin arritur të merrnin asnjë mbështetje konkrete nga aktorët kryesorë të politikës ndërkombëtare.

Përfaqësues të Komiteteve Kombëtare në SHBA, Kanada, dhe Zvicër, i dërguan një letër Presidentit të Komisionit të senatit amerikan për çështjet e jashtme. Në të ata shprehnin besimin në vlerat amerikane si mbrojtës të lirisë dhe paqes, duke iu referuar në veçanti Presidentit Wilson dhe deklaratës së tij mbi 14 Pikat.²⁰⁶ Ndër të tjera, ata vunë në dukje përsëri padrejtësitë që Greqia bënte vazhdimisht ndaj shqiptarëve.²⁰⁷ Ndërkohë, më datë 25 Tetor, Sir Eyre Crowe deklaroi se Komisioni Territorial i ngarkuar me përcaktimin e kufirit (Verior dhe Jugor të Shqipërisë) nuk vendosi në bazë të vlerësimeve etnografike.²⁰⁸ Në të njëjtin takim, Berthold deklaroi se nëse do të ndryshonin kufijtë e Shqipërisë, ndryshe nga ç'ishte përcaktuar në Konferencën e Londrës (1913), kjo duhet të vinte si pasojë e një vendimi politik.²⁰⁹

²⁰⁴ Isufi 2007: 255.

²⁰⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 9, Viti 1919, f. 318. *Peticion me anë të të cilit Kërkohet Rikonfirmimi i Pavarësisë Politike dhe Rikthimi i Çamërisë dhe i Kosovës Shqipërisë*. (16 Shtator 1919)

²⁰⁶ Naska 1999: 60, 61, dok. 26.

²⁰⁷ Ibidem.

²⁰⁸ Woodward dhe Burton 1948: 75.

²⁰⁹ Ibidem.

Më 19 Nëntor 1919, Zj. Lejla Dino, e bija e Rasih Dinos i dërgoi një letër zj. Wilson duke i kërkuar asaj të ndikonte pranë Presidentit në lidhje me çështjen shqiptare.²¹⁰ Në këtë letër, Zj. Dino vinte në dukje të gjitha padrejtësitë dhe masakrat e kryera ndaj popullsisë Shqiptare, sidomos ndaj grave të pafajshme të cilat vuajtën duke parë të gjitha pasojat nën qeverisjen greke e serbe.²¹¹

Duke parë mungesën e arritjeve të cilat pala shqiptare dhe çamët shpresonin të gjenin pranë Kongresit të Parisit (1919), kryetari i Partisë Kombëtare Shqiptare, Kristo Dako, i dërgoi një letër Clemenceau-it. Në këtë letër, ai shprehte zhgënjimin për mbështetjen që Fuqitë e Mëdha i dhanë marrëveshjes Italo-Greke, e cila do të kishte përfshirë dhe Gjirokastrën në territorin Grek. Ai deklaroi se do të kundërshtonte çdo vendim që nuk do të kishte të bënte me njohjen e shtetit Shqiptar sipas kufijve etnikë të tij.²¹²

Në 11 Shkurt 1920, Vehip Demi dhe Galip Xhaferri, dy përfaqësuesit kryesorë të shoqatës Çamëria në Worcester, i dërguan një petition kryetarit të Konferencës së Paqes, duke i kërkuar për të disatën herë përfshirjen e Çamërisë brenda shtetit shqiptar, sepse sipas tyre në Çamëri gjendeshin 30,587 Myslimanë shqiptarë, 7.255 të krishterë shqiptarë, dhe vetëm 13,280 grekë.²¹³ Të njëjtat statistika u deklaruan më parë në kohë nga Asaf Çami dhe përfaqësuesit e memorandumit të datës 25 Tetor 1919.²¹⁴

Përpjekjet e shqiptarëve çamë, e aktorëve të tjerë të shtetit amë, ishin të shumta në mbrojtje të çështjes kombëtare e çame. Ata kishin vetëm mundësinë e dërgimit të peticioneve

²¹⁰ Isufi 2007: 259, 260.

²¹¹ Ibidem.

²¹² AQSH, Fondi 251, Dosja 7, Viti 1920, f. 56. *Protestë ndaj vendimit të Fuqive të Mëdha që nuk njohën pavarësinë e plotë politike dhe ekonomike të Shqipërisë dhe integritetin e saj territorial.* (12 Janar 1920)

²¹³ Isufi 2007: 266; Destani et al 2013: 62.

²¹⁴ Isufi 2007: 265, 266.

pranë autoriteteve përgjegjëse të këtij forumi ndërkombëtar, e për këtë mund të thuhet se këmbëngulja shqiptare për ruajtjen e territorit shqiptar e ndërtimin e tij brenda kufijve etnikë ishte e jashtëzakonshme, ndonëse vështirësitë e hasura ishin të shumta duke nisur që në organizimin e delegacionit shqiptar, e deri në rëndësinë e papërfillshme që çështja e tyre ashtu sikurse dhe çështja çame përbënte për të vendim-marrësit e politikës ndërkombëtare.²¹⁵

²¹⁵ Për më tepër shih: Schevill 2002: 416.

Kreu IV: Çamët në Shkëmbimin e Popullsive midis Greqisë e Turqisë

4.1 Qëndrimet dhe Pikëpamjet Greko-Turke për Shkëmbimin e Popullsive dhe Përfshirja e Çamëve në këtë Proces.

Shkëmbimi i popullsisë midis Greqisë dhe Turqisë ka qënë në diskutimet dypalëshe të këtyre vendeve që prej përfundimit të Luftërave Ballkanike (1913).²¹⁶ Sipas një artikulli të botuar në "La Gazetta di Puglia" (7 Gusht 1923), ky proces nisi në vijim të qëndrimit të shtetit grek e cila pas humbjes së thellë në Luftën Greko-Turke, kërcënoi se do të kryente raprezalje ndaj qytetarëve myslimanë që banonin nën kufijtë e saj. Edhe për turqit kjo konsiderohej një zgjidhje pasi do të largonte "elementi heterogjen i cili ishte vatër irredentizmi" në territorin turk.²¹⁷

Pas përfundimit të Luftës Greko-Turke, gjatë bisedimeve në Konferencën e Lozanës, në seancën e datës 14 Dhjetor (1922²¹⁸), Venizelos deklaroi se idea e shkëmbimit të detyruar të popullsive ishte një ide "e urryer", por duhej pranuar për shkak të dëbimit të 630,000 grekëve të Anadollit.²¹⁹ Megjithatë, kërkesa për shkëmbimin e popullsive ishte paraqitur edhe më parë në arenën ndërkombëtare nga përfaqësuesi i shtetit grek, ndonëse kërkohet që ky shkëmbim të ishte i karakterit vullnetar.²²⁰ Por, gjatë punimeve të Konferencës së Paqes në Paris (1919), ai nuk ishte interesuar vetëm për shkëmbimin e popullsive greko-turke²²¹, por

²¹⁶ Për më tepër shih seksionin "3.3 Traktati i Athinës dhe Nismat për Homogjenizimin e Territoreve Greke dhe Turke".

²¹⁷ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/3/4/1/1/ La Gazetta di Puglia. *L'Albania e lo Scambio delle Popolazioni tra la Grecia e La Turchia*. [Shqipëria dhe Shkëmbimi i Popullsive midis Greqisë dhe Turqisë. (7 Gusht 1923).

²¹⁸ Shënim* Dokumenti nuk ka vit të shënuar, por duke u bazuar në aktorët pjesëmarrës në këtë takim dhe deklaratat përkatëse mendohet se i përket vitit 1922, gjatë të cilit nisën bisedimet për shkëmbimin e popullsisë midis Greqisë dhe Turqisë në prag të marrëveshjes së Lozanës (30 Janar 1923).

²¹⁹ IAYE. 1922/114/3/1/1/ Deklarata e Venizelos. *Minorities. Seance du 14 Decembre*. [Minoritetet. Seanca e 14 Dhjetorit]. (14 Dhjetor 1922*-Shënim më sipër).

²²⁰ Në vitin 1914 në bisedimet me Turqinë, dhe në vitin 1919 gjatë punimeve të Konferencës së Paqes në Paris.

²²¹ Venizelos 1919: 25.

kërkoi të shtronte në diskutim edhe shkëmbimin vullnetar të popullsive me vendet balkanike.²²² Ndonëse kjo ide u përkrah gjatë Konferencës së Parisit (1919)²²³, ajo nuk u zbatua më tej.

Bisedimet në Lozanë e bënë të paqartë fatin e shqiptarëve. Për këtë arsye, ende pa u nënshkruar Konventa e Shkëmbimit të Popullsive Greko-Turke (30 Janar 1923) më 19 Janar 1923, Kaklamanos deklaroi se *"Greqia nuk ka aspak qëllimin të kryejë këmbimin e myslimanëve me prejardhje shqiptare. Shqiptarët banojnë në një rajon të përcaktuar qartë, Epiri. Nëse ata janë bashkëfetarë me turqit, nuk janë aspak bashkatdhetarët e tyre"*.²²⁴ Historiani Sami Repishti vë në dukje pasaktësinë e kësaj deklarate në lidhje me fjalët "prejardhje shqiptare", e cila u keqpërdor më vonë nga autoritetet greke²²⁵ dhe toponimia "Epir" e cila nuk ishte e vetmja krahinë e banuar nga Shqiptarët.²²⁶

Në fillim të bisedimeve për shkëmbimin e popullsisë greko-turke, Montagna, Kryetari i Nënkomisionit të Minoriteteve, theksoi se duhej saktësuar teksti "shtetas grekë të fesë myslimane", në mënyrë që të mos përfshinte shqiptarët e fesë myslimane. Ai propozoi që të theksohej fjala "turke" duke e saktësuar në "shtetas grekë të fesë turke myslimane".²²⁷ Riza Nur Beu, në këtë takim, kërkoi që propozimi i Montagnas të zëvendësohej me fjalët "ndaj myslimanëve turq".²²⁸

²²² Woodward dhe Butler 1948: 348, 349.

²²³ Ibidem.

²²⁴ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 100. *Pjesë nga Përmbledhja e Akteve të Konferencës së Lozanës, 1923.* (19 Janar 1923)

²²⁵ Autori i referohet përpjekjeve të autoriteteve greke për të përcaktuar origjinën shqiptare; Për më tepër shih në këtë punim seksionin: "4.2. Përcaktimi i Popullsisë me Origjinë Shqiptare"

²²⁶ Repishti 2014: 43, 44.

²²⁷ Ibidem.

²²⁸ Ibidem.

Më tej, duke e marrë të mirëqenë deklaratën e përfaqësuesit grek, dhe duke pranuar vrojtimin e përfaqësuesit turk, Montagna mendoi se teksti mund të thjeshtohet në "që do t'u përkisnin personave që i nënshtrohen këmbimit në të dy vendet".³⁵ Përsëri, ky formulim e linte të hapur mundësinë e shkëmbimit të çamëve pasi ata ishin myslimanë. Sipas delegatit italian Garroni, duke qënë se përfaqësuesi grek dhe ai turk u shprehën se shqiptarët ishin *de jure* dhe *de facto* të përjashtuar nga shkëmbimi i popullsisë, në vijim nuk u gjykua e nevojshme që të hartohet një dispozitë e veçantë në lidhje me këtë shqetësim të paraqitur nga pala shqiptare [Mehdi Frashëri], pasi deklaratat e tyre ishin shënuar në procesverbal të mbledhjes²²⁹, dhe për këtë arsye nuk ishte e nevojshme që të pasqyroheshin me anë të një neni të veçantë në Konventë.²³⁰ Por, zbrazëtinë e këtyre deklaratave, të cilat as nuk u inkorporuan në tekstin e Konventës (30 Janar 1923), e tregojnë dhe sjelljet e autoriteteve vendore në Çamëri. Në muajin Dhjetor 1923, në Filat, nënprefekti i zonës u kishte shpërndarë komuniteteve mendime të publikuara nga Komisioni Mikst për mënyrat e zbatimit të Konventës së Këmbimit.²³¹

Ndërkohë, përfundimi i Luftës midis Greqisë e Turqisë, kishte sjellë shpërnguljen e përafërsisht një milion refugjatëve grekë të cilët u zhvendosën drejt shtetit amë. Një pjesë e tyre, pasi u mbledh në kampe përqëndrimi, u transportua drejt Greqisë nën kujdesin e Komisionerit të Lartë të Refugjatëve pranë Lidhjes së Kombeve, Fritdjof Nansen.²³² Në gazetën "Journal d'Orient" (29 Gusht 1923) botohet një artikull mbi lajmet e fundit nga

²²⁹ Garroni 1923: 238.

²³⁰ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/3/4/1/1/ La Gazzetta di Puglia. *L'Albania e lo Scambio delle Popolazioni tra la Grecia e La Turchia*. [Shqipëria dhe Shkëmbimi i Popullsisë midis Greqisë dhe Turqisë. (7 Gusht 1923).

²³¹ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 446. *Telegram mbi Caktimin e Blinishtit si Delegat në Mbledhjen e Këshillit të Lidhjes së Kombeve si edhe për Dërgimin e Dokumentacionit për këtë Çështje*. (15 Dhjetor 1923)

²³² Lidhja e Kombeve, C.660.M.263.1923.II.; Shih gjithashtu: Ozsu 2011: 1-4.

Ankaraja.²³³ Sipas artikullit, 90 deputetë turq gjatë një mbledhje private kishin diskutuar mbi mënyrat më të përshtatshme që do të aplikoheshin për shkëmbimin e popullsisë, bazuar në interesat kombëtare. Në artikull shkruhet se "*qarqet parlamentare janë të impresionuar nga lajmi se qeveria greke kishte informuar krerët e komuniteteve që do të largoheshin forcërisht nga terreni grek deri më 30 shtatorin e ardhshëm*". Qeveria turke do t'i kërkonte Komisionit Mikst mbledhje të menjëhershme në mënyrë që të ruante të drejtat e myslimanëve.²³⁴

Për numrin e lartë të refugjatëve që qeveria greke u detyrua të priste nga shteti turk, ajo do të deklaronte në vitin 1935 se "...180 familje kishin gjetur strehim në një krahinë me shtrirje të gjerë, thënë ndryshe ku 18,000 myslimanë, të përjashtuar nga shkëmbimi, jetojnë në rehati".²³⁵ Ndonëse në këtë deklaratë, përfaqësuesit e saj pranuan se po shpreheshin me emocion për shkak të gjendjes së krijuar, vihet re se popullsia e Çamërisë konsiderohej si "popullsi myslimane e përjashtuar nga shkëmbimi"²³⁶, përveç etiketimit si "një popullsi e cila jetonte në rehati".²³⁷ Për autorë të ndryshëm, çamët konsiderohen si të përjashtuar nga shkëmbimi i popullsisë greko-turke (1923), por zbrazëtia ligjore e Konventës së hartuar për këtë qëllim e "legjitimonte" disi tryshinë që autoritetet e shtetit grek ushtronin ndaj kësaj popullsie me qëllim që t'i detyronin ata të braktisnin vatrat e tyre shekullore jo vetëm gjatë periudhës së shkëmbimit zyrtar të sanksionuar në Konventën e Lozanës (30 Janar 1923). Kombësia e personave që përjashtoheshin nga shkëmbimi i popullsisë duhet të ishte e

²³³ IAYE. Lidhja e Kombeve 1923/3/4/1/1/ Journal D'Orient. *Dernieres Nouvelles d'Angora*. [Lajmet e Fundit nga Ankaraja]. (botuar në Ankara më 28 Gusht në Mbrëmje). (29 Gusht 1923).

²³⁴ Të drejtat e myslimanëve në këtë dokument nënkuptojnë gjithashtu edhe origjinën turke, duke anashkaluar faktin se pjesa dërrmuese e shqiptarëve i përkiste fesë myslimane gjithashtu.

²³⁵ Lidhja e Kombeve, C.349.1935.I.

²³⁶ Ibidem.

²³⁷ Ibidem.

përcaktuar sipas ligjit grek.²³⁸ Sipas nenit 1 të Traktatit për mbrojtjen e minoriteteve që Greqia firmosi më 10 Gusht 1920, kombësia shqiptare do të njihej *ipso facto*, por një dispozitë e tillë nuk u zbatua.

Gjatë bisedimeve për mënyrat e shkëmbimit të popullsisë, shpeshherë Turqia refuzoi prerazi pranimin e çamëve myslimanë për shkak të origjinës së tyre shqiptare. Në 6 Dhjetor 1923, delegacioni turk i drejtohej Komisionit Mikst (1923), për t'i kërkuar ndërhyrjen e autoriteteve greke në mënyrë që të ndalonin lëvizjen drejt Turqisë të Shqiptarëve dhe të Serbëve, pasi Turqia mund të pranonte vetëm popullsi nga "*krahinat e përcaktuara për shkëmbim*".²³⁹ Gjatë punimeve të Nënkomisionit të Katërmbëdhjetë, Bratli dhe përfaqësuesi turk Mithat Bej kundërshtuan shkëmbimin e çamëve duke qënë se ata kishin origjinë shqiptare, por përfaqësuesi grek Nikolaos Totsis deklaroi se të gjithë ata ishin shtetas grekë, dhe për këtë do të shkëmbeheshin, përveç rasteve në të cilat do të mund të vërtetonin me anë të të dhënave të mjaftueshme origjinën e tyre shqiptare.²⁴⁰ Më 8 Prill 1925, përfaqësuesi turk i Nënkomisionit të Katërmbëdhjetë i deklaroi vetë Petihakit, guvernatorit të përgjithshëm të Epirit, se i njihte çamët si të pashkëmbyeshëm duke qënë se ata ishin shqiptarë.²⁴¹

Në muajin Maj 1925, Mihalopulos shkruan se Ministria Ushtarake e Greqisë i drejtohej Ministrisë së Punëve të Jashtme të këtij vendi duke shprehur shqetësimin e pengesave dhe të vonësive të shkëmbimit të çamëve. Sipas kësaj Ministrie "*kjo çështje*

²³⁸ Gjykata Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare 1925: 22.

²³⁹ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/2/1/1/3-3/ Delegacioni Turk. *Kopje- Delegation Turque a la Commission Mixte pour l'Echange de la Populations Turques et Grecques*. [Delegacioni Turk Komisionit Mikst për Shkëmbimin e Popullsisë Turke dhe Greke]. (6 Dhjetor 1923). Sidoqoftë, "krahinat e përcaktuara për shkëmbim" nuk u qartësuan gjatë zbatimit të Marrëveshjes Greko-Turke (30 Janar 1923).

²⁴⁰ Mihalopulos 1993: 50, 51.

²⁴¹ Ibidem: 54.

*duhej të zgjidhej sa më shpejt të ishte e mundur në mënyrë të kënaqshme për interesat kombëtarë, sepse kishte lidhje të drejtëpërdrejtë me sigurinë ushtarake të kufijve; në të njëjtën shkresë shpreheshin edhe shqetësimet e deri atëhershme në lidhje me vonesën dhe zvarritjen e zgjidhjes së saj”.*²⁴²

Nga ana tjetër, qëndrimi i “zakonshëm” zyrtar i Greqisë pas firmosjes së Konventës së Shkëmbimit të Popullsive Greko-Turke u confirmua edhe më 24 Korrik 1923 me përfaqësuesit e saj, Kaklamanos e Venizelos, të cilët firmosën një deklaratë në lidhje me pronat e myslimanëve që nuk ishin subjekte të kësaj konvente. Në të shkruhej se *“nuk do të bëhej asnjë shkelje për të drejtën e pronës së myslimanëve të cilët ishin përjashtuar nga Konventa, dhe ata që ishin larguar nga Greqia përpara datës 18 Tetor 1912, ose të cilët kishin banesën jashtë Greqisë”.*²⁴³ Por, situata në terren pasqyrohet ndryshe, pasi të paktën për elementin shqiptar gëzimi i të drejtës së pronës hasi në vështirësi të shumta gjatë viteve.²⁴⁴

Më 6 Gusht 1923, Venizelos iu drejtua Avenolit, sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, duke i bërë me dije se i kishte tërhequr vëmendjen qeverisë së tij për respektimin e të drejtave të myslimanëve shqiptarë. Në këtë shkresë ai i kërkoi këtij të fundit që të sigurtonte z. Blinishti se këto të drejta do të respektoheshin. Më anë të kësaj shkresë, përfaqësuesi grek pranoi rrjedhimisht gjendjen jo të mirë të shqiptarëve, të cilët rreth 2 muaj pas afatit zyrtar të nisjes së shkëmbimit ishin përfshirë gjerësisht në nismat ligjore shtrënguese

²⁴² Ibidem: 55; Për më tepër shih: Divani 1995: 232; IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Perridhis, K., Miliotis, I, Meksis, D. *Pros to S'on Ipurjion ton Ekzoterikon*. [Për Ministrinë e Punëve të Jashtme]. (9 Dhjetor 1923); dhe AYE, A/21/I 1935, cituar në Kretsi 2005: 61.

²⁴³ Kaklamanos dhe Venizelos 1923: 153-155.

²⁴⁴ Tsitselikis 2012: 292.

të hartuara nga autoritetet greke.²⁴⁵ Më 3 Shtator 1923, Joanis Kocotakis, i ngarkuari me punë i Greqisë në Durrës, i shprehu qeverisë Shqiptare vullnetin e mirë të autoriteteve Greke për të respektuar angazhimet e marra në Konferencën e Lozanës, duke deklaruar se shqiptarët nuk do të përfshiheshin në shkëmbim.²⁴⁶ Sipas autorit Mihalopulos, deklaratat e Kaklamanosit (19 Janar 1923), Venizelosit (6 Gusht 1923), dhe të Kocotakis “ishin të destinuara për t’u kthyer në armë të forta të diplomacisë shqiptare”.²⁴⁷ Është e vërtetë që diplomacia shqiptare i përmendi disa herë këto deklarata në takimet dypalëshe me Greqinë, ose me përfaqësuesit e Lidhjes së Kombeve, për t’i kujtuar këtij shteti premtimet që kishte dhënë në forumet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve. Mjafton të përmendim këtu që përfaqësuesit e nënkomisioneve të Selanikut (1923), të cilët regjistruan popullsinë me origjinë shqiptare sipas një logjike të pa bazë, ndiqnin dy kritere: deklaratën e Kaklamanosit për përjashtimin e shqiptarëve nga shkëmbimi i popullsive si dhe urdhërin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë (5 Nëntor 1923)²⁴⁸, i cili e përcaktonte origjinën shqiptare në bazë të *"vendlindjes në Shqipëri të personave të interesuar, ose vendlindjes në Greqi me kusht që babai të kishte lindur në territorin zyrtar të Shqipërisë, si dhe fëmijët e tyre të mitur të mos kishin ndërgjegje turke"*.²⁴⁹ Për këtë arsye, diplomacisë shqiptare s’i mbetej gjë tjetër veçse

²⁴⁵ AMPJ, Dosja 361, Viti 1923, f. 20. *Lettre de M. Venizelos au Secrétaire General*. [Letër e Z. Venizelos drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm]. (6 Gusht 1923).

²⁴⁶ AMPJ, Dosja 361, Viti 1923, f. 38. *Lettre du Charge d’Affaires de Grece en Albanie au President du Conseil de l’Albanie*. [Letër e të Ngarkuarit me Punë të Greqisë në Shqipëri drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë]. (3 Shtator 1923)

²⁴⁷ Mihalopulos 1993: 28.

²⁴⁸ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Prefekti i Prevezës. *Procesverbal i Regjistrimit të Popullsisë në Prevezë*. [Marrë nga Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë më 21 Dhjetor 1923]. (nr. i protokollit 7582 (në Prefekturën e Prevezës), nr. i protokollit 40001 (në Ministrinë e Çështjeve të Jashtme të Greqisë). (13 Dhjetor 1923).

²⁴⁹ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Spiros Ikonomu. *Tin Sin Jenikhin Dhiikisin Ipiru*. [Drejtuar Administratës së Përgjithshme të Epirit]. (nr. konfidencial 119). (29 Nëntor 1923).

të përmendte herë pas here në takimet zyrtare këto deklarata të përfaqësuesve të shtetit Grek të cilat kishin një kontrast të dukshëm me realitetin që popullsia shqiptare “në territorin e ri grek” (pas vitit 1913) po përjetonte pavarësisht këtyre deklaratave.

Mithat Frashëri informonte më 21 Korrik 1923 ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë mbi takimin e përfaqësuesve çamë me përfaqësuesit grekë. Ata ishin takuar me katër përfaqësues: Plastiras, kryetarin e kryengritjes, Gonatas, kryeministrin, dhe dy ministrat e kabinetit, përkatësisht Ministrin e Bujqësisë, Sideris, dhe Ministrin e Punëve të Jashtme, Aleksandris. Plastiras e mbështeti çështjen shqiptare, ndërsa antarët e tjerë u shprehën me rezerva në lidhje me këtë. Sipas kryeministrit, "shumë" turq po regjistroheshin si nënshtetas shqiptar, ndonëse shqiptarët nuk do të këmbëheshin si turq. Gjithashtu, dhe Ministri i Punëve të Jashtme u premtoi se nuk do të përfshiheshin në procesin në fjalë, dhe komisioni që do të caktohej pas marrëveshjes së Lozanës do të vendoste mbi këtë. Ndërsa, Ministri i Bujqësisë deklaroi se në Paramithi banorët ishin turq, dhe në lidhje me dëmshpërblimin ai nuk mund t'i jepte një zgjidhje.²⁵⁰

Në një takim gjatë muajit Tetor 1923, dy përfaqësuesit grekë të Ministrisë së Punëve të Jashtme i deklaruan sekretarit të Legatës Shqiptare në Athinë se masat e marra ndaj shqiptarëve ishin të përkohëshme, ndërkohë që situata në terren vijonte të përkeqësohej.²⁵¹ Në terren problematikat që hasnin shqiptarët e çamët ishin të shumta. Blinishti i ishte drejtuar më parë Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve për ta vënë në dijeni mbi situatën e vështirë në të cilën po kalonin çamët. Ai deklaronte se një komision kishte shkuar në Çamëri me qëllim për të vendosur refugjatë në to. Komisioni kryesohej nga Bakalbashi dhe

²⁵⁰ Malltezi dhe Delvina: 66, 67, dok. 21.

²⁵¹ Naska 1999: 123, dok. 75.

Fillandros, dy ish-deputetë grekë.²⁵² Disa muaj më vonë, përfaqësues çamë iu drejtuan Athinës zyrtare, duke vënë në dukje se një urdhëresë i përjashtonte ata në përfshirjen e popullsisë që do të shkëmbehej, por nga ana tjetër një urdhëresë e dytë ua mohonte të drejtën e pronës, duke ua ndaluar shitjen e pasurive të paluajtshme, urdhëresë e cila u përkiste popullsisë të përcaktuara në shkëmbim.²⁵³

Nga ana tjetër, ministri turk i cili merrej me çështjet e shkëmbimit, kishte shfaqur shqetësimin e tij në Parlamentin Turk për shkak të ndryshimeve që karakterizonin popullsinë në ikje, dhe popullsinë në ardhje. Sipas tij, ata që iknin i përkisnin një klase tregëtarësh, ndërsa ata që vinin i përkisnin një klase fermerësh e fshatarësh.²⁵⁴ Gjithashtu, politikanët turq druanin ndryshimet kulturore që karakterizonin këto popullsia.²⁵⁵ E njëjta gjë vlente dhe për Greqinë. Të dyja shtetet të cilat synonin homogjenizimin e territorit, duhet të përballeshin me vënien në zbatim të politikave që të mund të arrinin këtë qëllim. Po ashtu, dhe grekët e ardhur nga Azia e Vogël duhet të integroheshin në shoqërinë greke, pasi shumë prej tyre nuk njihnin gjuhën greke.²⁵⁶

Greqia ishte e vendosur në keqpërcaktimin e fesë myslimane, duke e asociuar atë me kombësinë turke. Sipas autorit Tsitselikis, ky shtet kërkonte detyrimisht përdorimin e termit "Minoritet mysliman" në vend të "Minoritet Turk", për aq sa në vitin 1929, inspektori i Minoriteteve të Greqisë, Stilianopulos kishte kërkuar ndalimin e gazetës turke *Yeni Adım* pasi

²⁵² AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 76. *Letër për të tërhequr Vëmendjen e Përfaqësuesit Grek për Shkeljet e Parimeve të së Drejtës Ndërkombëtare ndaj Pakicave Myslimane Shqiptare në Greqi.* (27 Korrik 1923)

²⁵³ Ibidem.

²⁵⁴ Aktar 2008: 89.

²⁵⁵ Ibidem: 88; Bayir 2016: 95.

²⁵⁶ AQSH, Fondi 251, Dosja 79, Viti 1924, f. 277. *Raport mbi Kriteret për Përcaktimin e Kombësisë së Banorëve në Çamëri.* (7 Qershor 1924);

kjo e fundit kishte përdorur termin "Minoriteti turk" dhe jo "Minoriteti mysliman".²⁵⁷ Një qëndrim i tillë vihet re dhe në Traktatin e Athinës (1 Dhjetor 1926), i cili njihte si subjekte përveç turqve, grekëve, edhe myslimanët.²⁵⁸

Rauf Fico deklaronte në 23 Janar 1927 se Ministri Grek në Turqi kishte kërkuar përkrahjen e këtij shteti për shpërnguljen e rradhës së disa çamëve të cilët kishin shprehur dëshirën e tyre për t'u përfshirë në proces. Për këtë arsye, Ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë kishte deklaruar se ky fakt nuk mund të pranohej, duke u bazuar edhe në punimet e mbledhjeve të Lidhjes së Kombeve, ku ishte pranuar përjashtimi i çamëve, meqënëse ata ishin shqiptarë.²⁵⁹ Por, Greqia e fshehte shkëmbimin e çamëve drejt Turqisë nën stigmën e "dëshirës së tyre"²⁶⁰ për t'u shkëmbyer, në një kohë kur në vitin 1923, mohimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore të kësaj popullsie arriti kulmin e tij, pasi çamët myslimanë u zhveshën nga çdo e drejtë, duke u transformuar në subjekte "pashtetësi" për shkak të procesit të shkëmbimit të popullsive greko-turke.

Shkëmbimi i popullsive greko-turke u konsiderua zyrtarisht i mbyllur pas përfundimit të mandatit të Komisionit Mikst më 1934, por çështjet e shkëmbimit të popullsive, vijuan edhe pas kësaj periudhe, sidomos për elementin shqiptar. Në vitin 1935, Ministri i Jashtëm i Turqisë deklaroi se kishte udhëzuar në mënyrë të prerë konsullatat turke në Greqi që të mos u jepnin vizë çamëve të cilët dëshironin të shpërnguleshin drejt Turqisë.²⁶¹

²⁵⁷ Tsitselikis 2012: 284.

²⁵⁸ Traktati i Athinës. 1926.

²⁵⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 130, Viti 1927, f. 15. *Njoftohet se Qeveria Turke duke u mbështetur në Vendimet e Lidhjes së Kombeve nuk Pranon më Çamë në Turqi.* (23 janar 1927)

²⁶⁰ Shih: Gazeta "Dajti" cituar në Puto 2010: 177; Mihalopoulos (1993) duke cituar deklaratën e Petihakis, Drejtuesit të Përgjithshëm të Epirit në të cilën thuhet se 95% e çamëve kishin shprehur lirisht dëshirën e tyre për t'u shkëmbyer. Shih f. 49.

²⁶¹ AQSH, Fondi 251, Dosja 475, Viti 1935, f. 1. *Qeveria Turke njeht Çamët si Shqiptarë dhe nuk do të japë Viza për ata që duan të vendosen në Turqi.* (10 prill 1935).

Në vijim të qëndrimit të shtetit turk për të mos i pranuar çamët duke qenë se ishin shqiptarë, dhe të vendosjes së marrëdhënieve të mira greko-turke nën qeverisjen e Gjeneral Pangalosit, Margaritis shprehej se ata [çamët] "e fituan çështjen".²⁶² Por, pavarësisht këtyre "arritjeve", pasojat në terren ishin të konsiderueshme.

4.2 Përcaktimi i Popullsisë me Origjinë Shqiptare

Në 14 Korrik 1923, autoritetet shqiptare ishin vënë në dijeni se një komision për vendosjen e refugjatëve do të dërgohej në Epir. Për këtë komision thuhej se kishte fuqi diktatoriale.²⁶³ Më 19 shtator 1923, Dhimitër Popa, sekretar i Legatës Shqiptare në Athinë i tërhiqte vëmendjen Ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë mbi një korrespondencë të mëparshme me Legatën Greke në Athinë në të cilën thuhej se *"qeveria Greke do ta shohë me kënaqësi krijimin e një komisioni të ngarkuar për të verifikuar, pas shqyrtimit të thelluar të dokumenteve përkatëse, prejardhjen e vërtetë të të interesuarve"*.²⁶⁴ Me të drejtë, sekretari i Legatës argumentonte mbi gjendjen e atyre shqiptarëve të cilët nuk dispononin dokumente për të vërtetuar origjinën e tyre.

Më 5 Tetor 1923, sekretari i Legatës Shqiptare në Athinë njoftonte ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë se në Çamëri situata vazhdonte e njëjtë, dhe kjo krahinë kishte pësuar një sërë largimesh të popullsisë. Pavarësisht, kësaj situatë, kishte dhe shumë çamë të cilët po rezistonin me çdo kusht ndaj politikave shtrënguese që kishin për qëllim largimin e tyre.²⁶⁵

²⁶² Margaritis 2009: 118.

²⁶³ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 72. *Njoftim për Krijimin nga Qeveria Greke të një Komisioni për Vendosjen e Refugjatëve Grekë të Azisë së Vogël në Tokat e Çamërisë*. (14 Korrik 1923).

²⁶⁴ AQSH, Fondi 251, Viti 1923, Dosja 203, f. 192, *Dhimitër Popa drejtuar Ministrit të Jashtëm Tiranë, Nr. 1031, Athinë*. (19 Shtator 1923)

²⁶⁵ AQSH, Fondi 251, Viti 1923, Dosja 203, f. 181, *Dhimitër Popa drejtuar Ministrit të Jashtëm Tiranë, Nr. 1101, Athinë*. (5 Tetor 1923)

Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë kishte premtuar se të gjitha paqartësitë do të sqaroheshin me ardhjen e Komisionit Mikst, e megjithatë Greqia do të mbante qëndrimet e saj të deklaruara në mbështetje të përjashtimit të Shqiptarëve.²⁶⁶

Ende pa nisur punën e tij në terren Komisioni Mikst, organi i mandatuar prej Lidhjes së Kombeve për mbikëqyrjen e procesit të shkëmbimit të popullsive midis Greqisë e Turqisë, autoritetet greke vendosën të përcaktonin kombësinë shqiptare të krahinave të aneksuara, në të cilat u përfshi edhe Çamëria. Në funksion të këtij qëllimi u ngrit Komisioni i Selanikut (1923). Puna në terren u zhvillua prej nënkomisioneve përkatëse sipas krahinave. Autoritetet shqiptare nuk u përfshinë në këto punime. Ata deklaruan se në këtë mënyrë këto punime nuk do të mbartnin më një "karakter ligjor", duke qënë se po zhvilloheshin "njëanësisht".²⁶⁷ Në përgjigjen që Ministria e Punëve të Jashtme të Greqisë i dërgonte Legatës Shqiptare për shkresën e datës 24 Tetor 1923, shprehej se ajo i njihte si subjekte osmane të gjithë banorët e territoreve të aneksuara prej saj edhe "*nëse ata kanë lindur në Shqipëri, kanë origjinë shqiptare, ose kanë lindur në një shtet tjetër*"²⁶⁸, për shkak të natyralizimit kolektiv të tyre, por Legata Shqiptare deklaronte se Traktati i Athinës, i hartuar gjatë kohës që shtetit Shqiptar iu njoh pavarësia (29 Korrik 1913), nuk mund të përfshinte këtë palë, pa shprehjen e dakordësisë prej saj.²⁶⁹

²⁶⁶ Ibidem.

²⁶⁷ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/2/1/1/3-3/ Legata e Shqipërisë, Athinë. *Notë Verbale*. [Për mospërfshirjen në Komisionin e Selanikut gjatë punimeve për përcaktimin e nënshtetësisë shqiptare; përgjigje ndaj shkresës nr. 32275 të Ministrisë së Çështjeve të Jashtme të Greqisë.] (nr. i notës 1344). (1 Dhjetor 1923). Shënim*: Në këtë shkresë nr. i notës së Ministrisë Greke paraqitet si 32375, ndërsa në shkresën e Ministrisë Greke është 32275. Po ashtu, data shihet si 5 Nëntor, por në shkresën e Legatës Shqiptare pasqyrohet si 25 Nëntor.

²⁶⁸ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/2/1/1/3-3/ Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë. *Notë Verbale*. [përgjigje ndaj shkresës nr. 1187 të Legatës së Shqipërisë]. (nr. i notës 32275). (5 Nëntor 1923).

²⁶⁹ Ibidem. Kufiri Greko-Shqiptar u vendos me anë të Protokollit të Firences 17 Dhjetor 1913.

Në vijim, më 1 Dhjetor, pas insistimit të Ministrisë Greke e cila vijonte t'i quante shqiptarët si subjekte helene, Legata Shqiptare vuri theksin mbi faktin se kjo qeveri i ka trajtuar gjithmonë ata si subjekte të huaja, sidomos elementin mysliman, gjithashtu edhe për shkak të dhunës së përditshme që ushtrohej mbi ta.²⁷⁰ Më 5 Nëntor 1923, Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë shpalli një urdhër për përcaktimin e origjinës shqiptare të banorëve të Çamërisë. Kriteri për përcaktimin e kësaj origjine ishte "*vendlindja në Shqipëri e personave të interesuar, ose vendlindja në Greqi me kusht që babai të kishte lindur në territorin zyrtar të Shqipërisë, si dhe fëmijët e tyre të mitur të mos kishin ndërgjegje turke*".²⁷¹ Ky kriter kishte një karakter arbitrar pasi nuk merrte parasysh autoktoninë e pjesës dërmuese të popullsisë në këtë krahinë e cila ishte shqiptare. Sipas këtij përcaktimi dhe rezultateve përkatëse të mbledhura në përfundim të këtij procesi, Çamëria duhet të kishte qenë e banuar nga shqiptarët në një hapësirë kohore të shtrirë në më pak se një shekull. Por, ky hamendësim mbetet i pamundur, pasi gjatë sundimit të Perandorisë Osmane nuk kishte një lëvizje të kontrolluar të popullsisë; për këtë arsye, është vështirë të mendohet që kjo krahinë, duke u gjendur në kufij me territorin zyrtar të shtetit Shqiptar, të mos ketë qenë e banuar nga Shqiptarët ndër shekuj, qoftë dhe në një përqindje të vogël të popullsisë së saj.

Pjesa tjetër e këtij kriteri, ajo që kishte të bënte me "ndërgjegjen turke të fëmijëve të mitur" të subjekteve të përfshira në këtë urdhëresë, e ngushtonte më tepër mundësinë për t'u deklaruar me origjinë shqiptare, pasi në këtë periudhë kishte një paqartësi në masat e

²⁷⁰ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/2/1/1/3-3/ Legata e Shqipërisë, Athinë. *Notë Verbale*. [Për mospërfshirjen në Komisionin e Selanikut gjatë punimeve për përcaktimin e nënshtetësisë shqiptare; përgjigje ndaj shkresës nr. 32275 të Ministrisë së Çështjeve të Jashtme të Greqisë.] (nr. i notës 1344). (1 Dhjetor 1923).

²⁷¹ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Spiros Ikonomu. *Tin Sin Jenikhin Dhiikisin Ipiru*. [Drejtuar Administratës së Përgjithshme të Epirit]. (nr. konfidencial 119). (29 Nëntor 1923).

popullatës mbi ndërgjegjen e tyre, e aq më tepër të fëmijëve, duke qënë se në pesë shekuj të sundimit osman individët dalloheshin në bazë të fesë e jo të kombësisë, dhe fjalët "ndërgjegje turke" linin hapësirë të gjerë për interpretim pasi feja myslimane lidhej në këtë kohë me Turqinë.

Kriteri i përcaktuar nga qeveria greke i arriti synimet e tij në këto rregjistrime të popullsisë pasi pjesa më e madhe e subjekteve të përfshira u deklarua me ndërgjegje turke, pasi përveç këtij kriteri të padrejtë, të cilit ata duhet t'ju bindeshin, në terren ushtrohej herë pas here dhunë me qëllim që të terrorizohej kjo popullsi, duke e kthyer në këtë mënyrë numrin e atyre që deklaroheshin shqiptarë thuajse të papërfillshëm. Kjo përpjekje e Greqisë u vu në zbatim në një kohë kur traktati i Sevres ishte ratifikuar nga Parlamenti Grek (29 Shtator 1923²⁷², ndonëse mori fuqi më datë 6 Gusht 1924).

Ndonëse Lidhja e Kombeve deklaronte se Komisioni Mikst i caktuar prej saj do të ushtronte të drejta të plota në përcaktimin e origjinës, shteti grek i kishte paraprirë këtyre punimeve në kundërshtim me përcaktimet e kësaj organizate ndërkombëtare, pasi Greqia synonte homogjenizimin e territorit të saj duke përdorur çdo metodë zyrtare dhe jo zyrtare.

Por, në rrugë zyrtare kryeministri grek i dërgoi një shkresë administratës së Përgjithshme të Epirit në Janinë më 24 maj të vitit 1923, duke i kërkuar që shqiptarët myslimanë nënshtetas grekë të mos përfshihen në shkëmbim. Kjo kërkesë vinte si pasojë e deklaratës së përfaqësuesit të Greqisë, Kaklamanos, i cili pas lutjes së delegacionit shqiptar ishte shprehur për mospërfshirjen e shqiptarëve duke thënë se feja myslimane nuk i bënte këta

* Komisioni Mikst duhet të kishte qënë një organ neutral, por zbatimi i platformës së tij në terren ishte i paqartë.
²⁷² Fletorja Zyrtare e Greqisë. Nr. 311. (30 Tetor 1923).

shqiptarë bashkëatdhetarë me turqit.²⁷³ Nënkomisionet e caktuara nga Komisioni i Selanikut (1923) për saktësimin e origjinës shqiptare merrnin për bazë si deklaratën e Kaklamanosit në Lozanë për përjashtimin e shqiptarëve myslimanë nga shkëmbimi, ashtu edhe urdhërin e Ministrisë së Jashtme Greke e cila kishte vendosur kritere të paqëndrueshme në përcaktimin e origjinës shqiptare.²⁷⁴

Në burimet arkivore greke, ndër të tjera, autoritetet greke të nënkomisionit të Margëlliçit deklarorin:

"...Sepse armiqësia dhe pabesia e këtyre myslimanëve për shtetin grek u konstatua dhe konstatohet në mënyrë të përsëritur nga Autoritetet politike dhe ushatarake të Epirit, fakt i cili përbën rrezik për ekzistencën e Shtetit, pasi këta janë në kufi me shqiptarët dhe janë në kontakt të pandërprerë me Italianët, nëpërmjet detit, dhe janë gjithmonë armikë të Helenizmit, dhe janë gjithmonë të ekspozuar, pasi prezenca e tyre në Epir ofron, si për territorin shqiptar ashtu edhe për ata që mbështeten në këto shtete, shkak të pandërprerë jo vetëm për ndërhyrjen në çështjet e brendshme të Greqisë për mbrojtjen e popullsisë shqiptare, por edhe të rivendikimeve territoriale të Greqisë autentike dhe për momentin Greqia e konsideron humbjen e Vorio Epirit si fatkeqësi të përkohshme

²⁷³ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 39. Njoftim për Nënshetësit Grekë Myslimanë me Origjinë Shqiptare të cilët nuk do të përfshihen në Këmbimin e Popullsisë. (24 Maj, 1923)

²⁷⁴ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Prefekti i Prevezës. *Procesverbal i Regjistrimit të Popullsisë në Prevezë*. [Marrë nga Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë më 21 Dhjetor 1923]. (nr. i protokollit 7582 (në Prefekturën e Prevezës), nr. i protokollit 40001 (në Ministrinë e Çështjeve të Jashtme të Greqisë). (13 Dhjetor 1923).

politike, dhe këtë do ta kërkojë gjithmonë, si pjesë të pandashme të Shtetit Grek."

275

Në këtë deklaratë vihet re "frika" që prania e elementit shqiptar, mysliman, shkaktonte tek autoritetet greke, të cilat e shihnin të domosdoshëm evakuimin e kësaj krahine nga elementi "i huaj" për "helenizimin" e shtetit grek. Në mendimin e përgjithshëm grek, çamët shiheshin si një popullsi armike e cila gjendej në kufi me Shqipërinë, dhe rrjedhimisht mendohej se kjo popullsi do të mund t'i shkaktonte probleme të mëtejshme këtij shteti, si psh. destabiliteti. Për këtë arsye më vonë në kohë, me ndërrimin e regjimeve dhe ardhjen në pushtet të Metaksait, u vu në zbatim ligji 376, i vitit 1936 i cili sanksiononte një sërë masash ndaluese edhe për çamët, duke qenë se shiheshin si element i huaj dhe i rrezikshëm për shtetin grek edhe gjatë viteve '30.

Mirëpo, duke iu rikthyer përfundimeve të antarëve të nënkomisionit të Margëlliçit, këta myslimanë të caktuar për t'u përfshirë në shkëmbim dalloheshin si të ndryshëm nga popullsia shqiptare si në baza antropologjike ashtu edhe në baza kulturore, pasi sipas tyre ata pohonin ndërgjegjen e tyre turke "*për shkak të qytetarisë së tyre në përgjithësi*".²⁷⁶ Përfundimet në të cilat doli ky nënkomision kishin një trajtë të përgjithshme të cilat nuk përcaktonin në mënyrë objektive origjinën e tyre shqiptare, po u lihej hapësirë marrjes së deklaratave, të cilat mund të jepeshin në një formë të caktuar si rrjedhojë e rrethanave të caktuara.

²⁷⁵ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Perridhis, K., Miliotis, I, Meksis, D. *Pros to S'on Ipurjion ton Ekzoterikon*. [Për Ministrinë e Punëve të Jashtme]. (9 Dhjetor 1923).

²⁷⁶ Ibidem.

Në lidhje me nënkomisionin e Margëlliçit, përveç deklaratës se askush nga banorët e këtij rajoni nuk kishte origjinë shqiptare, autoritetet greke deklarorin se: "*Autencitetin dhe vërtetësinë e këtyre deklaratave të myslimanëve e vërtetoi edhe Përgjegjësi Fetar dhe Kryetari i çdo komuniteti përballë Nënkomisionit në lidhje me situatën e tyre në arkivin e Nënkomisionit të Margaritit.*"²⁷⁷ Anësinë e këtyre qëndrimeve e dëshmonte dhe Musa Demi i cili deklaronte se kryetarët e komunave përgjigjeshin për këtë fakt (origjinën shqiptare ose turke), duke lënë hapësirë në vendime të padrejta për përfshirjen e çamëve në këtë proces.²⁷⁸ Musa Demi përmendet gjithashtu në raportin e nënkomisionit të Filatit si një ndër kundërshtuesit kryesorë të shkëmbimit të shqiptarëve.²⁷⁹

Përfaqësuesit fetarë luajtën një rol të rëndësishëm në bindjen e çamëve për t'u shpërngulur drejt Turqisë; gjithashtu, edhe kryetarët e komunave ishin funksionarë të shtetit grek, dhe si të tillë do të vepronin në bazë të udhëzimeve të eprorëve të tyre. Prandaj, "vërtetimi" i deklaratave prej tyre nuk mund të merret parasysh që nga ky moment. Ashtu sikurse deklarohet edhe në përfundimet e nënkomisionit të Filatit (29 Nëntor 1923), shqiptarët për palën greke njiheshin si persona të cilët nuk e respektonin bindshëm fenë myslimane por vetëm disa aspekte të saj, ndërsa pjesa e shkëmbyeshme e cila ishte fanatike në respektin ndaj fesë quhej si turke.²⁸⁰

Numri i personave që përcaktoheshin si të pashkëmbyeshëm ishte i papërfillshëm për të gjithë krahinën e Çamërisë. Në raportin e datës 6 Dhjetor 1923, autoritetet greke deklaruan

²⁷⁷ Ibidem.

²⁷⁸ Naska 1999: 124, dok. 75.

²⁷⁹ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Spiros Ikonou. *Tin Sin Jenikhin Dhiikisin Ipiru*. [Drejtuar Administratës së Përgjithshme të Epirit]. (nr. konfidencial 119). (29 Nëntor 1923)

²⁸⁰ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Perridhis, K., Miliotis, I, Meksis, D. *Pros to S'on Ipurjion ton Ekzoterikon*. [Për Ministrinë e Punëve të Jashtme]. (9 Dhjetor 1923).

se edhe në zonën e Paramithisë nuk u gjet asnjë person i përshtatshëm për t'u përjashtuar nga shkëmbimi.²⁸¹ Këto të dhëna paraqiten gjithashtu edhe në telegramin që Komanda e Përgjithshme e Epirit i dërgonte Ministrisë së Jashtme Greke, në të cilën deklarohet se komisioni i caktuar në zonën e Margëlliçit e kishte përfunduar punën e tij; Komisioni i Paramithisë kishte paraqitur pranë këtyre autoriteteve një raport sipas të cilit nuk ishte gjetur asnjë person me origjinë shqiptar, pra i pashkëmbyeshëm.²⁸²

Për të shtuar bindjen se shqiptarët e Çamërisë kishin ndërgjegje turke, nënkomisioni i nënprefekturës së Margëlliçit deklaronte në 9 Dhjetor 1923:

*"Ndërgjeja aktive turke e këtyre myslimanëve i përqëndroi ata unanimisht gjatë Revolucionit Shqiptar para Luftërave Ballkanike rreth flamurit turk, dhe kishin entuziasëm të plotë dhe i bindeshin urdhërave të Kolonelit vendas Hamdi Bej të dëbonin nga Shqipëria në zonën e Filatit ata pak shqiptarë që kishin mbetur."*²⁸³

Deklaratat në raportin e nënkomisionit të Margëlliçit ashtu sikurse dhe në regjistrimet e nënkomisioneve të tjera në krahinën e Çamërisë, janë të pa baza pasi në rastin konkret "dëbimi i pak shqiptarëve që kishin mbetur" është një pohim i pavërtetuar dhe subjektiv. Në raportin e Margëlliçit shënohet se banorët nuk kanë origjinë shqiptare por kanë lindur në Epirin e Jugut prej shekujsh, dhe kanë origjinë turke²⁸⁴, në një kohë që as origjina turke e as

²⁸¹ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Moskhatos, N., Tzirakopulos, D, Gatsis, Th. *Pros Tin Jenikhi Dhiikisin Ipiru*. [Drejtuar Administratës së Përgjithshme të Epirit]. (nr. konfidencial 112) (6 Dhjetor 1923).

²⁸² IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Guvernatori i Përgjithshëm i Epirit.. *Telegram nr. 19436 mbi Shkëmbimin e Myslimanëve*. [Marrë nga Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë më 13 Dhjetor 1923]. (nr. i mbërritjes 2862, nr. i protokollit 39071 (në Ministrinë e Çështjeve të Jashtme të Greqisë). (12 Dhjetor 1913)

²⁸³ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Perridhis, K., Miliotis, I, Meksis, D. *Pros to S'on Ipurjion ton Ekzoterikon*. [Për Ministrinë e Punëve të Jashtme]. (9 Dhjetor 1923).

²⁸⁴ Ibidem.

ajo shqiptare nuk mund të vërtetohej objektivisht, përveçse pas analizimit të traditave, zakoneve, dhe kulturave në të cilën këto banorë bënë pjesë. Por, këto autoritete vendore greke ashtu si dhe të tjerë zyrtarë grekë, shprehnin më me lehtësi mbështetjen e tyre nëse kjo popullsi deklarohej turke, sesa në ato raste kur deklarohej shqiptare.

Problematika të menjëhershme u ngritën si pasojë e masave ligjore të marra prej Greqisë në funksion të procesit të shkëmbimit. Pjesa dërmuese e popullsisë çame ishte myslimane, dhe pavarësisht deklaratave të autoriteteve të larta të Greqisë në mbështetje të tyre, ata nuk mundën të dilnin lehtësisht nga situata e krijuar. Çamët duhet të kalonin vështirësi të ndryshme përpara se të arrinin përjashtimin e tyre nga shkëmbimi.

Në raportin që nënkomisioni i Filatit i dërgonte Autoriteteve Drejtuese të Epirit më 29 Nëntor 1923, si dhe Ministrisë së Jashtme Greke, thuhej se nuk ishte hasur asnjë pengesë në marrjen e deklaratave të popullsisë vendase.²⁸⁵ Rreth dy muaj më vonë, qeveria e Tiranës i kërkonte legatës së saj në Athinë të vërtetonte informacionet mbi strategjitë e përdorura nga komisioni grek për marrjen e deklaratave të popullsisë shqiptare. Sipas tyre, rreth 15 ditë përpara mbërritjes së komisionit grek në Çamëri, disa çeta ushtronin dhunë mbi popullsinë në mënyrë që ata të shihnin si të vetmen rrugë shpëtimi ikjen e tyre drejt emigrimit.²⁸⁶

Në përgjigje të protestes shqiptare, Ministria e Jashtme Greke e konsideronte ndërhyrjen e qeverisë shqiptare si përfshirje në punët e brendshme të Greqisë, duke qëne se

²⁸⁵ Autoritetet e nënkomisionit të Filatit deklarorin: "Në kundërshtim me pritshmërinë që procesi mund të haste në vështirësi/pengesa dhe mungesë vullneti në lidhje me paraqitjen e myslimanëve, veçanërisht të fshatrave, çdo gjë u realizua me normalitet dhe saktësi."... në një kohë kur procesi i shpërnguljes së detyruar nuk shfaqti shenja normaliteti as në krahina të tjera të Greqisë. Shih përfundimet e raportit në:

IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Spiros Ikonou. *Tin Sin Jenikhin Dhiikisin Ipiru*. [Drejtuar Administratës së Përgjithshme të Epirit]. (nr. konfidencial 119). (29 Nëntor 1923)

²⁸⁶ Naska 1999: 207, dok. 115.

ajo nuk ishte palë në marrëveshjen për shkëmbimin e popullsisë.²⁸⁷ Megjithatë, kjo ministri e ftonte Tiranën zyrtare që të paraqiste shqetësimin e saj për raste të veçanta "anësie".²⁸⁸

Duke u bazuar në kriterin që Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë kishte vendosur për përcaktimin e origjinës Shqiptare, nënkomisioni i caktuar për kryerjen e këtij funksioni pranë qytetit të Filatit vuri re se në këtë krahinë u gjetën vetëm tre familje shqiptare, të cilave iu dhanë certifikatat për ushtrimin e të drejtës së votës, bazuar gjithashtu në nenin 9 të ligjit të datës 25 Shtator 1923 "*Për amendimin e ligjit të zgjedhjes së deputetëve*".²⁸⁹ Në këtë raport deklarohet se në Filat ndodheshin mbi 10,000 myslimanë. Gjatë shqyrtimit të origjinës së banorëve të kësaj zone, komisioni nuk anashkaloi as ndërgjegjen kombëtare të tyre. Mirëpo, nga të dhënat përfundimtare doli se familjet shqiptare u deklaruan vetëm 216, ndërsa ato turke 821.²⁹⁰ Në raportin e Gumenicës, rezultoi vetëm një familje me origjinë shqiptare.²⁹¹

Gjatë kësaj periudhe, të tilla fakte denoncuan dhe përfaqësuesit politikë shqiptarë pranë kancelarive europiane. Blinishti, konsulli Shqiptar pranë Lidhjes së Kombeve, njoftoi Drumondin mbi strategjitë e ndjekura nga Greqia për përfshirjen e çamëve në shkëmbim. Ai deklaronte se vetëm në një rajon të Çamërisë, nga 200 familje të racës shqiptare, vetëm 9 u njohën si të pa shkëmbyeshme.²⁹² Nga të dhënat që disponojmë në raportin e Prevezës, në një

²⁸⁷ Naska 1999: 212, dok. 118.

²⁸⁸ Ibidem.

²⁸⁹ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Spiros Ikonomu. *Tin Sin Jenikhin Dhiikisin Ipiru*. [Drejtuar Administratës së Përgjithshme të Epirit]. (nr. konfidencial 119). (29 Nëntor 1923)

²⁹⁰ Ibidem.

²⁹¹ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Katselidhis, S., Papaianu, Folidhis, K. *Pinaks. Emafenon Musulmanikas Ikojenias tis Periferias Igumenicis (Ipodhiikiseos Filiaton) Ellinikis Ipikootitoskhe Alvanikis Katagogis mi Ipokimenas eis Antallagin*. [Tabelë. Paraqitje e Familjeve Myslimane të Rrethinave të Igumenicës (Nënprefekturë e Filatit) të Shtetasve Grekë që nuk janë Subjekte për Shkëmbim]. (Firmosur në Janinë më 18 Dhjetor 1923). (6 Dhjetor 1923)

²⁹² Naska 1999: 168, dok. 103.

popullsi me mbi 50,000 banorë, nënkomisioni përcaktoi vetëm 9 familje të origjinës shqiptare.²⁹³ Një detaj rëndësishëm, i cili përmendet në raportin e nënkomisionit të Filatit, është dhe "dëshira për t'u shkëmbyer"²⁹⁴, një qëndrim i cili përputhej plotësisht me politikën zyrtare të Greqisë.²⁹⁵ Në raportin e nënkomisionit të Filatit, bëhet një dallim i mëtijshëm i myslimanëve duke i ndarë në myslimanët turq të cilën drejtoheshin nga myftiu i Filatit dhe në myslimanët shqiptarë nga Musa Demi.²⁹⁶ Një ndër arsyet me anë të të cilave autoritetet greke e justifikonin dëshirën e çamëve për t'u larguar, më konkretisht në rrethin e Filatit, ishte përçarja që ekzistonte midis dy grupimeve të sipërpërmendura; të parët ishin fanatikë të fesë myslimane, ndërsa të dytët ishin më tepër të përfshirë nga ideologjia nacionaliste, dhe për shkak të konflikteve midis tyre, të parët mendonin se do të gjendeshin më mirë duke u zhvendosur në Turqi, pasi në këtë mënyrë ata do të ishin më të qetë në shprehjen e identitetit të tyre fetar.⁷⁶

Në deklaratimet e nënkomisionit të Filatit doli se myslimanët e deklaruar si turq drejtoheshin prej myftiut të zonës, dhe ishin tërësisht të bindur mbi përfitimet e shpërnguljes së tyre.²⁹⁷ Në përmbyllje, raporti informon mbi propagandën shqiptare e cila përpiquej të ndalonte këtë shpërngulje drejt Turqisë, duke u përpjekur të paktën të realizonte këtë

²⁹³ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Prefekti i Prevezës. *Procesverbal i Regjistrimit të Popullsisë në Prevezë*. [Marrë nga Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë më 21 Dhjetor 1923].

[nr. i protokollit 7582 (në Prefekturën e Prevezës), nr. i protokollit 40001 (në Ministrinë e Çështjeve të Jashtme të Greqisë)]. (13 Dhjetor 1923)

²⁹⁴ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Spiros Ikonomu. *Tin Sin Jenikhin Dhiikisin Ipiru*. [Drejtuar Administratës së Përgjithshme të Epirit]. (nr. konfidencial 119). (29 Nëntor 1923)

²⁹⁵ Shih: Gazeta "Dajti" cituar në Puto 2010: 177.

²⁹⁶ Ibidem.

²⁹⁷ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Spiros Ikonomu. *Tin Sin Jenikhin Dhiikisin Ipiru*. [Drejtuar Administratës së Përgjithshme të Epirit]. (nr. konfidencial 119). (29 Nëntor 1923)

zhvendosje drejt Shqipërisë, duke qenë se e para nuk mund t'i garantonte popullsisë çame premtimet e pabazuara se do të gjenin një jetë shumë më të mirë në Turqi.²⁹⁸

Nënkomisionet për përcaktimin e origjinës shqiptare e trajtonin këtë çështje me anë të argumentave të përgjithshëm, duke dalë në përfundimin se pjesa dërrmuese e popullsisë së Çamërisë ishte turke, dhe si e tillë duhet të përfshihej në shkëmbim.

Në seancën e datës 10 Dhjetor, në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, Viskont Ishi shtroi në bisedime një ankesë të palës turke, sipas së cilës Greqia kishte nisur të merrte masa abuzive kundër personave të fesë myslimane, duke mos pritur nisjen e punimeve të Komisionit Mikst i cili duhet të kishte kompetenca të plota mbi mbarëvajtjen e procesit të shkëmbimit të popullsive greko-turke. Megjithatë, më vonë gjatë muajit nëntor, palët greke e turke kishin rënë dakord për t'i lënë Komisionit hapësirë të plotë në vijimin e punimeve në bazë të Konferencës së Lozanës (30 Janar 1923).²⁹⁹ Për këtë arsye, çështja u deklarua e mbyllur, duke vijuar mëtej me trajtimin e çështjeve të myslimanëve shqiptarë në Greqi.

4.3 Punimet e Komisionit Mikst

Komisioni Mikst u formua më 7 Tetor 1923. Ky komisioni i caktuar prej Lidhjes së Kombeve do të mbikëqyrte procesin e shkëmbimit të popullsisë greko-turke, duke zbatuar politikat e duhura për arritjen e kësaj marrëveshje. Përmbushja e këtyre objektivave u shfaq e vështirë për sa i përket krahinës së Çamërisë. Zyrtarisht, shkëmbimi i popullsisë së Çamërisë u mbyll më 16 Mars 1926, ndonëse një sërë çështjesh vijuan të mbeteshin pezull e të diskutoheshin pranë Lidhjes së Kombeve në pamundësi për të gjetur një zgjidhje pranë

²⁹⁸ Ibidem.

²⁹⁹ Naska 1999: 180, 181, dok. 110.

autoriteteve greke. Greqia, e cila më parë, ishte përpjekur të ndikonte në mendimin e përgjithshëm të çamëve për t'i bërë ata të deklaroheshin si turq, hoqi dorë vetëm në rrugë zyrtare nga këto manipulime duke deklaruar besimin e saj në veprimtarinë e këtij komisioni.³⁰⁰ Pranë Lidhjes së Kombeve, Dendramis do të deklaronte në vitin 1926: *“Minoriteti Shqiptar në Greqi është i përbërë nga Myslimanë të Epirit dhe të Maqedonisë të cilët Komisioni Mikst i konsideroi si të pashkëmbyeshëm për shkak të origjinës së tyre shqiptare”*.³⁰¹

Komisioni Mikst hartoi platformën që do të zbatonte edhe në Çamëri, në një kohë kur kriteret e caktuara nuk ishin në përputhshmëri me rrethanat historike dhe etnografike që e karakterizonin këtë krahinë. Gjithashtu, në strukturën e tij, përfaqësuesi shqiptar nuk u caktua menjëherë, pavarësisht se fati i shqiptarëve ishte diskutuar që prej nisjes së bisedimeve për Konventën e Shkëmbimit të Popullsive greko-turke. Për më tepër, në vitin 1924 përfaqësuesi Spanjës pranë Lidhjes së Kombeve sugjeronte që kryetarët e nënkomisioneve të kishin nga një përfaqësues shqiptar.³⁰²

Për Dendramisin, të ngarkuarin me punë të Athinës në Bernë, prania e një përfaqësuesi shqipëtar në Komisionin Mikst ishte një kërkesë e papërfillshme pasi kjo kishte të bënte me çështjen e një minoriteti përballë Lidhjes së Kombeve, Greqisë, dhe Turqisë.³⁰³ Duke arsyetuar më tej mbi kthimin e 1500 shqiptarëve, të cilët pasi ishin shkëmbyer nga Çamëria në Turqi, kishin shkuar menjëherë në Shqipëri, Dendramis vë theksin në rëndësinë e pranisë së delegatit turk në Komisionin Mikst dhe nënkomisionet përkatëse, pasi sipas tij *“nëse vërtetë*

³⁰⁰ Ibidem.

³⁰¹ Tsitselikis 2012: 75.

³⁰² Naska 1999: 399, dok. 212.

³⁰³ Lidhja e Kombeve, C.81.1935.I.

ata do të jenë shqiptarë, delegati turk nuk do që ata të deklarohen turq".³⁰⁴ Në një kohë kur fare mirë interesat shqiptare mund t'i mbronte një përfaqësues shqiptar.

Kërkesat e ndryshme që pala shqiptare i dërgoi këtij Komisioni nuk u morën parasysh, siç ishin informacionet mbi përbërjen demografike dhe etnografike të popullsisë së këtij territori, të cilat do të kishin ndihmuar sadopak antarët e Komisionit me njohjen e terrenit në të cilin ata do të zhvillonin punimet e tyre.

Në një nga përpjekjet e përfaqësuesve çamë, të deleguar pranë qeverisë së Athinës, ministri i Bujqësisë së Greqisë, Milonas, iu përgjigj delegacionit shqiptar se të gjithë myslimanët shqiptarë të Greqisë do të përfshiheshin në shkëmbim.³⁰⁵ Përpara se Komisioni Mikst të niste punën e tij në terren, gazetari londinez Spender publikoi një artikull në gazetën Westminster, në të cilën denonconte fatin e shqiptarëve myslimanë të Çamërisë të cilët duhet të shpërnguleshin drejt Turqisë, si pasojë e Konventës së Lozanës mbi shkëmbimin e popullsisë greko-turke.³⁰⁶ Ai deklaronte se "*çamët banonin në këtë krahinë për breza me rradhë dhe pavarësisht se kishin përqaftuar fenë myslimane ata nuk kishin ndryshuar as racën e as origjinën e tyre*".³⁰⁷

Një telegram nga Athina, i datës 11 Tetor 1923, i drejtohej Kaklamanosit për të sqaruar më tej vendimin e Komisionit Mikst i cili synonte të bënte nisjen e personave të shkëmbyeshëm pas vlerësimit të pronave të tyre.³⁰⁸ Më 13 Tetor 1923, Kaklamanos shprehej i shqetësuar mbi faktin që Komisioni Mikst kishte pranuar për rishqyrtim disa prona të

³⁰⁴ Ibidem.

³⁰⁵ Naska 1999: 341, dok. 184.

³⁰⁶ Destani dhe Elsie 2013: 74.

³⁰⁷ Ibidem.

³⁰⁸ IAYE. Lidhja e Kombeve. /1923/5/4/1/ Nga Athina. *Telegram për Legatën Greke në Londër*. [Teksti në Frengjisht]. (11 Tetor 1923).

myslimanëve të përcaktuar më parë si të shkëmbyeshëm. Pjesa më e madhe e këtyre pronarëve ishte larguar, ndonëse pronat e tyre do të rishqyrtoheshin. Për më tepër, në këtë dokument që Kaklamanosi, shprehte shqetësimin e tij mbi shqyrtimin e "një kategorie tjetër pronarësh" të cilët duhet të qëndronin në Greqi, deri në një vendim përfundimtar që antarët e Komisionit Mikst do të merrnin. Ai vijonte duke deklaruar se *"Turqia ka të gjithë tokën e nevojshme për të vendosur emigrantë, ndërsa Greqia nuk e disponon një gjë të tillë, përveçse me ikjen e myslimanëve"*.³⁰⁹

Më 5 Dhjetor 1923, në letrën që Komisioni Mikst i drejtonte nënprefekturës së Filatit, jepeshin udhëzimet për mënyrat e shkëmbimit që do të zbatoheshin. Nga ky komunikim zyrtar kuptohet që për Greqinë e Lidhjen e Kombeve respektimi i të drejtave themelore i minoritetit shqiptar nuk ishte një çështje me rëndësi ndonëse Traktati i Sevrës ishte ratifikuar që në muajin Shtator 1923.³¹⁰ Nga ana tjetër, Konventa për Shkëmbimin e Popullsive Greko-Turke ishte hartuar në kundërshtim me Traktatet e Minoriteteve të hartuara në vitin 1920, dhe Konventën e Lidhjes së Kombeve, pasi shpërngulja e detyruar është një kundërshtim i qartë me të Drejtat Themelore të Njeriut, e të minoriteteve.

Ende pa u vendosur një platformë e qartë e Komisionit Mikst, qeveria greke u drejtua menjëherë drejt kësaj krahine duke mohuar në këtë mënyrë deklaratat e funksionarëve të saj të lartë, pasi mbi 22,000 çamë u panë si të përshtatshëm për t'u përfshirë në shkëmbimin e popullsisë greko-turke për shkak të fesë myslimane.³¹¹

³⁰⁹ IAYE. Lidhja e Kombeve. /1923/5/4/1/ Kaklamanos, D. *Telegram nga Londra në Athinë nr. 3606*. [Teksti në frengjisht]. (nr. protokolli 30669). (13 Tetor 1923).

³¹⁰ Naska 1999: 340-346, dok. 184.

³¹¹ Lidhja e Kombeve, C.308.M.117.1926.II.

Në 14 mars 1924, në mbledhjen e tij plenare, Komisioni Mikst vendosi “përrjashtimin e qytetarëve grekë, të fesë myslimane e të origjinës shqiptare, të cilët banonin në Epir nga shkëmbimi i detyrueshëm”, siç parashikohej në Konventën e datës 30 Janar 1923.³¹²

Në 21 Prill 1923, Komisioni vizitoi Prevezën dhe Janinën në mënyrë që të vendosej mbi kriterin që do të përdorej për përcaktimin e origjinës shqiptare. Ky udhëtim nuk qe objektiv për disa arsye. Rolin e përkthyesit e kreu delegati grek, në një kohë që komisioni duhet të vepronte mbi baza pa anësie. Ndër të tjera, në takimin me përfaqësuesit e komisionit u thirrën vetëm disa prej drejtuesve të klerit mysliman. Pas këtij takimi, antarët e komisionit arritën në përfundimin se “95% e popullsisë Çame ishte turke”.³¹³

Në promemorien e Sulejman Delvines deklarohet se thirrja e myftinjve për të diskutuar mbi çështjen e shkëmbimit ishte pikerisht për të evituar “ndjenjat shqiptare”.³¹⁴ Myftinjtë kishin arritur të ndikonin tek pronarët e mëdhenj të tokave të shpronësuar nga grekët të shprehnin dëshirën për t’u shkëmbyer, pasi siç u premtonin myftinjtë, ata do të merrnin shumë pasuri në Turqi. Ndërsa boshti tjetër i çamëve si Musa Demi, Haki Musai, Xhevat Merushi, etj kishin shprehur bindshëm ndjenjat e tyre shqiptare dhe për këtë arsye ata ishin burgosur.³¹⁵

³¹² IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Komisioni Mikst. *Commission Mixte Pour L'Echange des Populations Grecques et Turques. Resolution de l'Assemble Pleniére*. [Komisioni Mikst për Shkëmbimin e Popullsisë Greke dhe Turke. Rezolutë e Mbledhjes Plenare]. (14 Mars 1924); Lidhja e Kombeve, C.160.1924.I.;

³¹³ AQSH, Fondi 251, Dosja 84, Viti 1924, f. 28-30. Legata Shqiptare në Athinë. (9-25 Maj, 1924)

³¹⁴ AQSH, Fondi 251, Viti 1924, Dosja 84, f. 56, *Sulejman Delvina-Promemorje*. (12 Gusht 1924); Shih Mihalopoulos 1993: 57, i cili citon Drejtuesin e Përgjithshëm të Epirit Petihakis që deklaronte se “*organet bazë që do të vepronin për të nxitur shkëmbimin e çamëve drejt Turqisë, do të ishin përsëri myftinjtë.*”; Shih gjithashtu Divani 1995: 233.

³¹⁵ Ibidem.

Në 9 Prill 1924, legata shqiptare në Athinë informoi Ekstrandin, antarin e Komisionit Mikst mbi disa zona të Çamërisë të cilat ishin shqiptare. Nëse kjo listë do të ishte marrë parasysh, do të kishte përmirësuar gjëndjen e çamëve të cilët gjendeshin nën juridiksionin e masave shtrënguese të marra në funksion të procesit të shkëmbimit.³¹⁶

Kur komisioni që shkoi në Prevezë e Janinë doli në përfundimin se 95% e popullsisë ishte e vendosur për të emigruar bazuar në deklaratat e klerit mysliman të ftuar për të qenë të pranishëm.³¹⁷ Në të njëjtin muaj, përfaqësuesi i këtij komisioni, Ekstrand u shpreh se vetëm 3-5% e popullsisë së Çamërisë është shqiptare, pasi shumë prej të pyeturve u deklaruan si turq, raportonte ai në takimin me Mithat Frashërin.³¹⁸ Ky i fundit, i shpjegoi z. Ekstrand që çamët deklaroheshin si të tillë për shkak të vuajtjeve dhe propagandës se në Turqi ata do të kishin një jetesë shumë më të mirë.³¹⁹

Në raportin e përgjithshëm të datës 2 Qershor 1924, Komisioni deklaroi se mbi popullsinë e pyetur, jo vetëm të Epirit por dhe të Maqedonisë, shumica e personave shprehën origjinën e tyre turke, dhe vullnetin për t'u përfshirë në shkëmbim. Sipas antarëve të tij, këta persona nuk kishin patur asnjë lloj pengese për të bërë të tilla deklaratat. Ende nuk ishte vendosur një kriter "*i përgjithshëm e i paprekshëm*", dhe çdo rast ishte shqyrtuar më vehte, duke analizuar në detaje prejardhjen, gjuhën, zakonet dhe kostumet. Prejardhja do të konsiderohej e vlefshme nëse i interesuari do të paraqiste të gjitha faktet për të dëshmuar këtë. Sipas antarëve të komisionit, dëshira e shumë e prerë, e shprehur për t'u përfshirë në

³¹⁶ AQSH, Fondi 251, Viti 1924, Dosja 85, f. 4-6, *Legata Shqiptare në Athinë drejtuar Erik Ekstrand*. (9 Prill 1924)

³¹⁷ Naska 1999: 288-299, dok. 162, 163.

³¹⁸ Malltezi dhe Delvina 2012: 142-144, dok. 58.

³¹⁹ Ibidem.

shkëmbim, nuk duhej lënë pasdore. Doket dhe zakonet u konsideruan si elementë të dorës së dytë, ashtu sikurse dhe gjuha pasi dallimet nuk ishin të qarta midis popullsive të shqyrtuara.³²⁰

Mirëpo, petitionet e dërguara shpeshherë nga çamët drejt qeverisë greke, shqiptare dhe Lidhjes së Kombeve, tregonin se pjesa më e madhe e tyre nuk gëzonte lirinë për të vendosur.

Më 18 Qershor 1924, Komisioni Mikst udhëzonte nënkomisionet që të bazoheshin në kriterin e prejardhjes, të gjuhës, dhe të ndërgjegjes kombëtare.³²¹ Paraqitja e fakteve për vërtetimin e prejardhjes, nuk ishte një procedurë e lehtë për çamët, pasi juridikisht ata kishin qenë nënshettas të Perandorisë Osmane, dhe pas vitit 1913 u bënë nënshettas grekë. Nocioni i shtetit komb për Shqipërinë ishte ende në hapat e parë të tij, dhe çamët kishin mbetur jashtë kufijve zyrtarë të shtetit Shqiptar (1913), duke mos patur asnjë dokument ligjor që të mund të vërtetonin kombësinë e tyre shqiptare. Gjuha ishte një element i cili duhet të ishte marrë në konsideratë për të përcaktuar origjinën shqiptare pasi pjesa dërrmuese e popullsisë çame fliste shqip, me përjashtim të disa zonave në të cilat përdorej edhe gjuha greke e turke. Por, arbitrariteti i këtij kriteri të vendosur për përcaktimin e origjinës së çamëve mund të shihet dhe nga këndvështrimi i emigrantëve grekë të ardhur nga Turqia, pasi shumë prej tyre nuk flisnin greqisht e megjithatë ata u quajtën "grekë", ndonëse, nëse do të i ishte dhënë rëndësi kriterit të gjuhës për shqiptarët atëherë ky kriter do të kishte ndihmuar në përcaktimin e prejardhjes së tyre shqiptare.³²²

³²⁰ AQSH, Fondi 251, Viti 1924, Dosja 85, f. 13-17, *Raport i Përgjithshëm i Delegacionit të Komisionit Mikst të Ngarkuar me Studimin e Çështjes Shqiptare*. (2 Qershor 1924)

³²¹ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Komisioni Mikst. *Pa titull*. [Udhëzim për Nënkomisionet për Përjashtimin nga Shkëmbimi të Shtetasve Myslimanë Grekë, me origjinë Shqiptare]. (17 Qershor 1924).

³²² AQSH, Fondi 251, Dosja 79, Viti 1924, f. 273-280. *Raport mbi Kriteret Bazë për Përcaktimin e Kombësisë së Banorëve të Çamërisë [sugjeruar nga Ali Dino]*. (7 qershor 1924)

Ndërgjegja kombëtare ishte një kriter i cili linte një hapësirë të gjerë për interpretim pasi nën qeverisjen e Perandorisë Osmane popujt njiheshin në bazë të fesë, dhe popujt nuk ishin të mësuar të identifikoheshin në bazë të kombësisë, e mbi të gjitha ky kriter mund të anashkalohej edhe për shkak të rrethanave të tjera që i detyronin çamët që të mos deklaroheshin si shqiptarë.

Udhëzimet që iu dhanë nënkomisionit të XIV, në Çamëri, nuk ishin të përshtatshme për përcaktimin e origjinës. Në raportin e datës 2 Qershor u arrit në përfundimin se puna që duhet të bënte ishte e madhe dhe për këtë duheshin përdorur certifikatat e moskëmbimit, si një mënyrë për të lehtësuar më tej procedurat që do të ndiqeshin.³²³ Dhënia e këtyre certifikatave ishte një rrugëtim tjetër i gjatë të cilin çamët duhet ta ndiqnin, dhe me ato pak kursime që iu kishin mbetur pas pasojave të procesit të shkëmbimit të popullsive greko-turke që ra mbi ta, si dhe të shpronësimeve, apo të ndalimit të së drejtës mbi transaksionet ekonomike mbi pronën të cilat kishin filluar që në vitin 1917, pavarësisht se ligjet e reformës agrare u vunë në zbatim vetëm gjatë viteve '20 e më tej.

Në përpjekje që të informonte antarët e Komisionit Mikst, Ali Dino (7 Qershor 1924), një nga personalitetet e shquara të Çamërisë dhe ish- deputet i zgjedhur "me votat e çamëve", i dërgoi një letër kryetarit të Komisionit Mikst në Athinë, Widdingut. Në këtë letër, Dino i parashtron kryetarit të Komisionit kriteret që mund të merreshin në konsideratë për përcaktimin objektiv të kombësisë së popullsisë së Çamërisë. Ndër to, ai dallon: racën, fenë, ndërgjegjen kombëtare, gjuhën, doket dhe zakonet. Duke shpjeguar elementin e racës, ai i referohet një sërë veprave të autorëve të huaj si Leake, Pouqueville, Smart, Ibrahim Manzour,

³²³ AQSH, Fondi 251, Viti 1924, Dosja 85, f. 17, *Raport i Përgjithshëm i Delegacionit të Komisionit Mikst të Ngarkuar me Studimin e Çështjes Shqiptare*. (2 Qershor 1924)

Boue', dhe disa autorë të tjerë të cilët nuk kishin interesa të drejpërdrejta në Çamëri, pasi shumica e tyre ishin thjesht udhëtarë ose personalitete të shquara të kohës. Në vijim, Dino deklaroi se turqit dhe grekët i quanin çamët shqiptarë; për këtë ai jep dhe disa shembuj personalë lidhur me familjen e tij të cilët ishin përzgjedhur nga Sulltani si përfaqësues të çamëve duke u veshur me kostumin tradicional shqiptar. Për më tepër, Dino deklaroi se shtypi grek e quajti zgjedhjen e tij në Parlamentin Grek si një sukses të shqiptarëve. Duke përforsuar më tej shpjegimin e racës shqiptare ai i referohet veprës antropologjike të Pitard, titulluar "Popujt e Ballkanit", sipas të cilit raca shqiptare dallohej nga raca greke.³²⁴

Në lidhje me kriterin e fesë, Dino theksonte se pas pushtimit Osman në Ballkan, çamët [shumica e tyre] përqafuan fenë myslimane, por kjo sipas tij nuk ua kishte ndryshuar racën [nënkuptonte prejardhjen shqiptare] atyre. Më tej, ai ndalet më gjerë në kriterin e ndërgjegjes kombëtare, një kriter në të cilin Komisioni Mikst ishte përqëndruar shpesh herë duke e përkrahur si një element të domosdoshëm në përcaktimin e origjinës, e sidomos nëse ajo do të ishte shprehur bindshëm nga të interesuarit; ndonëse, shpeshherë kjo e fundit, nuk ishte objekt i vullnetit të lirë. Duke e konsideruar ndërgjegjen kombëtare si një kriter "*të pallogaritshëm e të paqëndrueshëm*", Dino i referohet Traktatit të Athinës, nenit mbi deklarin e nënshtetësisë e cila mund të bëhej vullnetarisht nga subjektet e përfshira në këtë akt ligjor. Sipas tij, një numër i vogël çamësh zgjodhi që të merrte nënshtetësinë Osmane, e shumë prej tyre hoqën dorë prej saj në 1917, pas mbarimit të afatit tre vjeçar ku nënshtetasit Osmanë duhet të shpërnguleheshin në Turqi. Në vazhdim, Dino ndalet në padrejtësitë dhe

³²⁴ AQSH, Fondi 251, Dosja 79, Viti 1924, f. 273-280. *Raport mbi Kriteret Bazë për Përcaktimin e Kombësisë së Banorëve të Çamërisë [sugjeruar nga Ali Dino].* (7 qershor 1924)

keqtrajtimet e ndryshme që çamëve po iu bëheshin nga autoritetet greke, në mënyrë që të tregonte se këto keqtrajtime çonin në një deklaram të pavërtetë të ndërgjegjes kombëtare.³²⁵

Gjuha sipas Dinos përbënte një element që duhej konsideruar si i vlefshëm në përcaktimin e kombësisë pasi çamët flisnin shqip, e një përqindje e vogël flisnin edhe gjuhët greke e turke. Doket dhe zakonet e çamëve ai i shpjegoi në detaje duke u shprehur se ato nuk kishin ngjashmëri me traditat turke. Ai klasifikoi si kriterin më të rëndësishëm racën, më tej gjuhën, doket dhe zakonet, dhe të fundit me një rëndësi të papërfillshme ishin ndërgjegja kombëtare dhe feja.⁹⁰ Por, as këto sugjerime nuk u morën parasysh nga antarët e Komisionit Mikst.

Në disa raporte që ky komision i dërgonte Lidhjes së Kombeve, deklaratat e qeverisë shqiptare quheshin jo të sakta.³²⁶ Gjithashtu, shqiptarët të cilët guxonin të deklaroheshin si të tillë përpara komisionit mikst, akuzoheshin dhe përndiqeshin nga autoritetet vendore.³²⁷ Me vendosjen e refugjatëve grekë në Çamëri, çamët nuk mund të ankoheshin për padrejtësitë që po iu bëheshin. Ndonëse kishte probleme të tilla si vjedhjet e pasurive, disa çamë të cilët u ankuan për këto fakte u burgosën e u dërguan në Prevezë.⁹²

Në 26 Korrik 1924, Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve i deklaroi Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë se komisioni kishte vendosur të merrte si element kryesor të përcaktimit të origjinës gjuhën.³²⁸ Por, asnjë nismë e ndërmarrë prej Komisionit nuk rezultoi objektive në trajtimin e çështjes së çamëve.

³²⁵ Ibidem.

³²⁶ Naska 1999: 315, dok. 170.

³²⁷ AQSH, Fondi 251, Dosja 84, Viti 1924, f. 28-30. Legata Shqiptare në Athinë. *Raport mbi Veprimet e Komisionit Mikst për Përcaktimin e Popullsisë së Këmbyeshme*. (9-25 maj 1924)

³²⁸ Naska 1999: 321, dok. 175.

Në vijim të punimeve të Komisionit Mikst, kur shqiptarët, ashtu sikurse dhe çamët u vunë përballë pyetjes "je grek apo turk", natyrisht ata u identifikuan me fenë e tyre si turq.³²⁹ Kishte një pjesë të konsiderueshme të popullsisë që për shkak të fesë myslimane e shihnin Turqinë si vendin e tyre.³³⁰ Pavarësisht kësaj, në identitetin kombëtar ata ishin shqiptarë, por nuk u mbetej asnjë zgjidhje tjetër, e mbi të gjitha duke konsideruar vuajtjet, e propagandën se duke shkuar në Turqi do të shpëtonin nga zgjedha greke, shumë shqiptarë vendosën të deklaroreshin si turq. Këtu vlen të përmendim takimin e Jasin Sadikut nga Margëlliçi me Karl Bratlin³³¹, kryetar i nënkomisionit të XIV të Epirit, ku përfaqësuesi çam i deklaroi këtij të fundit që vërtetë kishte deklaruar një vit më parë (1924) se dëshironte të shkëmbehej si turk, por vetëm prej padrejtësive të shkaktuara nga grekët, dhe pasi nuk kishte mundur të shpëronte prej keqtrajtimit të autoriteteve greke, duke përfshirë dhe bandat, kishte vendosur të qëndronte "në shtëpinë e tij, në vendin e tij".³³²

Një pengesë tjetër që nalonte popullsinë shqiptare për të shfaqur lirisht origjinën e tyre ishte dhe shtetrrëthimi i vendosur në krahinat e Çamërisë, ku personat që deklaroreshin turq lireshin të lirë, ndërsa për shqiptarët ndodhte e kundërta.³³³

Më 23 Qershor 1924, Mithat Frashëri informonte Ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, mbi vendimin e Komisionit Mikst i cili duke parë zhvillimet e fundit ku shumë shqiptarë deklaroreshin si turq, ata do t'i kërkonin atyre vërtetimin e kësaj origjine. Gjithashtu, Mithat Frashëri vë në dukje një tjetër mangësi në strukturën e komisionit, që ishte

³²⁹ Naska 1999: 258, dok. 143; Isufi 2002: 182.

³³⁰ Lidhja e Kombeve, C.81.1935.I.

³³¹ Në Shtojcën 11, të paraqitur nga Mehdi Frashëri pranë Lidhjes së Kombeve, 4 Dhjetor 1925, deklarohej se takimi është bërë me Ekstrandin.

³³² Isufi 2006: 344, 345; Isufi 2012: 95.

³³³ Naska 1999: 363, dok. 191.

mungesa e një përfaqësuesi shqiptar. Ai vijon, më tej, duke theksuar se Komisioni Mikst ishte ofenduar prej kërkesës shqiptare pranë Lidhjes së Kombeve.³³⁴ Gjithashtu, Ekstrandit nuk e kishte konsideruar ankesën e datës 5 Maj të Mithat Frashërit, kur ishte pyetur prej Lidhjes së Kombeve nëse kishte patur ndonjë ankesë nga popullsia vendase.³³⁵

Në 12 Gusht 1924, Legata Shqiptare në Athinë informonte Ministrinë e Jashtme të Shqipërisë mbi disa vërejtje lidhur me punimet e Komisionit Mikst. Sipas saj, Komisioni Mikst nuk kishte shqyrtuar nga afër situatën e shqiptarëve të cilët vuanin keqtrajtime nga më të ndryshmet. Ata e kishin marrë parasysh vetëm pjesërisht listën e dërguar nga Legata shqiptare, por kishin deklaruar se ishin dëgjuar shqiptarët e sugjeruar nga kjo e fundit. Një element tjetër i vërejtur nga përfaqësia shqiptare në Athinë ishte se Komisioni kishte thirrur për dëgjim elementë "turkofilë". Për më tepër, përkthyesi shqiptar ishte anashkaluar nga antarët e Komisionit dhe nuk ishte vendosur ende.³³⁶ Në këtë periudhë, në Shqipëri, fati i çamëve kishte marrë një vëmendje të konsiderueshme nga shtypi i kohës.³³⁷ Në Gazetën "Dajti", shkruhej se kjo popullsi ishte e detyruar "të zgjidhte midis braktisjes (së territorit) dhe likuidimit fizik".³³⁸

Bratli deklaronte më 27 Gusht 1924, që çamët e shkëmbyer në mënyrë të pavullnetshme, duke qenë të detyruar, të dërgoheshin në Shqipëri, dhe qeveria shqiptare të

³³⁴ Malltezi dhe Delvina 2013: 148, 149, dok. 64.

³³⁵ Ibidem.

³³⁶ AQSH, Fondi 251, Dosja 84, Viti 1924, f. 94-98. *Vërejtje rreth Raportit të Komisionit Mikst për Këmbimin e Popullsisë*. (12 Gusht 1924)

³³⁷ Puto 2010: 177.

³³⁸ Ibidem.

realizonte një marrëveshje me qeverinë turke për t'i dhënë kësaj popullsie kundërvleftën e pasurisë së lënë në Greqi.³³⁹

Një tjetër problematikë e hasur gjatë punimeve të komisionit ishte dhe mënyra sesi merrej informacioni nga shqiptarët mbi origjinën e tyre. Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, deklaronte se në Çamëri Komisioni Mikst shoqërohej nga autoritete ushtarake dhe shumë krahina i linte pa vizituar pasi sipas tyre mund të vriteshin nga Shqiptarët.³⁴⁰ Përpjekjet e Greqisë për të ndalur deklarimin e origjinës shqiptare vijonin. Ushtarakë të Filatit (1924) rrethuan katundin Varfan, Shulash, Spatar duke bërë perkuizicione në shtëpitë e këtij fshati nën justifikimin se po kërkonin të gjenin disa të arratisur, në një kohë kur popullsia vendase denonconte grabitjet e sendeve me vlerë që këto autoritete i bënë kësaj të fundit, dhe duke terrorizuar popullsinë.³⁴¹

Në muajin Tetor 1924, Dendramis, i ngarkuari me punë i Greqisë në Bernë, paraqiti pranë Lidhjes së Kombeve telegramin e dërguar nga Athina më 7 tetor 1924. Në këtë dokument deklarohet se qeveria Greke do të priste vendimin e Lidhjes së Kombeve për sa i përkiste shkëmbimit të popullsisë shqiptare. Si rrjedhojë, qeveria greke kishte urdhëruar ndalimin e largimit nga Greqia të atyre personave që ishin subjekte të shkëmbimit në vijim të vendimeve të Nënkomisionit.³⁴²

Pra, rreth dy vjet nga deklarata e Kaklamanosit, Venizelosit, dhe një sërë përfaqësuesve të tjerë të shtetit grek të cilët deklaruan që shqiptarët nuk do të përfshiheshin

³³⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 80, Viti 1924, f. 155-157. *Udhëzim për rastin e Çamërisë drejtuar Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë*. (27 gusht 1924).

³⁴⁰ Naska 1999: 367, dok. 195.

³⁴¹ AQSH, Fondi 251, Dosja 82, Viti 1924, f. 18. *Informacion për Masat Detyruese dhe për Grabitjet e Popullsisë fshatare Varfan, Shulash, dhe Spatar*. (20 qershor 1924)

³⁴² Lidhja e Kombeve, C.641.1924.VII.

në shkëmbim, në këtë dokument, ministria greke pranonte përfshirjen e shqiptarëve në shkëmbimin e popullsisë, pavarësisht faktit se ata nuk ishin subjekte legjitime të këtij procesi.

Për më tepër, në rezolutën e Këshillit në muajin Dhjetor 1923, "u pranua me kënaqësi "deklarata e përfaqësuesit grek i cili u shpreh se qeveria e tij nuk kishte për qëllim të përfshinte shqiptarët në këtë proces. Po ashtu, Këshilli ngarkonte Komisionin me detyrën për të vendosur drejtë në vendimarrjen gjatë këtij procesi, çka nënkuptonte përjashtimin e shqiptarëve.³⁴³ Por, në këtë shkresë³⁴⁴ deklarohet se ishte Nënkomisioni ai i cili kishte vendosur mbi shkëmbimin e shqiptarëve, duke pasqyruar nga ana tjetër një nga pikat e dobëta të këtij organi (Komisioni Mikst) të mandatuar nga Lidhja e Kombeve, i cili duhet të merrte vendime të drejta dhe objektive në terren.

Në vijim të shkresës, Dendramis deklaronte se këta persona që ishin shpërngulur nga pronat e tyre, kishin qenë në pikën e nisjes, në porte, nga ku nuk mund të ktheheshin më pas. Sipas përfaqësuesit grek, situata ishte e rënduar sidomos për shkak se ata nuk mund të ktheheshin në pronat e tyre duke qenë se refugjatët ishin vendosur në pronat e tyre. Në mbyllje të telegramit, Dendramis i kërkoi Këshillit të Lidhjes së Kombeve shpërnguljen e menjëhershme të shqiptarëve, të cilët ishin rreth 1,500 vetë, drejt Turqisë në mënyrë që ata të mund të siguronin sa më shpejtë një strehë.³⁴⁵

Ligjërisht, Greqia në bazë të Konventës së Lozanës (30 Janar 1923) mund të shpërngulte nga territori i saj shtetëror çdo subjekt grek të fesë myslimane, i cili nuk përjashtohej nga shkëmbimi sipas nenit 2 të këtij dokumenti. Në rrugë diplomatike, në saj të

³⁴³ Lidhja e Kombeve, C.762.(1).1923.VII.

³⁴⁴ Lidhja e Kombeve, C.641.1924.VII.

³⁴⁵ Ibidem.

angazhimit të elementit shqiptar për t'u përjashtuar nga ky shkëmbim i padrejtë, një sërë deklaratah për përjashtimin e shqiptarëve u bënë nga aktorët kryesorë të politikës greke gjatë kësaj periudhe.

Në raportin e datës 28 Tetor 1924, përfaqësuesi spanjoll pranë Këshillit të Lidhjes së Kombeve deklaroi se kërkesa e qeverisë greke mbi shkëmbimin e 1000-1500 personave pranohej. Për më tepër, në këtë shkresë shprehet vlerësimi për mendimin human të qeverisë greke, e cila e kërkoi këtë shkëmbim me qëllim që të evitonte vuajtjet e mëtejshme të këtij grupi shqiptarësh. Përfaqësuesi De Leon deklaroi gjithashtu se Këshilli nuk ishte në dijeni të kësaj situate, dhe për sa i përkiste çështjes së shqiptarëve që banonin në Greqi, ajo do të diskutohej në seancën e muajit Dhjetor (1924).³⁴⁶

Në shkresën e datës 5 Dhjetor 1924, Dendramis, shfaqti një qëndrim kundërshtues në krahasim me dokumentin e paraqitur prej tij gjatë muajit Tetor. Në shkresën e dytë, ai shprehet se popullsia të cilën më parë e kishte quajtur shqiptare, ishte në fakt popullsi myslimane, për të cilën Këshilli i Lidhjes së Kombeve kishte dhënë dakordësinë e tij, në vijim të kërkesës greke, për shkëmbimin e tyre.³⁴⁷

Këshilli i Lidhjes së Kombeve, i cili në këtë periudhë kishte vendosur që ta trajtonte çështjen e shqiptarëve si një çështje minoriteti në shtetin Grek, e anashkaloi faktin se në shkëmbim ishin të përfshirë rreth 1500 shqiptarë, për të cilët deklarata të shumta ishin kryer për përjashtimin e tyre nga ky proces për shkak të kombësisë së tyre shqiptare.

Më 23 korrik 1925, Qenan Mesareja, përfaqësuesi shqiptar i nënkomisionit njoftonte mbi situatën në Çamëri dhe punimet e Komisionit atje. Situata në Arpicë ishte tepër e

³⁴⁶ Destani dhe Elsie 2013: 163; Mihalopoulos 1993: 45, 46;

³⁴⁷ Lidhja e Kombeve, C.813.1924.VII.

rënduar pasi vetë komandanti terrorizonte popullsinë vendase. Ky i fundit kishte mbështetjen e myftiut gjithashtu. Sipas denoncimeve të Ahmed Abdurrahman, këta dy persona ndëshkonin në çdo mënyrë këdo që deklarohesh shqiptar.³⁴⁸

Komisioni Mikst vijonte të ndiqte politika të paqarta ndaj përcaktimit të shkëmbyeshmërisë së shqiptarëve në Greqi. Më 3 gusht 1925 në Kostandinopojë, antarët e tij shpallën vendimin e radhës në lidhje me këtë popullsi. Sipas tyre, personat e shkëmbyeshëm duhet të përzgjidheshin vetëm pasi të ishin caktuar personat e pa shkëmbyeshëm, dhe për këtë sugjerohej që të bëhej "një dallim dhe ndarje" e myslimanëve shqiptarë të Greqisë, me myslimanët e tjerë.³⁴⁹

"Ngrirja" e të drejtave themelore të popullsisë së fesë myslimane në Greqi (në të cilën përfshiheshin edhe çamët) ishte një fenomen i pranuar edhe nga Lidhja e Kombeve. Në përgjigjen që Drumondi i dërgonte mandatarëve, më 24 Gusht 1925, ai deklaronte se pas vërtetimit të kombësisë shqiptare, dhe përjashtimit nga shkëmbimi të personave të caktuar, ata nuk duhet t'i drejtoheshin Komisionit Mikst në rast se do të vijonin duke mos patur të drejtat e tyre themelore, por për këtë duhet t'i drejtoheshin drejtpërdrejtë Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve në Gjeneve.³⁵⁰ Në këtë mënyrë, Lidhja e Kombeve pranonte faktin që çamëve iu mohoheshin të drejtat themelore.

Rreth dy vite pas fillimit të punimeve të Komisionit Mikst, Mithat Frashëri iu drejtua Kryetarit të Komisionit Mikst në Stamboll, duke i kërkuar atij vëmendjen për trajtimin e

³⁴⁸ AQSH, Fondi 251, Dosja /1, Viti 1925, f. 33-35. *Raport për Keqtrajtimet dhe Dhunimet e Popullsisë Çame të Arpicës nga Autoritetet Greke, si edhe për Përpjekjet pranë Komisionit Mikst në Mbrojtje të tyre.* (23 Korrik 1925).

³⁴⁹ Komisioni Mikst 1925: 318.

³⁵⁰ Drummond 1925: 1683.

padrejtë ndaj shqiptarëve. Sipas Mithat Frashërit (1925) prej 3 vitesh Shqiptarët, po ashtu sikurse dhe çamët po vuanin masat shtrënguese të qeverisë greke. Ai denonconte dhe faktin se të dhënat e marra në terren nuk merreshin parasysh. Sipas të dhënave të raportit në fjalë, më shumë se 60 mijë persona ishin dëbuar prej trojeve të tyre.³⁵¹

Nga ana e saj Lidhja e Kombeve vijonte ta trajtonte çështjen shqiptare në Greqi në mënyrë sipërfaqësore. Më 17 Nëntor 1925, Drumondi iu drejtua Vrionit në lidhje informacionin e dërguar prej kryetarit të Komisionit Mikst për marrëveshjen greko-turke e cila kishte për shkëmbimin e 5,000 shqiptarëve të Greqisë, duke e siguruar se një marrëveshje e tillë nuk ekzistonte. Ndërkohë që në të njëjtën datë, Sekretari i Lidhjes së Kombeve siguroi Ministrin Shqiptar Vrioni se çështja e shqiptarëve në Greqi do të bëhej pjesë e sesionit të muajit Dhjetor në Këshill.³⁵² Megjithatë, marrëveshja greko-turke në lidhje me shpërnguljen e 5,000 çamëve drejt Turqisë, ishte hartuar në fshetësi midis palëve të interesuara, ndonëse fillimisht Ankaraja zyrtare nuk e kishte pranuar këtë.³⁵³ Megjithatë, kjo marrëveshje nuk u realizua.

Më 12 Dhjetor 1925, Mithat Frashëri shprehu pakënaqësinë e tij duke vënë në dukje problematikat e punimeve të Komisionit Mikst, i cili sipas tij nuk i kishte dhënë rëndësinë e duhur elementit shqiptar, duke e detyruar atë të përfshihej në shkëmbim. Sipas Mithat Frashërit, këto problematika kishin ardhur prej mungesës së përfaqësimit të shtetit shqiptar

³⁵¹ Malltezi dhe Delvina 2012: 337, dok. 186.

³⁵² Naska 1999: 459, 460, dok. 250; Shih: Divani 1995: 231, 232.

³⁵³ Mihalopoulos 1986: 308-309.; Shih gjithashtu Mihalopoulos 1993: 61-62.

me anë të një sekretari permanent në Gjeneve, si dhe të një përfaqësuesi diplomatik në Turqi.³⁵⁴

Qeveria Greke (dhjetor 1925-janar 1926) po planifikonte t'i kërkonte Komisionit Mikst shpërbërjen e nënkomisionit të Epirit, dhe heqjen e masave shtrënguese të marra ndaj popullsisë të menduara si të shkëmbyeshme.³⁵⁵ Në seancën e datës 16 mars 1926, qeveria greke e konsideronte shkëmbimin e popullsisë të Epirit si të përfunduar së bashku me punimet e nënkomisionit të XIV-të.³⁵⁶

Më 27 Janar 1926, Mithat Frashëri iu drejtua Ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë për ta informuar mbi situatën në Çamëri. Ai vuri në dukje se autoritetet greke i kishin premtuar Z. Colban që do të ndryshonin sjellje ndaj elementit shqiptar. Megjithatë, në kërkesën për suprimimin e nënkomisionit të Gumenicës, qeveria greke mendonte se 800 persona të kësaj krahine ishin ende të kontestuar dhe pritej rishqyrtimi i komisionit mikst për këtë çështje.³⁵⁷ Sidoqoftë, në seancën e datës 16 Mars 1926, kur Greqia kërkoi zyrtarisht përfundimin e shkëmbimit të çamëve, ajo pranoi gjithashtu se nuk do të kërkonte shkëmbimin e 800 çamëve të cilët ishin diskutuar gjatë mbledhjes së Këshillit në muajin Dhjetor 1925.³⁵⁸ Pasi bisedës me Mithat Frashërin mbi prejardhjen shqiptare të popullsisë në fjalë, drejtori i seksionit të Minoriteteve në Lidhjen e Kombeve i premtoi atij se do të merrte parasysh çdo ankesë të çamëve. Në këtë shkresë kërkohet të dërgohet edhe një herë çështja çame pranë Lidhjes së Kombeve në Mars, me delegat Mehdi Frashërin.³⁵⁹

³⁵⁴ AQSH, Fondi 251, Dosja 131/2, Viti 1925, f. 182-183. *Raport mbi Qëndrimet e Padrejta të Komisionit Mikst ndaj Popullsisë Çame*. (12 Dhjetor 1925)

³⁵⁵ Shih për më tepër Divani 1995: 235.

³⁵⁶ Destani dhe Elsie 2013: 228.

³⁵⁷ Malltezi dhe Delvina 2013: 366, 367, dok. 202.

³⁵⁸ Correspondance d'Orient 1926, 05: 211 (pa autor).

³⁵⁹ Malltezi dhe Delvina 2013: 366, 367.

Më 2 Shkurt 1926, Qenan Mesare informonte De Larën mbi disa çështje të Çamërisë në situatën e shkëmbimit të popullsisë. Sipas asistentit shqiptar, vendosja e refugjatëve grekë ishte bërë në mënyrë të padrejtë përse u përkiste fshatrave shqiptarë. Në disa fshatra grekë nuk ishin vendosur refugjatë. Shumë shtëpi ishin lënë të pabanuara, pasi një pjesë e mirë e popullsisë çame ishte përfshirë në shkëmbim. Për këtë, Mesare përmend rastin e Pargës. Në këtë letër, autori kritikonte dhe procedurat e Zyrës Autonome të Vendosijes. Ai përfundon duke theksuar se masat shtrënguese që prej fillimit të procesit kishin prekur, ndër të tjera çamët, dhe jo të gjithë Grekët.³⁶⁰

Karl Bratli, kryetar i nënkomisionit të 14-të Mikst, kishte hasur vështirësi në aplikimin e procedurave të vendosura nga Komisioni për shkëmbimin e popullsive në Çamëri.³⁶¹ Pala shqiptare e shihte zëvendësimin e tij me Sliben, si të qëllimshëm, por kjo u kundërshtua nga autoritetet e Lidhjes së Kombeve.³⁶²

Më 4 Shkurt 1926, Mesare informonte Mithat Frashërin mbi debatin e tij me Sliben. Sipas asistentit shqiptar, antari i Komisionit e kishte pranuar dështimin e nënkomisionit të Epirit, por besonte se kriteret në përcaktimin e një popullsie çamë prej 5,000 vetësh dhe 800 vetësh për shkëmbim ishin zbatuar në mënyrë të paanshme. Përfaqësuesi shqiptar në këtë komision premtoi se do të përpiqej që të ndalonte shkëmbimin e padrejtë të çdo shqiptari.³⁶³ Komisioni Mikst i mbylli punimet më 19 Tetor të vitit 1934. Nga fillimi i punimeve të tij e

³⁶⁰ AQSH, Fondi 251, Dosja 119, Viti 1926, f. 140-145. *Raport në të cilin jepet Zënia e Shtëpive të Myslimanëve Çamë prej Refugjatëve Grekë*. (2 shkurt 1926)

³⁶¹ Naska 1999: 466-478, dok. 257.

³⁶² Naska 1999: 466-478 dok. 257.

³⁶³ AQSH, Fondi 251, Dosja 119, Viti 1925, f. 442. *Peticion mbi Gjendjen e Vështirë Ekonomike dhe Kërkesa për një Ndërhyrje të Shpejtë pranë Qeverisë Greke për Kthimin e Pronave të tyre*. (11 nëntor 1925)

deri më 31 Mars 1925, ishin shkëmbyer gjithësej 354,647 myslimanë nga Greqia drejt Turqisë.³⁶⁴

Me përfundimin e punimeve të Komisionit Mikst, secili prej vendeve duhet të caktonte një organ shtetëror i cili do të vijonte me çështjet e lëna pezull prej komisionit të cilat kishin të bënin me përcaktimin e nënshtetësisë. Për këtë, në Greqi u krijua Këshilli i Nënshtetësisë.

Për shkëmbimin e 800 [tetëqind] gardhiqotëve dhe dhragumiotëve, çështje e cila ishte lënë pezull, përfaqësuesi i Shqipërisë në Ankara, Rauf Fico, kishte marrë premtimin nga pala greke dhe turke se ata nuk do të përfshiheshin në këtë proces pasi ishin shqiptarë. Mirëpo, për këtë duhet të vendoste përfundimisht Komisioni Mikst.³⁶⁵

Punën e Komisionit Mikst, autorja Georgia Kretsi e quan "të dyshimtë e të pasuksesshme" pasi ndryshimi i herë pas hershëm i kriterëve që do të përcaktonin origjinën shqiptare, çonte në këtë drejtim, sipas saj.³⁶⁶

4.4 Qeverisja Greke në Çamëri gjatë Shkëmbimit të Popullsive Greko-Turke

Spastrimi etnik ndaj çamëve kishte nisur që prej pushtimit të krahinës nga forcat ushtarake greke, por me nisjen zyrtare të procesit të shkëmbimit të popullsive greko-turke (1923), gjendja e të drejtave themelore të çamëve u rëndua dukshëm. Të drejtat civile dhe

³⁶⁴ Lidhja e Kombeve, C.34.1935.I.

³⁶⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 119, Viti 1926, f. 470. *Njoftim mbi Qëndrimin e Përfaqësuesve të Komisionit Mikst dhe të Qeverisë Greke për Çështjen e Dragumit dhe Gardhiqit.* (16 mars 1926)

³⁶⁶ Kretsi 2005: 60.

ekonomike të personave që do të caktoheshin për t'u përfshirë në shkëmbim, "u ngrinë" deri në vërtetimin e origjinës përkatëse. Në gjendjen kaotike të krijuar si rrjedhojë e këtyre masave, çamët duhet të vërtetonin kombësinë e tyre shqiptare për të rimarrë të drejtat e humbura. Vërtetimi i kombësisë shqiptare nuk ishte një rrugëtim i lehtë për t'u arrirë, pasi, ndër të tjera, kishte vonesa të shumta administrative për të tilla çështje.

Aktorët kryesorë që ndikuan në gjendjen e krijuar në Çamëri ishin: qeveria greke, autoritetet vendore, kleri mysliman, si dhe refugjatët. Qeveria greke mori masat ligjore për ngrirjen e të drejtave të çamëve për shkak të fesë së tyre myslimane, në kundërshtim me deklaratat e funksionarëve të lartë të saj të cilët shprehën se do të përjashtonin shqiptarët (çamët) nga këto rrethana. Në këtë periudhë, çamët humbën të drejtën për shfrytëzimin e pronës së tyre. Autoritetet vendore luajtën rolin kryesor në keqtrajtimin që iu bëhej çamëve në çdo drejtim të jetës së tyre të përditshme. Edhe gjatë kësaj periudhe, këto autoritete synonin të ndikonin vendimarrjen e popullsisë vendase, duke e detyruar atë që të përmbushte aspiratat e shtetit grek. Si në vitin 1913, kur ata u përpoqën me çdo mënyrë të detyronin shqiptarët të deklaroheshin grekë, edhe këtë herë të njëjtat struktura qeverisëse i detyronin shqiptarët që të deklaroheshin si turq në mënyrë që të përfshiheshin në shkëmbimin e popullsisë.³⁶⁷

Kleri mysliman, duke qenë se kishte një marrëdhënie të konsoliduar klientelizmi me autoritetet qendrore dhe vendore greke, luajtën një rol thelbësor në manipulimin e mendimit të masave të popullsisë, me qëllim që të arrinin synimet politike të qeverisë greke. Bashkëjetesa me refugjatët ishte një tjetër problem i krijuar në vijim të shkëmbimit të

³⁶⁷ Isufi 1997: 68.

popullsisë, për shkak të mungesës së hapsirave për vendosjen e tyre, e cila u krye në dëm të çamëve duke u uzurpuar pronat private e publike. Si rrjedhojë, lindën një sërë kazusesh të cilat u paraqitën pranë Lidhjes së Kombeve nga pala shqiptare dhe çame me anë të peticioneve, deklaratave dhe takimeve.

Stavro Stavri, Ministri i Shqipërisë në Athinë i dërgoi një letër më 4 Janar 1927 Ministrin të Punëve të Jashtme në Tiranë për ta vënë në dijeni mbi gjendjen e çamëve. Çamët e moshës 50 vjeç ishin të detyruar të bënin 4 muaj shërbim, ose të paguanin një gjobë prej 3000 dhrahmi. Këto masa nuk aplikoheshin në pjesë të tjera të popullsisë brenda shtetit grek.³⁶⁸ Për më tepër, çamëve iu kërkohej pagesa e taksës *foron qefalou*, e cila ishte një taksë dhjetëfish më shumë sesa vlera e tokës së shpronësuar. Në rastet kur kjo taksë nuk mund të paguhej, ata ishin të detyruar të largoheshin prej pronave të tyre.¹⁰⁷

Me dekretin e datës 15 Shkurt 1923 "Mbi Rehabilitimin e të Varfëve", çamët shpronësoheshin në favor të fermerëve pa tokë dhe të refugjatëve. Mohimi i të drejtës së pronës në Çamëri kishte qenë i pranishëm dhe më parë në vijim të një sërë ligjeve të hartuara të cilat u ndalonin atyre traksaksionet mbi pronat e paluajtshme.³⁶⁹ Pas vitit 1923, kjo masë u shtri dhe në pronat e luajtshme.³⁷⁰ Në bazë të dekretit të vitit 1922 "3/4 e tokave të myslimanëve u jepej refugjatëve si dhe 1/2 e tokave djerrë".³⁷¹ Thirrja që përfaqësuesit çamë Musa Demi, Haki Musaj, dhe Hysni Abazi, i kishin drejtuar qeverisë së Athinës për përjashtimin e tyre nga masat shtrënguese të qeverisë greke për rregullimin e procesit të

³⁶⁸ AQSH, Fondi 251, Dosja 130, Viti 1927, f. 8,9. *Raport në të cilin bëhet fjalë për Gjendjen e Mjeruar Ekonomike të Çamëve dhe për Shtrëngimet e Autoriteteve Greke*. (4 Janar 1927)

³⁶⁹ Tsitselikis 2012: 298.

³⁷⁰ AQSH, Fondi 251, Dosja 81, Viti 1923, f. 2. *Peticion ndaj Masave që kanë marrë Nënguvernatorët e lokaliteteve Prevezë, Paramithi, Margëlliç, dhe Filat kundër Elementit Shqiptar të Çamërisë*. (20 Tetor 1923).

³⁷¹ Isufi 2016: 140.

shkëmbimit të popullsisë, të cilat përfshinin edhe çamët myslimanë, nuk ishte dëgjuar³⁷², pasi më 2 Tetor 1923, Komanda e Përgjithshme e Epirit deklaroi masa të mëtejshme shtrënguese mbi shitjen dhe dhënien me qira të pronave të myslimanëve.³⁷³

Legata Shqiptare në Athinë iu drejtua Ministrisë së Jashtme të Greqisë më 5 Prill 1923 për ta vënë në dijeni mbi gjendjen e krijuar në popullsinë shqiptare në vijim të ligjeve të hartuara nga qeveria greke në lidhje me pronat e myslimanëve. Në këtë shkresë, Mithat Frashëri vinte theksin mbi subjektet që këto ligje duhet të përfshinin, të cilët ishin myslimanët turq e jo myslimanët shqiptarë, apo dhe të kombësive të tjera.³⁷⁴ Në përgjigje të peticionit të përfaqësuesit shqiptar në Greqi, Ministria e Jashtme i kërkoi Legatës Shqiptare në Athinë një listë të detajuar me emër, mbiembër dhe vendndodhje të subjekteve shqiptare të cilët ishin ankuar në vijim të zbatimit të dekret ligjit të datës 6 Tetor 1922.³⁷⁵ Në 19 Prill, Legata Shqiptare deklaronte se kishte marrë dakordësinë e Z. Lagudhakis, Drejtorit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë që të bëhej dallimi midis myslimanëve turq dhe myslimanëve shqiptarë. Në këtë shkresë deklarohet se ishte e pamundur që të hartohej një listë me emrat e shqiptarëve të cilët kishin patur apo do të kishin në të ardhmen qëllim për të

³⁷² AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 71. *Kërkesë për Përfshirjen nga Këmbimi, si edhe për Ndalimin e Shitjes së Pasurive të Patundshme*. (10 korrik 1923)

³⁷³ Baltiotis 2011: 7.

³⁷⁴ IAYE. Zyra Qendrore /1923/16/5/1/1/ Mithat Frashëri (Legata Shqiptare në Athinë). [Dërguar Ministrisë (Ministrit) së Jashtme të Greqisë]. (nr. 26, nr. protokoll në Ministrinë e Çështjeve të Jashtme të Greqisë 8724, data 10-4-1923). (5 Prill 1923).

³⁷⁵ IAYE. Zyra Qendrore /1923/16/5/1/1/ Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë. *Notë verbale*. [Përgjigje ndaj shkrësës nr. 26 të Legatës së Shqipërisë, Athinë, më 5 Prill 1923]. (nr. protokoll 8724, dosja 139, seksioni Δ'). (18 Prill 1923); IAYE. Zyra Qendrore /1923/16/5/1/1/ Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë. *Notë verbale*. [Përgjigje ndaj shkrësës nr. 140 të Legatës së Shqipërisë, Athinë, më 19 Prill 1923]. (nr. protokoll 10641, dosja 139, seksioni Δ'). (26 Prill 1923)

shitur, apo dhënë me qera, pronat e tyre.³⁷⁶ Më 30 Prill, Mithat Frashëri iu përgjigj shkresës së datës 26 Prill 1923 të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë, duke i përmendur deklaratën e Kaklamanosit më 19 Janar 1923, mbi përjashtimin e elementit shqiptar nga shkëmbim, dhe në vijim, i deklaronte se nuk mund t'i siguronte kësaj ministrie një listë të personave që kishin bërë ankesa pranë kësaj legatë pasi dhe në të ardhmen do të kishte shqiptarë të tjerë që do të mund të dëshironin të gëzonin plotësisht të drejtat mbi pronat e tyre, pra nuk mund të vijohej me anë të paraqitjes së peticioneve për cilindo shqiptar që dëshironte të gëzonte plotësisht të drejtat mbi pronat që dispononte, pasi ashtu siç e pranonin dhe përfaqësuesit politikë grekë, numri i shqiptarëve në Greqi ishte disa herë më i madh në krahasim me minoritetet e tjera.³⁷⁷

Më 23 Qershor 1923, gazeta "Kirikis" kishte botuar një qarkore të prefektit të Janinës në të cilën thuhej se dhe çamët do të përfshiheshin në shkëmbimin greko-turk, mirëpo kryediplomati i Legatës Shqiptare në Athinë³⁷⁸ ishte informuar pranë ministrisë greke duke u vënë në dijeni për qarkoren e dërguar me datë 22 Qershor dërguar prefekturave të Janinës, Maqedonisë, dhe Thrakës, ku shprehej vullneti i qeverisë greke për të ndaluar shkëmbimin e çamëve.³⁷⁹

Përpjekjet e çamëve vijonin si pranë autoriteteve greke ashtu edhe pranë autoriteteve të Lidhjes së Kombeve. Më 20 Tetor 1923, disa përfaqësues të kësaj krahine iu drejtuan

³⁷⁶ IAYE. Zyra Qendrore /1923/16/5/1/1/ Legata Shqiptare në Athinë. *Notë verbale*. [Përgjigje ndaj shkresës së Ministrisë së Jashtme të Greqisë, datë 18 Prill 1923]. (nr. 140, nr. protokolli në Ministrinë e Çështjeve të Jashtme të Greqisë 10641, dosja Δ 139, data 21-4-1923). (19 Prill 1923).

³⁷⁷ IAYE. Zyra Qendrore /1923/16/5/1/1/ Legata Shqiptare në Athinë. [Përgjigje ndaj shkresës së Ministrisë së Jashtme të Greqisë, datë 26 Prill 1923]. (nr. 207 (bis), nr. protokolli në Ministrinë e Çështjeve të Jashtme të Greqisë 11868, dosja Δ' 139, data 4-5-1923). (30 Prill 1923).

³⁷⁸ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 51. *Njoftim për Shqiptarët që nuk do Trajtohen si Turq në Çështjet e Këmbimit të Popullsive Greko-Turke*. (23 qershor 1923)

³⁷⁹ Ibidem.

gjeneralit De Lara, kryetarit të Komisionit Mikst në Athinë për ta vënë në dijeni në lidhje me disa të drejta themelore të mohuara ndaj kësaj popullsie. Ndër të tjera, ato denonconin pamundësinë për të marrë qiranë e pronave të tyre pasi qiramarrësi ja jepte shtetit detyrimin që duhet t'ja dorëzonte pronarit.³⁸⁰

Në 5 Qershor 1924, Kaklamanos informonte majorin Abraham në Lidhjen e Kombeve se Greqia do të jepte urdhër për të hequr masat shtrënguese që kishin përfshirë dhe shqiptarët, sapo të merrte informacionin mbi platformën që do të zbatonte Komisioni Mikst për përcaktimin e kriterëve të përjashtimit nga shkëmbimi.³⁸¹ Në këtë deklaratë të Kaklamanosit kuptohet që Greqia e pranonte faktin që masat shtrënguese të marra në funksion të realizimit të procesit të shkëmbimit kishin përfshirë dhe myslimanët shqiptarë.

Në 4 Gusht 1924, Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Rusos, i dërgonte një letër legatës greke në Durrës duke i komunikuar disaprovimin e qeverisë Greke për petitionet që qeveria Shqiptare dërgonte drejt Lidhjes së Kombeve për të denoncuar keqtrajtimet që autoritet e së parës [qeverisë greke] i bënin popullsisë së Epirit. Për këtë, qeveria Greke shfaqti një reagim të ashpër nëse do të zbatohet parimi i reciprocitetit, duke deklaruar se:

*"në rast se një masë e çfarëdoshme do të merrej ndaj elementit grek të Epirit të Veriut, qeveria greke nuk mund të qëndrojë mospërfillëse, por do të veprojë si t'ja diktojnë interesat e saj".*³⁸²

³⁸⁰ AQSH, Fondi 251, Dosja 81, Viti 1923, f. 2. *Peticion ndaj Masave që kanë marrë Nënqevernatorët e lokaliteteve Prevezë, Paramithi, Margëlliç, dhe Filat kundër Elementit Shqiptar të Çamërisë.* (20 Tetor 1923).

³⁸¹ AQSH, Fondi 251, Dosja 80, Viti 1924, f. 57. *Njoftim që Qeveria Greke të Përfshijë nga Këmbimi Myslimanët Shqiptarë, pasi Komisioni Mikst të përcaktojë Prejardhjen e Shqiptarëve të tyre.* (5 Qershor 1924).

³⁸² AQSH, Fondi 251, Dosja 85, Viti 1924, f. 176. *Njoftim për Ankesat e Shqiptarëve ndaj Raportit të Komisionit Mikst që i trajton sikur Myslimanët Shqiptarë kanë hyrë vullnetarisht në Këmbim.* (4 Gusht 1924)

Në 14 dhjetor të vitit 1923, pas një peticioni të dërguar nga një grup përfaqësuesish çamë, drejtuesi i përgjithshëm i Epirit përgjigjej se për aq sa Komisioni nuk i kishte përjashtuar çamët nga përfshirja e tyre në shkëmbimin e popullsisë, ata rrezikonin të mos votonin në zgjedhjet e ardhshme që do të mbaheshin.³⁸³ Në fakt, në zgjedhjet lokale të datës 25 tetor 1925, çamëve iu ndalua e drejta e votës në vijim të një urdhëri të Ministrisë së Brendshme botuar në fletoren zyrtare nr. 317, të datës 22 tetor 1925, duke qënë se konsideroheshin si elementë për t'u përfshirë në shkëmbim, bazuar në fenë e tyre myslimane.³⁸⁴ Kryediplomati shqiptar në Athinë, Frashëri, informonte Ministrin e Punëve të Jashtme në Tiranë mbi të mohimin e të drejtës së votës që i kanosej shqiptarëve fill pas nisjes së procesit zyrtar të shkëmbimit të popullsive greko-turke (1923). Jetesa e tyre po bëhej tepër e vështirë duke i detyruar ata gjithnjë e më tepër që të largoheshin.³⁸⁵

Më 29 Dhjetor 1927, disa çamë dërguan një peticion drejt Lidhjes së Kombeve për të kërkuar mbrojtje të të drejtave të tyre pasi ato nuk respektoheshin nga autoritetet greke, pavarësisht premtimeve të saj të vazhdueshme. Për këtë, autorët e këtij peticioni paraqesin një sërë faktesh precedente si deklarata e përfaqësuesit grek në muajin mars 1926, ku u dha premtimi se masat shtrënguese ndaj çamëve do të hiqeshin. Përtej këtij momenti historik, përpjekjet për t'i përfshirë çamët në shkëmbim, ose për t'i detyruar ata që të largoheshin nga trojet e tyre, nuk ndaluan. Kretsi shkruan se për këtë ndikuan si shteti grek, ashtu dhe autoritetet lokale.³⁸⁶ Shteti grek sidomos në këtë periudhë (1926 e më tej) ndiqte “politika të

³⁸³ Destani dhe Elsie 2013: 102.

³⁸⁴ AQSH, Fondi 251, Dosja 40, Viti 1928, f. 20-31. *Pasqyrë e Hollësishme e Grabitjes së Pasurive në Çamëri dhe e Mohimit të të Drejtave Politike e Sociale të Çamëve*. (14 Janar 1928)

³⁸⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 147. *Informacion për Veprimet e Delegacionit Çam të Filatit në Athinë, si edhe për Propagandën Greke që i shtyu Çamët të Deklarohen Turq*. (31 Gusht 1923)

³⁸⁶ Kretsi 2005: 60.

heshtura” me anë të mosveprimeve për të ndaluar keqtrajtimin e vazhdueshëm që çamëve i bëhej nga autoritetet lokale.³⁸⁷ Lutjet e shqiptarëve mbartinin disa tone të forta dhe për këtë qeveria greke në pikën e parë të përgjigjes që i dërgonte Lidhjes së Kombeve për këtë petition, kërkonte që ky i fundit të mos gjykohej pasi nuk përmbante kriteret e një gjuhe të moderuar.³⁸⁸ Nga ana tjetër, reagimi i çamëve vinte si pasojë e mohimit të të drejtave të tyre themelore, si e drejta e banesës, e pronës private, e jetës, për të cilën ata kërcënoheshin shpesh herë. Greqia në pikën e parë ndalet duke i vënë theksin dëshirën e myslimanëve për t’u lidhur me atë që ajo quan "metropolin" e tyre fetar, pra Turqinë.³⁸⁹

Kjo shprehje tregonte qartazi realitetin, që shumë myslimanë, bazuar në rrethana të ndryshme, të kërcënuar ose jo, vendosnin që të tranferoheshin në Turqi pasi mendon se atje do t’u jepej fund shkeljes së të drejtave të tyre themelore. Në përgjigjen e pikës së dytë, Greqia shprehte një deklaratë të pavërtetë: sipas saj, masat e marra për vendosjen e refugjatëve në shtëpitë e çamëve ishin hequr pothuajse në shumicën e rasteve, dhe gjithashtu çështja e pronave për personat e përjashtuar nga procesi i shkëmbimit ishte zgjidhur, përveç një numri të vogël rastesh.³⁹⁰ Por, çështjet e mbetura pezull për çamët për shkak të procesit të shkëmbimit të popullsisë greko-turke vijuan dukshëm për një numër të madh rastesh të cilat nuk gjetën zgjidhje pavarësisht peticioneve të ndryshme të dërguara drejt autoriteteve greke apo aktorëve të tjerë ndërkombëtarë.

³⁸⁷ Ndonëse nuk mund të fajësohet qeverisja qendrore e Pangalosit, autoritetet vendore ushtruan një dhunë të vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe ndaj popullsisë çame. Shih: AMPJ. Dosja 31, Viti 1926, *Demi, M., Braho, A., Izeti, Q., Seti, H., Ndon, R., Dajaka, A. Përfaqësuesit e Filatit i dërgojnë një Peticion të Ngarkuarit të Këshillit të Lidhjes së Kombeve, Komisionit Mikst, Stamboll.* (2 Shkurt 1926).

³⁸⁸ Lidhja e Kombeve, C.662.1927.I.

³⁸⁹ Ibidem.

³⁹⁰ Ibidem.

Thënien *"Myslimanët e Epirit nuk gëzojnë asnjë të drejtë njerëzore"* Greqia e hidhte poshtë.³⁹¹ Por, fill pas Konventës së Lozanës [30 Janar 1923], myslimanët çamë të Epirit, si dhe popullsi të tjera të fesë myslimane u përfshinë në masat shtrënguese që u aplikuan për të gjithë myslimanët. Deri në vërtetimin e statusit të përjashtimit nga shkëmbimi, atyre iu mohoheshin këto të drejta themelore. Për shqiptarët, Greqia vendosi kriterin e vendlindjes në territorin aktual shqiptar, duke anashkaluar mundësinë e lindjes në krahinën e Çamërisë, dhe përtej presioneve të tjera shumë çamë u detyruan të largoheshin prej trojeve të tyre.

Në dy pikat përmbyllëse, Greqia e cila më vonë në kohë do të deklaronte pranë Lidhjes së Kombeve se për të minoritet trajtoheshin në një shkallë superioriteti në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë³⁹², në përgjigje të këtij peticioni³⁹³ deklaroi se çamët ishin *"...të paafte gjithmonë për çfarëdo kulture, duke iu shmangur sistematikisht çdo përpjekjeje intelektuale..."*. Në të njëjtën shkresë, Greqia deklaroi se u kishte kërkuar çamëve të caktonin mësuesit e tyre të cilët autoritetet greke do të mund t'i emëronin në vijim. Mirëpo, ishte vetë qeveria Greke ajo e cila nuk e zbatoi këtë premtim disa vite më vonë. Ndërkohë, edhe nëse çamët nuk kishin treguar interes për të drejtën e shkollimit gjatë kësaj periudhe, kjo mund të kuptohet qartë, pasi atyre u mungonin një sërë të drejtash të tjera themelore si e drejta e jetës, e pronës private. Në akuzën mbi mohimin e të drejtave qytetare e politike, të cilat Greqia i hodhi poshtë si të pavërteta, mjafton të përmendet fakti se të drejtat themelore të çamëve myslimanë u ngrinë nga një sërë aktesh ligjore të hartuara në funksion të realizimit të procesit të shkëmbimit.

³⁹¹ Ibidem.

³⁹² Lidhja e Kombeve, C.614.1930.I.

³⁹³ Lidhja e Kombeve, C.662.1927.I.

Nga ana tjetër, autoritetet vendore luajtën rolin kryesor në shkeljen e të Drejtave Themelore të Njeriut pasi ata i zbatuan politikat greke drejtpërdrejtë mbi çamët. Në Nëntor të vitit 1922 zëvendës drejtori i policisë së Gjirokastrës njoftonte se autoritetet greke keqtrajtonin edhe fëmijët e çamëve.³⁹⁴ Përveç pasojave të luftës greko-turke në Greqi, popullsia vendase terrorizohej nën pretekstin e gjetjes së armëve.³⁹⁵ Në pretekstin e kërkimit të banditëve, njësi greke të formuara enkas për këtë fakt, persekutonin popullsinë shqiptare.³⁹⁶ Në zonat ku shkonin banditët Cil Mastori dhe Niko Qamo etj, xhandarmëria greke shfaqej vetëm pas largimit të tyre, duke shtuar dhunën ndaj popullsisë vendase, në vend që të shihnin mundësinë e eliminimit të saj. Në Gazetën “Dajti” (17 Shtator 1924), shkruhej: “...Gjindarmëria greke për të ndjekur hajdutët e lartpërmendur (që i titullojnë “komita shqiptarë”) vete nëpër katunde, pasi largohen hajdutët dhe i shemb në dru katundarët e mjerë dhe u kërkon me zor laknora dhe mishëra në hell?,,”³⁹⁷ Nga ana tjetër, shtetrrrethimi ishte një mënyrë tjetër për t’ua vështirësuar jetesën çamëve. Ata nuk mund të dilnin në hapësirat publike pas orës 5 të pasdites. Në bashkëngjitje të këtyre vendimeve, Ethniqi Eteria (Komiteti Nacional), synonte dhe internimin e çamëve të moshës 15-45 vjeç, duke nënkuptuar meshkujt. Burgosja dhe kërcënimi sistematik i elementit shqiptar, e aq më tepër të nacionalistëve shqiptarë, ishte një masë e njohur e aplikuar gjerësisht në Çamëri.

Në 7 Prill të vitit 1924, Mithat Frashëri i dërgon një letër Ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, duke e njohur mbi përndjekjen e disa figurave çame si propagandistë

³⁹⁴ AQSH, Fondi 251, Dosja nr. , Viti 1922, f. 289. *Njoftim për Keqtrajtimin që i bëhet Popullsisë Çame.* (12 Nëntor 1922)

³⁹⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 102, Viti 1922, f. 287, 288. *Memorandum për Shprehjen e Indinjatës ndaj Shpërnguljes së Popullsisë Çame prej Vatrave të Tyre dhe ndaj Zënies së Shtëpive të tyre prej Muhaxhirëve Grekë.* (6 Dhjetor 1922).

³⁹⁶ Naska 1999: 208, dok. 116.

³⁹⁷ Puto 2010: 178.

shqiptarë.³⁹⁸ Në Shkurt të vitit 1925, Komanda e Përgjithshme e Epirit ndërmorri një lëvizje e cila kishte për qëllim të bindte çamët të largoheshin drejt emigrimit.³⁹⁹ Sipas autorit Mihalopulos, autoritet vendore të Epirit mendonin se nëse një numër i caktuar çamësh do të emigronte, pjesa e mbetur do të bënte të njëjtën gjë.⁴⁰⁰

Si pasojë e situatës së krijuar, shqiptarët përdornin shtypin e shtetit amë për të informuar të interesuarit mbi gjendjen në Çamëri. Në një artikull të gazetës *Korça*, një autor anonim denonconte vrasjet, masakrat, rrahjet, që bëheshin ndaj popullsisë çame në mënyrë që ata të terrorizoheshin duke zgjedhur në vijim braktisjen e trojeve të tyre shekullore. Në këtë artikull, autori nuk le pa përmendur në një kohë kur çamët nuk gëzonin as të drejtat themelore si individë, shteti shqiptar u ofronte minoritetit grek një sërë të drejtash siç ishte dhe hapja e një numri të konsiderueshëm shkollash në krahasim me krahinën e Çamërisë.⁴⁰¹

Ndonëse qeverisja e Gjeneralit Pangalosit njihet si periudhë në të cilën të drejtat e çamëve u respektuan gjerësisht, në muajin shkurt 1926, një përfaqësi çamësh denoncuan keqtrajtimin që autoritetet ushtarake të Filatit ushtronin ndaj popullsisë vendase. Ata deklarorin se "do të godasin deri në çrrënjosjen e plotë të myslimanëve shqiptarë çamë", përtej qëndrimeve e premtimeve që u kishte bërë Gjenerali Pangalos.⁴⁰² E megjithatë, qeveria greke në këtë kohë ishte e vendosur në mbrojtjen e minoritetit shqiptar. Ajo premonte gjithashtu se nuk do të lejonte askënd të keqtrajtonte pjesëtarët e këtij minoriteti.⁴⁰³

³⁹⁸ AQSH, Fondi 251, Dosja 81, Viti 1924, f. 163. *Njoftim për Arrestimet që bënin Autoritetet Greke ndaj Personaliteteve të Popullsisë Çame që Shpreheshin për Qëndrimin e Çamëve në Greqi.* (7 Prill 1924)

³⁹⁹ Baltiotis 2011: 7.

⁴⁰⁰ Mihalopulos 1986: 308.

⁴⁰¹ Destani dhe Elsie 2013: 75.

⁴⁰² AMPJ. Dosja 31, Viti 1926, *Demi, M., Braho, A., Izeti, Q., Seti, H., Ndonga, R., Dajaka, A. Përfaqësuesit e Filatit i dërgojnë një Peticion të Ngarkuarit të Këshillit të Lidhjes së Kombeve, Komisionit Mikst, Stamboll.* (2 Shkurt 1926).

⁴⁰³ Isufi 1997: 74.

Një nga aspektet e përdorura prej autoriteteve greke ishte dhe paqartësia e masave mbi kombësinë e tyre. Çamët myslimanë për shkak të fesë ndjeheshin të lidhur me Turqinë jo rrallë herë. Struktura e shoqërisë çame, sidomos e pjesës myslimane, ishte formuar gjatë shekujve sipas modeleve të ofruara nga shoqëria osmane, e cila ishte e organizuar në *milet*-e, koncept sipas të cilit popujt dalloheshin në bazë të fesë.⁴⁰⁴ Për këtë arsye Greqia e kishte të vështirë asimilimin e elementit çam. Për arritjen e synimeve të tyre, autoritetet greke përdorën klerin mysliman. Myftinjtë ishin drejtuesit e komuniteteve myslimane të Çamërisë. Në vitin 1930, inspektori i pakicave Stilianopulos raportonte se myftinjtë ndaheshin në tre klasa. Myftiu i Janinës ishte i klasit të parë, i Margëlliç ishte i klasit të tretë, ndërsa pjesa tjetër i përkiste klasit të dytë. Paga e Myftiut të Janinës ishte rreth 3,000 dhrahmi, sipas ligjit nr. 372 të vitit 1936.⁴⁰⁵ Myftiu i Filatit merrte një pagë prej 1,800 dhrahmi, në vitin 1930.⁴⁰⁶ Stilianopulos i kishte propozuar qeverisë së tij ngritjen në pozicion të myftinjve të Filatit dhe të Margëlliçit, respektivisht në klasin e parë për myftiun e Filatit, dhe në klasin e dytë për myftiun e Margëlliçit duke qënë se ishte i vetmi i klasifikuar në klasin e tretë.⁴⁰⁷ Në disa raste, disa prej tyre i tejkalonin kompetencat për të arritur përfitime vetjake.⁴⁰⁸ Por, në muajin Maj 1923, myftiu i Filatit ishte "nxjerrë përpara gjykatës, por u la menjëherë i lirë pas premtimit për t'u deklaruar si ithtar i këmbimit".⁴⁰⁹

⁴⁰⁴ Puto 2001: 19; Bayir 2016: 26.

⁴⁰⁵ Tsitselikis 2012: 385.

⁴⁰⁶ AQSH, Fondi 251, Dosja 192, Viti 1930, f. 1-2. *Njoftim se Qeveria Greke nuk kishte marrë Masa për Kthimin e Pronave të Çamëve, në vijim të Premtimeve të bëra ndaj Përfaqësisë Çame.* (5 Shkurt 1930)

⁴⁰⁷ Tsitselikis 2012: 384.

⁴⁰⁸ Tsitselikis 2012: 368.

⁴⁰⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 84, Viti 1924, f. 28-30. *Raport mbi Veprimet e Komisionit Mikst për Përcaktimin e Popullsisë së Këmbyeshme.* (9-25 maj 1924)

Myftiu i Filatit, Mehmet Efendi, pas nisjes zyrtare të shkëmbimit të popullsive greko-turke kishte blerë një dyqan dhe kishte pasuri rreth 400,000 dhrahmi; Shtëpitë dhe kopshtet e myftiut të Gumenicës Halilit ishin zënë nga refugjatët, ashtu si çdo pronë tjetër e shqiptarëve, por pasi ata u larguan nga pronat e tij me ndihmën e autoriteteve greke, myftiu kishte deklaruar mbështetjen e tij për shkëmbimin e popullsive.⁴¹⁰ Myftiu i Margëlliçit nuk u korruptua nga prefekti i Prevezës, ashtu siç ndodhi me myftinjtë e tjerë.⁴¹¹

Më 31 Tetor 1923, disa përfaqësues çamë denoncuan propagandën e myftinjve Halil Hilmiu dhe Mehmet Zeqiraj të cilët u kërkonin çamëve që të mos e deklaronin origjinën e tyre shqiptare, pasi do të qëndronin në Greqi, dhe "...greku do i djegij...", ndërsa ata që do të shkonin në Turqi do të merrnin pasuri të mëdha.⁴¹² Në vitin 1934, myftiu i Paramithisë, Hasan Abdul, denoncoi propagandën shqiptare në krahinë.⁴¹³

Ai deklaronte se

"Komunitetet myslimane të rajonit të Paramithisë protestojnë kundër akuzave të shtypit shqiptar mbi trysninë e pretenduar se ushtrohej nga autoritetet helenike. Ata (duke nënkuptuar komunitetet myslimane) e lusin Shkëlqesinë tuaj që ta sigurojë Shoqërinë e Kombeve se minoriteti mysliman i Çamërisë gëzon një pavarësi të plotë për sa i përket kultit dhe shkollimit, dhe nuk e ndjen në asnjë mënyrë të nevojshme t'i drejtohet klauzolave minoritare të traktateve".⁴¹⁴

Në një peticion të ngjashëm, të datës 27 nëntor 1934 myftinjtë e Janinës, Fuad Mustafa dhe Mehmed Sadik Pasha, deklaronin ndër të tjera se "*minoriteti mysliman në Janinë përfiton nga rasti për të shprehur mirënjohjen e thellë ndaj qeverisë greke, e cila i frymëzon çdo ditë*

⁴¹⁰ Pa autor (Shtojcë e paraqitur nga Mehdi Frashëri). Shtojca 11. *Gazeta Zyrtare e Lidhjes së Kombeve. Shkurt 1926. Vol. 7, 319.*

⁴¹¹ Ibidem.

⁴¹² Malltezi dhe Delvina 2013: 83, 84, dok. 29.

⁴¹³ Tsitselikis 2012: 370.

⁴¹⁴ Lidhja e Kombeve, C.81.1935.I.

drejt një shpirti liberal të barazisë dhe të paanësisë drejt të gjithë qytetarëve pa dallim, u siguron pa diskriminim, myslimanëve të Epirit, respektin e të gjitha të drejtave të njeriut duke ofruar të gjitha mjetet e mundshme në mënyrë që ata të gëzojnë të mirat e qytetërimit bashkëkohor..." ⁴¹⁵

Në këtë deklaratë, qeveria greke shprehej se pala shqiptare e akuzonte atë pa fakte, në një kohë kur ajo vetë dha një sërë petitionesh të cilat nuk shprehnin asnjë fakt konkret, çka lë hapësirë për dyshim mbi vërtetësinë e tyre.

Më 26 Korrik 1917, gjatë pushtimit italian në Çamëri, disa myftinj të kryesuar nga myftiu i Janinës Fuad Efendi, u paraqitën pranë Komisarariatit të Përgjithshëm Italian për t'i shprehur autoriteteve italiane mirënjohjen

"për mënyrën sesi autoritetet italiane i trajtoi dhe vijonte t'i trajtonte myslimanët e këtij vendi, njësoj me banorët e feve të tjerë; të cilët që prej fillimit të pushtimit italian ndihen të sigurtë për jetët e tyre, për pronat e tyre, për shfaqjen e ndjenjave të tyre fetare; pasi për shumë kohë jetonin në një gjendje ankthi për fatet e tyre dhe tanimë janë të qetë dhe shpresojnë që pushtimi italia të qëndrojnë në këtë Krahinë". ⁴¹⁶

Myftinjtë i luteshin Komisarit të Përgjithshëm që t'ia transmetonin këtë deklaratë Qeverisë Italiane dhe Autoriteteve të Larta; dhe duke qenë se ishin vënë në dijeni që fatet e kësaj krahine do të diskutoheshin në Konferencën e Parisit, ata kërkonin mbështetjen italiane pasi ndryshimi i kësaj gjendje do të vinte përsëri në rrezik jetën dhe pasuritë e myslimanëve. ⁴¹⁷

⁴¹⁵ Ibidem.

⁴¹⁶ Colonna di Cesaro 1922: 176.

⁴¹⁷ Ibidem: 177.

Për sa i përket deklaratës se në 40 fshatra të Paramithisë e të Filatit imamët u mësonin edhe gjuhën shqipe, autori Tsistelikis shprehet se kjo bëhej pa një autorizim zyrtar, dhe në mënyrë të kufizuar.⁴¹⁸ Gjithashtu, në vitin 1937, u dha urdhër që mësimet fetare të bëheshin vetëm në gjuhën greke.⁴¹⁹

Nga ana tjetër, përveç rolit të myftinjve vendosja e refugjatëve solli një sërë problemesh të bashkëjetesës së çamëve me ta [refugjatët], për shkak të administrimit aspak të favorshëm të situatës. Pritja e tyre në Greqi ishte një rrjedhojë e menjëhershme e Luftës Greko-Turke. Megjithatë, edhe pse i përkisnin kombësisë greke ata ranë pre e racizmit të personave që vetë-quheshin grekë, pasi sipas tyre refugjatët nuk i mishëronin vlerat e vërteta të shoqërisë greke.⁴²⁰ Pavarësisht se Greqia ishte ende në hapat e parë të shtet-ndërtimit si rrjedhojë e aneksimeve territoriale të here pas hershme, prania e tyre ishte një problem i shtuar në sfondin e gjerë që e priste rindërtimin e shoqërisë greke nën vlerat e politikës zyrtare të saj.

Në këtë sfond, shqiptarët i detyronin të grumbulloheshin 3-4 familje në një shtëpi, duke lënë shtëpitë e tyre të zbrazura për sistemin e refugjatëve. Kjo metodë u aplikua në Pargë, Margëlliç, Arpicë, Volë, Grikohor, Gremicë, Varfanj, Filat, Verselë, Lopës dhe Koskë.⁴²¹

Në këtë atmosferë, çamët nuk mund të kishin ndjenja miqësore ndaj refugjatëve, duke u bazuar në rastet e denoncuara prej të parëve si pasojë e konflikteve që lindnin midis këtyre grupimeve shoqërore. Mbi të gjitha, për shkak të dëmshpërblimit të vonuar mbi pronat e

⁴¹⁸ Tsistelikis 2012: 441.

⁴¹⁹ Naska 1999: 686, dok. 361.

⁴²⁰ Mavrogordatos 1983: 194.

⁴²¹ Puto 2010: 177, 178.

shpronësuar, dhe një sërë çështjesh të tjera, çamët shpesh herë nuk morën zgjidhje duke u detyruar të linin trojet e tyre shekullore në dorë të këtyre refugjatëve si pasojë e mungesës së qeverisjes së duhur të shtetit greke. Për këtë, Margaritis shkruan se emigrantët kishin mbështetjen e legjislacionit grek.⁴²² Ata u vendosën në zona të pasura si Gumenica dhe Fanari.⁴²³ Në memorandumin e përfaqësuesve të Çamërisë, drejtuar Pangalosit, çamët deklarorin se me ardhjen e refugjatëve ata ishin detyruar të largoheshin nga pronat e shtëpitë e tyre dhe të vendoseshin në kasolle. Tokat bujqësore ishin të pamjaftueshme për vetë nevojat e popullsisë vendase.⁴²⁴

Masat e ndërmarra për mbarvajtjes e procesit të shkëmbimit të popullsive greko-turke dhe të vendosjes së refugjatëve dëmtuan mbi të gjitha pjesën myslimane të Çamërisë, kryesisht në fshatrat: Njihor, Mininë, Picar, Karbunar, dhe rrethinat e Paramithisë.⁴²⁵ Sipas autorit Baltsiotis, vendosja e tyre e cila kishte nisur që prej vitit 1923, shërbente si një shtysë tjetër për të larguar çamët nga pronat e veta.⁴²⁶ Asaf Çami dhe Haki Musai denonconin në muajin dhjetor 1922 se refugjatët kishin zaptuar 26 çifliqe nën mbështetjen e qeverisë greke, e cila gjatë kësaj kohe kishte nisur vënien në zbatim të ligjeve agrare për shpronësimin e këtyre pronave. Ndërkohë në terren kishte filluar vendosja e refugjatëve grekë nga Azia e Vogël. Në Margëlliç ishin vendosur 3500, në Pargë 3000, në Gumenicë 1800, në Filat 1700.⁴²⁷ Në bazë të regjistrimit të refugjatëve në Greqi gjatë vitit 1923 rezulton se nënprefektura e

⁴²² Margaritis 2009: 119.

⁴²³ Ibidem.

⁴²⁴ Isufi 2012: 233, paragrafi 1.

⁴²⁵ Isufi 2012: 233, paragrafi 2.

⁴²⁶ Baltsiotis 2011: 7.

⁴²⁷ AQSH, Fondi 251, Dosja 102, Viti 1922, f. 287, 288. *Memorandum për Shprehjen e Indinjatës ndaj Shpërnguljes së Popullsisë Çame prej Vatrave të Tyre dhe ndaj Zënies së Shtëpive të tyre prej Muhaxhirëve Grekë.* (6 Dhjetor 1922)

Margëlliçit kishte 1926 refugjatë, ndër të cilët 1378 ishin vendosur në Pargë. Në nënprefekturën e Filatit kishte 5819, ndër të cilët 766 ishin vendosur në Gumenicë, ndërsa nënprefektura e Paramithisë kishte 906 refugjatë.⁴²⁸ Sipas autorit Sideris të cituar nga George Kritikos, në vitin 1920 qeveria greke kishte shpronësuar 63 çifliqe, ndërsa gjatë viteve 1921 dhe 1922 ishin shpronësuar 12 çifliqe.⁴²⁹ Në të njëjtën mënyrë, shpronësimi i çifliqeve e vështirësonte më tej gjendjen e një pjese të madhe të popullsisë në Çamëri pasi shkelte mbi një të drejtë themelore si e drejta e pronës. Çamët kishin si mjet kryesor të jetesës pronën dhe tokat bujqësore, prandaj dhe mohimi i të drejtës mbi to e çonte këtë popullsi drejt kushteve të mbijetesës.

Gjithashtu, burgosjet dhe uzurpimet e pronave të çamëve duke i zhveshur ata nga këto të drejta themelore ishin një praktikë e njohur që vinin edhe prej vendosjes së refugjatëve në këto zona. Më 26 Tetor 1923, Haki Musaj e Asaf Çami iu drejtuan Kryeministrit në Tiranë duke e informuar mbi gjëndjen e rënduar në Çamëri. Ata deklaruan, ndër të tjera, se 15 familje nga Parga, 15 nga Arpica, disa nga Margëlliçi, si dhe 15 familje raportohen të kenë shkuar në Shqipëri.⁴³⁰ Mbi 200 familje refugjatësh të cilët kishin zbarkuar në portin e Gumenicës rreth muajit Tetor të vitit 1923, kishin nisur të shkatërronin xhamitë. Çamët ishin mbledhur shume familje në një shtëpi, në një kohë kur refugjatët jetonin edhe dy vetë në një shtëpi.⁴³¹

Në raportin e 10-të, tremujor të zyrës autonome për vendosjen e refugjatëve, deklarohet se në vitin 1924, qeveria greke kishte dërguar një numër të madh refugjatësh në këtë krahinë pasi kishte menduar të shkëmbente 22,000 myslimanë të çamërisë me refugjatët

⁴²⁸ Ministria e Shëndetësisë dhe e Mirëqënies (Departamenti i Statistikave) 1923.

⁴²⁹ Kritikos 2005: 329.

⁴³⁰ Naska 1999: 138, dok 84.

⁴³¹ Ibidem: 208, dok. 116.

grekë të Turqisë, ndonëse më vonë këta persona u shpallën si të pashkëmbyeshëm pasi i përkisnin kombësisë shqiptare.⁴³²

Sipas deklaratave të Greqisë, në vitin 1935, në Çamëri kishte vetëm dy krahina të vogla me refugjatë, me rreth 330 familje, të vendosura në afërsi të Gumenicës.⁴³³ Margaritis deklaronte se refugjatët ishin vendosur në zonat më të pasura të Çamërisë si Gumenica dhe Fanari.⁴³⁴ Qeveria shqiptare denonconte faktin se këto terrene i përkisnin dy pronarëve të mëdhej, të shpronësuar nga qeveria greke, por sipas saj shpronësimet ishin bërë konform ligjit agrar.⁴³⁵

Në 21 Gusht të vitit 1924, një artikull në gazetën "Kirikis" informonte se 2100 refugjatë grekë do të vendoseshin në Çamëri, sipas dekret ligjit të vitit 1922, në bazë të cilit "3/4 e tokave të myslimanëve u jepej regugjatëve si dhe 1/2 e tokave djerrë".⁴³⁶ Ndërkohë shqiptarët nën shtetin grek ishin të detyruar të emigronin drejt Shqipërisë ose Turqisë. Gjatë këtyre muajve, Teki Selenica njoftonte ministrin shqiptar në Athinë mbi shpërnguljen e detyruar të disa prej çamëve drejt shqipërisë, pas trysninsë së ushtruar nga qeveria greke për t'i shkëmbyer ata si turq.⁴³⁷ Ai njoftonte gjithashtu dhe mbi vendosjen e tyre në Shqipëri, në bazë të ndihmës që qeveria e vendit u ofronte atyre për të nisur jetën në vendin amë.⁴³⁸

Në Gazetën e Korçës më 5 Janar 1926, shpjegohej se si kishte nisur rasti i Gardhiqotëve, i cili u paraqit më tej për shqyrtim pranë Lidhjes së Kombeve. Përtej burgimeve

⁴³² Lidhja e Kombeve, C.308.M.117.1926.II.

⁴³³ Lidhja e Kombeve, C.349.1935.I.

⁴³⁴ Margaritis 2009: 119.

⁴³⁵ Lidhja e Kombeve, C.349.1935.I.

⁴³⁶ Isufi 2015: 140.

⁴³⁷ AQSH, Fondi 251, Dosja 79, Viti 1924, f. 160. *Njoftim mbi Masat e Qeverisë Shqiptare për Emigrantët Çamë që Duan të Vendosen në Tokën Shqiptare.* (29 prill 1924)

⁴³⁸ Ibidem.

dhe keqtrajtimeve, siç shprehet në këtë artikull, që prej vitit 1921 bandat greke kishin hyrë në fshat duke keqtrajtuar e kërcënuar popullsinë vendase e duke vrarë disa prej pjestarëve të këtij fshati. Ndërkohë, për shkak të dhunës, e njëkohësisht me ardhjen e refugjatëve, ata u ndjenë të detyruar që të braktisnin pronat e tyre duke iu drejtuar Shqipërisë. Në pamundësi për të mbërritur atje, ata kërkuar shpërnguljen drejt Turqisë. Në artikull raportohet se nga 2000 persona, në fshat kishin mbetur vetëm 550. Antari turk i Komisionit Mikst pasi shqyrtoi rastin, nuk pranoi dërgimin e tyre drejt Turqisë. Gardhiqotët mbetën në këtë mënyrë pa pronat e tyre duke jetuar në mjerim.⁴³⁹

Në 13 Shkurt 1926, përfaqësues së Gardhiqit e Dhragomisë iu drejtuan Qenan Mesaresë për padrejtësitë që po iu bëheshin. Ata ishin të vendosur për të mos u përfshirë në procesin e shkëmbimit pasi ishin shqiptarë. Në këtë petition, banorët e krahinave të sipër përmendura kërkonin rikthimin e pronave të tyre dhe vendosjen e tyre në to, si dhe dëmshpërblim për padrejtësitë e bëra.⁴⁴⁰ Një petition të ngjashëm, delegatët e këtyre fshatrave [Gardhiq e Dhragomi], ia dërguan dhe Kryetarit të Komisionit Mikst dhe përfaqësuesit të Turqisë, duke i akuzuar drejtpërdrejtë që të mos përndiqeshin më nga Sliben dhe Floridhi, dy përfaqësuesit e nënkomisionit të Epirit.⁴⁴¹

Duke qënë se situata e popullsisë në Gardhiq dhe Dhragomi nuk po përmirësohej, pas përpjekjeve të bëra pranë qeverisë shqiptare, Hoxhë Haxhi Sheh e pa të arsyeshme t'i lutej autoriteteve turke për shpërnguljen e 200 familjeve, respektivisht gardhiqote dhe

⁴³⁹ Destani dhe Elsie 2013: 205.

⁴⁴⁰ AQSH, Fondi 251, Dosja 119, Viti 1926, f. 217, 218. *Në letër shtrohen kërkesat e tyre për t'ia paraqitur Komisionit Mikst dhe Lidhjes së Kombeve që të përjashtohet Popullsia e Gardhiqit dhe Dragumisë nga Këmbimi dhe t'u Kthehen Pronat e Grabitura.* (13 shkurt 1926)

⁴⁴¹ AQSH, Fondi 251, Dosja 119, Viti 1926, f. 251. *Kërkesë për Lirimin e Gardhiqit dhe të Dragumit nga Refugjatët dhe Kthimin e Pasurive, sepse Asnjë nuk Dëshiron të Largohet nga Greqia.* (19 Shkurt 1926)

dhragomiotë, si dhe 50 familjeve nga Kurtesi e 30 të tillave nga Paramithia.⁴⁴² Në vijim të ndërhyrjes së ambasadorit shqiptar në Greqi, ministri grek i deklaroi përfaqësuesit shqiptar se kishte dhënë urdhërat për lirim të shtëpive të Gardhiqit dhe Dhragomisë.⁴⁴³

Në rastin e tyre, qeveria greke u shkeli të drejtat në kundërshtim me dispozitat ligjore të paracaktuara prej saj, duke i zaptuar qoftë dhe shkolla e xhamia. Pasi Turqia vendosi të mos i pranonte më çamët duke qënë se ata ishin shqiptarë, fati i tyre mbeti i papërcaktuar.

Një dëshmi e kohës, nga Hurshit Osmani në Selanik, tregon se si një pjesë e këtyre personave, vuanin mjerisht të mbetur në këtë qytet pasi kishin braktisur pronat e tyre. Osmani deklaronte se 170 persona kishin vdekur, dhe kishin mbetur 130.⁴⁴⁴

Më 26 Janar 1926, përfaqësues të Margëlliçit dhe të Gumenicës iu drejtuan kryetarit të Këshillit të Ministrave në Athinë me kërkesën për të larguar refugjatët nga pronat e tyre dhe vendosjen e tyre në këto prona.⁴⁴⁵ Një petition të ngjashëm e dërguan pranë Lidhjes së Kombeve dhe disa përfaqësues të Gardhiqit e Dhragomisë, të cilët protestonin për përjashtimin e tyre nga procesi i shkëmbimit dhe në të njëjtën kohë kërkonin rikthimin e pronave të tyre.⁴⁴⁶ Në vitin 1927, disa përfaqësues të Epirit i dërguan një letër, Andrea Mihalakopoulit në lidhje me gjendjen e tyre gjatë kësaj periudhe, ku refugjatët ishin vendosur në Çamëri duke prishur rendin në këtë krahinë për shkak të mosmarrëveshjeve të shumta që lindnin midis tyre dhe popullsisë vendase. Gjithashtu, ata kërkonin vëmendje që të shiheshin

⁴⁴² Naska 1999: 527, dok. 282.

⁴⁴³ Naska 1999: 533, dok. 288.

⁴⁴⁴ Naska 1999: 265, dok. 149.

⁴⁴⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 119, Viti 1926, f. 96. *Në Telegram Kërkohet Largimi i Refugjatëve Grekë nga Shtëpitë e Çamëve.* (26 Janar 1926).

⁴⁴⁶ AQSH, Fondi 251, Dosja 119, Viti 1926, f. 217, 218. *Në Telegram Protestohet Kundër çdo Përpjekje për Shpërngulje në Azi dhe Kërkohet Kthimi i Pronave.* (12 shkurt 1926)

veprimet e autoriteteve vendore ndaj tyre të cilat i nënshtonin këta të fundit në keqtrajtime të ndryshme.⁴⁴⁷

Mirëpo, sipas pikëpamjes së qarqeve greke, e cila mbështetet edhe në qëndimet e autorit grek Mihalopulos, në 30 Janar të vitit 1928, pavarësisht se gjendja në Çamëri vijonte të ishte e mjerueshme, përpjekjes shqiptare për të dërguar rreth 200 kuintal ndihmë me misër për popullsinë e Çamërisë, ambasadori grek në Shqipëri e konsideronte si një nismë për prishjen e imazhit ndërkombëtar të Greqisë.⁴⁴⁸

4.5 Pasojat e Shkëmbimit të Popullsive Greko-Turke mbi Pronat e Çamëve

Kushtetua e amenduar e Greqisë në vitin 1911, me anë të nenit 17 të saj i lejoji qeverisë së vendit të drejtën për shpronësimin e detyrueshëm të tokës për qëllime publike.⁴⁴⁹ Si fillim shpronësimi do të bëhej në toka shtetërore dhe të kishës, por nëse nevojat i tejkalonin këto sipërfaqe, atëherë qeveria caktonte një shifër përkatëse në hektarë.⁴⁵⁰

Shpronësimi në Greqi solli pasoja të konsiderueshme mbi pronarët çamë. Ndonëse ky proces u realizua për një periudhë 3 vjeçare në terren (zyrtarisht⁴⁵¹), dhe mund të quhej efikas për refugjatët dhe fermerët e varfër, kompensimi i pronarëve për këto lëvizjeve të

⁴⁴⁷ Naska 1999: 553, dok. 292.

⁴⁴⁸ Mihalopulos 1986: 311.

⁴⁴⁹ Lambru 1949: 15; Isufi 2002: 158; Stavrianos 1958: 677.

⁴⁵⁰ Stavrianos 1958: 677.

⁴⁵¹ Përfundimi zyrtar i shkëmbimit përkon me datën 16 Mars 1926.

detyrueshme zgjati për vite me rradhë.⁴⁵² Sipas Mavrogordatos, Greqia nuk mund të shpronësonte pronarët e territoreve të aneksuara pa "risqe të mëdha diplomatike".⁴⁵³

Katër mënyra u përdorën për heqjen e titullit të pronësisë ndaj nënshtetasve shqiptarë në Greqi: grabitja, përvetësimi i padrejtë, konfiskimi, shpronësimi.⁴⁵⁴ Grabitja dhe përvetësimi i padrejtë zbatohej në ato raste kur bandat greke kalonin në këtë krahinë nën pretekste të ndryshme, duke dëmtuar drejtpërdrejtë popullsinë vendase dhe pronat e tyre; në të njëjtën mënyrë, refugjatët ishin të përkrahur nga kuadri ligjor dhe autoritetet vendore të kohës për të rrëmbyer pronat e çamëve. Konfiskimi ishte një mjet ligjor i përdorur nga autoritetet greke kryesisht në funksion të shkëmbimit të popullsisë greko-turke. Pavarësisht këtyre metodave drastike dhe të pakthyeshme të heqjes së titullit të pronësisë ndaj elementit shqiptar në Greqi, rreth viteve '30 doli më tepër në pah edhe shpronësimi ndaj pronave të shqiptarëve, ndonëse ai ishte aplikuar dhe më parë në kohë ndaj kësaj popullsie.

Sipas Tsitselikis, vihej re një pakënaqësi e vazhdueshme midis pronarëve çamë dhe fshatarësisë së krishtere, si dhe të ardhurve që vendoseshin në fshatrat çame.⁴⁵⁵ Por, shpronësimi i pajustificuar, ndarja e padrejtë e tokave, llogaritja e gabuar e dëmshpërblimeve, dhe vlerësimi i gabuar i pronës së paluajtshme përbënin "ankesa serioze të çamëve myslimanë".⁴⁵⁶

Sidoqoftë, rastet kur pronat e shqiptarëve morën një zgjidhje ishin të papërfillshme në krahasim me problematikat që la pas kuadri ligjor i hartuar posaçërisht për reformën agrare në Greqi.

⁴⁵² Mavrogordatos 1983: 159.

⁴⁵³ Ibidem.

⁴⁵⁴ Nazarko 2007: 95, 96.

⁴⁵⁵ Tsitselikis 2012: 306.

⁴⁵⁶ Ibidem.

Ndonëse shqiptarët nuk gëzonin të drejtat e tyre themelore, sidomos pas nisjes zyrtare të shkëmbimit të popullsisë greko-turke, periudhë të cilën Mehdi Frashëri e krahasonte me epokën mesjetare, duke qënë se qytetarët shqiptarë u zhveshën nga çdo e drejtë politike, civile dhe ekonomike⁴⁵⁷, problemi i pronës i dëmtoi së tepërmi shqiptarët pasi u hoqi atyre mjetin kryesor të jetesës.⁴⁵⁸

Më 8 Shtator 1923, Musa Demi nën pseudonimin Damo Laska, i dërgonte një letër Mithat Frashërit duke i përshkruar situatën në Çamëri, ku denonconte pengesën e hasur për gëzimin e të drejtës së pronës bazuar në urdhrat e marra nga qeverisja greke.⁴⁵⁹

Në memorandumin që çamët i dërguan Pangalosit (1926), ata deklarorin se dëmshpërblimi i caktuar ndaj tyre ishte disa herë më i ulët sesa vlera reale e pronës.⁴⁶⁰ Në fshatrat rreth Prevezës, një stremë tokë u vlerësua me 7 dhrahmi, në vend të 120 dhrahmi siç ishte dhe vlera reale.⁴⁶¹ Në paragrafin e katërt të këtij dokumenti deklarohet se komisioni për vlerësimin e këtyre pronave zvogëlonte sipërfaqet reale të tokave, si psh. në fshatrat Gorrica, Jonuz, etj nga disa mijëra strema llogariteshin më pak se 2000 strema. Në paragrafin e shtatë, paraqitej një tjetër problem ndaj të cilit ishin nënshtruar pronarët çamë për shkak të reformës agrare. Pas shpronësimit, pronarët e rinj deklarorin "sa të dëshironin" dhe mbi këtë sasi caktohej dhe përqindja që i takonte pronarit të shpronësuar çam. Gjithashtu, në kuadër të

⁴⁵⁷ Frashëri 1925: 309.

⁴⁵⁸ Rama 2014: 297.

⁴⁵⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 160. *Letra vë në Dijeni për Gjendjen e Vështirë Ekonomike, si edhe për Presionet dhe për Propagandën Greke që Shqiptarët Myslimanë të Çamërisë të Deklarohen të Këmbyeshëm si Turq.* (8 Shtator 1923)

⁴⁶⁰ Isufi 2012: 233, 234, paragrafi 3, 4.

⁴⁶¹ Ibidem: 233, paragrafi 3.

reformës agrare, 3/4 e pronave të çamëve quhej tokë shteti dhe nuk dëmshpërblehej, ndërsa 1/4 shkontë në favor "të arkës për stabilizimin e vendit".⁴⁶²

Më 11 Nëntor 1925, Abedin Haki Sejko nga Filati, denoncoi pranë Lidhjes së Kombeve arbitraritetin që qeveria greke përdori në rastin e tokave të familjeve Demi dhe Sejko në kuadrin e procesit të shkëmbimit të popullsisë. Për tokat e tyre të marra që prej aneksimit të Çamërisë nga Greqia, ata nuk kishin marrë asnjë shpërblim më tepër se një paradhënie prej 150,000 dhrahmish, dhe për këtë kishin bërë vazhdimisht kërkesa pranë autoriteteve greke. Sipas qeverisë greke, këto toka vareshin nga shuma të mëdha për të cilat pronarët e tyre ishin përgjegjës pranë Bankës Bujqësore Osmane e cila kaloi nën qeverisjen greke pas pushtimit. Sipas autoriteteve greke këta pronarë nuk ishin përpjekur për të paguar këto shuma. Mirëpo, në kërkesën e vitit 1925, qeveria Greke i ishte përgjigjur se ajo ishte bërë nga myslimanë shqiptarë dhe për këtë arsye pronat e tyre duhet të konfiskoheshin.⁴⁶³ Sipas Fejzi Lepenicës, pas përpjekjes për ta shqyrtuar çështjen në gjyq më 25 gusht 1927, ministri i Bujqësisë, Papanastasiu, mik i avokatit të marrë prej zaptuesve të pronave të familjeve Demi e Sejko, nxorri një urdhër për ndalimin e gjykimit pasi "*do të bëhej një përmirësim në ligj*".⁴⁶⁴

Në 5 Shkurt 1926, Haki Musa Seiko i kërkonte ndihmë Colbain-it, drejtorit të Minoriteteve pranë Lidhjes së Kombeve, për shkak të pamundësisë për gjetjen e një zgjidhje për tokat që autoritetet greke iu kishin shpronësuar atyre.⁴⁶⁵ Në këtë petition ata denonconin

⁴⁶² Ibidem: 236, paragrafi 8.

⁴⁶³ AQSH, Fondi 251, Dosja 119, Viti 1925, f. 442. Sejko, A.H. *Peticion mbi Gjendjen e Vështirë Ekonomike dhe Kërkesa për një Ndërhyrje të Shpejtë pranë Qeverisë Greke për Kthimin e Pronave të tyre*. (11 nëntor 1925)

⁴⁶⁴ AQSH, Fondi 251, Dosja 40, Viti 1928, f. 20-31. *Pasqyrë e Hollësishme e Grabitjes së Pasurive në Çamëri dhe e Mohimit të të Drejtave Politike e Sociale të Çamëve*. (14 Janar 1928)

⁴⁶⁵ Lidhja e Kombeve, C.225.1926.I.

ndërhyrjen e mitropolitit për shqyrtimin e çështjes pranë Gjykatës së Janinës.⁴⁶⁶ Gjithashtu, Seiko deklaronte se të përfaqësuarit prej tij, ashtu sikurse dhe ai vetë, kishin mbetur pa asnjë pronë aq sa dhe ushqimet për të mbijetuar u mungonin.⁴⁶⁷ Duke paraqitur vëzhgimet e qeverisë greke, Dendramis hodhi poshte akuzat e shqiptarit, duke thënë se duhej pritur vendimi i gjykatës. Ai gjithashtu nuk pranoi si të vërtetë ndërhyrjen e mitropolitit për këtë çështje.⁴⁶⁸

Në 17 Shkurt 1926, disa përfaqësues të nënprefekturave të Çamërisë përkatësisht të Filatit, Paramithisë, Margëlliçit dhe Gumenicës i dërguan një letër drejtorit të Zyrës Autonome për Vendosjen e Refugjatëve, duke e informuar mbi padrejtësitë që iu bëheshin atyre që prej fillimit të procesit të shkëmbimit. Për këto ata bënë bashkëfajtores jo të drejtpërdrejtë këtë zyrë; e më tej, duke shprehur besimin e tyre, kërkonin prej saj vendosjen e drejtësisë.⁴⁶⁹

Më 20 Korrik 1927, pranë Lidhjes së Kombeve u dërgua një peticion nga disa çamë parganjotë, të cilët ishin deklaruar shqiptarë por ishin caktuar për t'u shkëmbyer. Rasti i tyre lidhej me dispozitat e Traktatit të Athinës, sipas të cilit këto familje parganjote kishin zgjedhur nënshtetësinë osmane, mirëpo pas urdhërit të qeverisë greke për t'u larguar ose për t'iu rikthyer nënshtetësisë greke, ata kishin zgjedhur këtë të fundit, pas marrjes së të cilës meshkujt kishin kryer gjithashtu edhe shërbimin ushtarak⁴⁷⁰. Pas këtij peticioni, qeveria greke dërgoi

⁴⁶⁶ Ibidem.

⁴⁶⁷ Ibidem.

⁴⁶⁸ Ibidem.

⁴⁶⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 119, Viti 1926, f. 236-238. *Lutja Shpreh Indinjatën Ndaj Veprimeve të Zyrës Autonome të Refugjatëve dhe Kërkon të merren Masat e Nevojshme për Lirimin e Pronave të zëna Padrejtësisht prej Refugjatëve dhe Kthimin e tyre Pronarëve.* (17 Shkurt 1926)

⁴⁷⁰ Lidhja e Kombeve, C.575.1927.I. cituar në Naska 1999: 535.

vëzhgimet e saj pranë Lidhjes së Kombeve. Në pikën e parë, ajo deklaronte me plot bindje se këto familje nuk ishin aspak shqiptare duke qenë se pas Traktatit të Athinës ato kishin zgjedhur nënshtetësinë Osmane.⁴⁷¹

Sipas qeverisë greke, familjet në fjalë kur duhet t'i shmangeshin detyrimeve ndaj shtetit, shfaqesin si turq dhe kur duhet të mbanin pronat e tyre, deklaroheshin si shqiptarë.⁴⁷² Mirëpo, këto prezumime nuk mund të vërtetonin nëse familjet parganjote i përkisnin racës turke apo shqiptare, pasi rrethanat për të kuptuar përse ata zgjodhën nënshtetësinë osmane fill pas Traktatit të Athinës, nuk janë të shpjeguara në këto deklarata.

Rreth një muaj më vonë, Legata Shqiptare në Athinë njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë mbi gjendjen e çamëve. Bazuar në dëshminë e Musa Demit pranë kësaj legatë, refugjatët kishin zaptuar toka me 60-70 strema, kur me kushtetutë ishte i ndaluar shpronësimi i tokave nën 300 strema.⁴⁷³ Disa banorë të Filatit, duke parë situatën e vështirë në të cilën ndodheshin, i dërguan një telegram Pangalosit dhe ministrisë së Brendshme. Por, përgjigja për këtë çështje i kishte ardhur nga nënprefekti i Filatit, i cili u kishte kërkuar largimin e tyre nga Çamëria.⁴⁷⁴

Ndërkohë, më 18 Korrik 1927, i ngarkuari me punë i Shqipërisë në Athinë kishte vënë në dijeni Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë mbi rastin e parganjotëve, më konkretisht rastin e Husein Iliaz Lukaviçiotit.⁴⁷⁵ Autoritetet shqiptare ishin në dijeni të

⁴⁷¹ Ibidem.

⁴⁷² Ibidem.

⁴⁷³ AQSH, Fondi 251, Dosja 119, Viti 1926, f. 564-567. *Raport për Gjendjen e Vështirë të Popullsisë Shqiptare në Greqi dhe Kërkesat e tyre për Njohjen e të Drejtave të Ligjshme si edhe për Nënshetësit e tjerë Grekë.* (7 Gusht 1926)

⁴⁷⁴ Ibidem.

⁴⁷⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 130, Viti 1927, f. 102. *Kërkesë për Ndërhyrje pranë Qeverisë Greke për të mos futur në këmbim 24 Familje nga Parga.* (18 Korrik 1927)

problematikës së krijuar për shkak se çamët e Pargës ishin deklaruar si turq fill pas traktatit të Athinës (1913), mirëpo më vonë e kthyen vendimin duke marrë përsëri nënshtetësinë greke. Por, pas Konventës së Lozanës, ata hasën problematikën e nënshtetësisë, pasi ishin të detyruar për t'u përfshirë në shkëmbim, kundër vullnetit të tyre. Për këtë, i ngarkuari me punë i Shqipërisë në Athinë kishte bërë disa përpjekje të quajtura "miqësore", pra jozyrtare pranë Ministrisë së Jashtme të Greqisë, duke marrë premtimin se ata nuk do të dëboheshin.⁴⁷⁶ Sidoqoftë, në të tilla raste kur persona të caktuar kishin zgjedhur nënshtetësinë turke fill pas Traktatit të Athinës, dhe më pas nuk ishin larguar nga Greqia, ata ishin konsideruar më tej si nënshtetas grekë.⁴⁷⁷

Më 3 Shtator 1927, disa përfaqësues çamë si Musa Demi, Haki Musai, Galip Xhaferri etj, i dërguan një peticion qeverisë greke në lidhje me pengesat që Ministria e Bujqësisë kishte vendosur mbi zbatimin e vendimeve të paracaktuara më parë nga qeveria. Sipas përfaqësuesve çamë, kjo ministri i ishte drejtuar Gjykatës së Janinës me anë të telegramit nr. 118232 për t'i kërkuar asaj anulimin e dëmshpërblimit që qeveria greke kishte vendosur më parë për padrejtësitë që iu ishin bërë pronarëve myslimanë pas aneksimit të krahinës. Në këtë peticion përfaqësuesit çamë vlerësonin përpjekjen e Guvernatorit të Epirit, Stergiadhes, si dhe të Venizelosit, i cili me anë të një urdhërese speciale nr. 2520 synonte t'i jepte një kompensim prej 350,000 dhrahmish pronarëve myslimanë të disa fshatrave të Filatit si: Fatir, Ahur, Revani, Lithari, Qeramica etj.⁴⁷⁸

⁴⁷⁶ AQSH, Fondi 251, Dosja 130, Viti 1927, f. 102. *Raport mbi Çështjen e Këmbimit të Familjeve nga Parga dhe Kërkesa për Ndërhyrjen e Qeverisë Shqiptare*. (22 Korrik 1927)

⁴⁷⁷ Tsitselikis 2012: 195.

⁴⁷⁸ AQSH, Fondi 263, Dosja 47, Viti 1927, f. 9-10. *Peticion dërguar Seksionit të Pakicave në Athinë dhe Lidhjes së Kombeve në Gjeneve*. (3 Shtator 1927).

Më 25 Maj 1928, Mehmet Fuat Pronjo në Tiranë informonte Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë mbi çështjen e pasurisë së tij, dhe shkeljet ligjore të bëra nga autoritetet greke. Ai denonconte vlerësimin disa herë më të vogël të dëmshpërblimit që duhet të merrte. Për më tepër, autoritetet greke në kundërshtim me nenin 119 të Kushtetutës [1927] u shpronësonin çamëve kullota, male e pyje.⁴⁷⁹ Qeveria greke, duke u bazuar në shpjegimet e nenit 119, deklaronte se në këtë nen nuk përfshiheshin ndër të tjera, dhe bastainat, të cilat ishin të përfshira në çifliqet. Sipas qeverisë greke, shpërndarja e tokës u ishte bërë bujkëve myslimanë, të cilët mund të merrnin përfitimin e plotë të tokës që u jepej, me sipërfaqe që shkonin nga 20 deri në 50 strema.⁴⁸⁰

Nga ana tjetër, autori Tsitselikis, i cili citon një sërë burimesh arkivore greke të viteve '20, deklaron se nga shpronësimi i pronave të pronarëve të mëdhej të Çamërisë, përfituan kryesisht të krishterët.⁴⁸¹ Në dokumentin që qeveria greke paraqiti pranë Lidhjes së Kombeve (C.349.1935.I.) nuk përmendet një fakt i tillë, për ta justifikuar shpronësimin si një politikë sociale e cila u erdhi në ndihmë pjesës më të madhe të popullsisë së varfër e aq më tepër asaj myslimane. Për më tepër, inspektori Sitlianopulos në vitin 1930 deklaroi se pronarët shqiptarë nga "*udhëheqës vendorë ishin bërë shumë të varfër*".⁴⁸²

Më 7 Gusht 1928, disa banorë të Pargës i dërguan një peticion Lidhjes së Kombeve mbi xhaminë e tyre dhe disa prona të zëna nga autoritetet Greke. Në përmbyllje të këtij raporti,

⁴⁷⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 40, Viti 1928, f. 190. Fuat Pronjo, M. *Kërkesë që të bëhen Hapat e Duhura pranë Qeverisë Greke për Kthimin e Pasurisë së tij në Paramithi, Filat, Gumenicë dhe Margëlliç*. (25 Maj 1928); Neni 119: "*Nga neni në fjalë përjashtohen shpronësimet:...6) bimët e përhershme ... pyjeve pasi përjashtohen nga ligji agrar që është në fuqi dhe i përkasin personave fizikë...*"

⁴⁸⁰ Lidhja e Kombeve, C.349.1935.I.

⁴⁸¹ Tsitselikis 2012: 304.

⁴⁸² Ibidem.

banorët kërkuar nga qeveria greke në rast se nuk do t'ua kthente pronat e kërkuara të paktën të përgjigjej për mirëmbajtjen e xhamisë dhe të klerit të saj. Mirëpo, qeveria greke nga vëzhgimet e bëra deklaroi se e kishte të pamundur të merrte një qëndrim mbi këtë çështje pasi sipas saj banorët në fjalë kishin përfituar nga Traktati i Athinës (1913), neni 4 për zgjedhjen e nënshtetësisë turke. Ndërkohë, të tilla metoda aplikoheshin dhe ndaj popullsisë myslimane të Thrakës, ku përveç keqtrajtimit ndaj popullsisë vendase, objektet e kultit uzurpoheshin nga ushtria greke e cila i transformonte në depo municionesh, ashtu sikurse dhe varrezat.⁴⁸³ Në këtë shkresë, qeveria turke i rikujtonte qeverisë helenike se ishte vendosur që "populli grek i Kostandinopojës nuk do të shkëmbehej me kusht që populli mysliman i Thrakës të mund të vijonte të qëndronte në vendin e tij".⁴⁸⁴

Në përgjigjen që Ministria e Punëve të Jashtme të Greqisë i dërgonte Legatës së Vendeve të Ulta, deklaronte se kishte qenë e detyruar për të shfrytëzuar çdo lloj ndërtese që do t'i shërbente për të strehuar refugjatët ose për çdo qëllim tjetër publik. Sipas saj, dy prej xhamive të qytetit Dimotiko ishin shfrytëzuar për këto qëllime, por pas një farë kohë i ishin dorëzuar përsëri komunitetit mysliman.⁴⁸⁵ Ndonëse, banorët myslimanë të kësaj krahine nuk janë objekt i këtij punimi, shembujt e sipërpërmendur vlejnë të pasqyrohen pasi tregojnë të

⁴⁸³ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/8/3/1/1/ Qeveria e Asamblesë së Madhe Kombëtare Turke, Ministria e Çështjeve të Jashtme. Delegacioni i Kostandinopojës. Kopje-Ankesë Dërguar Legatës së Vendeve të Ulta në Kostandinopojë. [Mbi keqtrajtimet e kryera ndaj popullsisë myslimane të Thrakës Perëndimore.]. (Teksti në Frengjisht). (nr. 3574/104). (22 Gusht 1923). (Kjo shkresë iu dërgua më tej nga Legata e Vendeve të Ulta në Athinë Ministrisë së Çështjeve të Jashtme në Athinë, më datë 25 Shtator 1923, nr. 2572, me titull "*Protection des Interets Turcs*"[Mbrojtja e interesave turke])

⁴⁸⁴ Ibidem.

⁴⁸⁵ IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/8/3/1/1/ Ministria e Çështjeve të Jashtme të Greqisë. *Notë verbale Drejtuar Legatës së Vendeve të Ulta*. (nr. 9707). (27 Nëntor 1923).

njëjtat metoda që autoritetet greke përdorën edhe ndaj popullit shqiptar mysliman të krahinës së Çamërisë.

4.6 Disa Vlerësime Demografike për Krahinën e Çamërisë në Vështrim Krahësues

Shpërngulja e çamëve drejt Turqisë, u mbyll zyrtarisht në Mars 1926. Gjatë kësaj periudhe tre vjeçare, ata hasën një sërë problemesh të cilat mbetën për t'u zgjidhur në vijim.⁴⁸⁶ Pas vitit 1926, kur Greqia e njohu zyrtarisht minoritetit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, në Çamëri u krijua një lidhshmëri e re e cili merrte përsipër të përfaqësonte në nivel ndërkombëtar çështje të ndryshme të cilat nuk kishin gjetur ende zgjidhje pranë autoriteteve qendrore dhe vendore të Greqisë.⁴⁸⁷ Gjatë kësaj periudhe, çamët nuk gëzonin të drejtat e tyre themelore as si individë edhe për shkak të konflikteve lokale e rajonale. Shkëmbimi i popullsisë greko-turke ishte një shtysë e mëtejshme e cila ndihmoi në përmbushjen e synimeve të Greqisë ndaj krahinës së Çamërisë, pasi shumica e çamëve të cilët ishin myslimanë u detyruan të shpërnguleheshin kryesisht drejt Turqisë. Sipas Tsitselikis, një nga arsyet e zvogëlimit të pranisë së myslimanëve në Epir, ishte largimi i detyrueshëm i çamëve.⁴⁸⁸

Në vitin 1913, pas aneksimit të krahinës, Ministria e Ekonomisë Kombëtare të Greqisë, kishte regjistruar të paktën 68,587 banorë në Çamëri, pasi në këtë krahinë në rajonin e Paramithisë kishte 16,947, në Margëlliç 16,265, dhe në Filat e Gumenicë kishte 35,375 banorë.⁴⁸⁹

⁴⁸⁶ Margaritis 2009: 118.

⁴⁸⁷ Baltsiotis 2011: 8.

⁴⁸⁸ Tsitselikis 2012: 82.

⁴⁸⁹ Ministria e Ekonomisë Kombëtare të Greqisë (Drejtoria e Statistikave) 1913.

Studiuesi shqiptar Shkëlzen Raça, raporton disa statistika osmane, në prag të Luftërave Balkanike, mbi përbërjen demografike të krahinës së Çamërisë. Sipas këtyre statistikave në Çamëri kishte një popullsi me përafërsisht 70,000 banorë. Sipas autorit Raça, duke u bazuar në këto statistika, rreth 60% e popullsisë së atëhershme të Çamërisë ishte shqiptare. Në Filat nga një popullsi prej 28.473 banorësh, vetëm 6.125 ishin Grekë. Në Gumenicë, jetonin 10.126 Shqiptarë, dhe asnjë grek. Në Paramithi kishte gjithësej 16.355 banorë, ndër të cilët 13780 ishin shqiptarë e 2.575 ishin grekë. Në Margëlliç, 15.723 ishin banorë shqiptarë, dhe në Pargë kishte 800 banorë shqiptarë, dhe 500 grekë.⁴⁹⁰

Sipas censusit të Greqisë më 1928, territoret çame, duke marrë në konsideratë dhe ndarjet e reja administrative deri në këto vite, paraqitej me një popullsi prej të paktën 62,000 banorë.⁴⁹¹ Ndërsa elementi shqiptar sipas këtyre statistikave paraqitej me 18,773 banorë, ndër të cilët 18,598 i përkisnin fesë myslimane. Por, sipas disa burimeve të tjera greke, në Çamëri kishte 22,000 shqiptarë.⁴⁹² Ndonëse nuk mund t'iu referohemi këtyre të dhënave për nxjerrjen në pah të së vërtetës për shkak të anësisë që i karakterizojnë ato gjatë kësaj periudhe, ato sidoqoftë paraqesin një zvogëlim të popullsisë, e sidomos elementit shqiptar në Çamëri.

Sipas konsullit britanik në Korfuz, Douglas William Keane, në 30 shtator 1929, në afërsi të Janinës nuk ekzistonte më minoriteti shqiptar.⁴⁹³ Ai citonte konsullin shqiptar, sipas të cilit i vetmi minoritet shqiptar kishte mbetur në territorin e Çamërisë me një popullsi prej

⁴⁹⁰ Raça 2009: 253.

⁴⁹¹ Ministria e Ekonomisë Kombëtare (Statistikat e Përgjithshme të Greqisë) 1928

⁴⁹² Tsitselikis 2012: 85.

⁴⁹³ Destani dhe Elsie 2013: 285.

35,000 shqiptarësh për afërsisht⁴⁹⁴ ndonjëse e tillë shifër mohohet nga ana e autoriteteve greke në këtë periudhë.⁴⁹⁵

Në këtë kohë në Epir destabiliteti mbizotëronte për shkak të nivelit të lartë të kriminalitetit. Megjithatë, përfaqësuesit e Komandës së Përgjithshme të Epirit mundoheshin ta mbulonin këtë realitet sipas konsullit britanik në Korfuz.⁴⁹⁶ Sidoqoftë, përfaqësuesi i Legatës Britanike në Athinë deklaronte se ishin bërë përpjekje për eliminimin e bandave të cilat destabilizonin rendin publik.⁴⁹⁷ Ai gjithashtu mbështeste qëndrimin e konsullit Keane në lidhje me helenizimin e krahinave në afërsi të Janinës.⁴⁹⁸

Zëvendëskonsulli i konsullatës shqiptare në Korfuz deklaronte se çdo krahinë e Çamërisë shihej si turke, dhe jo si e minoritetit shqiptar⁴⁹⁹. Ky qëndrim ishte konstant për elementin grek, i cili fenë myslimane e asocionte me kombësinë turke. Konsulli shqiptar në Korfuz deklaronte disa statistika në lidhje me reduktimin e popullsisë çame. Sipas tij:

*Gardhiqi nga 400 shtëpi, kishte 10 ose 15 shtëpi
Dhragomia nga 75-80 shtëpi kishte 25 ose 30 të tilla Margëllëçi
nga 650-700 shtëpi kishte jo më shumë se 300 Karbunara nga
300 familje kishte 70 ose 80.
Paramithia nga 550-600 shtëpi kishte 350-400*

Gjithashtu, dhe disa fshatra të tjerë kishin një zvogëlim të konsideruar të popullsisë.⁵⁰⁰

⁴⁹⁴ Ibidem: 284, 285.

⁴⁹⁵ Lidhja e Kombeve, C.349.1935.I.

⁴⁹⁶ Destani dhe Elsie 2013: 285.

⁴⁹⁷ Ibidem: 286.

⁴⁹⁸ Ibidem.

⁴⁹⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 130, Viti 1927, f. 22-24. *Raport për Gjendjen e Përgjithshme të Pakicës Shqiptare në Çamëri.* (28 Dhjetor 1927)

⁵⁰⁰ Naska 1999: 542, dok. 290.

Kreu V: Të Drejtat Themelore gjatë Viteve '30 në Çamëri

5.1 Status Quo-ja e të Drejtave Themelore të Njeriut

Konsulli i konsullatës shqiptare në Janinë, e përkufizonte gjendjen e çamëve në vitin 1936 me fjalët:

"Deri në një kohë para dy vjetëve, autoritetet greke vinin njerëz dhe sistematikisht vrisnin rregullisht ata çamër patriotë shqiptarë që nuk i përulëshin propagandës helmuese të tyre. Tash që prej dy vjet e tëhu, e kanë ndëruar taktikën. Nuk vrasin njerëz ma me plumba por i shkatërrojnë, i rrënojnë dhe i varfërojnë familjet deri në uri të vdekjes me mjete indirekte që asht ajo e mos mbarimi, kur e kursesi, të punëravet të pasunisë së tyre dhe çdo tjetër punë që munt të kenë me autoritete të atyre viseve, në mënyrë që të besdisen dhe të ikin".⁵⁰¹

Pas mohimit të të Drejtave Themelore të Njeriut, që kishte nisur që prej aneksimit të krahinës së Çamërisë (1913), në vitet '30 banorët e saj hasën probleme të shumta në lidhje me gëzimin e një sërë të drejtave, kryesisht për sa i përkiste të drejtës së pronës, duke qenë se reforma agrare vuri pengesa të ndryshme ndaj gëzimit të pronës private duke ndaluar si qiradhënien dhe qiramarrjen, ashtu edhe shit-blerjen, sidomos gjatë viteve '20, pasi nevojitej një sipërfaqe e madhe toke për të sistemuar mbi 1,000,000 refugjatë të ardhur nga Azia e Vogël. Në vijim të shkëmbimit të popullsive greko-turke, një pengesë tjetër ndaj çamëve ishte dhe vonesa ose mos-dhënia e certifikatave "*etablis*", pa të cilat ata nuk gëzonin asnjë të drejtë si subjekte të shtetit grek.

Fillimi i viteve '30 karakterizohet nga një periudhë thuajse pozitive në marrëdhëniet dypalëshe Shqipëri-Greqi, dhe rrjedhimisht vihej re edhe një mirëkuptim më i gjerë për

⁵⁰¹ AQSH, Fondi 251, Dosja 164, Viti 1936, f. 16-18. Raport mbi Kërkesën e Spiro Iliadhit për Mësues të Gjuhës Shqipe në Çamëri, si dhe për Keqtrajtimin e Popullsisë Çame prej Palës Greke. (19 Janar 1936)

respektimin e të drejtave themelore të popullsisë së Çamërisë. Në vijim të peticioneve të ndryshme të çamëve drejtuar kryesisht Lidhjes së Kombeve, Greqia u angazhua duke treguar vullnetin e saj për realizimin e kërkesave të çamëve me anë të nismave ligjore të ndërmarra kryesisht gjatë gjysmës së parë të viteve '30. Me ndërrimin e regjimit në vitet 1935-36, çamëve iu mohuan përsëri një sërë të drejtash, pasi konsideroheshin si popullsi armike e cila duhej mbajtur nën vëzhgim. Atyre iu ndalua përdorimi i gjuhës amtare në hapësirat publike. Gjithashtu, pas vitit 1938 u vu re një valë e re propagande e cila i detyronte të emigronin në Turqi, ose në Shqipëri. Mirëpo, ky objektiv u arrit në formë më të zbutur në krahasim me masat e mëparëshme të cilat implikonin ushtrimin e dhunës në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi ta, ndonëse kjo e fundit ishte një masë në funksion të spastrimit etnik, ku elementi grek favorizohej në huazimin e kredive bankare me qëllim blerjen e pronave të çamëve.

Statusi i të drejtave themelore të çamëve kishte një trajtë thuajse të pandryshuar, dhe shpesh herë të përkeqësuar. Duke u gjendur në trysni të vazhdueshme, edhe gjatë kësaj periudhe, shumë prej tyre zgjodhën shpërnguljen jashtë territorit zyrtar të shtetit Grek (të pas vitit 1913).

Sfondi i përgjithshëm i të drejtave të njeriut, gjithashtu dhe të minoritetit, në Çamëri haste në problematika të shumta ende të pazgjidhura. Një komision nga Çamëria i përbërë nga myftiu i Paramithisë, së bashku me Mazar Dinon, dhe Agush Muhamedin kishte shkuar pranë qeverisë greke në vitin 1929, duke marrë premtimin se një komision i posaçëm i saj [qeverisë] do të shkonte në Çamëri për të parë gjendjen nga afër në mënyrë që të propozonin

më tej masa për përmirësimin e çështjeve të kërkuara nga pala çame.⁵⁰² Në mungesë të një zgjidhje, komisioni ishte paraqitur përsëri në muajin Shkurt të vitit 1930 pranë qeverisë greke pasi situata në Çamëri vijonte të ishte e njëjtë. Pronat e çamëve, falë ndihmës që autoritetet greke u jepnin refugjatëve dhe të pastrehëve, grabiteshin prej tyre për këtë shtresë të shoqërisë në dëm të shqiptarëve të Çamërisë.⁵⁰³

Ndërtimi i dy fshatrave për vendosjen e refugjatëve në jug të krahinës së Filatit, kishte dëmtuar kullotat e përdorura prej çamëve, duke i hequr atyre të drejtën mbi një aktivitet bujqësor i cili u sillte përfitime ekonomike. Mungesa e dhënies së certifikatave "*etablis*" ishte një kalvar tjetër për popullsinë vendase, pasi të gjendur të shpronësuar e të dëmtuar nga çdo aktivitet ekonomik e sidomos bujqësor të cilët ishin mjetet kryesore të jetesës së tyre, e kishin gjithashtu të vështirë të lëviznin nëpër qytetet e Greqisë, pasi iu duhej të shpenzonin "edhe mbi fuqinë ekonomike që zotëronin në atë periudhë kohore".⁵⁰⁴ Sipas dëshmisë së Eqerem bej Vlorës, deputetët e ministri grek të cilët komisioni çam takoi deklaruan se çështjet e tyre vareshin nga marrëveshja greko-turke mbi pronat në vijim të shkëmbimit të popullsisë, duke mos u dhënë atyre asnjë zgjidhje ndonëse vetë shteti grek i kishte njohur herë pas here dhe zyrtarisht në nivel ndërkombëtar si minoritet shqiptar.⁵⁰⁵

Ndërsa në takimin e komisionit në vitin 1930, Ministri i Bujqësisë u premtoi atyre se do të bëheshin hetime në terren për përmirësimin e gjendjes së tyre. Prania e myftiut në

⁵⁰² AQSH, Fondi 251, Dosja 192, Viti 1930, f. 1-2. *Njoftim se Qeveria Greke nuk kishte marrë Masa për Kthimin e Pronave të Çamëve, në vijim të Premtimeve të bëra ndaj Përfaqësuesit Çame.* (5 Shkurt 1930)

⁵⁰³ Ibidem.

⁵⁰⁴ Ibidem.

⁵⁰⁵ Ibidem.; Në fund të viteve '20 dhe fillim të viteve '30, Çamët njiheshin si minoritet shqiptar nga qeveria greke. Kjo vihet re gjithashtu edhe në "Vëzhgimet" që kjo qeveri i dërgonte Lidhjes së Kombeve, në përgjigje ndaj peticioneve mbi çështjet e çamëve.

komisionin çam, vlerësohej nga Bej Vlora si e pafrytshme për shkak të klientelizmit që ekzistonte midis klerit mysliman dhe autoriteteve greke.⁵⁰⁶

Megjithatë, pas disa peticioneve të përfaqësuesve çamë të dërguara në Lidhjen e Kombeve, qeveria greke vendosi të dërgonte në terren inspektorin e saj në mënyrë që të merrte masat e duhura për përmirësimin e gjendjes së tyre. Stilianopulos, i cili shkoi në Çamëri në fillim të viteve '30, shënoi në raportin e tij se çamët nga të pasur ishin kthyer në shumë të varfër deri në nivelet e mbijetesës.⁵⁰⁷

Pavarësisht peticioneve të tyre (çamëve) të cilat qenë të shumta sidomos në gjysmën e dytë të viteve '20, përpjekjet e qeverisë greke për përmirësimin e gjendjes së tyre ishin të papërfillshme. Në 19 Nëntor 1934, dy peticione të dërguara nga Konispoli dhe Saranda drejt Lidhjes së Kombeve denonconin gjendjen e shqiptarëve të Çamërisë. Shtysa për t'iu drejtuar kësaj organizate ndërkombëtare, në këtë rast, ishte një mbledhje ku çamët e Filatit kishin qenë të detyruar për të marrë pjesë në mënyrë që të firmosnin një peticion i cili do t'i dërgohej më tej Lidhjes së Kombeve. Në këtë peticion do të shkruhej se çamët gëzonin të gjitha të drejtat nën qeverisjen greke.⁵⁰⁸ Menjëherë pas këtyre shkresave, qeveria greke dërgoi vëzhgimet e saj. Duke i rradhitur peticionet e shqiptarëve nën emërtimin si "Tentativat Shqiptare" [Lidhja e Kombeve C.81.1925.I.], në pikën e 13-të, ajo deklaroi se "shqiptarët gëzonin qetësisht nga liberalizmi i mirënjohur i cili është baza e të gjithave regjimeve në Greqi".⁵⁰⁹ Në pikën e 15-të qeveria greke iu referua një shkresë të disa përfaqësuesve çamë të cilët kishin shprehur, sipas saj, dëshirën për të shkuar në Turqi, dhe keqardhjen për disa pengesa që po hasnin për

⁵⁰⁶ Ibidem.

⁵⁰⁷ Tsitselikis 2012: 304.

⁵⁰⁸ Shih seksionin "4.4. Qeverisja Greke në Çamëri gjatë Shkëmbimit të Popullsisë Greko-Turke."

⁵⁰⁹ Lidhja e Kombeve, C.81.1935.I.

realizimin e vullnetit të tyre. Në këtë shkresë, ndër të tjera, lavdërohej dhe puna e autoriteteve greke si mbrojtëse të dinjitetit dhe jetës së çamëve. Ajo deklaronte se "ky qëndrim që lavdëronte autoritetet helenike për punën e tyre, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, shfaqja e mohimit të origjinës shqiptare, ishte një sjellje karakteristike".⁵¹⁰

Në vijim të përgjigjes së saj, qeveria greke e publikoi të plotë petitionin e Filatit të datës 15 Nëntor 1934, në të cilin shprehej solidarizimi i çamëve në Greqi me minoritetin grek që banonte në Shqipëri. Fjala përmbyllëse e këtij peticioni iu drejtua qeverisë duke i kërkuar që t'i ndalonte aktet "keqtrajtuese" ndaj minoritetit grek, përndryshe Epiri i Veriut duhet të bashkohej me vendin helen, duke qenë se Shqipëria nuk po tregohej "e aftë për të qeverisur banorët e kulturuar helenë".⁵¹¹ Siç deklaroi dhe historiani Meta, Greqia pasi arriti të spastronte etnikisht pjesën dërmuese të shqiptarëve në Greqi, ushtroi një trysni të dukshme me qëllim që të "fuqizonte pozitat ekonomike dhe sociale të minoritetit grek në Shqipëri".⁵¹²

Ky peticion nga Filati ishte firmosur nën drejtimin e myftiut Zekeria. Në vijim, për të përgënjeshtuar shtypin shqiptar, disa nga krerët fetarë e civilë të Filatit kishin firmosur një peticion tjetër në të cilin deklaroheshin se "jetonin përkrah të krishterëve nën mbrojtjen e ligjit grek, duke gëzuar një barazi perfekte".⁵¹³

Autoritetet greke deklaroheshin në vijim se më datë 22 Nëntor të të njëjtit vit, disa përfaqësues të të gjithë popullsisë së krahinës së Çamërisë përgënjeshtrojnë aludimet e palës shqiptare se ata i kishin firmosur këto peticione nën trysinë e autoriteteve greke.⁵¹⁴ Në

⁵¹⁰ Ibidem.

⁵¹¹ Ibidem.

⁵¹² Meta 2010: 84.

⁵¹³ Lidhja e Kombeve, C.81.1935.I.

⁵¹⁴ Ibidem.

përmbyllje të këtij peticioni deklarohet prej tyre, sipas qeverisë greke, se shqiptarët duke bërë të tilla deklarata kishin vetëm për qëllim që të fshehnin mizoritë e tyre në Epirin e Veriut. Për më tepër, përfaqësuesit çamë të këtij peticioni deklarorin se ata gëzonin "liri të plotë të besimit dhe të gjuhës".⁵¹⁵ Në fakt, vetëm fjalia e fundit e këtij peticioni lë hapësirë për dyshime pasi liria e fesë u ishte ndrydhur çamëve sidomos që prej Konventës së Shkëmbimit të Popullsive Greko-Turke (1923). Për më tepër, zaptimi i objekteve të kultit ishte një fenomen i njohur në Çamëri, i cili bëhej ndër vite kryesisht nga autoritetet ushtarake. Gjithashtu, në fund të viteve '20, në një kohë kur çamët nuk kishin asnjë shkollë në gjuhën shqipe, minoriteti grek në Shqipëri gëzonte disa dhjetëra shkolla.

Pasi gjendja në Çamëri vijonte në trajta të njëjta, në 10 Dhjetor 1934, përfaqësues të popullsisë çame të Filatit iu drejtuan Jozef Avenolit, sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve. Ata vunë në dukje shkeljet e traktatit të Sevres në disa pika dhe kërkonin prej këtij institucioni ndërkombëtar mbështetjen për gëzimin e të drejtave të tyre themelore. Sipas tyre, ishin shkelur disa nene të këtij akti ndërkombëtar:

1. *"një sistem zgjedhor që mban parasysh të drejtat e përfaqësimit të pakicave etnike*
2. *që dasia e fesë ose e kombësisë nuk duhet të dëmtojë asnjë shtetas grek për pranimin e tij në punët publike*
3. *që asnjë kufizim nuk do të lejohet kundër përdorimit të lirë të një gjuhe çfarëdo në marrëdhëniet private ose zyrtare, me gojë ose me shkrim, ndaj shtetasve greke me tjetër gjuhë nga greqishtja*
4. *nenet 8 dhe 9 të të njëjtit traktat përmbajnë detyrimet që Greqia ka marrë për të siguruar të drejtën e mësimdhënies së gjuhës së pakicave*
5. *neni 3 parashikon jo vetëm zotërimin e lirë të pronës për pakicat, por edhe e detyron Greqinë të lejojë gjithashtu zotërimin e pronave të paluajtshme për ata që kanë ushtruar të drejtën e adoptimit për një kombësi tjetër*
6. *kurrë nuk ka lejuar që elementi shqiptar të ketë shkollë në gjuhën e vetë dhe ndalon futjen e botimeve të çfarëdoshme në gjuhën shqipe*
7. *shkollë shqipe dhe mësimi i gjuhës shqipe nuk ishte lejuar*
8. *konfiskimi i tokave të shqiptarëve bëhej në mënyrë të kundraligjshme"*

⁵¹⁵ Ibidem.

Në përgjigje të këtij peticioni të rradhës, qeveria greke hodhi poshtë pretendimet Shqiptare duke deklaruar se në lidhje me popullsinë ajo njihte rezultatet e censurit të vitit 1928, sipas së cilës në Çamëri nuk kishte rreth 35,000 banorë siç deklaronte pala shqiptare por 18,773 banorë. Sipas saj, shqiptarët gëzonin të drejta të plota, por, edhe në ato raste kur çamët deklarorin se nuk iu ishin respektuar të drejtat, kjo gjendje nuk ishte vetëm për çamët, por "për të gjithë pjesën tjetër të popullsisë".⁵¹⁶ Qeveria greke ishte kontradiktore pasi në shkresën C.614.1930.I. të Lidhjes së Kombeve kishte deklaruar se për të minoritetet trajtoheshin në mënyrë superiore.⁵¹⁷

5.2 E Drejta e Shkollimit në Gjuhën Shqipe

Në përgjigjen që qeveria greke i dërgonte Lidhjes së Kombeve në vijim të peticionit të shqiptarëve në muajin Nëntor 1934, ajo deklaronte se gjuha shqipe mësohej në 40 fshatrat e Filatit dhe të Paramithisë prej imamëve.⁵¹⁸

E drejta e shkollimit ka qënë pjesë e kërkesave të çamëve që në fillim të qeverisjes greke mbi territorin e tyre, por kjo ishte e pamundur të realizohej gjatë dhjetëvjeçarit të parë, për shkak të zhvillimeve kombëtare, rajonale e botërore; gjatë dhjetëvjeçarit të dytë, masat shtrënguese në funksion të realizimit të shkëmbimit të popullsisë greko-turke të cilat përfshinë dhe popullsinë e fesë myslimane në Çamëri, e zbehën dukshëm detyrimin ligjor të Greqisë

⁵¹⁶ Lidhja e Kombeve, C.349.1935.I.

⁵¹⁷ Shih Lidhja e Kombeve, C.614.1930.I.

⁵¹⁸ Lidhja e Kombeve, C.81.1935.I.

për t'u garantuar çamëve të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare; ndërsa, në vitet '30, pjesa më e madhe e shkëmbimit të popullsisë çame kishte përfunduar dhe Greqia nuk ishte më e detyruar ligjërisht nga marrëveshje ndërkombëtare si Konventa e Lozanës (30 Janar 1923), dhe mund të hartonte kuadrin e plotë ligjor në plotësimin e të Drejtave Themelore të Njeriut e të minoritetit, pjesa më e madhe e të cilave iu ishte mohuar çamëve deri në këtë periudhë. Por, ky shtet vijoi me politikën e paracaktuara për asimilimin e kësaj popullsie, apo spastrimin etnik të tyre me çdo formë.

Në vitet pas aneksimit të Çamërisë, shkollat ekzistuese ishin kryesisht shkolla të fetare myslimane si dhe shkolla greke. Identiteti kombëtar shqiptar ishte tej mase i paqartë gjatë kësaj periudhe, ashtu sikurse edhe gjatë shkëmbimit të popullsive greko-turke. Si rrjedhojë, kërkesat për hapjen e shkollave shqipe dolën në pah sidomos gjatë viteve '30.

Studiuesi Tsitselikis thotë se Traktati për Minoritetet i firmosur në Sevër (1920) nuk u vu thujtë aspak në zbatim për sa u përkonte të drejtave të çamëve.⁵¹⁹ Në vitin 1930, kishte vetëm një shkollë fillore greke në 33 fshatra të Çamërisë.⁵²⁰ Ndjekja e shkollës nga nxënësit shqiptar ishte e ulët, edhe për shkak të zakoneve fetare të cilat nuk lejonin pjesëmarrjen e vajzave në shkolla.

Në vitin 1930, Myftiu i Margëlliçit kishte sugjeruar popullsinë vendase për dërgimin e vajzave në shkolla deri në moshën 10 vjeçare.⁵²¹ Por, në këtë kohë një grup prindërisht shqiptarë të Çamërisë kishin bërë një ankesë, pasi sipas tyre feja e ndalontë pjesëmarrjen e vajzave në shkolla, por gjithashtu një grup tjetër prindërisht [që mendohet të jenë po ashtu

⁵¹⁹ Tsitselikis 2012: 440.

⁵²⁰ Ibidem.

⁵²¹ Ibidem.

muslimanë çamë] i kishin dërguar fëmijët e tyre në shkolla, edhe vajzat gjithashtu. Për mbrojtësit e tezës greke, kjo interpretohej si një mungesë dëshire e çamëve për t'u shkolluar, për aq sa dhe vetë qeveria greke në përgjigjen që i kishte dërguar Lidhjes së Kombeve në vitin 1927, në lidhje me petitionin e banorëve të Gardhiqit, ishte shprehur se "kjo popullsi i qëndron larg çdo përpjekjeje për shkollim".⁵²²

Nga ana tjetër, traktati për mbrojtjen e minoriteteve i firmosur nga Greqia në vitin 1920, dhe i ratifikuar prej saj më 29 Shtator 1923 shprehte angazhimin e saj për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Neni 8 i kësaj marrëveshje pasqyronte të drejtën e shkollimit të këtyre popullsive, sipas përmbajtjes:

*"Subjektet greke të cilat i përkasin minoriteteve racore, fetare ose gjuhësore, duhet të gëzojnë të njëjtin trajtim dhe siguri përpara ligjit si individët e tjerë të kombësisë greke. Në veçanti, ata duhet të kenë të drejta të barabarta për të hapur, administruar, dhe kontrolluar, me shpenzimet e tyre, institucione bamirësie, fetare, dhe sociale, shkolla dhe institucione të tjera edukative, duke pasur të drejtën të përdorin gjuhën e tyre dhe të praktikojnë fenë e tyre."*⁵²³

Neni 1 i këtij traktati e quante këtë nen [nr. 8] si ligj themelor, mbi të cilin nuk do të dilte asnjë ligj tjetër. Por, gjendja në Çamëri tregonte një situatë në të cilën këto të drejta u plotësuan në një përqindje të papërfillshme nga autoritetet greke. Në një petition dërguar

⁵²² Tsitselikis 2012: 441.

⁵²³ Fletorja Zyrtare e Greqisë. Nr. 311. (30 Tetor 1923).

Lidhjes së Kombeve çamët deklarorin se në Filat e Paramithi kishte vetëm shkolla fillore, të mesme, e për vajza, ku nxënësit shqiptarë mund të arsimoheshin vetëm në gjuhën greke.⁵²⁴

Për më tepër, as arsimimi fetar nuk lejohej të bëhej në gjuhën amtare, pasi një shkollë e cila ishte lejuar të hapej në Filat, u mbyll pas një periudhe të shkurtër sepse mësimi zhvillohej në shqip, dhe studentet u detyruan të merrnin pjesë në shkollat greke, pasi ato rrezikonin të gjobiteshin në rast se do të kundërshtonin.⁵²⁵ Sipas qeverisë greke, kjo shkollë duhet të mbyllej për shkak të nivelit të ulët të ndjekjes së saj.⁵²⁶ Nëqoftëse shqiptarët e Çamërisë nuk do t'i kishin dashur shkollat në gjuhën e tyre amtare, me siguri ata do të kishin zgjedhur ndjekjen e mësimave pranë shkollave greke, duke ua thjeshtuar në këtë mënyrë punën autoriteteve greke. Natyrisht, nuk mund të përgjithësohet sfondi që i karakterizonte kërkesat e kësaj popullsie për shkollimin në gjuhën e tyre, por niveli i ulët i frekuentimit të shkollave shqipe, nëse do të kishte qenë vërtetë i tillë, nuk i përjashtonte zyrtarët grekë ndaj përmbushjes së detyrimeve që kishin marrë përsipër të zbatonin, bazuar në detyrimin ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar për respektimin e të drejtave të minoriteteve. Nëse çamët nuk do të kishin dëshiruar t'i frekuentonin shkollat në gjuhën amtare, me siguri ata do të ishin asimiluar nga Greqia brenda një periudhe të shkurtër kohore, në më pak se katër dhjetëvjeçarë [koha që iu desh Greqisë për të asimiluar e spastruar etnikisht krahinën e Çamërisë].

Në vitin 1927, pas kërkesës së çamëve për të hapur dy shkolla myslimane dhe një për vajza, duke marrë përsipër vetë mbulimin e shpenzimeve, zyrtarët grekë e konsideronin këtë kërkesë si pjesë e propagandës shqiptare pasi deri në atë periudhë, "ashtu sikurse dhe gjatë

⁵²⁴ Naska 1999: 648, dok. 336.

⁵²⁵ Tsitselikis 2012: 441.

⁵²⁶ Ibidem.

periudhës së Perandorisë Osmane", shqiptarët nuk gëzonin të drejtën për të hapur shkolla në gjuhën amtare.⁵²⁷ Propaganda shqiptare e kësaj periudhe ishte një mjet i nevojshëm për t'i bërë ballë shtypjeve të shpeshta të të drejtave themelore të çamëve prej autoriteteve greke. Kjo propagandë, ndonëse nuk pati shumë sukses, u përdor nga shqiptarët për të njoftuar grupe të ndryshme banorësh që të shihnin realitetin e gjëndjes së tyre, e cila ishte krejt e kundërt nga sa u paraqitej atyre prej përkrahësve të shkëmbimit të popullsive greko-turke. Në të njëjtën mënyrë, u përdor dhe në sfondin e shkollimit në gjuhën shqipe, pasi Greqia ishte e vendosur në zbatimin e politikave të saj të cilat kishin për qëllim asimilimin e minoriteteve, në një kohë kur këto të drejta ishin të rregulluara nga konventat ndërkombëtare të kohës. Pra, shteti grek i anashkalonte detyrimet ligjore përballë konventave të cilat autoritetet e saj i ratifikonin, por nuk i zbatonin më tej në terren, duke i mbajtur ato larg realitetit që u ofrohej minoriteteve, siç ndodhi me shqiptarët e Çamërisë. Për këtë arsye, propaganda shqiptare e kësaj kohe në Çamëri kishte një rol vetëmbrojtës ndaj shkeljeve të të drejtave themelore që çamëve iu bëhej në mënyrë sistematike. Greqia i frikësohej hapjes së shkollave shqipe në Çamëri, edhe pse kërkesat e shqiptarëve ishin për një numër të vogël shkollash në krahasim me ato që gëzonte minoriteti grek në Shqipëri. Për Greqinë, ato mund të shtonin propagandën shqiptare në këtë rajon.⁵²⁸

Një diplomat grek deklaronte në vitin 1928 se Shqipëria po ushtronte "raprezalje" ndaj përdorimit të gjuhës Greke që prej vitit 1922. Dhe për këtë, diplomati vijonte se: "Greqia nuk po i pengonte shqiptarët e Çamërisë, por ajo do ta detyronte Shqipërinë që të përmbushte

⁵²⁷ Manda 2015: 53.

⁵²⁸ Manda 2015: 53, 54.

detyrimet e saj (duke nënkuptuar Traktatin e Minoriteteve të Lidhjes së Kombeve 1920)".⁵²⁹

Por, shteti shqiptar nuk vuri në zbatim asnjëherë të njëjtat metoda e taktika që Greqia zbatoi ndaj çamëve. Nëse do të ishte e vërtetë deklarata e diplomatit grek, numri i shkollave greke në Shqipëri nuk do të kishte qenë disa herë më i lartë sesa numri i të tilla institucioneve në Çamëri, gjatë kësaj periudhe. Në të njëjtin vit, Musa Demi arriti të dërgonte 20 nxënës myslimanë në shkollat shqiptare, por ky veprim i tij i frikësoi grekët pasi “ata mendonin se këta fëmijë të vegjël do të trajnoheshin për të nxitur ndjenjat nacionaliste të minoritetit kundër Grekisë”.⁵³⁰

Shqiptarët e Çamërisë hasën pengesa të shumta edhe për të drejtën e shkollimit në gjuhën e tyre amtare. Qeveria greke e cila kishte rolin kryesor në këtë pikë nuk i dha rëndësinë e duhur shkollave të çamëve. Bazuar në faktin që shpesh herë ajo caktonte mësues të cilët nuk përfaqësonin këtë minoritet, e as nuk i përkisnin kombësisë shqiptare, mund të thuhet se Greqia synonte t’iu ndalonte çamëve të drejtën e shkollimit në gjuhën e tyre.

Prevelakis (2007) shprehej se Greqia duke synuar homogjenizimin e popullsisë me vlerat e politikës qendrore të shtetit, krijoi një sistem të shkollimit publik. Sipas tij, vllahët dhe arvanitasit ishin të interesuar për këtë sistem shkollimi.⁵³¹ Duhet theksuar se përthithja e elementit ortodoks në kulturën e përgjithshme greke nuk hasi në vështirësi. E kundëta ndodhi me elementin çam, i cili përbëhej kryesisht nga popullsi shqiptare të fesë myslimane. Ata u quajtën shpeshherë si të paaftë për të marrë dije, dhe si elementë me vështirësi të theksuar për t’u integruar në shoqërinë greke. Në këtë drejtim, kuptohet se shteti Grek nuk ishte i interesuar

⁵²⁹ Tsitselikis 2012: 441.

⁵³⁰ Divani 1995: 242-243.

⁵³¹ Prevelakis 2007: 93.

në plotësimin e të drejtave të minoritetit pasi ai synonte homogjenizimin e territorit dhe asimilimin e popullsisë që banonte nën kufijtë e tij zyrtarë.

Nga ana tjetër, Prevelakis deklaronte se Greqia nuk synoi kurrë çrrënjosjen e gjuhës shqipe, pasi ajo ende përdoret në ditët e sotme.⁵³² Por, profesor Çabej, duke cituar gjuhëtarin francez A. Meillet, shkruante se: *“Forca e rezistencës së gjuhës shqipe dëshmon tenacitetin e kombit”*.⁵³³ Argumenti i autorit kretez [Prevelakis] shpreh një të vërtetë të pjesshme pasi gjuha shqipe ende flitet në krahinën e Çamërisë edhe në pjesën e banuar nga arvanitasit, mirëpo, siç deklaroi dhe vetë ai, Greqia synoi homogjenizimin e territorit⁵³⁴, çka nënkupton me fjalë të tjera mundësitë për t'u shkolluar në gjuhën amtare qenë të pakta dhe rrjedhimisht kjo pasqyrohet edhe në qëndrimet e autoriteteve greke, qendrore dhe vendore, në periudha të ndryshme të qeverisjes së tyre mbi popullsinë shqiptare, një pjesë e mirë e së cilës u shpëngul e detyruar për t'u përfshirë në shkëmbim, dhe pjesa tjetër, emigroi ose vuajti pasojat e genocidit të vitit 1944, dhe keqtrajtimit të ndryshme të pësuar gjatë viteve, siç ndodhi me çamët e fesë myslimane, të cilët u çrrënjosën nga trojet e veta, pasi asimilimi i tyre ishte i pamundur.

Në Margëlliç, në Shkurt 1939, dy mësues të cilët nuk mund të shkruanin e as të lexonin shqip u caktuan për të dhënë mësim. Këto dy emra nuk ishin as të përfshirë në listën e hartuar nga Legata Shqiptare në Athinë, për të cilën qeveria greke ishte zotuar se do ta respektonte.⁵³⁵

⁵³² Ibidem.

⁵³³ Çabej 1939: 90. Po në këtë artikull, Çabej duke përmendur besimet e ndryshme fetare në Shqipëri shkruan se: *“... njësia e kombit në themel nuk u shkatërrua. Ekzistenca e shumë zakoneve të përbashkëta parakrishtere e krishtere të të gjitha shtresat e popullit dhe në gjithë krahinat ka ndihmuar, pa ditur, në ruajtjen e kësaj njësie. Ndërgjegjja e fisit dhe ndjenja nacionale kanë qënë gjithmonë më të forta. Ky fakt i njohur nga shkëncën duhet marrë parasysh kur studiohet historia shqiptare.”* f. 91-92.

⁵³⁴ Për më tepër shih: Prevelakis 2007: 93, 134.

⁵³⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 125, Viti 1939, f. 23. *Kërkesë për të Shpejtuar Transferimet dhe Emërimet e Mësuesve që janë propozuar nga Legata Shqiptare.* (27 Shkurt 1939)

Nga ana tjetër, hapja e shkollave në fshatra të vogla ishte më e inkurajuar sesa hapja në fshatra apo qytete me sipërfaqe më të madhe.⁵³⁶

Një tjetër e drejtë e mohuar ndaj çamëve në sfondin e shkollimit, ishte dhe e drejta për përdorimin e gjuhës amtare, e cila shkeli gjithashtu edhe nenin 8 të Traktatit të Sevres. E drejta për përdorimin e gjuhës shqipe në hapësirat publike u ndalua edhe pas ndërrimit të regjimit politik në Greqi, me ardhjen e Metaksait.⁵³⁷ Ata që nuk e zbatonin qarkoren e lëshuar nga Prefekti i Gumenicës për ndalimin e përdorimit të gjuhës shqipe, ndëshkoheshin me masa nga më të egrat. Konsulli shqiptar në Janinë i raportonte në Maj 1936 Ministrin shqiptar të Punëve të Jashtme se disa çamë qenë rrahur barbarisht nga korofillaqia [xhandarmëria] pasi ata ishin kapur duke folur shqip.⁵³⁸ Në Shtator 1936, disa shtëpi myslimanësh në Paramithi u kontrolluan me pretekstin për të gjetur armë, por autoritetet e xhandarmërisë gjetën vetëm tekste të shkollës fillore. Në këtë situatë, korofillakët i deklaruan pronarëve çamë se nëse donin të mësonin shqip, ata duhet të shkonin diku tjetër.⁵³⁹

Imamët e Filatit dhe të Margëlliçit ishin urdhëruar që të mësonin mësimet fetare në gjuhën greke.⁵⁴⁰ Në prill 1936, Abedin Bako, një qytetar nga Paramithia, informoi konsullin shqiptar në Janinë mbi inspektimin e shtëpisë së tij nga korofillaqia. Ata gjetën atje disa materiale në gjuhën shqipe, dhe i deklaruan z. Bako se të tilla materiale përbënin një rrezik për Greqinë. Në të njëjtën kohë, i kërkuan z. Bako që të largohej për në Turqi.⁵⁴¹ Ndërsa në

⁵³⁶ Ibidem.

⁵³⁷ AQSH, Fondi 251, Dosja 84, Viti 1937, f. 5-6. *Njoftim për Masat e Rrepta të Autoriteteve greke për të ndaluar Mësimin e Gjuhës Shqipe në Çamëri*. (7 Maj 1937).

⁵³⁸ AQSH, Fondi 251, Dosja 164, Viti 1936, f. 8. *Raport për Keqtrajtimet e Autoriteteve Greke ndaj Popullsisë Vendase*. (20 Maj 1936)

⁵³⁹ Naska 1999: 676, 677, dok. 356.

⁵⁴⁰ Naska 1999: 686, dok. 361.

⁵⁴¹ AQSH, Fondi 251, Dosja 164, Viti 1936, f. 174. *Presionet e Xhandarëve Grekë për Ndalimin e Gjuhës Shqipe dhe Librave në Shqip*. (14 Prill 1936)

vitin 1935, qeveria Greke kishte deklaruar pranë Lidhjes së Kombeve se ajo i lejonte librat dhe gazetat shqiptare, por kishte bërë përjashtim vetëm për gazetën *Besa*, për të cilën kjo e fundit përmbante disa tone nacionaliste dhe për këtë ishte ndaluar në Greqi. Megjithatë, kontrolli që i ishte bërë z. Bako një vit më vonë pra në vitin 1936, tregonte qartë qëndrimin grek në lidhje me mbrojtjen e të drejtës për informimin në gjuhën amtare, i cili shkonte ndesh me respektimin e të drejtave themelore të këtij minoriteti. Qeveria greke dërgonte në Çamëri mësues të gjuhës shqipe të fesë së krishterë, fakt i cili ndikonte në ndjenjat e popullsisë vendase.⁵⁴² Nga ana tjetër, minoriteti grek në shqipëri mund t'i caktonte vetë mësuesit për shkollat minoritare.⁵⁴³ Por, në përgjigjen që zëvendës ministri i punëve të jashtme i dërgonte konsullit shqiptar në Janinë i deklaronte se nuk mund të vendoste pala shqiptare mbi përcaktimin e mësuesve të shkollave çame pasi ato ishin shtetërore, megjithatë ata mund t'i rekomandonin autoriteteve greke disa emra të zotë për pozicionin e mësuesit.⁵⁴⁴

Sidoqoftë, në vitin 1936 autoritetet shqiptare vunë në dukje vonesën për hapjen e shkollës shqipe në Filat, një nga qendrat kryesore të Çamërisë.⁵⁴⁵ Mësuesit e emëruar në shkollat shqipe të Çamërisë luanin një rol negativ kundrejt popullsisë vendase, pasi ata propagandonin braktisjen e gjuhës shqipe tek nxënësit shqiptar.⁵⁴⁶

Greqia nuk arriti t'i përballonte me sukses kërkesat e çamëve për hapjen e shkollave shqipe duke aplikuar si zakonisht vonesat administrative, politikat asimiluese dhe nga ana tjetër, rol në mungesën e realizimit të këtyre kërkesave e luajti shpesh herë dhe mungesa e

⁵⁴² Naska 1999: 656 , dok. 340.

⁵⁴³ Ibidem.

⁵⁴⁴ Ibidem.

⁵⁴⁵ Naska 1999: 662, dok. 344.

⁵⁴⁶ Naska 1999: 676, dok. 356.

fondeve nga ana e shtetit grek. Megjithatë, reagimet e tij ishin të papërfillshme edhe ndaj kërkesave të çamëve për t'i mbuluar vetë shpenzimet e hapjes dhe të administrimit të institucioneve të shkollimit [në gjuhën amtare].

5.3 E Drejta e Pronës gjatë Viteve '30

Problematikat për pronat e çamëve nisën kryesisht nga baza ligjore në fuqi. Çështja e pronave të çamëve pas vitit 1930 deri në vitin 1939 karakterizohet nga dy etapa që përkojnë me periudhën e intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe me Shqipërinë në lidhje me çështjet e pazgjidhura midis dy vendeve dhe periudhën e qeverisjes së Metaksait i cili erdhi në pushtet në vitin 1935. Etapa e parë ishte relativisht më liberale karshi të drejtave themelore të kësaj popullsie, ndërsa etapa e dytë u shoqërua me një izolim tërësor për shoqërinë Greke, ku elementi çam ishte nën vëzhgim më të rreptë, pasi ata nuk u integruan dot nën shoqërinë greke, duke qënë se të drejtat e tyre u neglizhuan në vazhdimisht.

Në pikëpamjen e historiografisë greke, çamët mbanin qëndrime irredentiste pasi synonin bashkimin me atdheun e tyre Shqipërinë. Mirëpo, në anën tjetër, ata u gjendën vazhdimisht nën presion fill pas aneksimit të krahinës që në vitin 1913, e më tej me nisjen e procesit të shkëmbimit të popullsisë shume autorë të kohës e konsideruan këtë si një mohim të qartë të të drejtave themelore të njeriut, ndonëse ky proces ishte i domosdoshëm me fillimin e krijimit të shtet kombeve, në mënyrë që të spastroheshin territore të caktuara në ndihmë të krijimit të homogjenitetit territorial e kulturor të krahinave të caktuara.

Në shkurt të vitit 1930, disa përfaqësues nga qyteti i Paramithisë në Çamëri i dërguan një letër Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, për ta vënë në dijeni mbi vështirësitë që ata po hasnin në gëzimin e të drejtës së pronës. Pavarësisht ligjit agrar dhe

nenit 119 të Kushtetutës Greke, ata u shpronësuan nga tokat e tyre nën 30 hektarë dhe në disa raste dhe gjysëm hektari⁵⁴⁷. Ata i konsideronin këto masa arbitrare për faktin se Paramithia ishte një qytet e jo një fermë, dhe për më tepër një sipërfaqe e madhe toke ishte marrë nga një numër i madh pronarësh për t'iu shpërndarë një numri të vogël fshtarësh, duke i lënë pronarët pa asnjë pronë.⁵⁴⁸ Në përgjigjen që qeveria greke i dërgonte Lidhjes së Kombeve, deklaronte se një përfaqësues i saj kishte shkuar në këto territore për të vlerësuar situatën. Inspektori i dërguar ishte kthyer nga udhëtimi i tij me disa sugjerime në mbështetje të popullsisë vendase. Pas kësaj, qeveria Greke u zotua se do të merrte masa për përmirësimin e kësaj gjendjeje.⁵⁴⁹

Një tjetër peticion u dërgua disa muaj më vonë nga Paramithia, dhe në vëzhgimet që qeveria greke i dërgonte Lidhjes së Kombeve qartësonte faktin se ajo kishte marrë disa masa për përmirësimin e situatës së këtij minoriteti, për të cilin ajo deklaroi se trajtoheshin në një nivel më të lartë sesa pjesa dërrmuese e popullsisë, duke qënë se ishin minoritet.⁵⁵⁰ Këto masa nënkuptonin dyfishimin e kompensimit për territore më të vogla se 30 hektare.⁵⁵¹ Për më tepër me ligjin nr. 5136 të vitit 1931, i cili amendoi ligjin agrar nr. 4816 të vitit 1930, çamët kishin të drejtë të çonin çështjet e tyre në Gjykatën e Apelit, për rishqyrtim të atyre çështjeve të cilat Ministria e Bujqësisë do t'i konsideronte si të gjykuara më parë në kundërshtim me ligjin.⁵⁵²

⁵⁴⁷ Në nenin 119 të Kushtetutës së Greqisë (1927) deklarohet:

"Për rehabilitimin qytetar të refugjatëve ka vend shpronësimi dhe pushtimi përpara kompensimit të terreneve të pandërtuara për ndërtimin e lagjeve me të paktën njëzet shtëpi, me sipërfaqe jo më të vogël se dymijë metra katrorë, ose për zgjerimin apo plotësimin e lagjeve ekzistuese... Terrenet, në të cilat tashmë janë ndërtuar lagje refugjatësh prej të paktën njëzet shtëpi dhe me sipërfaqe jo më të vogël se 2000 metra katrorë, janë subjekt i shpronësimit, i kompesimit të caktuar sipas kësaj mënyre."

⁵⁴⁸ Naska 1999: 600, dok. 306.

⁵⁴⁹ Shih për më tepër: Lidhja e Kombeve C.664.1931.I.

⁵⁵⁰ Lidhja e Kombeve, C.664.1931.I.

⁵⁵¹ Naska 1999: 605, 606, dok. 309.

⁵⁵² Neni 2 i Ligjit 5136 në Fletoren Zyrtare të Greqisë. (18 Qershor 1931). Nr. 217.

"I-E drejta që i është dhënë sipas nenit 2 të ligjit 4816 Ministrit të Bujqësisë për rigjykimin e pronave të shpronësuar të zonave të Margaritit dhe të Paramithisë, ushtrohet që këtej e tutje vetëm në rastin kur nuk është

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, gjendja e pronave në Çamëri nuk përmirësime të dukshme. Duke analizuar raportin e inspektorit të minoriteteve të hartuar në vitin 1930, studiuesja Kretsi deklaronte se reforma agrare ishte "jologjore" dhe "diskriminuese" për minoritetin çam.⁵⁵³ Në Gusht të vitit 1930, Musa Demi, një nga përfaqësuesit kryesorë të çamëve, i shfaqti disa kërkesa Inspektorit të zyrës së Minoriteteve, Z. Stilianopulos, por ata patën një debat midis tyre.⁵⁵⁴

Nga kërkesat e të parit [Musa Demit], kuptohet që situata në Çamëri nuk ishte e favorshme për kuadrin e të Drejtave Themelore të Njeriut e të minoriteteve. Inspektori grek, shkruajti në raportin e tij që çamët u lanë pa asnjë pronë.⁵⁵⁵ Konfiskimi i pronës dhe shpronësimet u aplikuan gjerësisht në këtë kohë në Çamëri, pasi të tilla procedura ndihmuan në zbatimin e planit të rivendosjes së refugjatëve Grekë të procesit të shkëmbimit të popullsisë greko-turke (1923).

Banorë të një qyteze tjetër të Çamërisë, Dhragomisë, i dërguan një petition Lidhjes së Kombeve, duke i kërkuar rikthimin e pronave të tyre të cilat u ishin vënë në dispozicion refugjatëve Greke. Në anën tjetër, qeveria greke deklaroi se vetëm një numër i vogël refugjatësh ishin caktuar për t'u vendosur në këtë krahinë, pasi ata kishin vendosur më tej të

realizuar brenda afateve kohore të vendosura ose sipas paragrafit 1 të nenit të mëparshëm.... (sipas të cilit: Brenda një afati kohor prej tre muajsh nga data e hyrjes në fuqi të pranohen 7/10 e rehabilitimeve të justifikuara, me qëllimin e tjetërsimit të përbashkët e të vullnetshëm të pronës nga ish pronari tek pronarët (ata që kanë marrë një pjesë toke me short) e regjistruar.)

*2-E drejta e sipërpërmendur e rigjykit të Ministrisë është në fuqi deri më 31 dhjetor 1932."*¹⁷² Kretsi citon nga ky raport: "situatën... e krijuar ndaj pronarëve myslimanë, nga zbatimi i pamëshirshëm e i padrejtë i ligjit agrar nga nëpunësit lokalë, që kishin marrë përsipër zbatimin, të cilët këtë çështje tejet delikate e trajtuan si antipolitike". Marrë nga burimi arkivor në Ministrinë e Jashtme të Greqisë, A/4/9/2. (7 Gusht 1935). Raport i datës 22 Prill 1930, nënshkruar nga inspektori i përgjithshëm i zyrës së Ministrisë së Bujqësisë. Për raporte të tjera të inspektorit të Ministrisë së Bujqësisë, mbi gjendjen e pronave të myslimanëve çamë shih Tsitselikis 2012: 304 dhe Baltsiotis 2011: 8, 9.

⁵⁵³ Kretsi 2005: 65.

⁵⁵⁴ Naska 1999: 607, dok. 311.

⁵⁵⁵ Tsitselikis 2012: 304.

transferoheshin në Maqedoni. Për këtë arsye, peticioni i çamëve ishte i pabazë, sipas qeverisë greke.⁵⁵⁶ Sidoqoftë, konfliktet që u ndëzën gjatë kësaj kohë për shkak të pranisë së refugjatëve grekë ishin të dukshme. Në Janar të vitit 1923, Shoqëria e Lindjes së Afërt dhe të Mesme, denoncoi në gazetën "The Times", kushtet e mjerueshme të refugjatëve Grekë, e për këtë, ata kërkuar vëmendjen e qeverisë Greke, në mënyrë që të tilla vuajtje të mos shtriheshin më tej tek të tjerë të pafajshëm, siç ishin çamët në këtë rast.⁵⁵⁷ Prandaj, dhe peticioni i çamëve në Dhragomi nuk mund të quhej i pabazë, pasi kjo situatë ekzistonte prej vitesh.

Qeveria greke synonte çrrënjosjen e popullsisë shqiptare nga vatrat e saj.⁵⁵⁸ Të detyruar nga gjendja e mjeruar në të cilën çamët u ndodhën fill pas aneksimit të krahinës nga Greqia, meshkujt çamë u detyruan të emigronin në vende si Amerika, Franca, Turqia e Shqipëria, ndërkohë që familjet e tyre mbetën në Çamëri duke u kujdesur për pronat e tyre dhe duke u marrë me aktivitete bujqësore. Ministria e Bujqësisë së Greqisë kishte kërkuar një listë të këtyre personave të mbetur në mënyrë që t'ia paraqiste në vijim Komisionit Mikst për shqyrtim të statusit të tyre të shkëmbyeshmërisë.⁵⁵⁹ Ndonëse ky urdhër nuk u ekzekutua, ai ngjalli debate tek pala shqiptare, autoritetet zyrtare ashtu sikurse dhe tek çamët. Megjithatë, përfaqësuesi shqiptar i legatës në Athinë u interesua pranë autoriteteve të ministrisë greke të bujqësisë, të cilët e siguruan se ndonëse ishte shkruajtur se lista do të paraqitej pranë Komisionit Mikst në Stamboll, ky urdhër kishte për qëllim nxjerrjen e statistikave të sakta për

⁵⁵⁶ Naska 1999: 609, dok. 313.

⁵⁵⁷ Destani dhe Tomes 2012: 406, 407.

⁵⁵⁸ Naska 1999: 617, dok. 317.

⁵⁵⁹ Ibidem.

çamët autoktonë si dhe personat e ardhur, në mënyrë që të mos abuzohej me këto deklarata.

560

Në Dhjetor të vitit 1931, Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë sugjeroi ambasadorin Shqiptar në Greqi që të shqyrtonte disa masa që ishin marrë në lidhje me pronat e minoritetit shqiptar. Sipas tij, shqiptarët në Greqi kishin vështirësi pasi edhe nëse "një Shqiptar do të kalonte të gjitha etapat e një procesi, në fund atij do t'i duhej të verifikonte kombësinë e tij shqiptare".⁵⁶¹

Qeveria greke i kërkonte pronarëve shqiptarë pagesën e shumës prej 20% të vlerës së pronës që u rikthehej pas konfiskimit të mëparshëm. Ministri shqiptar vuri në dukje se kjo masë nuk aplikohet për minoritetet e tjera, për të njëjtën procedurë. Për më tepër që vlerësimi i pronave të shqiptarëve ishte i ulët. Një ditë më vonë, përfaqësuesi shqiptar në Greqi, informoi Ministrin për bisedën e tij me përfaqësuesit Grekë. Ky i fundit deklaroi se shuma prej 20% e kërkuar ndaj Shqiptarëve vinte për dy arsye: për minoritetet e tjera kjo masë ishte hequr, pasi Greqia ishte e detyruar ta bënte për shkak të marrëdhënieve dypalëshe me shtetet përkatëse⁵⁶² ndonëse justifikimi i përdorur për palën shqiptare kishte të bënte me faktin se ky rregull ishte i trashëguar nga legjislacioni Osman dhe për këtë nuk mund të ndryshohej, aq më tepër që popullsia shqiptare ishte e pranishme me një përqindje më të lartë në territorin greke në krahasim me kombësitë e tjera.⁵⁶³

Për Ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, "*...vonesa e zgjidhjes së çështjes*

⁵⁶⁰ Naska 1999: 618, dok. 317.

⁵⁶¹ Naska 1999: 621, dok. 319.

⁵⁶² Ibidem: 618, dok. 317.

⁵⁶³ Ibidem: 623, dok. 320.

(së pronave) dhe estimacioni i ulët i pronjave shqiptare, kanë dëmtuar aq shumë shqiptarët, sa që, mund të thuhet, edhe sikur t'u paguheshin në flori e në vleftën e tyre të sotme, nuk do të shihnin profitra të mbëdha, mbasi, në disa raste, borxhet e shumta që shqiptarët kanë vënë për mbrojtjen e interesave të tyre në Greqi edhe për sigurimin e jetesës së fëmijëve të tyre, kalojnë një pikë të madhe sumat që këta kanë të drejtë të marrin, si çpërblim për pronjat që u janë çpronjësuar, nga arka e shtetit grek".⁵⁶⁴

Delegacioni shqiptar në Greqi, i cili duhet të trajtonte çështjen e likuidimit të pronave me palën greke, shkoi në Athinë duke firmosur një akt noterial së bashku me pronarët e interesuar në të cilin deklarorin se i pranorin ligjet Greke.⁵⁶⁵ Sipas prefektit të Shkodrës, anëtar të këtij delegacioni, ankesat e pronarëve shqiptarë nuk ishin të tepruara, pasi ata duhet të qëndronin në Athinë të paktën tre ose katër muaj në mënyrë që të merrnin dëmshpërbilimin që ishte caktuar për ta. Gjithashtu, buxheti që vendoste shteti për dëmshpërblimin e pronarëve nuk ishte i mjaftueshëm, duke e rënduar më tej edhe gjendjen e shqiptarëve që zotëronin prona në Greqi.⁵⁶⁶

Në vitin 1932, çështja e kombësisë u lehtësua më tej. Kjo konsistonte në shkurtimin e procedurave të marrjes së certifikatës së kombësisë (etablis).⁵⁶⁷ Megjithatë, procedurat nuk vijuan siç ishin pritshmëritë, dhe deri në gjysmën e parë të vitit 1933, vetëm disa çështje pronësore ishin zgjidhur.⁵⁶⁸ Pas kësaj periudhe, negociatat e reja midis Greqisë dhe Shqipërisë

⁵⁶⁴ Ibidem: 622.

⁵⁶⁵ Naska 1999: 625, dok. 321.

⁵⁶⁶ Ibidem.

⁵⁶⁷ Manda 2015: 77.

⁵⁶⁸ Ibidem: 78.

sollën një rezultat më të mirë në lidhje me kompensimet, dhe në vitin 1935 raportohet se një numër më i madh çështjeve pronësore gjetën zgjidhje.⁵⁶⁹ Përveç përpjekjeve dhe deklaratave në mbështetje të shqiptarëve në Greqi, situata e çamëve mbeti thuajse e pandryshuar edhe për shkak të ndryshimit të qeverive.⁵⁷⁰ Atyre iu kërkohej të tregonin çertifikatat e jo-shkëmbyeshmërisë [etablis] të paktën deri në vitin 1937.⁵⁷¹ Pas vitit 1935, masat shtrënguese në Epir e Çamëri, ishin të justifikuara edhe prej ligjit nr. 376 të vitit 1936 "Për masat shtrënguese të zonave të fortifikuara".⁵⁷²

Në një peticion të muajit Gusht 1937, që çamët i dërguan kryeministrit Metaksa, ata theksonin, ndër të tjera, disa çështje pronësore ende të pazgjidhura, pavarësisht nismave të mëparshme ligjore, ku përfshihej dhe mungesa e kompensimit pavarësisht se ai paracaktohej në një vlerë më të vogël sesa vlera reale e pronave.⁵⁷³ Nga ana e saj, qeveria greke arriti të zgjidhte vetëm çështjen e shkëmbyeshmërisë, ndërsa për të tjerat deklaroi se do t'i merrte në shqyrtim.⁵⁷⁴ Sipas studiueses Manda, trajtimi i çamëve ishte relativisht më i butë në krahasim me minoritetet e tjera, për shkak të parimit të reciprocitetit që lidhej me praninë e minoritetit Grek në Shqipëri, i cili do të mund të vuante pasojat e ndëshkueshmërisë së minoritetit Shqiptar në Greqi.⁵⁷⁵

Mirëpo, vlen të përmendet që qeveria shqiptare të vetmen masë ndëshkuese që ndërmorri ndaj minoritetit grek në Shqipëri lidhej me mbylljen e shkollave private të cilat u rihapën në vijim të ndërhyrjes së Lidhjes së Kombeve. Ndërsa, çamëve po në këtë periudhë

⁵⁶⁹ Ibidem.

⁵⁷⁰ Ibidem: 77-78.

⁵⁷¹ Ibidem: 79.

⁵⁷² Tsitselikis 2012: 310; Manda 2015: 86-87.

⁵⁷³ Naska 1999: 687, 688, dok. 362.

⁵⁷⁴ Ibidem.

⁵⁷⁵ Manda 2015: 91.

ku disa trajta të çështjes së të drejtave të tyre duken disi më të zbutura si premtimi i qeverisë Greke për marrjen në shqyrtim të çështjes së të drejtave të tyre, vlen të theksohet dhe fakti që gjatë regjimit autoritar të Metaksait, në Çamëri u ndalua gjuha shqipe me anë të një qarkoreje të Prefektit të Gumenicës, Antonaqeja, dhe ata të cilët nuk e zbatonin këtë urdhër ndëshkoheshin me forma nga më të egrat.⁵⁷⁶ Më vonë në vitin 1937, qeveria Greke implementoi një ligj të ri për pronat e Shqiptarëve. Ky ligj synonte lehtësimin e kushteve të tyre.⁵⁷⁷

Këshilli i Nënshetësisë, i cili ndodhej në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Greqisë, zëvendësoi rolin e Komisionit Mikst, mandati i të cilit kishte përfunduar më 1934. Ky Këshill do të vendoste më tej mbi kombësinë e atyre individëve të cilët aplikonin për rimarrjen e pronës së konfiskuar nga shteti ose Banka Kombëtare e Greqisë.⁵⁷⁸ Ky ligj garantonte një lehtësim të mëtijshëm të procedurave. Shqiptarët mund të dëshmonin që ishin ata pronarët e tokave të caktuara qoftë dhe me anë të dëshmitarëve.⁵⁷⁹ Megjithatë, kompensimi i premtuar nga këto akte ligjore, në shumicën e rasteve nuk u aplikua, duke i bërë këto dispozita të ekzistonin vetëm në formë të shkruar.⁵⁸⁰

Në vitin 1935, qeveria Greke deklaronte se Komanda e Përgjithshme e Epirit kishte një marrëveshje me Ministrinë e Bujqësisë për përshpejtimin e procedurave të pagesës për çështjet të cilat nuk ishin zgjidhur ende.⁵⁸¹ Ata e konsideronin këtë çështje të mbyllur pas

⁵⁷⁶ AMPJ, Dosja 134, Viti 1946, f. 35, 36. *Musa Demi në Emër të Komitetit Antifashist Çam i dërgon një Memorandum Asamblesë së Kombeve të Bashkuara në Londër.* (11 Janar 1946).

⁵⁷⁷ Fletorja Zyrtare e Greqisë. Ligji nr. 735. (15 Qershor 1937).

⁵⁷⁸ Ibidem.

⁵⁷⁹ Ibidem.

⁵⁸⁰ Tsitselikis 2012: 310.

⁵⁸¹ Lidhja e Kombeve, C.349.1935.I.

përgjigjes së dërguar ndaj një peticioni të çamëve në Lidhjen e Kombeve⁵⁸², përtej faktit që vonesat në pagesa ishin një model i qëndrueshëm i këtyre procedurave edhe në vitet që vijuan pas kësaj deklarate. Për më tepër, duke iu referuar të dhënave të sipërpërmendura (deklaratës pranë Lidhjes së Kombeve), shume çështje pronësie nuk ishin zgjidhur ende. Përtej masave ligjore, çamët hasnin probleme të shumta në gëzimin e të drejtave që u përkisnin, dhe për këtë arsye shumë prej tyre zgjodhën të emigronin.

5.4 Propaganda për Emigrimin e Çamëve.

Deri në vitet '30, të gjitha shkeljet e të drejtave themelore të popullsisë çame nga autoritetet greke mesa u vu re nuk kishin qenë të mjaftueshme për homogjenizimin dhe helenizimin e plotë të Çamërisë. Popullsia së zvogëluar të krahinës si pasojë e dhunës që mbi njëzetëvjeçare, i shtohet tanimë edhe një propagandë konstante e cila kishte për qëllim largimin e plotë të elementit të pa asimilueshëm nga kjo krahinë, në mënyrë që qëllimet e Greqisë të merrnin formë të plotë.

Kjo propagandë për largimin e vazhdueshëm të çamëve nga vendi i tyre, mori një hov të theksuar në pjesën e dytë të viteve '30, e sidomos gjatë viteve 1938-1939. Në këtë kontekst, kjo politikë e spastrimit etnik kishte të bënte me keqinformimin që iu bëhej atyre duke iu thënë se në Turqi do të gjenin kushte më të mira jetese. Nga ana tjetër, dilnin në pah lehtësirat që qeveria Greke i bënte elementit grek e ortodoks për marrjen e huave bankare në mënyrë që të blinin tokat e çamëve të cilët kishin vendosur të emigronin. Përfaqësuesit politikë shqiptarë bënë të gjitha përpjekjet e mundshme për ndalimin e kësaj propagande, duke

⁵⁸² Ibidem.

deklaruar në rast se nuk do të mund ta ndalonin atë, të paktën shqiptarët e Greqisë të mund të sistemoheshin në Shqipëri.⁵⁸³

Në vitet 1934 dhe 1935, mendimi për largimin e myslimanëve ishte i konsoliduar tek njerëzit me ndikim të krahinës së Epirit.⁵⁸⁴ Ata kërkonin me ngulm largimin e myslimanëve, dhe popullimin e zonës me banorë të krishterë.⁵⁸⁵ Këto pikëpamje nuk kishin ndryshime thelbësore në krahasim me deklaratat e paraqitura në përfundimet e nënkomisioneve të Selanikut (1923) të ngritura për përcaktimin e origjinës shqiptare të banorëve të kësaj krahine.⁵⁸⁶ Në to thuhej gjithashtu se këta banorë “armiq” përbënin rrezik për shtetin grek për shkak të afërsisë me Shqipërinë.⁵⁸⁷

Përveç politikave të tjera të zbatuara në Çamëri gjatë vitete 1913-1939, burimet arkivore greke tregojnë se të paktën në harkun kohor 1923-1935, mendimi i përgjithshëm grek e shihte shpërnguljen e çamëve si një domosdoshmëri e cila do të ndihmonte në arritjen e synimeve të politikës së këtij shteti, e thënë me fjalë të tjera, Greqia zbatoi çdo metodë në funksion të qëllimeve të saj, duke i mohuar në mënyrë sistematike kësaj popullsie çdo të drejtë themelore në kundërshtim me parimet që mbarte kuadri ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar i kohës për këto të drejta.

Më 9 Gusht 1933, konsulli shqiptar në Janinë njoftonte Ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë mbi një denoncim të bërë nga Bejas Braho nga fshati Gardhiq. *Sipas tij,*

⁵⁸³ Qeveria Shqiptare hartoi një sërë platformash për vendosjen e çamëve në Shqipëri, ndonëse të tilla politika shpesh here nuk u zbatuan mbi të gjitha për shkak të vështirësive financiare të shtetit shqiptar. Shih për shembull: *Dekreti i Qeverisë Shqiptare 2 Shtator 1931*. Marrë nga Naska 1999: 614-617.

⁵⁸⁴ Shih AYE, A/21/I 1935, cituar në Kretsi 2005: 61.

⁵⁸⁵ Ibidem.

⁵⁸⁶ Për më tepër shih: IAYE. Lidhja e Kombeve /1923/11/3/1/1/ Perridhis, K., Miliotis, I, Meksis, D. *Pros to S'on Ipurjion ton Ekzoterikon*. [Për Ministrinë e Punëve të Jashtme]. (9 Dhjetor 1923).

⁵⁸⁷ Ibidem.

*autoritetet greke i persekutonin shqiptarët në mënyrë që këta të shihnin si të vetmen rrugëzgjdhje largimin prej shtëpive të tyre, në të cilat, duke u bazuar në mbështetjen e autoriteteve vendore greke, do të vendoseshin të krishterët e fshatrave përreth.*⁵⁸⁸ Nga 200 familje shqiptare, në fshat kishin mbetur vetëm 80 të tilla, pasi ato kishin zgjedhur të shpërnguleshin drejt Turqisë ose Shqipërisë. Sipas kësaj dëshmie, post-komandanti i Karbunarës ushtronte trysni mbi familjet e mbetur duke i kanosur në mënyrë që të largoheshin.⁵⁸⁹

Në prill të vitit 1938, drejtori politik pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë i kërkoi prefektit të Gumenicës që ta informonte atë mbi propagandën e ushtruar në Çamëri.⁵⁹⁰ Disa kohë përpara kësaj nisme, konsulli shqiptar në Janinë kishte denoncuar prefektin e Gumenicës si pjesëmarrës në këto masa të spastrimit etnik të popullsisë.⁵⁹¹ Kjo akuzë u mohua prej tij në një korrespondencë me drejtorin politik të Ministrisë së Jashtme Greke. Prefekti deklaroi se propaganda nuk ishte nisur prej autoriteteve vendore, por prej disa çamëve.⁵⁹² E megjithatë, sipas tij çamët nuk e kishin marrë në konsideratë një propagandë të tillë. Në vijim, në Mars të vitit 1938, konsulli shqiptar Hulusi, deklaroi se disa prona të çamëve ishin blerë nga përkrahësit e politikës greke, në kohën kur këta çamë po largoheshin drejt emigrimit.⁵⁹³ Përfaqësuesi grek e siguroi përfaqësuesin shqiptar se qeveria e tij i kishte dërguar disa direktiva autoriteteve vendore me qëllim që të përjashtoheshin çamët nga të tilla situata.⁵⁹⁴

⁵⁸⁸ Naska 1999: 637, dok. 328.

⁵⁸⁹ Ibidem.

⁵⁹⁰ Ibidem: 701, 702, dok. 376.

⁵⁹¹ Ibidem: 700, 701, dok. 375.

⁵⁹² Ibidem.

⁵⁹³ AQSH, Fondi 251, Dosja 106, Viti 1938, f. 30. *Përgjigje për Maksut Hulusin*. (4 Prill 1938).

⁵⁹⁴ Ibidem.

Më tej, Ministri i Çështjeve të Brendshme të Shqipërisë informonte Ministrin e Punëve të Jashtme mbi faktin se pronat e çamëve po bleheshin nga grekët, bazuar në huatë që iu jepeshin prej Bankës Bujqësore, në një kohë, kur emigrimi i çamëve për në Turqi po arrihej me çdo mjet.⁵⁹⁵ I ngarkuari me punë i Shqipërisë në Athinë, deklaroi se çamët ishin të detyruar të largoheshin për shkak të shtrëngimeve që iu bëheshin në Greqi, sidomos prej autoriteteve vendore.⁵⁹⁶

Në vitin 1938, përfaqësuesi i ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë siguroi të ngarkuarin me punë të Shqipërisë në Athinë, se ata e kundërshtonin emigrimin e çamëve. Për këtë ai deklaronte se Banka e Bujqësisë kishte anuluar 19 kontrata që çamët kishin kryer me palë të tjera për shitjen e pronave të tyre.⁵⁹⁷ Në këtë takim, përfaqësuesi shqiptar pati mundësinë të denonconte disa fakte që po vështirësonin jetesën e çamëve në pronat e tyre. Ai denoncoi autoritetet vendore si prefekti i Gumenicës gjithashtu dhe gjykatësin e Pargës, të cilët sipas tij vepronin me qëllimin e vetëm se po përpiqeshin të tregonin një performancë të mirë në punën e tyre.⁵⁹⁸ Megjithatë edhe ky takim u mbyll me deklaratën se qeveria greke do të ndërmernte masat e nevojshme në mënyrë që të përmirësonte kushtet e çamëve.

Në vitin 1936, konsulli shqiptar në Janinë deklaroi se të gjitha direktivat që qeveria greke i dërgonte autoriteteve vendase nuk respektoheshin. Duke konsideruar që direktiva dërgoheshin edhe pas kësaj periudhe [1936], mund të dalim në përfundimin se qeverisë greke i interesonte vetëm mbajtja e një qëndrimi sipërfaqësor si mbrojtëse e të drejtave themelore të minoriteteve, pasi çamët nuk mund të gëzonin as të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre

⁵⁹⁵ Naska 1999: 702, dok. 377.

⁵⁹⁶ Ibidem.

⁵⁹⁷ Ibidem: 714, dok. 389.

⁵⁹⁸ Naska 1999: 715, dok. 389.

në hapësirat publike gjatë kësaj kohë. Një qëndrim i tillë është tregues i qartë i faktit se qeveria greke vazhdonte në mënyrë të pandërprerë politikat e spastrimit etnik ndaj popullsisë çame.

Kreu VI: Qeveria Shqiptare dhe Lidhja e Kombeve për Çështjen Çame

6.1 Roli i Qeverisë Shqiptare

Angazhimi i shtetit Shqiptar për Çështjen Çame ndahet në dy etapa gjatë harkut kohor 1913-1939. Kufiri ndarës midis tyre është data e antarësimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Në periudhën e dytë, sidomos duke nisur që prej gjysmës së dytë të viteve '20, dallohet një numër peticionesh të dërguar nga vetë përfaqësuesit çamë, krahas peticioneve të qeverisë shqiptare. Në këtë periudhë disa vjeçare shteti shqiptar ishte i prapambetur ekonomikisht, e si pasojë kishte një paqëndrueshmëri të dukshme politike. Kërkesat e Shqipërisë për ndihmë financiare nga Lidhja e Kombeve nuk u pranuan asnjëherë. Gjendja e shtetit shqiptar gjatë harkut kohor 1913-1939, u pasqyrua edhe në rezultatet e arrira për Çështjen Çame. Përtej korrespondencës diplomatike, e shkresave të tjera zyrtare në të cilat kërkohej vënia në vend e të drejtave të mohuara të kësaj popullsie, shteti shqiptar nuk arriti të konkretizonte asnjë qëndrim të paralajmëruar prej tij, siç ishte dhe vetë zbatimi i parimit të reciprocitetit. Megjithatë, këto komunikime zyrtare vlejnë të përmenden pasi vunë në dijeni aktorët kryesorë politikë të kohës, ndonëse nga ana tjetër qëndrimet e shumë prej tyre kishin të bënin thjesht me dhënien e disa deklaratave, dhe në ato raste kur këto të fundit ishin në mbështetje të çamëve, në terren nuk konkretizohej as një qëndrim i shprehur.

Angazhimi kryesor i qeverisë shqiptare dhe i përfaqësuesve të saj u zhvillua me aktorët politikë të Greqisë dhe të Fuqive të Mëdha. Aktorët politikë si diplomatët shqiptarë në Greqi, përfaqësuesit e Legatës Shqiptare në Athinë, ashtu sikurse edhe konsujt e tjerë në këtë vend, së bashku me përfaqësuesit e Legatave Shqiptare pranë kancelarive perëndimore bënë përpjekje të shumta në mbrojtje të Çështjes Çame. Interesimi i dukshëm i përfaqësuesve

shqiptarë në mbrojtje të kësaj çështje u vu re edhe pranë Lidhjes së Kombeve, me anë të peticioneve të ndryshme, të cilat bënë të mundur që çështja të trajtohej edhe gjatë punimeve të Këshillit herë pas here. Por, fatet e çështjes çame nuk arritën të ndryshoheshin vetëm me anë të deklaratave e peticioneve. Qëndrimi i politikës shqiptare ndoqi vetëm këtë bosht të pamjaftueshëm, ndonëse të tilla përpjekje nuk rreshtën, për zgjidhjen e problemeve që po hasnin shqiptarët nën juridiksionin grek (që prej vitit 1913).

Në seancën parlamentare të kërkuar nga Eshref Frashëri (18 Dhjetor 1922), kryetari i Këshillit Kombëtar, për përcaktimin e politikave që do të ndiqeshin në mbrojtje të çështjes çame, Ali Këlcyra pranoi se për interesin shtetëror politikanët shqiptarë ishin përpjekur të mbanin marrëdhënie miqësore me vendet fqinje ashtu sikurse dhe me Greqinë, pavarësisht vuajtjeve që i ishin shkaktuar popullit të tyre ndër vite në trojet e pushtuara prej autoriteteve të këtyre shteteve. Në fjalën e tij thuhej:

"Mjerisht këto kohët e fundit, despotizma dhe keqpërdorja e autoriteteve greke drejt vllazërve t'ënë kanë arritur në një të tillë shkallë, që si do që të jenë principet t'ona e interesat e Shtetit, ndjenjat njerzore ma tepër se patriotike, na shtrëngojnë e na detyrojnë të mos mbyllim veshët përpara këtij zërit të tmeruar, i mijërave vëllezërve t'ënë, të cilët vuajnë nën thundrën e pushtimit të huej e na lypin ndihmën morale. Këjo Zotërinj e përsritë prapë nuk ka asnjë qëllim irredentist po vetëm një ndije njerëzore e cila na shtrëngon të bëjmë të ndigjohet

*në botën e qytetruar lëngimet e atyne që zëri nuk u dëgjonet, nga pangja e robëris."*⁵⁹⁹

Ai vijonte duke përmendur faktin se si Shqipëria ashtu edhe Greqia ishin antare të Lidhjes së Kombeve, dhe si të tilla ishin zotuar përpara kësaj organizate për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve (çka përfshin më parë dhe mbrojtjen e të Drejtave Themelore të Njeriut).⁶⁰⁰ Pas diskutimeve të ndryshme, në përfundim të mbledhjes nuk u pa e arsyeshme që qeveria Shqiptare të komunikonte drejpërsëdrejti me qeverinë greke. Myderizi deklaroi në këtë takim se: "... në Athinë asht gjithnji në fuqi një Qeveri revolucionare e cila asht tue vra e tue pre...", e duke qënë se edhe Parlamenti grek ishte shpërbërë për shkak të luftës, qeveria shqiptare nuk mund të vendoste të tilla kontakte.⁶⁰¹ Në këtë takim u vendos që qeveria të njoftonte përfaqësuesin e saj në Konferencën e Lozanës që të interesohej për të drejtat e popullsisë çame, e gjithashtu, të dërgoheshin telegrame tek parlamentet e vendeve të tjera për t'i njoftuar mbi situatën e krijuar.⁶⁰² Vlen të theksohet se e ardhmja e Shqipërisë gjatë kësaj periudhe u vendos në bazë të interesave gjeopolitikë e strategjikë të Fuqive të Mëdha e të vendeve fqinje të saj. Për këtë arsye, informimi i përfaqësuesve të këtyre vendeve u gjykua me rëndësi nga mbledhja e Këshillit Kombëtar (1922).

Në dhjetëvjeçarin e parë pas aneksimit të Çamërisë, kërkesat e politikanëve shqiptarë kishin të bënin kryesisht me peticione të karakterit të përgjithshëm. Ndërsa pas vitit 1919, në Konferencën e Paqes në Paris, e më tej që prej vitit 1923, me fillimin e shkëmbimit zyrtar të

⁵⁹⁹ AQSH, Fondi 246, Dosja 84, Viti 1922, f. 102. *Këshilli Kombëtar, Mbledhja e 98-të*. (18 Dhjetor 1922)

⁶⁰⁰ Ibidem.

⁶⁰¹ Ibidem: 107.

⁶⁰² Ibidem: 106-107.

popullsive greko-turke, në të cilin u përfshinë dhe çamët, përfaqësuesit e shtetit shqiptar u treguan më konkretë në petitionet e tyre. Në to, ata kërkonin të vendosnin në vend të drejtat e munguara ndaj kësaj popullsie, dhe mbi të gjitha përfshirjen e krahinave me popullsi kompakte shqiptare, si Çamëria dhe Kosova, nën kufijtë zyrtarë të Shqipërisë.

Në muajin Janar të vitit 1913, në një kohë kur Greqia kishte pushtuar disa territore të Çamërisë, përfaqësuesit e qeverisë së Vlorës, Rasih Dino, Mehmet Konica dhe Filip Noga iu drejtuan Eduard Grejit, kryetarit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Në këtë memorandum, pala shqiptare paraqiti kërkesën për njohjen e shtetit shqiptar nën kufijtë e tij natyralë nga kufiri ekzistues i Mbretërisë Malazeze, duke vijuar me qendrat kryesore të Shqipërisë si qytetet e Pejës, Mitrovicës, Prishtinës, Shkupit, Manastirit, Meçovës, e deri në Prevezë. Për këtë ata kërkuan vendosjen e një komisioni mikst i cili do të vepronte në mënyrë neutrale, *pa dëmtuar interesat e asnjë kombi tjetër pasi popullsia që dominonte në këto krahina ishte në pjesën dërrmuese shqiptare*. Caktimin e kufijve zyrtarë të Shqipërisë duke u bazuar në kufijtë etnikë të saj, përfaqësuesit shqiptarë e shihnin si një element të domosdoshëm për të ruajtur paqen në rajonin ballkanik.⁶⁰³ Kjo pikëpamje u shpreh edhe në vijim nga aktorë të tjerë në mbrojtje të kauzës shqiptare, por ishte një kërkesë e papërfillshme kundrejt interesave gjeostrategjike të fqinjëve të Shqipërisë. Në shtojcën e këtij memorandum, përfaqësuesit shqiptarë dërguan disa statistika në mbështetje të kërkesave të tyre. Ata deklarorin se popullsia e territoreve të kërkuara prej tyre ishte krejtësisht shqiptare me përjashtimin e disa zonave të caktuara ku prania e popullsive të tjera ishte sidoqoftë e

⁶⁰³ AQSH, Fondi 245, Dosja 11-19, Viti 1913, f. 31-34. *Memorandum i Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës Drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Londër*. (2 Janar 1913)

papërfillshme. Sipas këtij dokumenti, në Çamëri kishte një popullsi prej 75,000 shqiptarësh, ndër të cilët 18,000 ishin të greqizuar, çka mund të nënkuptojë se i përkisnin fesë ortodokse.⁶⁰⁴

Në fund të Qershorit 1913, Qeveria e Përkohshme dërgoi në Romë një delegacion për të paraqitur kërkesën e saj për një nga krahinat Shqiptare e cila ishte e pushtuar nga ushtria greke gjatë kësaj periudhe, Çamërinë. Një nga antarët e delegacionit, ra në gjunjë përpara diplomatit italian, Skalea, duke iu lutur atij që të shpëtonte këtë krahinë.⁶⁰⁵ Sipas Eqerem Bej Vlorës, kjo krahinë ishte tërësisht shqiptare. Ajo kishte 94,000 banorë shqiptarë, ndër të cilët 50,000 banorë ishin myslimanë, dhe 14,000 ishin ortodoksë dhe "nuk kishte asnjë banor grek".⁶⁰⁶

Në 27 Shkurt 1916, Komiteti Shqiptar i Lozanës iu drejtua Presidentit Uilson, duke i paraqitur atij gjendjen e përgjithshme të vuajtjeve të shqiptarëve si pasojë e synimeve ekspansioniste të vendeve fqinje të Shqipërisë.⁶⁰⁷ Kontaktet e shqiptarëve me Presidentin Uilson qenë të shumta sidomos përpara e gjatë punimeve të Kongresit të Parisit më 1919, por pritshmëritë e palës shqiptare nuk u arritën prej tyre.⁶⁰⁸

Në 12 Nëntor 1917, Mihal Turtulli, iu drejtua konsullit Lamb, duke i kërkuar atij një mbështetje nga ana e britanikëve për çështjen shqiptare. Sipas Turtullit, në Çamëri banonin

⁶⁰⁴ AQSH, Fondi 245, Dosja 11-19, Viti 1913, f. 11-14. *Shtojcë e Memorandumit të Paraqitur më 2 Janar 1913 nga Delegatët Shqiptarë në Konferencën e Ambasadorëve*. (25 janar 1913).

⁶⁰⁵ Bej Vlora 2010: 325.

⁶⁰⁶ Ibidem: 325.

⁶⁰⁷ Për shkak të trazirave në nivel botëror e rajonal, shtetet fqinje të Shqipërisë vijonin të mësynin ushtarakisht në brendësi të territorit të saj.

⁶⁰⁸ AQSH, Fondi 251, Dosja 3, Viti 1915, f. 1. *Rezoluta kërkon mbështetjen e Qeverisë Amerikane për Mbrojtjen e Shqipërisë nga Copëtimi i Mëtejshëm i Trojeve të Saj prej Serbisë, Malit të Zi, e Greqisë*. (7 nëntor 1915)

përafërisht 80,000 shqiptarë, ndërsa grekët përbënin një pakicë të vogël.⁶⁰⁹ Në një informacion të ngjashëm që Turtulli i dërgoi ambasadorit të nderit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Paris, kolonel House-it, ai theksonte përsëri përbërjen demografike thuajse tërësisht shqiptare të krahinave që vendi i tij kërkonte të përfshinte nën kufijtë zyrtarë. Në këtë letër, Turtulli ndalet për të kundërshtuar deklaratat e pabazuara të shteteve fqinje të Shqipërisë, të cilat shprehnin besimin e tyre se shqiptarët nuk mund të formonin shtet.⁶¹⁰ Një qëndrim të tillë mbajti dhe Greqia gjatë punimeve të Konferencës së Parisit (1919), e cila ndonëse kishte aneksuar Çamërinë, synonte zgjerimin e saj territorial duke u justifikuar nën këtë deklaratë.⁶¹¹ Pavarësisht përpjekjeve të shqiptarëve në mbrojtje të kauzës së tyre, në terren nuk u arrit asnjë rezultat.

Megjithatë, Shqipëria i vendosi marrëdhëniet diplomatike me Greqinë në vitin 1923, duke caktuar si përfaqësuesin e saj Mithat Frashërin, i cili qëndroi në detyrë deri në vitin 1926. Frashëri ishte një ndër diplomatët shqiptarë më aktivë në mbrojtjen e të drejtave të çamëve .

Duke qenë se në fillim të shek. XX-të, rrethanat historike e justifikonin në një farë mënyre mungesën e gëzimit të të Drejtave Themelore edhe për banorët e Çamërisë, me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë e Greqisë, nuk mund të lejohej më tej shkelja e këtyre të drejtave. Megjithatë, Greqia ishte e vendosur në homogjenizimin e territorit, dhe përpjekjet shqiptare, ishin thuajse të gjitha pa sukses, pasi në terren gjendja nuk ndryshonte për çamët.

⁶⁰⁹ AQSH, Fondi 848, Dosja 6/1, Viti 1917, f. 108-118. *Në Letër theksohet se Kombi Shqiptar ka Besim te Populli Amerikan, i cili nuk do të Lejojë Copëtimin e Mëtejshëm të Trojeve Shqiptare nga Serbia dhe Greqia.* (1 Dhjetor 1917)

⁶¹⁰ Ibidem.

⁶¹¹ Venizelos 1919: 4.

Me përshkallëzimin e situatës pas zyrtarizimit të procesit të shkëmbimit të popullsisë greko turke, në 15 Maj 1923, Legata Shqiptare në Athinë njoftonte Tiranën zyrtare se përafërsisht 10,000 çamë kërkonin të shkonin në Turqi. Kërkesat e tyre ishin kryesisht nga Paramithia, dhe bëheshin me anën e myftiut të zonës. Sipas Ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, duhej përfshirë dhe shtypi në udhëzimet për ta ndaluar këtë emigracion. Ministri shqiptar ishte i bindur se me përpjekjet e tyre do të arrinin ta ndalonin këtë proces.⁶¹² Rreth një vit më vonë, Zyra shqiptare e shtypit dërgoi një informacion drejt agjensive të huaja homologe, si Reuters, Temps, Quotidien, Havas etj për të denoncuar gjendjen e rënduar të shqiptarëve në Greqi, duke përmendur gjithashtu dhe masat që autoritetet greke kishin marrë ndaj çamëve, duke i detyruar të braktisnin trojet e tyre, si pasojë e trysnisë dhe dhunës së pandalur që ushtrohej vazhdimisht mbi ta.⁶¹³ Për më tepër, Zyra e Shtypit deklaronte se Lidhja e Kombeve ishte në dijeni të kësaj situatë.⁶¹⁴

Në 7 Korrik 1923, Mithat Frashëri shkruante se në një letër kanosëse që i kishte paraqitur kryeministrit të Greqisë për zhvillimet në Çamëri, ky i fundit, bazuar në përgjigjen e prefektit të Prevezës, i ishte përgjigjur se të tilla letra hartoheshin nga vetë çamët.⁶¹⁵ Ky qëndrim u shërbente atyre për t'u shfajësuar nga veprimet ose mosveprimet e tyre, të cilat pasqyroheshin qartësisht në terren, pra në dhunën dhe mohimet sistematike ndaj çamëve.

Një nga mundësitë e qeverisë shqiptare për të ndaluar emigrimin çam drejt Turqisë ishte komunikimi zyrtar me autoritetet turke. Duke mos gjetur një zgjidhje pranë qeverisë

⁶¹² AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 38. *Njoftim për Ndërhyrjen pranë Përfaqësuesit në Angorë që të Këshillohet Popullsia Çame për të mos u Larguar nga Trojet e saj.* (15 maj 1923).

⁶¹³ AQSH, Fondi 251, Dosja 80, Viti 1924, f. 84. *Përfshijnë në Këmbim Popullsinë Shqiptare të Çamërisë.* (25 Korrik 1924)

⁶¹⁴ Ibidem.

⁶¹⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 88. *Informacion për Politikën e Qeverisë Greke për Shpërnguljen e Çamëve si dhe Domosdoshmëria për një Ankesë në Lidhjen e Kombeve.* (7 korrik 1923)

greke, Noli (1924) iu drejtua Fetih Beut, kryetarit të Këshillit të Republikës Turke në Ankara duke i kërkuar atij që delegati turk pranë Lidhjes së Kombeve të shprehte qartë qëndrimin për mospranimin e shqiptarëve të Greqisë në shkëmbim nga ana e shtetit turk.⁶¹⁶

Më 17 Tetor 1925, Pangalos i shprehu Frashërit mbështetjen e tij për mirëqënien e çamëve duke vënë njëkohësisht në dukje pakujdesinë e autoriteteve greke në trajtimin e papërshtatshëm të tyre.⁶¹⁷ Më 23 Janar 1926, Pangalos i deklaroi Colbain-it se do të jepte zgjidhjen përfundimtare për çështjen e çamëve, pasi nuk donte që të vazhdonte imazhi i keq për Greqinë në nivel ndërkombëtar.⁶¹⁸ Kjo deklaratë ishte rrallë në politikën greke, aq më tepër që Pangalos i konkretizoi premtimet e tij.

Në fund të vitit 1925, Shqipëria po vijonte të përballej me ardhjen e shqiptarëve myslimanë nga Turqia, të cilët pasi ishin përfshirë në procesin e shkëmbimit të popullsisë greko-turke, e panë të arsyeshme të shkonin drejt Shqipërisë, duke qenë se në Turqi nuk kishin gjetur kushtet të cilat iu ishin propaganduar nga elementët grekë në Greqi përpara nisjes së tyre. Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria, me anë të përfaqësuesit të saj pranë Lidhjes së Kombeve, kërkoi një hua prej tre milionë franga ari për të përballuar ardhjen e refugjatëve shqiptarë nga shteti Turk. Mirëpo, autoritetet e Lidhjes së Kombeve u përgjigjën se kjo situatë nuk mund të zgjidhej lehtësisht, pasi kërkonte procedura të gjata.⁶¹⁹ Në një kohë kur Greqisë i ishte akorduar një hua për vendosjen e refugjatëve, në vijim të Konventës së Lozanës për shkëmbimin e popullsisë, Shqipëria, e cila po vuante pasojat e këtij procesi e kishte më të

⁶¹⁶ AQSH, Fondi 251, Dosja 82, Viti 1924, f. 162. *Kërkesë për Qeverinë Turke që të mos i Pranojë pasi ata janë Shqiptarë.* (10 dhjetor 1924).

⁶¹⁷ Malltezi dhe Delvina 2012: 298-300, dok. 162.

⁶¹⁸ Divani 1995: 235.

⁶¹⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 131/2, Viti 1935, f. 1-2. *Raport për të Siguruar një Hua pranë Lidhjes së Kombeve në Mënyrë që të Vendosen Çamët në Shqipëri.* (Dhjetor 1925).

vështirë përballimin e situatës, pasi autoritetet ndërkombëtare nuk e morën në konsideratë gjendjen e Shqipërisë të ngjashme me gjendjen e Greqisë, duke deklaruar se dhe shtete të tjera po kërkonin hua nga Lidhja e Kombeve, por kjo nuk mund të akordohej me lehtësi.⁶²⁰

Shqipëria kishte hartuar politikat përkatëse për pritjen e emigrantëve çamë që kishin vendosur të shpërnguleshin drejt tokave të shtetit amë. Por, ajo haste vështirësi financiare në lidhje me zbatimin e politikave për vendosjen e tyre. Në një shkresë të datës 4 prill 1935, Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë njoftonte konsullatën shqiptare në Janinë në lidhje me vendimin e disa çamëve për t'u vendosur në Shqipëri. Në këtë shkresë deklarohet se çamët mund të shpërnguleshin menjëherë nëse ata i përballonin shpenzimet e rrugës. Në rast të kundërt, këtyre familjeve do t'u duhej të prisnin miratimin e buxhetit të ri, pasi fondi ekzistues ishte shpenzuar.⁶²¹

Më 31 Tetor 1927, Ministria e Punëve të Jashtme në Tiranë i dërgoi një memorandum Legatës Greke mbi çështjen e pronave të shqiptarëve në Greqi. Rreth katër vite pas fillimit zyrtar të shkëmbimit të popullsisë greko-turke, në të cilin u përfshinë edhe çamët ndonëse ishin shqiptarë, çështja e pronave për këta të fundit mbetej ende larg zgjidhjes përfundimtare dhe vendosjes në vend të të drejtave të munguara. Për këtë arsye, Ministria Shqiptare e Punëve të Jashtme i propozoi legatës greke në Tiranë një sërë masash të cilat përfshinin heqjen e pengesave ligjore për pronarët myslimanë, rikthimin e pronave të tyre të luajtshme dhe të paluajtshme, duke përfshirë dhe dëmshpërblimin e munguar, e aq më tepër në një kohë që Greqia kishte marrë një hua nga Lidhja e Kombeve për vendosjen e refugjatëve në vend. Këto

⁶²⁰ Ibidem.

⁶²¹ AQSH, Fondi 251, Dosja 187, Viti 1935, f. 7. *Njoftim për Familjet që kanë Shpenzimet e Udhëtimit mund të nisen Menjëherë për t'u vendosur në Lushnje.* (4 prill 1935)

masa shtrënguese ishin marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të vendit, ashtu siç ishte për pasuritë e luajtshme të çamëve të cilat ishin zaptuar nga persona të tjerë, si refugjatët, pa dëmshpërblimin e caktuar.⁶²²

Në 3 Janar të vitit 1928, qeveria shqiptare shpalli vendimin për të hyrë në negociata me qeverinë greke mbi çështjen e pronave të shqiptarëve (jo vetëm të pronave në Çamëri) në Greqi, me kryedelegat Milto Tutulanin dhe delegat Xhafer Vilën.⁶²³ Pavarësisht kësaj nisme, takimet e këtij delegacioni me autoritetet greke nuk qenë frytdhënëse.⁶²⁴ Sipas Fejzi Lepenicës, qeveria shqiptare ishte përpjekur për zgjedhjen e disa çështjeve pronësore në lidhje me disa çiflikë, por e kundërta kishte ndodhur me çamët.⁶²⁵

Megjithatë, një shtet nuk mund ta maste fuqinë e tij vetëm me anë të disa deklaratave. Për këtë arsye, as çështja çame nuk gjeti mbështetje konkrete tek shteti “amë”, pavarësisht përpjekjeve të shumta të cilat sidoqoftë mbetën thjesht të karakterit deklarativ.

6.2 Mobilizimi i Diplomacisë së Tiranës në Mbrojtje të të Drejtave të Popullsisë Çame

Duke parë përkeqësimin e situatës së çamëve në Greqi, qeveria shqiptare bëri disa deklaratat të herë pas hershme mbi mundësinë e zbatimit të masave reciproke ndaj minoritetit grek në Shqipëri. Pavarësisht numrit të lartë të deklaratave që synonin zbatimin e këtij qëllimi,

⁶²² AQSH, Fondi 251, Dosja 44, Viti 1927, f. 156-158. *Memorandum për Zgjidhjen e Çështjes së Pasurive të Shqiptarëve në Greqi*. (31 tetor 1927)

⁶²³ AQSH, Fondi 251, Dosja 44, Viti 1928, f. 173. *Vendim për të Hyrë në Bisedime me Qeverinë Greke lidhur me Pronat e Shqiptarëve në Greqi*. (3 janar 1928)

⁶²⁴ AQSH, Fondi 251, Dosja 40, Viti 1928, f. 32-36. *Raport për pasurive të Shqiptarëve, për Çamët, dhe për Dërgimin e një Delegacioni në Athinë*. (24 Janar 1928).

⁶²⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 40, Viti 1928, f. 20-31. *Pasqyrë e Hollësishme e Grabitjes së Pasurive në Çamëri dhe e Mohimit të të Drejtave Politike e Sociale të Çamëve*. (14 Janar 1928)

qeveria shqiptare ishte e butë në politikat e saj ndaj minoritetit grek, ndryshe nga ç'ndodhte me shqiptarët në Greqi.

Mundësia e zbatimit të këtij parimi u kërkua si nga aktorët politikë ndërkombëtarë ashtu dhe ata të medias së shkruar të kohës. Në 12 Dhjetor 1922, nënsekretari italian i Çështjeve të Jashtme, Vassallo, i drejtohej të ngarkuarit me punë të Italisë në Athinë, De Facendis, në mënyrë që t'i kërkonte qeverisë greke të ishte më e vëmendshme ndaj keqtrajtimeve që iu bëheshin çamëve, pasi nëse Shqipëria do të zbatonte reciprocitetin në marrëdhëniet dypalëshe, atëherë, Greqia do të dëmtohej nga kjo situatë.⁶²⁶ Gjendja e tensionuar e çamëve vijonte që prej aneksimit të krahinës. Në vitin 1920, në gazetën franceze "Le Rappel", raportohej shkurtimisht ky fakt, duke deklaruar se keqtrajtimet kryeshin ndaj popullsisë vendase prej bandave greke, aktiviteti i të cilave ishte rritur që prej vitit 1914.⁶²⁷

Në mbledhjen e 98-të të Këshillit Kombëtar Shqiptar, më datë 18 Dhjetor 1922, deputeti Ali Koprencka deklaroi se qeveria shqiptare e kishte për detyrë të zbatonte masa reciproke në mënyrë që të detyronte shtetin grek të respektonte të drejtat e minoritetit shqiptar që banonte në kufijtë e tij shtetërorë.⁶²⁸ Por, Shqipëria kishte lejuar hapjen e shkollave greke, si dhe integrimin e pjestarëve të këtij minoriteti në administratën vendore. Në këtë mbledhje zëvendës Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë shprehu qëndrimin e tij duke deklaruar se angazhimi për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve ishte marrë në Lidhjen e Kombeve, e jo në Greqi.⁶²⁹ Pas disa mbështetësve të mendimit të deputetit Koprencka për zbatimin e reciprocitetit, Këlcyra deklaroi se: *"...populli shqiptar duhet t'i apë me fakte shembull*

⁶²⁶ Moschati 1953: 152, dok. 22.

⁶²⁷ Le Rappel 1920, 19.04. (pa autor)

⁶²⁸ AQSH, Fondi 146, Dosja 84, Viti 1922, f. 105. *Këshilli Kombëtar, Mbledhja e 98-të*. (18 Dhjetor 1922)

⁶²⁹ Ibidem.

*qytetëniye atyne që quhen të qytetënuem e pretendojnë se populli shqiptar nuk asht i qytetënuem".*⁶³⁰

Një rol të rëndësishëm luajtën dhe diplomatët shqiptarë pranë kancelarive perëndimore. Në 19 Dhjetor 1922, Tefik Mborja, njoftonte Ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, mbi përpjekjet e tij pranë qeverisë italiane. Sipas përfaqësuesit shqiptar, qeveria italiane i kishte telegrafuar përfaqësuesit të saj në Athinë në mënyrë që të ndërhynte pranë qeverisë greke për ndalimin e masakrave ndaj çamëve pasi ato do të sillnin pasoja për shtetin në fjalë.⁶³¹ Diplomati shqiptar deklaroi se informacionet mbi masakrat greke ishin botuar në gazetën *Corriere d'Italia*, e gjithashtu ai kishte kërkuar dhe ndihmën e markezit Carlo Durazzo për të ndërhyrë pranë Musolinit.⁶³²

Më 7 Nëntor 1923, Ahmet Zogu, informonte legatat shqiptare në Romë, Paris e Londër, mbi mundësinë e zbatimit të parimit të reciprocitetit me Greqinë në rast se të drejtat e çamëve nuk respektoheshin.⁶³³ Por, asnjë nisëm konkrete nuk u vu në zbatim. Në vijim të telegramit të Ahmet Zogut drejtuar këtyre legatave, më 8 Nëntor 1923, Xhemil Dino, përfaqësues i Legatës Shqiptare në Paris i kërkoi z. Raymond Poincares, kryeministrit dhe njëkohësisht Ministrit të Punëve të Jashtme të Francës, mbështetjen e tij për t'i kërkuar qeverisë greke që të respektoheshin të drejtat e çamëve në vijim të Konventës së Lozanës (30 Janar 1923).⁶³⁴

⁶³⁰ Ibidem: 106.

⁶³¹ AQSH, Fondi 251, Dosja 102, Viti 1922, f. 322-323. *Letër për Trajtimin e Problemit Çam para Autoriteteve Politike të Romës, dhe për Veprimet e Tyre për Mbrojtjen e Kësaj Popullsie*. (19 dhjetor 1922)

⁶³² Ibidem.

⁶³³ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 342, 343. *Raport mbi Qëndrimet e Sekretarit të Lidhjes së Kombeve ndaj Problemit Çam*. (19 nëntor 1923).

⁶³⁴ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 316. *Kërkesë për Ndërhyrjen e Shkëlqesisë së tij pranë Qeverisë Greke për Zbatimin e Vendimit të Konferencës së Lozanës*. (8 nëntor 1923).

Ndërsa, më 30 Nëntor 1923, Xhemil Dino informonte Ministrin Shqiptar të Punëve të Jashtme se kishte deklaruar pranë autoriteteve franceze që qeveria shqiptare do të shihte mundësinë e aplikimit të parimit të reciprocitetit me Greqinë.⁶³⁵ Mirëpo, disa ditë më vonë, përfaqësuesi francez i deklaroi të ngarkuarit me punë të Shqipërisë në Paris, se ende nuk ishte bërë asnjë përpjekje për çështjen çame pasi përfaqësuesi britanik nuk kishte asnjë udhëzim nga qeveria e tij. Në këtë telegram, përfaqësuesi francez vinte në dijeni Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës se delegati turk i komisionit mikst kishte deklaruar se asnjë shqiptar nuk do të pranohej në shkëmbimin e popullsisë.⁶³⁶

Nëse reciprociteti midis dy vendeve do të ishte zbatuar në të njëjtën mënyrë me masat e ndërmarra për shqiptarët e Greqisë, ashtu sikurse dhe për ata të krahinës së Çamërisë, Greqia do të kishte qënë më e vëmendshme ndaj shqiptarëve. Këshilli i Ministrave shpalli një vendim më 29 Tetor 1923 në lidhje me këtë çështje, në mbrojtje të shqiptarëve të Çamërisë, duke u ndalur ndër të tjera edhe në mundësinë e shkëmbimit të çamëve me minoritetin grek në Shqipëri.⁶³⁷

Në 2 Nëntor 1923, Mithat Frashëri i tërhoqi vëmendjen ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë që të zbatohet parimi i reciprocitetit me Greqinë, duke parë që gjasat për largimin e çamëve nga trojet e tyre ishin të shumta. Ai ftoi përfaqësuesit shqiptarë të kryenin të njëjtat regjistrime të pasurive të minoritetit grek në Shqipëri, në rast se do të kishte një largim të çamëve, ata të vendoseshin në pronat e atij minoriteti e jo në Turqi.⁶³⁸

⁶³⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 315. *Raporti mbi Përçarjet e tij pranë Qeverisë Franceze për Mbrojtjen e Pakicës Shqiptare në Greqi*. (30 Nëntor 1923)

⁶³⁶ Naska 1999: 166, dok. 102.

⁶³⁷ Naska 1999: 140, dok. 85.

⁶³⁸ Ibidem: 142, dok. 87.

Në vijim të përpjekjeve të diplomatëve shqiptarë, Tefik Mborja, i ngarkuari me punë i Legatës Shqiptare në Romë, njoftoi mbi kërkesën që i kishte drejtuar përsëri qeverisë italiane për mbështetjen e saj në mënyrë që të zbatohet Konventa e Shkëmbimit (30 Janar 1923), duke përjashtuar elementin shqiptar, dhe në rast se kjo nuk do të arrihej atëherë qeveria italiane do ta mbështeste qeverinë shqiptare për zbatimin e reciprocitetit midis dy vendeve, duke shkëmbyer popullsinë greke në Shqipëri, me elementin shqiptar në Greqi.⁶³⁹

Mehmet Konica, ministri i Shqipërisë në Londër, informonte kryeministrin Ahmet Zogu mbi përpjekjet e tij pranë Foreign Office. Londra mbante një qëndim neutral ndaj Shqipërisë në këtë periudhë dhe për këtë arsye përfaqësuesit britanikë i ishin përgjigjur se Shqipëria si shtet i pavarur duhet t'i zgjidhte vetë çështjet e saj.⁶⁴⁰ Megjithatë, Lordi Robert Cecil i kontaktuar nga Konica i ishte përgjigjur se kjo çështje mund të zgjidhej vetëm pranë Lidhjes së Kombeve, dhe ai do të shfaqte qëndrimin e tij në mbrojtje të të drejtave të popullsisë çame në mbledhjen e datës 10 Dhjetor (1923).⁶⁴¹ Britania nuk mbajti një pozicion në mbështetje të shqiptarëve në Greqi. Në vitin 1929, diplomati britanik Jordan mendonte se Shqipëria po kërkonte të arrinte një shkëmbim midis çamëve dhe minoritetit grek në Shqipëri, në mënyrë që të mund të përfitonte nga tokat e pasura të tyre, në shkëmbim të tokave "të varfra të Çamërisë".⁶⁴²

⁶³⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 386.

⁶⁴⁰ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 339-342. *Letër mbi Përpjekjet për Rritjen e Interesimit të Parlamentit dhe të Personaliteteve Angleze për Mbrojtjen e Popullsisë Çame*. (20 nëntor 1923).

⁶⁴¹ Ibidem.; Për qëndrimin e Lordit Cecil ndaj Shqipërisë, dhe pikëpamjeve të tij në mbështetje të "Diplomacisë Liberale" shih: Gurakuqi 2007: 189, 190; Shih gjithashtu Stickney [1926] 1998: 220-223.

⁶⁴² Meta 2010: 91.

Blinishti iu drejtua Drumondit më 6 Dhjetor 1923 duke i bërë me dije situatën e vështirë në Çamëri, në të cilën, pavarësisht deklaratave të qeverisë greke, shkelja e të drejtave ishte një fenomen i zakonshëm.⁶⁴³

Me rastin e procedurave shtrënguese që nënkomisionet e Komisionit të Selanikut zbatonin gjatë regjistrimit të popullsisë çame në vitin 1923 (Shih Seksionin 4.2), qeveria shqiptare i kërkoi legatës së saj në Athinë, më 5 Janar 1924, që të konfirmonte vërtetësinë e këtij fakti, e nëse do të vërtetohej një gjendje e tillë, atëherë ajo "zotohej" për zbatimin e parimit të reciprocitetit ndaj minoritetit grek në Shqipëri.⁶⁴⁴

Në vijim të përpjekjeve të Konicës në Londër, qeveria Britanike shprehu interesin e saj për ndalimin e shkëmbimit të çamëve si turq, duke kërkuar paraprakisht konfirmimet përkatëse zyrtare pranë legatave të saj në Shqipëri e Greqi mbi anekesat që kishte paraqitur përfaqësuesi i Shqipërisë. Sapo të merrte këto konfirmime qeveria britanike do të kërkonte pranë qeverisë greke përjashtimin e shkëmbimit të shqiptarëve drejt Turqisë.⁶⁴⁵ Në këtë kontekst, gazeta britanike Westminster botoi një artikull mbi mundësinë e shkëmbimit të çamëve me minoritetin grek të shqipërisë.⁶⁴⁶ Autori i saj, gazetari Spender deklaronte se në rast se Shqipëria do të aplikonte parimin e reciprocitetit me Greqinë, duke shpërngulur 28000 shtetasit e saj të kombësisë greke, atëherë në ballkan do të përhapej "urrejtja racore" në një shkallë më të gjerë pas luftës së mundshme midis Greqisë e Shqipërisë.⁶⁴⁷

⁶⁴³ Naska 1999: 167, dok. 103.

⁶⁴⁴ Ibidem.

⁶⁴⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 81, Viti 1924, f. 61. *Letër për Interesimin e Qeverisë Britanike në Lidhje me Gjendjen e Shqiptarëve të Greqisë*. (21 Mars 1924)

⁶⁴⁶ AQSH, Fondi 251, Dosja 81, Viti 1924, f. 38, 39. *Njoftim për Parlamentin Anglez në Lidhje me Vendimin e Qeverisë Shqiptare për të Ndihmuar Shqiptarët e Greqisë*. (18 Mars 1924).

⁶⁴⁷ Destani dhe Elsie 2013: 74.

Nga ana tjetër, Xhemil Dino, njoftonte Tiranën zyrtare në fillim të muajit Prill 1924, mbi takimin e tij me z. Clinchant, ministër fuqiplotë dhe z. Bargeton, ekspert francez pranë Konferencës së Lozanës. Ai informonte ministrin shqiptar Vrioni mbi deklaratat jo zyrtare në mbështetje të kauzës shqiptare, dhe nga ana tjetër e vinte në dijeni mbi vështirësitë praktike të zgjidhjes së çështjes në rang ndërkombëtar, pasi *kancelaritë perëndimore nuk mund të ushtronin trysni mbi qeverinë e Athinës*.⁶⁴⁸ Sipas përfaqësuesit francez, nëse Greqia nuk do të arrinte një marrëveshje me Shqipërinë, atëherë kjo e fundit kishte të drejtë të vinte në zbatim parimin e reciprocitetit.⁶⁴⁹ Për më tepër, ministri francez e garantonte përfaqësuesin shqiptar se edhe nëse qeveria e tij do të mbante qëndrime konkrete ndaj Greqisë, Lidhja e Kombeve dhe Fuqitë e Mëdha do të mund ta shmangin një konflikt të mundshëm.⁶⁵⁰

Në takimin e radhës me Sekretarin e Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, Blinishti informoi Ministrin Shqiptar të Punëve të Jashtme mbi rëndësinë e ratifikimit të Traktatit të Lozanës (1923), pas të cilit do të vinte për pasojë dhe ratifikimi i Traktatit të Sevrës (1920) për Greqinë, me anë të të cilit shqiptarëve iu garantohej mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore.⁶⁵¹ Pavarësisht këtij fakti, Traktati i Sevrës për Minoritetet (1920), i cili kishte hyrë në fuqi në bazë të Protokollit XVI të Traktatit të Lozanës (1923), nuk mori asnjëherë vëmendjen e duhur nga qeveria greke.

Në një takim midis Blinishtit dhe zyrtarit të ngarkuar me çështjet balkanike pranë Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve, përfaqësuesit shqiptar iu tërhoq vëmendja se në rast se

⁶⁴⁸ AQSH, Fondi 251, Dosja 81, Viti 1924, f. 137, 138. *Raport mbi Qëndrimin e Qeverisë Franceze ndaj Myslimanëve Shqiptarë në Greqi*. (1 prill 1924)

⁶⁴⁹ Ibidem.

⁶⁵⁰ Ibidem.

⁶⁵¹ Naska 1999: 256, dok. 141.

Shqipëria do të zbatonte parimin e reciprocitetit me Greqinë, atëherë ajo duhet të përgjigjej përpara kësaj organizate në bazë të Traktatit të Minoriteteve (1920); nëse, Lidhjes së Kombeve do t'i duhej të trajtonte shpërnguljen e grekëve nga Shqipëria, në rast se do të zbatohet një nismë e tillë, vëmëndja nga situata e shqiptarëve në Greqi do të shkëputej.⁶⁵²

Më 22 Nëntor 1924, përfaqësuesi shqiptar i Legatës në Athinë deklaroi se Greqia e kishte përgjysmuar elementin shqiptar nën juridiksionin e saj, dhe për këtë kërkohet për të disatën herë zbatimi i parimit të reciprocitetit.⁶⁵³ Në këtë letër, sugjerohej që çamët të cilët ishin shpërngulur në Shqipëri, të mund të sistemoheshin në shtëpitë e minoritetit Grek në Shqipëri, në mënyrë që Greqia të rishqyrtonte pasojat që po i sillte kësaj popullsie nëse minoritetit të saj do t'i paraqiteshin për zbatim të njëjtat politika shtrënguese.⁶⁵⁴

Në një takim të zv. ministrit shqiptar në Athinë, Dhimitër Popa, me Colbain, drejtorin e seksionit të minoriteteve në Lidhjen e Kombeve, përfaqësuesi shqiptar i kujtoi këtij të fundit të drejtat që minoriteti grek gëzonte në Shqipëri, në një kohë që çamët, dhe shqiptarët e tjerë të Greqisë ndodheshin nën një tryzni të konsiderueshme për t'i bërë ata të largoheshin prej trojeve të tyre, përtej faktit që ata nën juridiksionin grek nuk gëzonin shumë prej të drejtave themelore të njeriut, e aq më pak të minoritetit.⁶⁵⁵ Në këtë takim, përfaqësuesi shqiptar raportoi se Colbain i përmendi atij trysninë që sipas tij, bazuar në ankesën e Politis pranë Lidhjes së Kombeve, po iu bëhej Himariotëve. Popa nuk ngurroi t'i bënte me dije drejtorit të seksionit të minoriteteve pranë Lidhjes së Kombeve se himariotët nuk ishin minoritet grek.⁶⁵⁶

⁶⁵² AQSH, Fondi 251, Dosja 82, Viti 1924, f. 47, 48. *Raport mbi Takimet me Personalitetet e Kualifikuara të Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve për Problemin Çam.* (8 gusht 1924)

⁶⁵³ AQSH, Fondi 251, Dosja 82, Viti 1924, f. 156-158. *Raport rreth Politikës së Shpërnguljes së Çamëve dhe Politikës që duhet të merren ndaj Minoritetit Grek.* (22 Nëntor 1924)

⁶⁵⁴ Ibidem.

⁶⁵⁵ Naska 1999: 385, dok. 203.

⁶⁵⁶ Ibidem.

Në takimin e radhës, që përfaqësuesi shqiptar pati me Colbain, ky i fundit deklaroi se çështja shqiptare do të shihej si një çështje midis Lidhjes së Kombeve dhe qeverisë Greke, pas ratifikimit të Traktatit të Sevrës (1920).⁶⁵⁷ Ai e shihte çështjen çame si të komplikuar, dhe gjithashtu shtoi se duhej të bënin një udhëtim në Çamëri për të parë nga afër gjendjen, mirëpo për këtë nuk i premtoi koha.⁶⁵⁸ Megjithatë, Colbain vijoi se autoritetet greke i kishin deklaruar se nuk ushtrohej trysni ndaj popullsisë çame, pasi këto masa ishin për të gjithë popullsinë greke, por ata e ndjenin më shumë edhe për shkak të ndryshimit fetar midis tyre dhe refugjatëve.⁶⁵⁹ Sipas përfaqësuesit shqiptar, drejtori i seksionit të minoriteteve pranë Shoqërisë së Kombeve mund të ishte ndikuar nga qarqet greke për qëndrimet e mbajtura gjatë takimit të tyre, pasi ai nuk u shpreh konkretisht në mbështetje të çështjes shqiptare.⁶⁶⁰

Pas përpjekjeve të shumta, drejtuar qeverisë së Shqipërisë, Mithat Frashëri u shpreh në letrën e tij të datës 29 Janar 1925 me fjalët: "*Nuk di në u aplikuan masa të atilla(në lidhje me reciprocitetin); po, sikur të ishin aplikuarë, sot, në vënt që të qaheshim ne, do të qahëshin Grekërit; dhe në vent që të bënja unë demarshe, do të bënte ministri i Greqisë*".⁶⁶¹ Në këtë letër, ai deklaroi se duke parë përpjekjet e shumta të bëra nga ndërhyrjet në Lidhjen e Kombeve, në Komisionin Mikst, disa zona si në Maqedoni, elementi shqiptar kishte marrë disa lehtësira, mirëpo në Çamëri, sipas Frashërit ende nuk ishin aplikuar këto politika si pasojë e masave shtrënguese që përfshinin të gjithë nënshtetasit grekë të fesë myslimane.⁶⁶²

⁶⁵⁷ Ibidem.

⁶⁵⁸ Ibidem.

⁶⁵⁹ Naska 1999: 387, dok. 204.

⁶⁶⁰ Ibidem.

⁶⁶¹ Malltezi dhe Delvina 2012: 209, 210, dok. 103.

⁶⁶² Ibidem.

Më 22 Janar 1926, Mithat Frashëri vuri në dukje qëndrimin e qeverisë shqiptare e cila kishte liruar nga burgu pesë himariotë në bazë të komunikimit dhe interesimit të ministrit grek Rufo, në një kohë kur 104 çamë ishin të burgosur pa arsye.⁶⁶³ Sipas tij, lirimi i himariotëve sipas kërkesës së autoriteteve greke mund të ishte përdorur si kusht për lirimin e çamëve të cilët siç deklaronte Frashëri mbaheshin të burgosur pa të drejtë.⁶⁶⁴

Qeveria shqiptare ndërkohë nuk kishte reagimin që pritej në mbrojtje të shqiptarëve që jetonin nën juridiksionin e Greqisë. Për këtë arsye, Mithat Frashëri shprehu pakënaqësinë e tij të rradhës.⁶⁶⁵ Pavarësisht mungesës së reagimit nga ana e qeverisë shqiptare, Frashëri i sugjeroi në vijim asaj gjashtë masa veçanërisht për shpëtimin e shqiptarëve të Çamërisë, të cilat ishin:

1. *"Të ndalojmë grekofonët prej votimit legjislativ"*
2. *Ti ndalojmë së bleri dhe së shituri pasuninë të pa tundurë*
3. *Të mos lihet një grekofon të dalë jashtë Shqipërisë*
4. *Të shkruhet pasuni e tundëshme e grekofonëve si bagëti, kafshë, drithë*
5. *Të shkruhen shtëpitë e tyre*
6. *Të rekizisionohen shtëpitë e tyre dhe të instalohen brënda në këto shtëpi refugjatë çamër që kanë ikur nga keqbërjet e autoriteteve lokale greke".⁶⁶⁶*

Në një takim gjatë vitit 1925 me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë, Frashëri vuri në dukje që minoriteti grek në Shqipëri gëzonte të drejta më shumë sesa minoriteti shqiptar në Greqi, pavarësisht se ata shprehën disa ankesa për mospërmblidhjen e detyrimeve nga ana e Shqipërisë ndaj minoritetit grek.⁶⁶⁷ Ai e mbylli

⁶⁶³ Naska, 1999: 490-492, dok. 258.

⁶⁶⁴ Ibidem.

⁶⁶⁵ Malltezi dhe Delvina 2012: 257-261, dok. 138.

⁶⁶⁶ Malltezi dhe Delvina 2012: 261-263, dok. 139.

⁶⁶⁷ AQSH, Fondi 251, Dosja 131/1, Viti 1925, f. 315-318. *Raport mbi Takimet me Autoritetet Greke për Trajtimin e Keq të Popullsisë Çame.* (29 Tetor 1925)

raportin duke sugjeruar masat e rradhës për zbatimin e politikave të reciprocitetit të cilat nëse do të ishin zbatuar do t'iu kishin ardhur në ndihmë elementit shqiptar, e atij çam në Greqi.⁶⁶⁸

Pas përpjekjeve të shumta, më 4 Nëntor 1925, Frashëri në informimin e rradhës që i dërgonte Ministrisë së Punëve të Jashtme u shpreh me fjalët: *"Mjerisht gjer më sot s'kemi asgjë"*.⁶⁶⁹

Më 17 Nëntor përfaqësuesi kryesor i Shqipërisë në Athinë mbajti një qëndrim të indinjuar duke deklaruar se autoritetet shqiptarë kishin punuar sikur të ishin *"armiq të kombit"* duke qënë se sugjerimet e tij për përfaqësimin e shtetit shqiptar në Selanik, Stamboll, e në Lidhjen e Kombeve nuk u morën parasysh.⁶⁷⁰ Nga përshkallëzimi i kërkesave të përfaqësuesit të Shqipërisë në Athinë, Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë i kërkoi dorëheqjen më datë 25 Nëntor 1925, duke e akuzuar atë se nuk përkrahte politikën e jashtme të Shqipërisë.⁶⁷¹ Kjo lëvizje tregonte qartazi mospërputhjen e qëndrimeve të Tiranës zyrtare me punën e palodhur të diplomatit Frashëri në Athinë.

Një dëshmi nga Janina e përkufizonte reagimin e qeverisë shqiptare për çështjen çame si *"gjumë letargjik që e kapërcen kufirin"*.⁶⁷² Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Vrioni, deklaronte se minoriteti grek në Shqipëri gëzonte të gjitha të drejtat civile, politike, dhe kulturore.⁶⁷³ Nga të dhënat e tjera në shkresën që Vrioni i dërgoi Drumontit rezulton se: *"Parlamenti shqiptar kishte dy deputetë të këtij minoriteti... Personeli i administratës në zonat*

⁶⁶⁸ Ibidem.

⁶⁶⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 133, Viti 1925, f. 13. *Sugjerohet të Merren Masa ndaj Minoritetit Grek në Shqipëri për të Detyruar Qeverinë Greke të Heqë Dorë nga Përpjekjet për Dëbimin e Çamëve*. (4 Nëntor 1925)

⁶⁷⁰ AQSH, Fondi 251, Dosja 131/2, Viti 1925, f. 232, 233. *Projekti për Dëbimin e Çamëve është Rezultat i një Pazarllëku midis Turqve dhe Grekëve*. (17 Nëntor 1925).

⁶⁷¹ AQSH, Fondi 251, Dosja 131/2, Viti 1925, f. 234. *Kërkohet Dorëheqja e Ministrit Fuqplotë të Shqipërisë në Athinë*. (25 Nëntor 1925)

⁶⁷² AQSH, Fondi 251, Dosja 40, Viti 1928, f. 20-31. *Pasqyrë e Hollësishme e Grabitjes së Pasurive në Çamëri dhe e Mohimit të të Drejtave Politike e Sociale të Çamëve*. (14 Janar 1928)

⁶⁷³ Naska 1999: 565, dok. 297.

minoritare përbëhej në pjesën dërrmuese të tij nga pjestarë të këtij minoriteti... Shkollat greke ishin 65-70 të tilla, në një kohë që çamët nuk kishin asnjë."⁶⁷⁴ Sipas Vrionit, minoriteti grek në Shqipëri kishte gëzuar gjithmonë të drejta të cilat ishin një realitet i largët për minoritetin shqiptar në shtetin grek.⁶⁷⁵

Më 15 Nëntor 1923, qeveria shqiptare kishte lëshuar një vendim për zbatimin e parimit të reciprocitetit për këtë situatë, vetëm në rast se nuk do të gjendej zgjidhja pranë Lidhjes së Kombeve⁶⁷⁶, por në seancën e datës 9 Qershor 1928, Këshilli i Lidhjes së Kombeve përkrahu qëndrimin e Greqisë e cila e konsideronte ndërhyrjen e shtetit shqiptar në mbrojtje të çamëve si një ndërhyrje në sovranitetin e saj [Greqisë]⁶⁷⁷, dhe nga ana tjetër, kjo organizatë e konsideroi çështjen çame vetëm në mënyrë sipërfaqësore pothuajse gjatë gjithë harkut kohor të veprimtarisë së saj (1920-1939).

Sulejman Delvina deklaronte se shqiptarët e Çamërisë duke qenë të detyruar për të lënë vatrat e tyre e informonin qeverinë shqiptare se ata do të vendoseshin në pronat e minoritetit grek në Shqipëri sesa të shpërnguleshin drejt Turqisë.⁶⁷⁸ Kështu, në vitin 1930, Komisioni çam i cili nuk po gjente ende zgjidhje për problemet e popullsisë shqiptare e sidomos myslimane, propozoi që disa familje çame të mund të vendoseshin në pronat e minoritetit grek në Shqipëri, pasi kjo shihej si e vetmja mënyrë që do të mund të zbuste politikën greke ndaj tyre.⁶⁷⁹ Në kujtimet e tij, Eqrem bej Vlora, shkruan në lidhje me një takim

⁶⁷⁴ Ibidem: 564-566.

⁶⁷⁵ Ibidem.

⁶⁷⁶ AQSH, Fondi 251, Dosja 203, Viti 1923, f. 404-405. Këshilli i Ministrave, Tiranë. *Vendim për Masat e Qeverisë dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme për Mospërfshirjen në Këmbim të Popullsisë Çame dhe Përpjekjet Diplommatike Pranë Lidhjes së Kombeve.* (29 Nëntor 1923).

⁶⁷⁷ Mihalopoulos 1986: 312.

⁶⁷⁸ Naska, 1999: 344, dok. 184

⁶⁷⁹ AQSH, Fondi 251, Dosja 192, Viti 1930, f. 1-2. *Njoftim se Qeveria Greke nuk kishte marrë Masa për Kthimin e Pronave të Çamëve, në vijim të Premtimeve të bëra ndaj Përfaqësuesit Çame.* (5 Shkurt 1930)

që kishte patur në vitin 1928 me një diplomat britanik. Duke i shprehur atij mundësinë se edhe Shqipëria do të mund të mbyllte shkollat greke, si një mënyrë për të zbatuar reciprocitetin dypalësh midis dy vendeve, diplomati britanik i ishte përgjigjur me fjalët: "*Ç'paturpësi! E si mund të krahasohet Shqipëria me Greqinë? Grekët kanë një kulturë 3,000 vjeçare, shqiptarët nuk kanë fare!*".⁶⁸⁰

Pala shqiptare nuk arriti të zbatonte parimin e reciprocitetit me Greqinë, pasi nuk tregoi vullnetin e duhur⁶⁸¹ për këtë e as nuk pati mbështetje nga aktorët ndërkombëtarë të kohës, dhe u detyrua t'i nënshtrohej interesave gjeopolitikë të Fuqive të Mëdha, e të vendeve fqinje. Të gjithë këta faktorë së bashku, e zbehën së tepërmi tragjedinë e kësaj popullsie në funksion të interesave politike të kohës.

6.3 Lidhja e Kombeve dhe Përballjet Shqiptaro-Greke

Përballjet shqiptaro-greke pranë Lidhjes së Kombeve qenë kryesisht në formë të shkruar, megjithatë pati dhe disa takime të drejtpërdrejta dypalëshe, në praninë e autoriteteve të Lidhjes së Kombeve, në seancat e Këshillit të kësaj organizate. Këtu mund të veçohen takimet e përfaqësuesit të Greqisë Kaklamanos, me përfaqësuesin shqiptar Blinishtin në datën 10 Dhjetor 1923, dhe takimet Politis, me përfaqësuesit shqiptarë përkatësisht Fan Nolin (29 Shtator 1924), dhe Mehdi Frashërin (5 Qershor 1928). Rëndësia e këtyre takimeve qëndron në denoncimin që përfaqësuesit shqiptarë i bënë mbarvajtjes së procesit të shkëmbimit të

⁶⁸⁰ Bej Vlora 2010: 339.

⁶⁸¹ "...Qëllimi i Guvernës tonë është të tremë grekët nga njëra anë dhe nga tjetëra të shtrëngoje Ligën e Kombeve ose Fuqitë e Mëdha që të sjellin Greqinë ndër ment..."Shih: AQSH, Fondi 251, Dosja 81, Viti 1924, f. 38, 39. *Njoftim për Parlamentin Anglez në Lidhje me Vendimin e Qeverisë Shqiptare për të Ndihmuar Shqiptarët e Greqisë*. (18 Mars 1924).; Shih Puto 2010:185, ku shkruhet "... nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se Qeveria e Nolit ka patur sadopak ndër mend të shkonte tej këtij paralajmërimi të thjeshtë dhe të kalonte në marrjen e masave konkrete..."

popullsisë i cili dëmtoi thellësisht çamët, shumica prej të cilëve pasi nuk gjeti në Turqi vëndin ideal për të jetuar, u zhvendosën drejt Shqipërisë.

Në sesionin e 27-të të Këshillit të Lidhjes së Kombeve, u kërkua që të hartoheshin regjistra të popullsisë myslimane me anë të një komisioni me një antar grek, një shqiptar, dhe një asnjëanës. Në këtë takim, përfaqësuesi shqiptar kërkoi vëmendjen e Lidhjes së Kombeve për katër çështje kryesore:

1. *"Të ngrihet një Komision Mikst në varësi të Lidhjes së Kombeve për t'u kujdesur për zbatimin e vendimit të marrë në Lozanë, lidhur me myslimanët e racës shqiptare, që duhet të përjashtohen nga këmbimi.*
2. *Të hiqen masat dhe trajtimet e zbatueshme për turqit e që gabimisht kanë qenë zbatuar ndaj shqiptarëve.*
3. *Të zhdëmtohen për dëmet që kanë pësuar në fakt shqiptarët e cënuar nga këto masa.*
4. *Të llogariten nga Komisioni Mikst që do të ngrihet, sipas vlerës së tyre reale, pasuritë që u përkasin myslimanëve të racës ose të kombësisë shqiptare dhe shuma e vlerësuar në ar t'u derdhet në dorë pronarëve."*⁶⁸²

Në këtë takim, Kaklamanos rikujtoi qëndrimet e Greqisë e cila nuk e mbështeste këtë shkëmbim, sipas tij, por u ndje e detyruar prej Turqisë për të përfunduar këtë marrëveshje. Ai deklaroi gjithashtu se dallimi midis myslimanëve turq dhe atyre shqiptarë nuk mund të bëhej; kjo kompetencë i përkiste Komisionit Mikst. Kaklamanos (10 Dhjetor 1923) deklaroi se kërkesa e palës shqiptare për ngritjen e një komisioni që do të merrej me regjistrimin e popullsisë shqiptare do të pengonte punimet e komisionit mikst. Për më tepër, përfaqësuesi grek vijoi duke shprehur habinë e tij mbi zhdëmtimin e pasurisë së kërkuar prej palës shqiptare, për aq sa këto çështje i takonin Komisionit për t'i zgjidhur.⁶⁸³ Megjithatë, siç do të

⁶⁸² Naska 1999:182, dok. 110

⁶⁸³ Ibidem: 183

vërtetohej në vijim, vonesat deri në përcaktimin e statusit të shkëmbyeshmërisë ishin të zgjatura, të cilat shpesh herë detyruan popullsinë myslimane shqiptare të shpërngulej nga trojet e veta qoftë në Turqi, ose vende të tjera. Blinishti gjatë kësaj seance insistoi në përcaktimin e personave të fesë myslimane me origjinë shqiptare, por kjo çështje nuk mori përgjigje të saktësuar, pasi u la në kompetencat e komisionit mikst për të vendosur mbi këtë. Përsëri, delegati grek deklaroi se qeveria e tij nuk do të shkëmbente shqiptarët. Këshilli ra dakord me mundësinë e qeverisë shqiptare për t'i paraqitur vërejtjet e saj komisionit mikst.⁶⁸⁴

Në lidhje me takimin e datës 10 Dhjetor 1923, në seancën e 27 të Lidhjes së Kombeve në të cilën u diskutua çështja shqiptare, delegat i qeverisë ishte Blinishti në pamundësi të dy delegatëve të tjerë të paracaktuar. Mirëpo, ai i deklaroi kryeministrit Shqiptar në një shkresë pamundësinë e tij për të përfaqësuar denjësisht çështjen e shqiptarëve myslimanë në Greqi, për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës, dhe të karakterit të ndërlikuar të saj.⁶⁸⁵ Sipas Blinishtit projekt rezoluta për këtë takim ishte paracaktuar dy ditë përpara.⁶⁸⁶ Megjithatë, në përfundim të takimit u arrit që:

- *Komisioni Mikst do të zbatonte detyrat e tij në përcaktimin e personave të origjinës shqiptare, bazuar në deklaratat e qeverisë greke e cila nuk kishte synim për të përfshirë shqiptarët.*
- *Qeveria shqiptare ishte e lirë t'i paraqiste pikëpamjen dhe vërejtjet e saj Komisionit, për cilëndo çështje që mund të vinte në rrezik shqiptarët që banonin në trojet e aneksuara nga Greqia që prej 1913.*
- *Këshilli i Lidhjes së Kombeve nuk hoqi dorë nga çështja shqiptare ashtu siç ndodhte rëndom me çështje të tjera të ngjashme.*
- *Nëse Komisioni do t'i raportonte Këshillit vështirësi të hasura në lidhje me çështjen shqiptare atëherë ky i fundit mund të ndërmerre hapa të mëtejshme për përmirësimin e gjendjes.*⁶⁸⁷

⁶⁸⁴ Ibidem:186

⁶⁸⁵ Naska 1999: 195, dok. 111; 254, dok. 114

⁶⁸⁶ Naska 1999: 195, dok. 111

⁶⁸⁷ Ibidem: 197

Në përmbyllje të raportit, Blinishti deklaroi se nëse qeveria greke do të vazhdonte me shkeljen e të drejtave themelore të popullsisë shqiptare atëherë bazuar në rezolutën e miratuar pas sesionit të 27 të Këshillit të Lidhjes së Kombeve, në mbështetjen e disa prej antarëve të Këshillit, dhe të provave të mbledhura në terren, duke sugjeruar ngritjen e një komisioni jozyrtar shqiptar, pala shqiptare do të mund ta ngrente përsëri këtë çështje pranë Lidhjes së Kombeve.⁶⁸⁸

Në Shtator të vitit 1924, Komisioni Mikst vijonte shkëmbimin e popullsisë mbi baza fetare, të vullnetit të shprehur, dhe jo të kombësisë. Për këtë arsye, Fan Noli u tregua i kujdesshëm të përmendte në fjalimin e tij rezultatet e raportit të Komisionit Mikst të datës 2 Qershor 1924, në të cilin thuhej se pjesa dërmuese e myslimanëve të Epirit deklaronte vullnetin e saj për t'u përfshirë në shkëmbim. Në këtë pikë, Noli shtroi pyetjen: *"Si është e mundur që Komisioni Mikst, pasi kishte marrë si pikënisje përjashtimin e shqiptarëve myslimanë të Greqisë nga këmbimi, arriti të përfshijë në këmbim shumicën dërmuese të shqiptarëve?"*.⁶⁸⁹ Ai e shpjegoi këtë duke iu referuar procedurës së ndjekur nga Komisioni. Megjithatë, Noli nuk la pa përmendur as qëndrimin e Kaklamanosit, i cili kishte deklaruar në seancën e nënkomisionit për minoritetet, se shqiptarët banojnë në një krahinë të përcaktuar qartë, Epir.⁶⁹⁰ Nga ana e tij, Politis vuri theksin në ndërhyrjen "e paligjshme" të Shqipërisë, pasi ajo nuk ishte një nga palët e marrëveshjes së shkëmbimit, duke u kthyer në këtë mënyrë në një faktor që po ndërhynte në punët e brendshme të Greqisë.⁶⁹¹ Ai vijoi duke theksuar në

⁶⁸⁸ Naska, 1999: 195, dok. 111

⁶⁸⁹ Naska 1999: 371-373, dok. 199

⁶⁹⁰ Ibidem: 378

⁶⁹¹ Ibidem: 373-374

korrektësinë e procedurave të ndjekura nga Komisioni Mikst, por nga ana e tij Noli i drejtoi pyetjen nëse shqiptarët ishin të lirë në deklaratimet e tyre për t'u shkëmbyer.⁶⁹²

Në takimin midis Frashërit dhe Politisit (5 qershor 1928) u trajtua një numër më i gjerë çështjesh. Mehdi Frashëri shpalosi disa fakte konkrete mbi gjendjen e shqiptarëve në Greqi, mirëpo Politis nuk u ndal në përgjigjen e tij veçanërisht për këto çështje. Si në takimin me Nolin, Politis theksoi se Shqipërisë nuk duhet t'i lejohej ndërhyrja në çështjet e brendshme të Greqisë.⁶⁹³ Frashëri, nga ana e tij, vuri në dukje faktin se qeveria shqiptare kishte dërguar disa peticione drejt autoriteteve Greke, por asnjë nismë konkrete nuk ishte ndërmarrë.⁶⁹⁴

Problematikat kryesore haseshin në gëzimin e të drejtës së pronës. Për këtë, Frashëri kujtoi detyrimet e Greqisë që prej Traktatit të Athinës, i cili sanksiononte të mbrojtjen e të drejtave të pronës që popullsia e territoreve të ceduara gëzonte që prej Perandorisë Osmane. Mirëpo, bazuar në kuadrin ligjor të mëtejshëm të Greqisë, fshatarët grekë e refugjatët mund të vendoseshin në pronat e çamëve (të shqiptarëve në tërësi) dhe të shfrytëzonin prodhimet e këtyre pronave, ku shpesh here pronarët mbeteshin pa asnjë përfitim. Sipas Frashërit (1928) shpronësimet që iu bënë myslimanëve, nuk pëfshinë asnjë lloj dëmshpërblimi për pronarët. Më tej në këtë takim, ai përmendi faktin e denoncuar disa herë prej palës shqiptare mbi favorizimin që ndarja territoriale i bënte përjashtimit nga zgjedhja e dy deputetëve çamë në parlament, siç do t'i takonte në bazë të numrit të popullsisë. Gjithashtu, ai theksoi se çamët nuk gëzonin as të drejtën e edukimit në gjuhën e tyre amtare.⁶⁹⁵

⁶⁹² Naska 1999, f. 374, dok. 199

⁶⁹³ Naska 1999, f. 583, dok. 300

⁶⁹⁴ Ibidem: 572.

⁶⁹⁵ AQSH, Fondi 251, Dosja 40, Viti 1928, f. 210-223. *Procesverbal i Diskutimit të Çështjes së Pasurive dhe të Pakicës Shqiptare në Greqi, Sesioni i 50-të i Lidhjes së Kombeve. (5 Qershor 1928)*

Pas qëndrimit të Politisit mbi çështjet në fjalë, Frashëri informoi të pranishmit mbi deklaratën e përfaqësuesit grek në Shqipëri i cili ishte shprehur se Greqia do të ndiqte interesat e saj në lidhje me cilëndo masë që do të merrej për minoritetin grek në Shqipëri; ai, gjithashtu, përkufizoi qëndrimet e përfaqësuesit grek me fjalët: *"... me gjithë që z. Politis ka rrëfye elokuencë, faktet ekzistojnë"*.⁶⁹⁶

Në të tre takimet, përfaqësuesit shqiptarë denoncuan probleme të procedurave të përcaktimit të shkëmbyeshmërisë duke nisur që prej deklaratave të autoriteteve të larta greke për të mos përfshirë shqiptarët, dhe mos/zbatimit të tyre në terren, ligjeve të reformës agrare, dhe urdhëresa të tjera për konfiskimet dhe shpronësimet në kuadër të realizimit të procesit të shkëmbimit të popullsisë ku çamët, shumica prej të cilëve ishin myslimanë, përfshiheshin drejtpërdrejtë në to; gjithashtu, çështja e dëmshpërblimit të këtyre pronarëve (të lindur në Çamëri, ose në territorin e shtetit amë, Shqipëri) vonohej deri në mosrealizim për arsye të ndryshme, pasi ata orvateshin nëpër institucione, dhe shpesh herë nuk gjenin një zgjidhje.

Pas shqyrtimit të çështjes së këtij takimi, antarët e komisionit të Lidhjes së Kombeve dolën në përfundimin se dy qeveritë duhet të negocionin drejtpërdrejtë me njëra tjetrën për sa u përkonte çështjes së pronave; për më tepër, mbrojtja e një minoriteti nuk duhet të kthehej në një çështje konflikti midis shteteve, por ai i përkonte Lidhjes së Kombeve dhe shtetit të përfshirë.⁶⁹⁷

Lidhja e Kombeve i trajtonte në mënyrë sipërfaqësore problemet e minoriteteve ashtu sikurse dhe problemin çam. Në dokumentin me numër C.292.1936.I, pas analizës së

⁶⁹⁶ Naska 1999: 586, dok. 300.

⁶⁹⁷ AQSH, Fondi 251, Dosja 40, Viti 1928, f. 223. *Raport i Zaleskit pas takimit shqiptaro-grek më 5 Qershor 1928*. (8 Qershor 1928).

dokumenteve C.528.1934.I, C.81.1935.I, C.152.1935.I dhe C.349.1935.I., shqyrtimi i përfaqësuesve neutralë të Lidhjes së Kombeve, përkatësisht Da Matta, Malkin, dhe Zaldumbide, veçoi katër çështje të cilat kishin të bënin me përdorimin e lirë të gjuhës shqipe, e cila sipas deklaratave të qeverisë greke nuk ishte ndaluar asnjëherë, ashtu sikurse dhe futja në Greqi e publikimeve shqiptare; gjithashtu, qeveria greke shprehej se i respektonte plotësisht të drejtat e ndërgjegjes së këtij populli, po ashtu dhe kërkesat e tij për edukim fetar.

Në lidhje me çështjen e shkollimit ata deklaruan se duhej një konfirmim i mëtijshëm mbi respektimin e nenit 9 të Traktatit të Minoriteteve sipas të cilit atyre duhet t'iu ofrohej shkollimi në gjuhën amtare në sistemin publik të shkollave greke.⁶⁹⁸ Përfaqësuesit neutralë ishin të bindur se çamët trajtoheshin sipas nenit 8 të Traktatit të Minoriteteve në të cilin thuhej se çdo njeri duhet të ketë të njëjtin trajtim përballë ligjit, si dhe ka të drejta të barabarta për të vendosur, administruar, dhe kontrolluar në bazë të shpenzimeve të veta shkolla dhe institucione të tjera edukimi, me të drejta për të përdorur fenë e tyre".⁶⁹⁹ Duke analizuar faktet e paraqitura, antarët e Komisionit e mbyllën çështjen pa qenë nevoja për ta dërguar për shqyrtim në Këshill.⁷⁰⁰ Ashtu sikurse dhe kjo analizë e përfaqësuesve neutralë të Lidhjes së Kombeve, dhe petitionet e mëparshme të çamëve e sidomos ato të gjysmës së dytë të viteve '20, e të gjysmës së parë të viteve '30, shpesh herë nuk dërgoheshin në Këshill pasi antarët neutralë mjaftoheshin me deklaratat dhe vrojtimet që qeveria greke paraqiste për cilindo rast.

⁶⁹⁸ Lidhja e Kombeve, C.292.1936.I.

⁶⁹⁹ Ibidem.

⁷⁰⁰ Ibidem.

Kreu VII: Konkluzione

Pas aneksimit të Çamërisë, Greqia synoi homogjenizimin e kësaj krahine. Duke qënë se asimilimi i çamëve, sidomos të atyre që i përkisnin fesë myslimane, ishte i vështirë, ajo hartoi dhe zbatoi një platformë të qartë të spastrimit etnik mbi këto troje. Këto politika konsistonin në një mohim sistematik të të drejtave themelore të kësaj popullsie, si dhe në ushtrimin e vazhdueshëm të dhunës në këtë krahinë në mënyrë që çamët të ndjeheshin të detyruar për të braktisur trojet e tyre shekullore.

Gjatë dhjetëvjeçarit të parë të periudhës së pas aneksimit të krahinës, të Drejtat Themelore të Njeriut e të Minoriteteve ishin në hapat e parë të kodifikimit të tyre, e sidomos të inkorporimit në legjislacionet kombëtare. Nga ana tjetër, konfliktet ushtarake të nivelit rajonal e botëror, e bënë të pamundur përmirësimin e tyre deri në përfundimin e Luftës së Parë Botërore. Në këtë periudhë, me krijimin e Lidhjes së Kombeve, u hodhën hapat e parë dhe konkretë për survejimin e respektimin e këtyre të drejtave. Sidoqoftë, mekanizmat e vendosur për këtë qëllim nuk ishin efikase, dhe rrjedhimisht e bënë sipërfaqësore punën e kësaj organizate. Për shkak të rendit botëror ekzistues, shteti vijonte të kishte rëndësi më të madhe sesa individi, dhe për këtë arsye respektimi i të drejtave të njeriut si dhe të minoriteteve mbetej në vullnetin e tij.

Mohimi i të Drejtave Themelore të Njeriut në Çamëri arriti kulmin e tij në vitin 1923, pasi çamët myslimanë u njohën si subjekte “pa shtetësi”, në funksion të rregullimit të procesit të shkëmbimit të popullsisë greko-turke, pasi myslimanëve iu ndalua çdo e drejtë e gëzimit të pronës private, si dhe e drejta e votës. Në këtë kohë ata nuk kishin as shkolle në të cilat mund të arsimoheshin në gjuhën e tyre amtare. Kultet fetare zaptoheshin nga ushtria greke.

Dhunë e vazhdueshme ushtrohej mbi këtë popullsi si nga ushtria e rregulltë, ashtu edhe nga bandat greke. Pra, çamët nuk gëzonin asnjë të drejtë, dhe mbi të gjitha në formë zyrtare duke nisur prej vitit 1923, pjesës myslimane iu mohuan të gjitha të drejtat që i takonin. Kjo gjendje la pasoja të konsiderueshme mbi shqiptarët e Çamërisë. Përveç zvogëlimit të ndjeshëm të popullsisë, pjesa e mbetur jetonte nën tryzni të vazhdueshmë, e cila herë shfaqej në formën e dhunës së drejtpërdrejtë, e herë më e zbutur nën formën e pengesave administrative, për sa i përkiste çështjeve pronësore. Ekonomia e popullsisë çame bazohej në tokën bujqësore, dhe pikërisht për këtë qeveria greke hartoi politika të vazhdueshme nën sfondin e reformës agrare, gjatë së cilës çamët duhet të kontribuonin për nevojat e shtetit grek, pa marrë shpesh herë dëmshpërbimin që u takonte. “Ngrirja” e të drejtave themelore të çamëve myslimanë shtrihej deri në vërtetimin e kombësisë së tyre me anë të dokumentacionit përkatës zyrtar. Në këtë sfond, qeveria greke hartoi një sërë makinacionesh në mënyrë që ta ngushtonte së tepërmi mundësinë e tyre për të deklaruar origjinën shqiptare. Një fakt i tillë, ishte në kundërshtim me Traktatin për Minoritetet të firmosur nga Greqia në 10 Gusht 1920. Në këtë traktat ajo e njihte origjinën shqiptare *ipso facto*. Por, ky dokument ndërkombëtar i firmosur nën sfondin e krijimit të Lidhjes së Kombeve, nuk qe i vetmi akt zyrtar i shkelur nga shteti grek. Për më tepër, sipas Opinionit të Gjykatës Permanente të Drejtësisë Ndërkombëtare, supozohej se Greqia e rregullonte përcaktimin e kombësisë sipas ligjit municipal. Por, ky realitet nuk ekzistonte në rastin e shqiptarëve që banonin në Greqi, deri në gjysmën e dytë të viteve ‘20, çka e vështirësonte më tej gjendjen e tyre (shqiptarëve) dhe i lejonte Greqisë hartimin e një sërë politikave siç ishte vendimi i Ministrisë së Jashtme të këtij shteti më datë 5 nëntor 1923, sipas së cilit origjina shqiptare nuk ekzistonte tek banorët e lindur në Epir, nëse babai i të interesuarve nuk kishte lindur në territorin e njohur ndërkombëtarisht të shtetit shqiptar. Nga

ana tjetër, Komisioni Mikst i cili kishte fuqi të plotë për të vendosur mbi fatin e çamëve, e zbatoi sipërfaqësisht dhe në mënyrë të paqartë platformën e tij, duke shtuar dëmin e pakthyeshem që po i bëhej kësaj popullsie.

Greqia nuk i respektoi konventat ndërkombëtare ekzistuese të cilat sanksionin të Drejtat Themelore të Njeriut e të Minoriteteve pasi vetëm në këtë mënyrë ajo mund të zbatonte politikat kombëtare të saj të cilat synonin zgjerimin dhe homogjenizimin e territorit. Për më tepër, në Traktatet e Athinës të viteve 1913 dhe 1926, si subjekte dalloheshin ndër kombësitë turke e greke, edhe *Myslimanët*. Ky përcaktim “legjitimonte” përfshirjen e *Myslimanëve* në zbatimin e të tilla marrëveshjeve. Në mendimin që mbizotëronte gjatë kësaj kohe, jo vetëm në Greqi, por edhe në fuqitë Europiane, fjala *mysliman* lidhej me kombësinë turke.

Por, më tepër sesa vetë interesat e shtetit Grek për spastrimin etnik të Çamërisë, ishte mungesa e mekanizmave të duhur për mbrojtjen e të Drejtave Themelore të Njeriut e të Minoritetit në të Drejtën Ndërkombëtare ekzistuese ajo çka ndikoi më tepër në këtë drejtim. Nëse Lidhja e Kombeve, dhe aktorët që e përfaqësonin atë, do të kishin zbatuar me rigoroziteturvejimin e të drejtave të njeriut në terren, as Greqia s’do të kishte patur mundësi të ushtronte shkelje të vazhdueshme ndaj këtyre të drejtave.

Nga gjysma e dytë e viteve ’20, nisi dërgimi i peticioneve të shumta për Çështjen Çame drejt Lidhjes së Kombeve. Mekanizmi i përdorur nga kjo organizatë konsistonte vetëm në mbledhjen dhe leximin e peticioneve, si dhe paraqitjen e ankesave tek qeveria përkatëse për shqyrtim. Në rastin konkret, sigurisht që duke mos patur asnjë hetim tjetër në terren, qeveria greke do të mbronte interesat e saj, ndërkohë që peticionet e çamëve drejtë aktorëve

ndërkombëtar por dhe drejt autoriteteve greke vijonin pa ndërprerje, çka nënkupton se gjendja e tyre me përjashtimin e pak rasteve, vijonte të ishte e rënduar.

Në vitet '30, të Drejtat Themelore të Njeriut në Çamëri, spastrimi etnik zbatohet në forma relativisht më të buta, e kryesisht në pengesa administrative. Gjendja e të Drejtave Themelore ishte thuajse e pandryshuar, por pas ardhjes në pushtet të Metaksait, në Çamëri filluan një sërë shkeljesh të këtyre të drejtave, aq sa çamëve iu ndalohej përdorimi i gjuhës shqipe në ambientet publike, pasi në të kundërt ata rriheshin nga autoritetet e xhandarmërisë greke. Kërkesa për hapjen e shkollave shqipe, edhe gjatë këtyre viteve haste vështirësi të ndryshme në sajë të veprimeve të autoriteteve greke. Në fund të viteve '30 doli në pah propaganda greke e cila synonte largimin e çamëve në formën e dëshirës së tyre për t'u larguar. Kjo politikë u arrit duke lehtësuar marrjen e kredive bankare nga elementi grek, të cilët joshnin çamët e varfëruar të mbetur në krahinë duke blerë pronat e tyre, në mënyrë që ata të mund të largoheshin drejt Shqipërisë ose Turqisë.

Shteti shqiptar ishte aktori i vetëm politik që mund të ndërhynte në mbrojtje të çështjes çame, për shkak të detyrimit moral dhe ligjor për mbrojtjen e popullsisë së tij e cila u la jashtë kufijëve zyrtarë të Shqipërisë (1913). Por, ai nuk gjeti përkrahje nga aktorët ndërkombëtarë të kohës. Zbatimi i parimit të reciprocitetit do të kishte ndryshuar gjendjen e çamëve në Greqi, por asnjë qeveri shqiptare nuk ndëmorri masa të tilla ndaj minoritetit grek në Shqipëri [në krahasim me ato që aplikoheshin ndaj çamëve]. Ky parim u përkrah bindshëm vetëm nga përfaqësuesi i Shqipërisë në Athinë, Mit'had Frashëri, e nuk gjeti mbështetjen e qeverisë së vendit, përveç disa deklaratave të përfaqësive të tjera shqiptare në Europë.

Në harkun kohor 1913-1939 u zbatuan dhe u realizuan politikat kryesore të spastrimit etnik ndaj çamëve, duke zvogëluar ndjeshëm popullsinë e krahinës, duke varfëruar banorët e

mbetur me anë të kuadrit ligjor, sidomos me anë të ligjeve të reformës agare, si dhe duke vënë në zbatim në mënyrë sistematike propagandën dhe çdo mjet që ndihmonte në largimin e çamëve nga trojet e tyre shekullore.

Rekomandime

Duke qenë se Çështja Çame është një çështje sa historike aq edhe aktuale, në përfundim të këtij studimi po japim disa rekomandime tepër modeste të cilat kanë për qëllim të nxisin sadopak angazhimin e mëtejshëm të studiuesve shqiptarë, pse jo dhe të huaj, në studime të tjera të thelluara në lidhje me këtë çështje të karakterit historik, politik, juridik dhe ekonomik, në mënyrë që të zgjerohen më tej edhe pikëpamjet e paraqitura në këtë studim.

-Njohuritë për Çamërinë dhe Çështjen Çame duhet të shtohen më tepër në tekstet shkollore të Historisë së Shqipërisë, në mënyrë që hulumtuesit e ardhshëm të mund të njihen më mirë me këtë çështje dhe të jenë të interesuar për kërkime të mëtejshme shkencore për këtë pjesë të rendësishme të Historisë së Kombit Shqiptar.

-Duke iu referuar njohjes aktuale të Çështjes Çame në nivel kombëtar e ndërkombëtar, duhet të këtë në vijim një angazhim të studiuesve shqiptarë në trajtimin e aspektit juridik të kësaj çështje që në origjinën e saj, pasi në këtë mënyrë do të krijohet një sfond më i qartë për aspektin politik e mbi të gjitha atë ekonomik që e karakterizon atë.

-Gjithashtu, duhet të këtë një shtim të përpjekjeve për mbledhjen e dokumentacionit arkivor grek (në bazë të marrëveshjeve përkatëse institucionale shqiptaro-greke), pasi në këtë mënyrë

do të zgjerohen më tej fondet arkivore për Çamërinë me qëllim që të ndriçohen më tepër shkencërisht të vërtetat rreth Çështjes Çame, të cilat kanë qenë peng i interesave politike dhe nacionaliste të shtetit grek.

-Për më tepër, shteti Shqiptar duhet të zhvillojë politika nxitëse me qëllim që të thellohen e zgjerohen më tej studimet për çështjen çame. Mundësisht të nxiten përpjekjet për bashkërendim të veprimtarive shkencore midis institucioneve shqiptare e atyre të huaja, me qëllim që argumentet historike e juridike për Çështjen Çame të zënë gjithnjë e më shumë vend sidomos në opinionin ndërkombëtar.

BIBLIOGRAFIA

Burime Parësore

Marrëveshje Ndërkombëtare

Konventa e Hagës. (II, 1899). *Ligjet e Zakonet e Luftës në Terren*. Komiteti Ndërkombëtar I Kryqit të Kuq. Marrë nga <https://ihl-databases.icrc.org/ihl/INTRO/150?OpenDocument> (parë më 3 Janar 2015)

Konventa e Hagës. (IV, 1907). *Ligjet e Zakonet e Luftës në Terren*. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq. Marrë nga <https://ihl-databases.icrc.org/ihl/INTRO/195> (parë më 3 Janar 2015)

Traktati i Paqes midis Greqisë dhe Turqisë [Teksti në anglisht]. (14 Nëntor 1913). *The American Journal of International Law*. Vëll. 8 (nr. 1). Suplementi: Dokumente Zyrtare. 46-55. Marrë nga <http://www.jstor.org/stable/2212405> (parë më 6 Maj 2016)

Traktati i Versajës. (1919). Marrë nga <http://net.lib.byu.edu/~rdh7/wwi/versailles.html> (parë më 23 Maj 2016)

Traktati i Sevrës. (1920). Marrë nga <http://www.hri.org/docs/sevres/> (parë më 23 Maj 2016)

Traktati për Mbrojtjen e Minoriteteve në Greqi. Firmosur në Sevrë. (10 Gusht 1920). Marrë nga <http://www.forost.ungarisches-institut.de/pdf/19200810-2.pdf> (parë më 23 Maj 2016)

Traktati i Athinës. (1 Dhjetor 1926). *Seria e Traktateve të Lidhjes së Kombeve*. Nr. 1565, viti 1927, 12-35.

Arkivi i Lidhjes së Kombeve

C.660.M.263.1923.II. (5 Tetor 1923). *The Greek Refugees Settlement Scheme*. [Skema për Vendosjen e Refugjatëve Grekë]

C.762.(1).1923.VII. (1923). *Mussulmans of Albanian Race in Greece*. [Myslimanët e Racës Shqiptare në Greqi]

[Myslimanë të Originës Shqiptare në Greqi]

C.160.1924.I. (22 Mars 1924). *Telegrame de la Commission Mixte du 15 Mars 1924*. [Telegram i Komisionit Mikst më 15 mars 1924]

C.641.1924.VII. (28 Tetor 1924). *Moslems of Albanian Origin in Greece*. [Myslimanë të origjinës Shqiptare në Greqi.]

C.813.1924.VII. (5 Dhjetor 1924). *Letter from the Greek Government*. [Letër nga Qeveria Greke]

C.225.1926.I. (9 Prill 1926). *Petition de Monsieur Haki Moussa Seiko et Observations du Gouvernement Hellenique et Relatives*. [Peticion nga Z. Haki Musa Sejko Vrojtmet e Qeverisë Greke dhe të tjera të lidhura me to].

C.308.M.117.1926.II. (1 Qershor 1926). *Dixieme Rapport Trimestriel sur l'Oeuvre de l'Office Autonome pour l'Etablissement des Refugies*. [Raporti i Dhjetë Tremujor i Hapjes së Zyrës Autonome për Vendosjen e Refugjatëve]

C.662.1927.I. (29 Dhjetor 1927). *Protection of Minorities in Greece*. [Mbrotjtja e Minoriteteve në Greqi]

C.81.1935.I. (30 Janar 1930). *Protection of Minorities in Greece*. [Mbrotjtja e Minoriteteve në Greqi]

C.664.1931.I. (6 Tetor 1931). *Protection of Minorities in Greece*. [Mbrotjtja e Minoriteteve në Greqi]

C.614.1930.I. (15 tetor 1930). *Protection de Minorites en Grece*. [Mbrotjtja e Minoriteteve në Greqi]

C.34.1935.I. (12 Janar 1935). *Cloture des Travaux de la Commission Mixte pour l'Echange des Populations Grecques et Turques*. [Mbyllja e Punimeve të Komisionit Mikst për Shkëmbimin e Popullsisë Greke dhe Turke]

C.349.1935.I. (11 Shtator 1935). *Petition d'un Certain Nombre de Membres de la Minorite' Albanaise en Grece et Observations du Gouvernement Hellenique*. [Peticion i një Numri të Caktuar Përfaqësuesish të Minoritetit Shqiptar në Greqi dhe Vrojtmet e Qeverisë Greke]

C.292.1936.I. (30 Qershor 1936). *Letter from the Representatives of Portugal, the United Kingdom and Ecuador Concerning Petitions Relating to the*

Postition of the Albanian Minority in Greece. [Letër nga Përfaqësuesit e Portugalisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Ekuadorit, në Lidhje me Peticionet për Pozitat e Minoritetit Shqiptar në Greqi]

Arkivi Qëndror i Shtetit: Tiranë.

Fondi i Ministrisë së Punëve të Jashtme
Fondi Qeveria e Përkohshme e Vlorës
Fondi i Parlamentit
Fondi Komiteti i Lozanës
Fondi Kristo Dako
Fondi Legata Italiane

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme: Tiranë.

Viti 1923- Dosja 361
Viti 1926- Dosja 31
Viti 1945- Dosja 59/2
Viti 1946- Dosja 134

Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme: Athinë (Marrë nga http://arxeio.mfa.gr/portal/mfa_welcome.jsp)

Fondi i Zyrës Qëndrore
Viti 1833- Dosja /36.7/
Viti 1913- Dosja /29/3/1/1/
Viti 1919- Dosja A Politiki A/5/II 11 “Peri Alvanias -Për Shqipërinë”
Viti 1923- Dosja /16/5/1/1/

Fondi i Lidhjes së Kombeve
Viti 1923
Dosja /2/1/2-3/
Dosja /2/1/3-3/
Dosja /5/4/1/
Dosja /3/4/1/1/
Dosja /8/3/1/1/
Dosja /11/3/1/1/

Parlamenti Grek (Marrë nga www.et.gr)

Kushtetuta e Greqisë (1927). Neni 119.

Fletorja Zyrtare e Greqisë. Nr. 311. (30 Tetor 1923).

Fletorja Zyrtare e Greqisë. Nr. 217. (18 Qershor 1931).

Fletorja Zyrtare e Greqisë. Nr. 735. (15 Qershor 1937).

Autoriteti Statistikor Grek- Biblioteka Dixhitale (Marrë nga <http://dlib.statistics.gr/portal/page/portal/ESYE>)

Mbretëria e Greqisë. (1913). Ministria e Ekonomisë Kombëtare- *Anarithmisis ton Katikon ton Neon Eparhion Tis Elladhos tu Etus 1913*. [Regjistrimi i Popullsisë së Territoreve të Reja të Greqisë të vitit 1913]

Mbretëria e Greqisë. (18 Tetor 1923). Ministria e Shëndetësisë- Departamenti i Statistikave. *Apografi Prosfugon*. [Regjistrimi i Refugjateve].

Mbretëria e Greqisë. (15-16 Maj 1928). Ministria e Ekonomisë Kombëtare- *Plithismos tis Elladhos*. [Popullsia e Greqisë].

Burime Arkivore të Botuara

Anchieri, E., Curato, F. (1980). *I Documenti Diplomatici Italiani*. [Dokumente Diplomatike Italiane], Seria V, Vëll. VIII. Romë, Istituto Poligrafico e Zecca Dello Stato.

Destani, B., Tomes, J. (2012). *Miku i Madh i Shqiptarëve Aubrey Herbert dhe Krijimi i Shqipërisë së Sotme. Ditare dhe Letra 1904-1923*. (Kastriot Myftiu, Përkthim). Tiranë: Via Egnatia.

Destani, B., Elsie, R. (2013). *The Cham Albanians. A Documentary History*. [Çamët Shqiptarë. Një Histori e Dokumentuar]. Londër: IB Tauris.

Duka, V. (2012). *Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe Shqiptarët*, Vëll. I. Tiranë: Toena.

Grispo, R. (1980). *I Documenti Diplomatici Italiani*. [Dokumente Diplomatike Italiane], Seria VI, Vëll. II. Romë: Istituto Poligrafico e Zecca Dello Stato.

Malltezi, L., Delvina, Sh. (2013). *Mit'dat Frashëri Ministër Fuqplotë Athinë (1923-1926) Çështja Çame*. Tiranë: Via Egnatia.

- Ministère des Affaires Étrangères (1922). *Documents Diplomatiques, Les Affaires Balcaniques 1912-1914* [Dokumente Diplomatike, Çështjet Balkanike 1912-1914], Vëll. I. Paris: Imprimerie Nationale.
- Moschati, R. (1953). *I Documenti Diplomatici Italiani*. [Dokumente Diplomatike Italiane]. Seria VII, Vëll. I. Romë: Istituto Poligrafico e Zecca Dello Stato.
- Naska, K. (1999). *Dokumente për Çamërinë 1912-1939*. Tiranë: Dituria.
- Woodward E.L., Burton, R. (1947). *Documents on British Foreign Policy 1919-1939* [Dokumente mbi Politikën e Jashtme Britanike], Seria I, Vëll. I. Londër: Her Majesty's Stationery Office.
- Woodward E.L., Burton, R. (1948). *Documents on British Foreign Policy 1919-1939* [Dokumente mbi Politikën e Jashtme Britanike], Seria I, Vëll. II. Londër: Her Majesty's Stationery Office.

Burime Dytësore

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2007). *Historia e Popullit Shqiptar III. Periudha e Pavarësisë 28 Nëntor 1912-7 Prill 1939*. Tiranë: Toena.
- Aktar, A. ([2003] 2008). Homogenizing the Nation, Turkifying the Economy: The Turkish Experience of Population Exchange Reconsidered. [Duke Homogjenizuar Kombin, Duke Turqizuar Ekonominë: Eksperienca e Shkëmbimit të Popullsisë e Rikonsideruar]. Në Rene Hirschon (red.), *Crossing the Aegean. An Appraisal of the 1923 Compulsory Population Exchange Between Greece and Turkey*. [Duke kaluar Egjeun. Një Vlerësim i Shkëmbimit të Detyrueshëm të Popullsisë midis Greqisë e Turqisë.] (79-95). Nju York: Berghan Books.
- Aravantinos, P. (1857). *Hronografia tis Ipiru* (Vëll. II). Athinë: S. K. Vllastos.
- Balbi, A., Brun, M. (1842). *System of Universal Geography* [Sistem i Gjeografisë Universale]. Londër: Stivenson & Co.
- Baltsiotis, L. (2011). The Muslim Chams of Northwestern Greece.[Çamët Myslimanë të Greqisë Veriperëndimore]. *European Journal of Turkish Studies*, 12, 1-31. Marrë nga <http://ejts.revues.org/4444> (parë më 2 Janar 2012)
- Bayir, D. (2016). *Minorities and Nationalism in Turkish Law*. [Minoritetet dhe Nacionalizmi sipas Ligjit Turk]. Nju Jork: Routledge.

- Bej Vlora, E. ([1973] 2010). *Kujtime 1885-1925*. Tiranë: IDK.
- Çabej, E. (1939). Për Gjenezën e Literaturës Shqipe (Pjesa e Dytë). Hylli i Dritës, Shkurt, Nr. 2, Viti i Botimit XV, Shkodër.
- Colonna di Cesaro', G.A. (1922). *L'Italia nella Albania Meridionale. Note e documenti (1917-1918)*. [Italia në Shqipërinë Jugore. Shënime dhe Dokumente (1917-1918)]. Foligno: F.Campitelli.
- Cora, G. (1875). *Cenni Generali Intorno ad un Viaggio nella Bassa Albania , Epiro, ed a Tripoli di Barbiera*. [Të dhëna të Përgjithshme në Lidhje me një Udhëtim në Shqipërinë e Poshtme, Epir, dhe Tripoli]. Torino: Istituto Geografico Guido Cora.
- Culaj, L. (2004). *Shqipëria dhe Problemi Kombëtar 1918-1928*. Instituti Albanologjik i Prishtinës: Prishtinë, Kosovë.
- De Azcarate, P. (1945). *League of Nations and National Minorities: An Experiment*. [Lidhja e Kombeve dhe Minoritetet Kombëtare: Një Eksperiment] (Eileen E. Brook, Përkthim). Uashington: Carnegie Endowment for International Peace.
- Dishnica, Dh. (2004). *Kristo Dako, Jeta dhe Vepra*. Tiranë: Erik.
- Divani, L. (1995). *Eladha qe Mionotites. To Sistima Dhiethnous Prostasias tis Koinonia ton Ethnon*. [Greqia dhe Minoritetet. Sistemi i Mbrojtjes Ndërkombëtare sipas Lidhjes së Kombeve]. Athinë: Nefeli.
- Drummond, E.. (24 Gusht 1925). Reply from the Secretary General to the Letter from the Mandatories of the Council of the League of Nations for the Protection of the Moslem Minority of Albanian Origin in Greece. [Përgjigje nga Sekretari i Përgjithshëm për Letrën e Mandatarëve të Këshillit të Lidhjes së Kombeve për Mbrojtjen e Minoritetit Mysliman të Origjinës Shqiptare në Greqi]. *Gazeta Zyrtare e Lidhjes së Kombeve*. Nëntor 1925, Vëll. 6, 1683.
- Duka, F. (2009). *Shekujt Osmanë në Hapësirën Shqiptare*. Tiranë: UET.
- Dushku, L. (2014). Administrimi Grek i Territoreve të Shqipërisë së Poshtme (1912-1913). Në Gurakuqi dhe Çabiri (red.) *Epiri i Jugut, Çamëria (171-186)*. Tiranë: UET.
- Frashëri, K. (2015). *Historia e Çamërisë*. Tiranë: UET.
- Frashëri, M. (7 Dhjetor 1925). Drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve. *Gazeta Zyrtare e Lidhjes së Kombeve*. Shkurt 1925. Vëll. 6, 309.

- Galanti, A. (1901). *L'Albania, Notizie Geografiche, Etnografiche e Storiche* [Shqipëria, Të dhëna Gjeografike, Etnografike dhe Historike]. Romë: Societa' Editrice Dante Alighieri.
- Garroni, M. (20 Janar 1923). Shtojcë 2. [Përkthyer nga gjuha italiane]. *Gazeta Zyrtare e Lidhjes së Kombeve*. Shkurt 1925, Vëll. 6, 238.
- Godart, J. ([1922] 2015). *Shqipëria në 1921* (Mirdash M. Shehu, Përkthim). Tiranë: Klubi i Poezisë.
- Guibernau, M., Rex, J. (2010). *The Ethnicity Reader. Nationalism, Multiculturalism & Migration*. [Lexuesi i Etnisë. Kombësia, Multikulturalizmi & Migrimi]. (Botimi i 2 të). Kembrixh, Mbretëri e Bashkuar: Polity.
- Gurakuqi, R. (2007). *Shqipëria dhe Çështja Shqiptare pas Luftës së Parë Botërore*. Shkodër: Camaj-Pipa.
- Gurakuqi, R. (2011). *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë 1913-1914*. Tiranë: UET.
- Gurakuqi, R. (2014). Historia e Ndarjes së Shqipërisë së Jugut, ose e Epirit: 1878-1914. Në Gurakuqi dhe Çabiri (red.) *Epiri i Jugut, Çamëria* (111-170). Tiranë: UET.
- Howland, Ch. (1926). Greece and Her Refugees. [Greqia dhe Refugjatët e saj]. *Foreign Affairs*. 4(4), 613-623.
- Isufi, H. (1997). Politika e Shtetit Grek për Dëbimin e Çamëve. *Studime Historike*, 1(4), 61-77.
- Isufi, H. (2002). *Musa Demi dhe Qëndresa Çame 1800-1947*. Tiranë: Botimet Dudaj.
- Isufi, H. (2006). *Çamëria Studime Historike-Sociologjike Shek. XIII-XX*. Tiranë: Pegi.
- Isufi, H. (2007). *Çamëria nëpërmjet Kronikave të Kohës 1902-1940*. Tiranë: Pegi.
- Isufi, H. (2012). *Jasin Sadiku Kapedani Çam*. Tiranë: Naimi.
- Kaklamanos, D., Venizelos, E. (1923). *Declaration Relative aux Propriétés Musulmanes en Grece, signée a Lausanne, le 24 Juillet 1923*. [Deklaratë në Lidhje me Pronat e Myslimanëve në Greqi, firmosur në Lozanë më 24 Korrik 1923]. *Seria e Traktateve*

- të Lidhjes së Kombeve*. Nr. 914, viti 1925, 153-155.
- Kola, A. P. (2008). *Arvanitët dhe Prejardhja e Grekëve* (Aldior Agora, Leonard Agora, Përkthim). Tiranë: Toena.
- Komisioni Mikst. (1925). Shtojca 8. *Gazeta Zyrtare e Lidhjes së Kombeve*. Shkurt 1926, Vëll. 7, 318.
- Kretsi, G. (2005). Pronësia në Çamëri. Vështrime rreth Konfliktëve Politike e Shoqërore midis Dy Luftërave. *Studime Historike*, 1(2), 57-71.
- Kritikos, G. (2005). Agricultural Settlement of Refugees: A Source of Productive Work and Stability in Greece, 1923-1930. [Vendosja Bujqësore e Refugjatëve: Një Burim i Punës Produktive dhe Stabilitetit në Greqi, 1923-1930]. *Agricultural History Society*. 79(3), 321-346. Marrë nga <http://www.jstor.org/stable/3745072> (Parë në 4 Maj 2016)
- Krisafi, K. (2009). *Diplomaci pas Luftë. Negociatat me Italinë dhe Gjermaninë për Dëmet e Luftës në Shqipëri*. Tiranë: Dita 2000.
- Krisafi, K. (2014). Marrëdhëniet Shqiptaro-Greke në Sfondin e Traktatit të Miqësisë dhe Hijeve të Ligjit të Luftës. Në Gurakuqi dhe Çabiri (red.) *Epiri i Jugut, Çamëria* (187-259). Tiranë: UET.
- Lambru, H.K. (1949) *I tsamidhes qe I Tsamuria* [Çamët dhe Çamëria], Athinë (nuk ka të dhëna për shtëpinë botuese).
- Leake, W.M. (1814). *Researches in Greece*. [Kërkime në Greqi]. Londër: J.Booth.
- Manda, E. ([2004] 2015). *Çamët Myslimanë të Epirit (1923-2000)*. (Instituti i Studimeve Balkanike, Selanik, Përkthim). Tiranë: Toena.
- Margaritis, J. (2009). *Bashkëpatriotë të Padëshiruar. Të dhëna mbi shkatërrimin e minoriteteve të Greqisë. Çamët- Hebrenjtë* (Maklena Nika, Përkthim). Tiranë: Bota Shqiptare.
- Mavrogordatos, G. Th. (1983). *Stillborn Republic. Social Coalitions and Party Strategies in Greece 1922-1936*. [Republika e Dështuar. Koalicione Sociale dhe Strategji Partiake në Greqi 1922-1936]. Los Angeles: University of California Press.
- Meta, B. (2007). *Tragjedia Çame*. Elbasan: Sejko.

- Meta, B. (2010). Problemi i minoriteteve shqiptare dhe greke në organizmat ndërkombëtare në vitet 1925-1929. *Studime Historike*, 1(2), 81-103.
- Mihalopulos, D. (1986). The Moslems of Chamuria and the Exchange of Populations between Greece and Turkey. [Myslimanët e Çamërisë dhe Shkëmbimi i Popullsive midis Greqisë e Turqisë]. *Balkan Studies*. 27(2), 303-313.
- Mihalopulos, D. (1993). *Tsamidhes* [Çamët] (Botimi i Dytë). Athinë: Ekdhoseis Arsenidhi
- Minga, H. (2006). *Çamëria, Vështrim Historik*. Tiranë (nuk ka të dhëna për botuesin).
- Morgenthau, H.J. (2008). *Politika ndërmjet Kombeve. Lufta për pushtet dhe paqe*. (Tonin Beci, Përkthim). Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare.
- Mourellos, Y.G. (1985). The 1914 Persecutions and the First Attempt at an Exchange of Minorities between Greece And Turkey [Persekutimet e 1914-tës dhe Përpjekja e Parë për të Shkëmbyer Minoritetet midis Greqisë dhe Turqisë]. *Balkan Studies*. 26 (2), 389-413.
- Mulaj, K. (2010). *Politics of Ethinc Cleansing. Nation-State Building and Provisions of In/Security in Twentieth-Century Balkans*. [Politikat e Spastrimit Etnik. Ndërtimi i shtetit-komb dhe Dispozitat e Pa/Sigurisë në Ballkanin e Shekullit të XX-të.] Lanham, MD: Lexington Books.
- Nazarko, M. (2007). *Lufta e Fundit. Pronat e Shqiptarëve në Greqi*. Tiranë: UET.
- Ozsu, U. (2011). *Fabricating Fidelity: Nation Building, International Law, and the Greek-Turkish Population Exchange*. [Duke Shpikur Besnikërinë: Shtet-Ndërtimi, E Drejta Ndërkombëtare, dhe Shkëmbimi i Popullsisë Greko-Turke]. Punim doktorat. Fakulteti i Ligjit në Universitetin e Torontos, Kanada.
- Pa autor. (Maj 1926). *Correspondance d'Orient*. Documents Officiels. A la Societe des Nations. Musulmans d'origine albanais en Grece. [Dokumenta Zyrtare. Shoqërisë së Kombeve. Myslimanët me origjinë Shqiptare në Greqi.] Nr. 341. Viti i 18-të i Botimit, 211.
- Pa autor. (19 Prill 1919). *Le Rappel*. En Quelques Mots. [Me disa fjalë]. Nr. 18.028. Viti i 128-të i Botimit.
- Pa autor. (6 Mars 1919). *Le Temps*. La Conference de la Paix. [Konferenca e Paqes]. Les Albanais demandent un plebiscite. [Shqiptarët kërkojnë një plebishit]. Nr. 21063. Viti i 59-të i Botimit.

- Pa autor (Shtojcë e paraqitur nga Mehdi Frashëri). Shtojca 11. *Gazeta Zyrtare e Lidhjes së Kombeve*. Shkurt 1926. Vol. 7, 319.
- Pallis, A.A. (1929). The Greek Census of 1928. [Censusi Grek 1928]. *The Geographical Journal*. 73 (6), 543-548. Marrë nga <http://www.jstor.org/stable/3745072> (Parë në 4 Maj 2016)
- Pentzopoulos, D. (2002) *The Balkan Exchange of Minorities and Its Impact on Greece*. [Shkëmbimi i Minoriteteve në Balkan dhe Ndikimi i tij në Greqi]. Londër: Hurst & Company.
- Petrota, G. (2013). Vijimësia dhe Ruajtja e Gjuhës Shqipe në Epir dhe Zhvillimi i Letërsisë në Çamëri. Në Martucci (red.) *Tokat e Çliruar Shqiptare II Çamëria*. Tiranë: Iceberg.
- Prevelakis, G. (1997). *I Balcani* [Balkani]. (Andrea De Ritis, Përkthimi në Italisht). Bolonja: Il Mulino.
- Publikimet e Gjykatës Permanente të Drejtësisë Ndërkombëtare. (21 Shkurt 1925) Përmbledhja e Opinioneve Këshillimore (*Shkëmbimi i Popullive Greko-Turke, Konventa e Lozanës VI, 30 Janar, 1923, neni 2*) Seria B, Nr. 10, f. 3.
- Puto, A. (2001). *Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare pas Luftës I Botërore* (Vëll. III). Tiranë: Albin.
- Puto, A. (2010). *Demokracia e Rrethuar. Qeveria e Fan Nolit në Marrëdhëniet e Jashtme*. Tiranë: Uegen.
- Raça, Sh. (2009). *Gjurmime në Historinë Shqiptare*. Prishtinë: Instituti Albanologjik Prishtinë.
- Rama, F. (2014). Çamëria në Vitet 1912-1940. Në Gurakuqi dhe Çabiri (red.) *Epiri i Jugut, Çamëria* (261-308). Tiranë: UET.
- Repishti, S. (2014). Hyrje në Problemin e Çamërisë. Në Gurakuqi dhe Çabiri (red.) *Epiri i Jugut, Çamëria* (31-90). Tiranë: UET.
- Sadiku, B. (2011). *Lindja e Çështjes Çame 1820-1943*. Tiranë: Naimi.
- Schevill, F. (2002). *Ballkani. Historia dhe Qytetërimi*. Tiranë: Uegen.
- Silajxhiç, H. ([1991] 1999). *Shqipëria dhe SHBA në Arkivat e Uashingtonit*. Tiranë: Dituria.

- Stavrianos, L. S. (1958) *The Balkans since 1435* [Balkani që prej vitit 1453]. Nju Jork: Rinehart & Company, Inc.
- Stickney, E. P. ([1926] 1998). *Shqipëria Jugore ose Epiri i Veriut në Çështjet Europiane Ndërkombëtare 1912-1923* (Mal Berisha, Përkthim). Tiranë: Koha.
- Shaw, M. (2003). *International Law* [E Drejta Ndërkombëtare] (Botimi i pestë). Kembrixh: Cambridge University Press.
- Tsitselikis, K. (2012). *Old and New Islam in Greece. From Historical Minorities to Immigrant Newcomers* [Islami i Ri dhe i Vjetër në Greqi. Nga Minoritetet Historike tek Emigrantët e Ardhur Rishtaz]. Leiden.Boston: Martinus Nijhoff Publishers.
- Venizelos, E. (1919). *Greece before the Peace Congress of 1919. A Memorandum Dealing with the Rights of Greece*. [Greqia përpara Kongresit të Paqes 1919. Një memorandum që ka të bëjë me të drejtat e Greqisë]. Përkthyer nga Frëngjishtja. Publikuar për Shoqërinë Amerikano-Helenike në Nju Jork: Oxford University Press [Dega Amerikane]. Marrë nga <https://archive.org/details/cu31924027901127> (parë 2 shkurt 2013)
- Xhufi, P. (2006). “Megali-Idea” dhe Pasqyrimet e saj në Marrëdhëniet Shqiptaro-Greke. *Studime Historike*, 1(2), 19-62.
- Xhufi, P., Kuçuku, B., Isufi, H., Koçi, D. (2015). *Çamëria Vështrim Etno-Kulturor*. Tiranë: Instituti i Studimeve për Çamërinë.
- Yildirim, O. (2006). *Diplomacy and Displacement. Reconsidering the Turco-Greek Exchange of Populations 1922-1934* [Diplomaci dhe Zhvendosje. Duke rikonsideruar Shkëmbimin e Popullsisë Turko-Greke 1922-1934] (Përshtatur nga Shahrough Akhavi). Nju Jork: Routledge.
- Zenelaj, E. (2013). *Historia e Diplomacisë*. Prishtinë: Vatra.